VENDIM
Nr. 348, datë 29.12.2025

MBI MIRATIMIN E UDHËZUESIT MBI OPERIMIN E SISTEMIT TË TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16, 20, germa "a", 23 pika 1, germa "b", 30, pika 2 dhe 90, pika 3, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 26 të rregullores "Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 29.12.2025, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 3143 prot., datë 24.12.2025, të përgatitur nga drejtoritë teknike, "Mbi miratimin e një udhëzuesi për operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike",

konstatoi se:

- Shoqëria OST sh.a., me shkresën nr. 2907, datë 26.5.2025, të protokolluar pranë ERE me nr. 1776, datë 28.5.2025, ka paraqitur kërkesën për miratimin e rregullores së Komisionit (BE) 2017/1485, e 2 gushtit 2017, "Për krijimin e një udhëzuesi mbi operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike".

1. Fillimi i procedurës për shqyrtimin e kërkesës së OST sh.a

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 150, datë 8.7.2025, vendosi fillimin e procedurës "Për miratimin e udhëzuesit për operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike", miratuar me rregulloren e Komisionit (BE) 2017/1485, datë 2 gusht 2017.

- "Draftudhëzuesi për operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike", i propozuar nga OST sh.a. përbën transpozim të drejtpërdrejtë të rregullores së Komisionit (BE) 2017/1485, "Për krijimin e një udhëzuesi mbi operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike", në përputhje me vendimin nr. 2022/03/MC-EnC të Këshillit Ministeror të Komunitetit të Energjisë.

2. Konsultimi publik dhe njoftimi i palëve

- ERE, me shkresën nr. 1776/2 prot., datë 14.7.2025, njoftoi palët e interesit, si më poshtë: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti i Konkurrencës, Operatori i Sistemit të Transmetimit sh.a., ALPEX sh.a., Shoqata Shqiptare e Furnizuesve të Energjisë Elektrike (AAES), Shoqata Shqiptare e Energjisë së Rinovueshme (AREA), si dhe Sekretariati i Komunitetit të Energjisë.

- Vendimi nr. 150, datë 8.7.2025, "Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së OST sh.a. për miratimin e një udhëzuesi mbi operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike", është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 141, datë 4.8.2025, si dhe është publikuar në faqen zyrtare të internetit të ERE-s, së bashku me draftudhëzuesi në gjuhët shqipe dhe angleze, në rubrikën "Konsultime". Gjatë procesit të konsultimit publik nuk janë paraqitur komente apo përgjigje nga palët e interesit.

3. Vlerësime të ERE-s

- Në përputhje me nenin 5 të rregullores 2017/2196, termat, kushtet dhe metodologjitë e hartuara nga OST-të të paraqiten për miratim brenda afateve përkatëse të përcaktuara në dispozitat specifike të "Udhëzuesit për operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike", dhe jo në një afat të vetëm të unifikuar në këtë nen. Afatet mund të zgjaten vetëm në raste përjashtuese, kur mosrespektimi i tyre vjen për shkaqe jashtë kontrollit të OST-ve, dhe shtyrja miratohet nga autoritetet rregullatore kompetente ose Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë, sipas rastit. Në rast se OST-të nuk arrijnë marrëveshje ose nuk paraqesin propozimet

brenda afateve të përcaktuara nga udhëzuesi, ato janë të detyruara të dorëzojnë draftet shoqëruar me shpjegimet përkatëse. Në këto raste, strukturat e Komunitetit të Energjisë, në bashkëpunim me autoritetet rregullatore, ndërmarrin veprimet e nevojshme për të mundësuar miratimin e termave, kushteve ose metodologjive përkatëse, brenda 4 muajve nga marrja e informacionit.

- Gjithashtu, neni 6 përcakton procedurën për miratimin e termave, kushteve dhe metodologjive të hartuara nga OST-të në zbatim të "Udhëzuesit për operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike" *(System Operation Guideline SOGL),* duke saktësuar kompetencat e autoriteteve rregullatore kombëtare, entiteteve të caktuara nga Palët Kontraktuese, Bordit Rregullator të Komunitetit të Energjisë dhe, kur është e aplikueshme, Agjencisë për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë (ACER). Propozimet duhet të përfshijnë afatin e zbatimit dhe vlerësimin e ndikimit dhe shqyrtohen në konsultim me OST-të përkatëse, me qëllim sigurimin e përputhshmërisë me objektivat e Rregullores. Opinionet e Bordit Rregullator të Komunitetit të Energjisë ose ACER-it jepen brenda 3 muajve, ndërsa vendimet për miratim merren, si rregull, brenda 6 muajve nga dorëzimi i propozimeve. Në mungesë të një marrëveshjeje ndërmjet autoriteteve rregullatore, vendimmarrja i kalon Bordit Rregullator të Komunitetit të Energjisë ose ACER-it. Neni parashikon, gjithashtu, të drejtën e ankimit, për të cilin autoriteti rregullator vendos brenda 2 muajve, me mundësi zgjatjeje në raste të arsyetuara.

- Duke marrë parasysh sfidat teknike dhe nevojën për ndërtimin e kapaciteteve për menaxhimin e emergjencave, propozohet që OST-ja të raportojë periodikisht për përgatitjen e këtyre planeve dhe të depozitojë dokumentacionin për shqyrtim pranë ERE-s brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij udhëzuesi, sikurse përcaktohet në rregullore.

- Në vijim të komenteve të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, të përcjella nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë më datë 24.7.2025, vlerësohet se këto sugjerime kanë rëndësi të veçantë për qasjen e ndjekur nga ERE në transpozimin e Kodit të Rrjetit dhe udhëzimeve të tregut, përfshirë rregulloren në fjalë. Kohëzgjatja ndërmjet marrjes së këtyre komenteve dhe përfundimit të procedurës së miratimit është diktuar nga nevoja për analizë të thelluar juridike dhe teknike të implikimeve të tyre, në veçanti lidhur me nivelin e duhur normativ për transpozimin e detyrimeve që rrjedhin për OST-të, NEMO-t dhe autoritetet rregullatore, si dhe nga domosdoshmëria e harmonizimit të këtij akti me procesin paralel të ndryshimeve në ligjin nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar. Komentet theksojnë nevojën që këto detyrime të jenë të përcaktuara qartë në nivelin përkatës ligjor, si dhe të sigurohet koordinim i plotë me dispozitat mbi Agjencinë për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë (ACER), metodologjitë e përbashkëta (TCMs), çështjet ndërkufitare dhe qendrat rajonale të koordinimit (RCC).

- Për rrjedhojë, ERE do të vijojë të ushtrojë diskrecionin e saj publik në zbatimin dhe interpretimin e këtyre detyrimeve, duke vlerësuar rast pas rasti çdo vendimmarrje që lidhet me zbatueshmërinë e drejtpërdrejtë të vendimeve të autoriteteve rregullatore kombëtare (NRAs), ACER-it dhe ECRB-së, në përputhje me legjislacionin sektorial kombëtar dhe detyrimet që rrjedhin nga kuadri i Komunitetit të Energjisë.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e "Udhëzuesit për operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike" (bashkëlidhur).

2. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë OST sh.a., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Sekretariatin e Komunitetit të Energjisë dhe palët e interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi, apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

PËR MIRATIMIN E UDHËZUESI PËR OPERIMIN E SISTEMIT TË TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

(RREGULLORE E KOMISIONIT (BE) 2017/1485, DATË 2 GUSHT 2017)

Inkorporuar dhe përshtatur me anë të Vendimit të Këshillit Ministror D/2022/03/MC-EnC më 15 Dhjetor 2022 mbi inkorporimin e Rregullores (BE) 2019/942, Rregullores (BE) 2019/943, Rregullores (BE) 2015/1222, Rregullores (BE) 2016/1719, Rregullores (BE) 2017/2195, Rregullores (BE) 2017/2196, Rregullores (BE) 2017/1485 në acquis të Komunitetit të Energjisë, mbi amendimin e Shtojcës I të Traktatit të Komunitetit të Energjisë dhe mbi ndryshimet e Vendimeve të Këshillit Ministor nr. 2021/13/MC-EnC dhe nr. 2011/02/MC-EnC.

PJESA I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Subjekti dhe fushëveprimi

Me qëllim ruajtjen e sigurisë së operimit, cilësinë e frekuencës dhe shfrytëzimin efikas të sistemit të interkonektuar dhe burimeve, kjo regullore përcakton udhëzime të hollësishme mbi:

a) kërkesat dhe parimet lidhur me sigurinë e operimit;
b) rregullat dhe përgjegjësitë për koordinimin dhe shkëmbimin e të dhënave ndërmjet OST, ndërmjet OST dhe OSSH, dhe ndërmjet OST, ose OSSH dhe SGU, në planifikimin operacional dhe në operimin në kohë reale;
c) rregullat për trajnimin dhe certifikimin e punonjësve të operatorit të sistemit;
d) kërkesat për koordinimin e ndërprerjeve;
e) kërkesat për skedulimin ndërmjet zonave të kontrollit të OST; dhe
f) rregullat për krijimin e një kuadri rajonal për kontrollin fuqi-frekuencë dhe rezervat.

Neni 2
Fushëveprimi

1. Rregullat dhe kërkesat e përcaktuara në këtë rregullore do të zbatohen për SGU e mëposhtme:
   a) modulet gjeneruese eksistuese dhe të reja që janë ose klasifikohen si të tipit B,C dhe D në përputhje me kriterin e përcaktuar në nenin 5 të Rregullores së Komisionit (EU) 2016/631[1], siç është përshtatur dhe miratuar nga Vendimi i Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë 2018/03/PHLG-EnC.
   b) objektet e kërkesës ekzistuese ose të reja, të lidhura në rrjetin e transmetimit
   c) sistemet e mbyllura të shpërndarjes, ekzistuese ose të reja, të lidhura në rrjetin e transmetimit;

[1] Commission Regulation (EU) 2016/631 of 14 April 2016 establishing a network code on requirements for grid connection of generators (OJ L 112, 27.4.2016, p. 1)

d) objektet e ngarkesës, sistemet e mbyllura të shpërndarjes dhe palë të treta, ekzistuese dhe të reja, nëse ato sigurojnë përgjigje (ndryshim) të ngarkesës direkt në OST, në përputhje me kriteret e nenit 27 të Rregullores Komisionit (EU) 2016/1388[2], siç është përshtatur dhe miratuar nga Vendimi i Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë 2018/03/PHLG-EnC.

e) ofruesit e redispeçimit të moduleve gjeneruese të energjisë apo objekteve të ngarkesës me anë të bashkimit (agregimit) dhe ofruesve të rezervës aktive të energjisë në përputhje me Titullin 8 të Pjesës IV të kësaj Rregulloreje; dhe

f) sistemet ekzistuese ose të reja të rrymës së vazhduar në tension të lartë në përputhje me kriterin në Nenin 3(1) të Rregullores së Komisionit (EU) 2016/1447[3], siç është përshtatur dhe miratuar nga Vendimi i Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë 2018/03/PHLG-EnC.

2. Kjo rregullore do të zbatohet mbi të gjitha sistemet e transmetimit, sistemet e shpërndarjes dhe interkoneksionet në Palët Kontraktuese dhe Shtetet Anëtarë si dhe qendrat e koordinimit rajonal, përveç sistemeve të transmetimit dhe sistemeve të shpërndarjes ose pjesëve të sistemeve të transmetimit dhe shpërndarjes të Palëve Kontraktuese sistemet e të cilëve nuk operojnë sinkrone me Evropën Kontinentale ('CE')<...>
3. Kur në Palët Kontraktuese ekziston më shumë së një OST, kjo Rregullore do të zbatohet për të gjithë OST-të në Palët Kontraktuese . Kur një OST nuk e ka një funksion të rëndësishëm për një ose më shumë detyrime sipas kësaj Rregulloreje, Palët Kontraktuese mund të parashikojnë, sipas regjimit rregullator kombëtar, që përgjegjësia e një OST-je për të përmbushur një, disa ose të gjitha detyrimet sipas kësaj Rregulloreje i është atribuuar një ose më shumë OST-ve specifike.
4. <...>
5. Kur kërkesat në përputhje me këtë Rregullore përcaktohen për një operator sistemi i cili nuk është një OST, Palët Kontraktuese mund caktojnë që në vend të tij, OST-ja të jetë përgjegjëse për përcaktimin e kërkesave përkatëse.

Neni 3

Përkufizimet

1. Për qëllime të kësaj rregulloreje, do të përdoren përkufizimet e përdorura në Nenin 2 të Rregullores Nr. 2019/943 të BE siç është përshtatur dhe miratuar nga Vendimi i Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë 2018/03/PHLG-EnC, Nenin 2 të Rregullores së Komisionit (BE) 2015/12224, siç është përshtatur dhe miratuar nga Vendimi i Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë 2018/03/PHLG-EnC, Nenit 2 të Rregullores së Komisionit (BE) 2016/631, siç është përshtatur dhe miratuar nga Vendimi i Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë 2018/03/PHLG-EnC, Nenin 2 të Rregullores së Komisionit (BE) 2016/1388[5], siç është përshtatur dhe miratuar

---

[4] Commission Regulation (EU) 2016/1388 of 17 August 2016 establishing a Network Code on Demand Connection (OJ L 223, 18.8.2016, p. 10).

[5] Commission Regulation (EU) 2016/1447 of 26 August 2016 establishing a network code on requirements for grid connection of high voltage direct current systems and direct current-connected power park modules (OJ L 241, 8.9.2016, p. 1).

[4] Commission Regulation (EU) 2015/1222 of 24 July 2015 establishing a guideline on capacity allocation and congestion management (OJ L 197, 25.7.2015, p. 24).

[5] Commission Regulation (EU) 2016/1388 of 17 August 2016 establishing a Network Code on Demand Connection (OJ L 223, 18.8.2016, p. 10

nga Vendimi i Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë 2018/03/PHLG-EnC, Nenin 2 të Rregullores së Komisionit të (BE) 2016/1447, siç është përshtatur dhe miratuar nga Vendimi i Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë 2018/03/PHLG-EnC, Nenin 2 të Rregullores së Komisionit (BE) 2016/1719[6], siç është përshtatur dhe miratuar nga Vendimi i Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë 2018/03/PHLG-EnC, nenin 2 të Rregullores së Komisionit (BE) nr. 543/2013[7]mbi paraqitjen dhe publikimin e të dhënave në tregjet e energjisë elektrike, siç është përshtatur dhe miratuar nga Vendimi i Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë 2018/03/PHLG-EnC, si dhe nenin 2 të Direktivës(BE) 2019/944 Keshillit dhe Parlamentit Evropian, siç është përshtatur dhe miratuar nga Vendimi i Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë 2018/03/PHLG-EnC, duhet të aplikohet.

2. Përveç tyre, do të përdoren edhe përkufizimet më poshtë :

1. **"Siguri operacionale"** nënkupton aftësinë e sistemit të transmetimit për të mbajtur gjendjen normale ose për tu rikthyer në gjendjen normale sa me shpejt të jetë e mundur dhe që karakterizohet nga limitet e sigurisë operacionale.
2. **"Kufizim"** do të thotë një situatë, në të cilën ka një nevojë për të përgatitur dhe aktivizuar veprime përmirësuese në mënyrë që të respektohen kufijtë e sigurisë operacionale;
3. **"Situata N"** do të thotë gjendjen në të cilën asnjë element i sistemit të transmetimit nuk është i padisponueshëm për shkak të një defekti të shkaktuar;
4. **Lista e kontigjencave** (Contingency) do të thotë lista e elementeve të rrjetit që duhet të simulohen në analizën e kontigjencave (ngjarjeve të paparashikuara) për të provuar pajtueshmërinë me limitet e sigurisë operacionale;
5. **"Gjendja normale"** do të thotë një situate në të cilën sistemi në situatën-N është brenda kufijve të sigurisë operacionale, edhe pas ndodhjes se një defekti nga lista e kontigjencave pasi ka marre në konsiderate efektin e veprimeve përmirësuese.
6. **"Rezervat e mbajtjes së frekuencës "** ose **"FCR"** janë rezervat e fuqisë aktive të disponueshme për të mbajtur frekuencën e sistemit pas shfaqjes së një disbalance;
7. **Rezervat e Rivendosjes së Frekuencës (FRR)** do të thotë Rezervat e Fuqisë Aktive të aktivizuara për të rivendosur Frekuencën e Sistemit në Frekuencën Nominale dhe në vlerat e skeduluara për Zonën Sinkrone të përbërë nga më shumë se një zonë balancimi fuqie LFC;
8. **"Rezervat zëvendësuese"** ose **"RR"** nënkuptojnë rezervat e fuqisë aktive në dispozicion për të rivendosur ose mbështetur nivelin e kërkuar të FRR që të përgatitet për disbalancat shtesë të sistemit, duke përfshirë rezervat në gjenerim;
9. **"siguruesi i rezervës"** nënkupton një person juridik me detyrimin ligjor ose kontraktual për të furnizuar FCR, FRR ose RR nga së paku një njësi siguruese të rezervës ose grup të sigurimi saj;
10. **"Njësia e Sigurimit të Rezervës"** do të thotë një njësi e vetme apo një grup i Moduleve të Gjenerimit të Energjisë dhe / ose Njësi të Kërkesës të lidhur në një pikë të përbashkët lidhje që përmbushin kërkesat për FCR, FRR ose RR;

---

[6] Commission Regulation (EU) 2016/1719 of 26 September 2016 establishing a guideline on forward capacity allocation (OJL 259, 27.9.2016, p. 42).

[7] Commission Regulation (EU) No 543/2013 of 14 June 2013 on submission and publication of data in electricity markets and amending Annex I to Regulation (EC) No 714/2009 of the European Parliament and of the Council (OJL 163, 15.6.2013, p. 1).

11. **“Grup i Sigurimit të Rezervës”** do të thotë një grup i Moduleve të Gjenerimit të Energjisë, Njësi të Kërkesës dhe / ose Njësi të Sigurimit të Rezervës të lidhur në më shumë së një pikë lidhje që përmbushin kërkesat për sigurim të FCR, FRR ose RR;
12. **"Zone kontrolli fuqi-frekuencë"** ose "zonë LFC" nënkupton një pjesë të një zone sinkrone ose një zone të tërë sinkrone, e përcaktuar fizikisht nga pikat e matjes në interkonektorët në zona të tjera të LFC-së, të operuara nga një ose më shumë OST që përmbushin detyrimet e kontrollit fuqi-frekuence;
13. **“Koha për Rivendosjen e Frekuencës** është koha maksimale e pritshme, pas ndodhjes së një disbalance në një zone LFC, me të vogël ose të barabarte me incidentin e referencës në të cilën frekuenca kthehet në diapazonin e rivendosjes së frekuencës për zonën sinkrone me vetëm një zone LFC dhe në rastin me më shumë se një zone LFC, kohën maksimale të pritshme pas ndodhjes se një disbalance të një zone LFC brenda së cilës kompensohet mosbalancimi;
14. **“Kriteri - (N - 1)** do të thotë rregulli, sipas të cilit elementet e mbetura në pune, brenda zonës së kontrollit të një OST-je, pas një defekti të një elementi të Sistemit të Transmetimit, duhet të jenë në gjendje të akomodojnë situatën e re operacionale pa shkelur Limitet e Sigurisë operacionale;
15. **“Situata - (N - 1)** do të thotë gjendja në sistemin e transmetimit, në të cilin ka ndodhur një defekt në një nga element e listës së kontigjencave
16. “**Rezerva e Fuqisë Aktive”** do të thotë rezervat balancuese në dispozicion për të ruajtur frekuencën;
17. “**Gjendje Alarmi** nënkupton gjendjen operacionale ku, Sistemi i Transmetimit është brenda limiteve të Sigurisë Operacionale, por është zbuluar një kontingjencë nga lista e kontigjencave, për të cilën në rast të ndodhjes, veprimet përmirësuese në dispozicion nuk janë të mjaftueshme për të mbetur në gjendjen normale të operimit;
18. **"Bllok kontrolli fuqi-frekuence"** ose "**bllok LFC**" nënkupton një pjesë të një zone sinkrone ose të një zone të tërë sinkrone, e përcaktuar fizikisht nga pikat e matjes në interkonektorët në blloqe e tjera të LFC-se, të përbërë nga një ose më shumë zona LFC, të operuara nga një ose më shumë OST që përmbushin detyrimet e kontrollit fuqi-frekuence;
19. **“Gabimi i Kontrollit të zonës”** ose “ACE” nënkupton shumën e gabimit të kontrollit të fuqisë aktive (‘ΔP’), i cili është diferenca në kohën reale ndërmjet vlerës së shkëmbyer të fuqisë të matur në kohë reale (‘P’) dhe programit të kontrollit (‘P_0’) në një zone ose bllok specific LFC dhe gabimit të kontrollit të zonës (‘$K*\Delta f$’)- i cili është product i K-faktorit dhe devijimit të frekuencës së asaj zone ose blloku specific, ku gabimi i kontrollit të zonës është i barabarte me $\Delta P+K*\Delta f$;
20. **"Program kontrolli"** nënkupton rendin e vlerave të përcaktuara për shkëmbimin e fuqisë aktive neto të një zone ose blloku LFC kundrejt interkonektoreve rrymës alternative ('AC');
21. **“Kontrolli i Tensionit”,** nënkupton veprimet manuale ose automatike të kontrollit në nyjen gjeneruese, në nyjet fundore të linjave AC ose në linjat e tensionit të lartë DC, në Transformatorë, ose mënyra të tjera të projektuara për të ruajtur nivelin e përcaktuar ose të referuar të tensionit dhe vlerën e përcaktuar të fuqisë reaktive;
22. **“Gjendja e blackout-it”** nënkupton gjendjen e sistemit ku ndërpritet pjesërisht ose totalisht operimi i sistemit të transmetimit;
23. **”Kontigjence e Brendshme”** nënkupton një kontigjence brenda zonës së kontrollit të OST-se, përfshirë interkonektorët;

24. **"Kontingjencë e jashtme"** nënkupton një kontigjencë jashtë zonës së kontrollit të OST-së së dhënë përjashtuar interkonektorët, me një faktor influence më të lartë se pragu i influencës së kontigjences;
25. **"Faktor i influencës"** nënkupton vlerën numerike të përdorur për të përcaktuar efektin më të madh të ndërprerjes së një elementi të sistemit të transmetimit që ndodhet jashtë zonës së kontrollit të OST-së duke përjashtuar interkonektorët, në terma të ndryshimit të flukseve të fuqisë aktive ose tensionit, të shkaktuar nga ajo ndërprerje në çdo element të sistemit të transmetimit. Sa më e lartë është vlera aq më i madh është efekti;
26. **"Pragu i ndikimit të kontigjences"** nënkupton një vlerë numerike kufi kundrejt të cilave kontrollohen faktorët e ndikimit dhe ndodhja e një kontingjence me vendndodhje jashtë zonës së kontrollit të OST-së me një faktor ndikimi më të lartë se pragu i ndikimit të kontigjences konsiderohet të ketë një ndikim të rëndësishëm në zonën e kontrollit të OST-së duke përfshirë interkonektorët;
27. **"Analize e kontigjencave"** nënkupton një simulim kompjuterik të kontigjencave nga lista e kontigjencave;
28. **"Koha kritike për pastrimin e defekteve"** do të thotë kohëzgjatja maksimale e defektit për të cilën sistemi i transmetimit mbetet në operim të qëndrueshëm.
29. **"Avari"** nënkupton ngjarjen që ndodh në pajisjet primare në një Sistem Transmetimi (ST) të tilla si të gjitha llojet e lidhjeve të shkurtra: një, dy, tre fazore me dhe pa kontakt me tokën, që do të thotë më tej një përcjellës i këputur, qark i hapur, ose një lidhje e paqëndrueshme që rezulton në daljen nga puna të elementit të ST;
30. **"Elementi i Sistemit të Transmetimit "** është çdo element i sistemit të transmetimit;
31. **"Shqetësim"** nënkupton një ngjarje të paplanifikuar që mund të shkaktojë devijimin e sistemit të transmetimit nga gjendja normale;
32. **"Qëndrueshmëria dinamike"** është term i përbashkët përfshirë qëndrueshmërinë këndore të rotorit, qëndrueshmërinë e tensionit dhe frekuencës;
33. **"Vlerësimi i qëndrueshmërisë dinamike"** nënkupton vlerësimin e sigurisë operacionale në terma të qëndrueshmërisë dinamike;
34. **'Qëndrueshmëria e frekuencës"** nënkupton aftësinë e sistemit të transmetimit për të mbajtur frekuencën stabel si në situatën-N ashtu dhe pasi ka kaluar një avari;
35. **"Qëndrueshmëria e tensionit"** nënkupton aftësinë e një sistemi transmetimi për të ruajtur vlera tensioni të pranueshme në të gjitha nyjet e sistemit të transmetimit si në situatën-N ashtu dhe pasi ka kaluar një avari;
36. **"Gjendja e Sistemit"** nënkupton gjendjen operacionale të Sistemit të Transmetimit në lidhje me kufijtë e sigurisë operacionale, e cila mund të jetë gjendje normale, alarmi, emergjence, gjendja e rënies së plote të sistemit, dhe gjendja e ringritjes;
37. "**Gjendja e emergjencës**" do të thotë gjendja e sistemit në të cilën janë cenuar një ose me shumë limite të sigurisë operacionale;
38. **"Gjendja e Rivendosjes"** nënkupton gjendjen e sistemit në të cilën qëllimi i të gjitha aktiviteteve në sistemin e transmetimit është rivendosja e funksionimit të sistemit në operim dhe mbajtja e sigurisë operacionale pas gjendjes së black-out-it ose gjendjes së emergjencës së sistemit;
39. **"Kontingjencë e jashtëzakonshme"** nënkupton shfaqjen e njëkohshme të rasteve të shumta të kontigjencave me një shkak të përbashkët;

40. **“Devijimi i frekuencës”** nënkupton diferencën midis frekuencës aktuale dhe asaj nominale të zonës sinkrone e cila mund të jetë negative ose pozitive;
41. **“Frekuenca e sistemit”** nënkupton frekuencën elektrike të sistemit që mund të matet në të gjitha pjesët e zonës sinkrone nën supozimin e një vlere koherente për sistemin për sekond, me dallime shumë të vogla ndërmjet vendndodhjeve të ndryshme të matjes;
42. **“Procesi i rivendosjes së frekuencës”** ose **“FRP”** nënkupton një proces që synon rikthimin e frekuencës në frekuencën nominale dhe, për zonat sinkrone që përbëhen nga më shumë së një zonë LFC, një proces që synon rivendosjen e balancës të fuqisë në vlerën e skeduluar;
43. **“Kontrolli i gabimit të rivendosjes të frekuencës”** ose **“FRCE”**, do të thotë kontrolli i gabimit për FRP i cili është i barabarte me ACE e një zone LFC ose i barabarte me devijimet e frekuencës kur zona LFC i korrespondon gjeografikisht zonës sinkrone;
44. “**Skedul”** do të thotë një grup vlerash referente që paraqesin gjenerimin, konsumin ose shkëmbimin e energjisë për një periudhe të dhënë kohe;
45. **“K-faktori i një zone LFC ose blloku LFC”** nënkupton një vlerë të shprehur në 'MW / Hz', e cila është sa me pranë të jetë e mundur praktike ose më e madhe së shuma e kontrollit automatik të gjenerimit, vete-rregullimit të ngarkesës dhe i kontributit të rezervës së mbajtjes së frekuencës në lidhje me devijimin maksimal të frekuencës në gjendje të qëndrueshme;
46. **”Gjendje lokale”** nënkupton klasifikimin e një gjendje alarmi, emergjence ose black-out kur nuk ka rrezik për zgjerimin e pasojave jashtë zonës së kontrollit duke përfshirë interkonektorët e lidhur me këtë zonë kontrolli;
47. **“Devijimi maksimal i frekuencës së gjendjes së qëndrueshme”** nënkupton maksimumin e pritshëm të devijimit të frekuencës pas shfaqjes së një disbalance të barabarte ose më të vogël së incidenti i referencës në të cilën frekuenca e sistemit është përcaktuar të stabilizohet;
48. **“Zona e observimit”** nënkupton sistemin e transmetimit të OST-së dhe pjesët përkatëse të sistemeve të shpërndarjes dhe sistemeve të transmetimit të OST-ve fqinjë, në të cilat OST zbaton monitorimin dhe modelimin në kohë-reale për të ruajtur sigurinë operacionale në zonën e saj të kontrollit, përfshirë interkonektorët;
49. **"OST-të fqinje"** nënkupton OST-të e lidhura direkt përmes të paktën një interkonektori AC ose DC;
50. **"Analiza e sigurisë operacionale"** do të thotë gjithë fushëveprimin e aktiviteteve kompjuterike, manuale dhe automatike të kryera për të vlerësuar sigurinë operacionale të sistemit të transmetimit dhe për të vlerësuar veprimet përmirësuese të nevojshme për ruajtjen e sigurisë operacionale;
51. **“Tregues të sigurisë operacionale”** nënkupton treguesit e përdorur nga OST-të për të monitoruar sigurinë operacionale në terma të gjendjeve të sistemit, si dhe defekteve dhe shqetësimeve që ndikojnë në sigurinë operacionale;
52. **“Rankimi i sigurisë operacionale”** do të thotë renditja e përdorur nga OST-të për të monitoruar sigurinë operacionale në bazë të treguesve të sigurisë operacionale;
53. **“Testet operacionale”** nënkuptojnë testet e kryera nga një OST ose OSSh për mirëmbajtjen, zhvillimin e praktikave të operimit të sistemit dhe trajnimin si dhe për të marrë informacion mbi sjelljen e sistemit të transmetimit në kushte jo-normale të sistemit dhe testet e kryera nga përdoruesit e rëndësishëm të rrjetit për qëllime të ngjashme mbi objektet e tyre;
54. **"Kontingjencë e Zakonshme"** do të thotë ndodhja e një kontigjence në një degë ose injektim të vetëm;

55. **“Kontingjencë jashtë rangut”** - nënkupton shfaqjen e njëkohshme të kontingjencave të shumta pa një shkak të përbashkët ose humbjen e moduleve gjeneruese të energjisë me një humbje totale të kapacitetit prodhues që tejkalon incidentin referues;
56. **“Shkalla e pjerrësisë”** nënkupton gradientin e ndryshimit të fuqisë aktive nga një modul gjenerues i energjisë, ngarkese konsumatore ose sistem HVDC;
57. **“Rezervë e fuqisë reaktive”** është fuqia reaktive e cila është e disponueshme, për mbajtjen e tensionit;
58. **"Incident referencë"** do të thotë devijimi maksimal pozitiv ose negativ i fuqisë aktive që ndodh në mënyrë të menjëhershme midis gjenerimit dhe kërkesës në një zonë sinkrone, e marre parasysh në dimensionimin e FCR;
59. **“Qëndrueshmëria këndore e rotorit”** nënkupton aftësinë e një makine sinkrone për të mbetur e sinkronizuar nen situatën N edhe pas një defekti në shkaktuar në te;
60. **“Plan sigurie”** nënkupton planin që përmban një vlerësim të riskut të aseteve kritike të OST-së në skenarë kryesorë cenimi fizik dhe kibernetik, me një vlerësim të ndikimeve të mundshme;
61. **“kufijtë e qëndrueshmërisë”** nënkuptojnë kufijtë e lejuar për operimin e sistemit të transmetimit në terma të respektimit të kufijve të qëndrueshmërisë së tensionit, të këndit të rotorit dhe të frekuencës;
62. **“Gjendje në shkalle të gjerë shtrirje”** nënkupton klasifikimin e një gjendje alarmi, gjendjes së emergjencës ose gjendjes rënies së sistemit kur ekziston rreziku i përhapjes në sistemet e transmetimit të interkonektuar;
63. “**Plani i Mbrojtjes së Sistemit”** nënkupton përmbledhjen e të gjitha masave teknike dhe organizative për tu ndërmarrë, për të parandaluar përhapjen apo përkeqësimin e një incidenti në Sistemin e Transmetimit, me qëllim për të shmangur zgjerimin e avarisë dhe rënien e Sistemit;
64. **“Topologji”** nënkupton të dhënat që kanë të bëjnë me lidhjen e sistemeve të ndryshme të transmetimit ose elementëve të sistemit të shpërndarjes në një nënstacion dhe përfshin konfigurimin elektrik dhe pozicionin çelësave dhe izolatorëve;
65. **“Mbingarkesat e lejuara kalimtare”** nënkupton mbingarkesat e përkohshme në elementet e sistemit të transmetimit që lejohen për një periudhë të kufizuar dhe të cilat nuk shkaktojnë dëm fizik të elementëve të sistemit të transmetimit për aq kohë sa respektohen kohëzgjatja dhe pragjet e përcaktuara;
66. **“Tie-line virtuale”** nënkupton një e dhënë shtesë e futur në kontolloreve te zonave të përfshira në LFC që kanë të njëjtin efekt si një vlerë e matur e një interkonektori fizik që lejon shkëmbimin e energjisë elektrike ndërmjet zonave përkatëse;
67. **“Sistemet fleksibel të transmetimit të rrymës alternative”** ose ' FACTS ' do të thotë pajisje për transmetimin e rrymës alternative të energjisë elektrike, që synojnë rritjen e kontrollit dhe rritjen e kapacitetit të transferimit aktiv të energjisë;
68. **“Mjaftueshmëria”** nënkupton aftësinë e furnizimit në një zonë për të plotësuar kërkesën në këtë zone;
69. **“Skedulimi i jashtëm i sintetizuar**” do të thotë pasqyra që përfaqëson bashkimin e të gjitha skedulimeve të jashtme të OST dhe të gjitha skedulimet jashtme të tregtareve komerciale midis dy zonave skedulimi apo në mes të një zone skedulimi dhe një grupi të zonave të tjera të skedulimit;
70. **“Plani i Disponueshmërisë”** do të thotë kombinimi i të gjitha statuseve të planifikuara të disponibilitetit për një aset relevant për një periudhë të dhënë kohe;

71. **"Status Disponueshmërie"** do të thotë aftësia e një moduli gjenerimi, elementi rrjeti, objekti konsumator për të ofruar një shërbim për një periudhë të caktuar kohë pavarësisht nëse është apo nuk është në operim;
72. **"Afërsisht në kohë reale"** do të thotë intervali kohor jo më shumë së 15 minuta ndërmjet mes mbylljes së fundit të portës brenda ditës dhe kohës reale;
73. **"Skedul Konsumi"** do të thotë pasqyra që përfaqëson konsumin e një objekti konsumator ose të një grupi objektesh konsumatorë;
74. **"Hapësira e të dhënave të planifikimit operativ të ENTSO-E**" nënkupton setin e pajisjeve dhe programeve të aplikimit të zhvilluara me qëllim që të lejojnë ruajtjen, shkëmbimin dhe menaxhimin e të dhënave të përdorura brenda proceseve operacionale të planifikimit ndërmjet OST-ve;
75. **"Skedulim i jashtëm tregtar komercial"** do të thotë pasqyra që përfaqëson shkëmbimin tregtar të energjisë elektrike ndërmjet pjesëmarrësve të tregut në zona të ndryshme skedulimi;
76. **"Skedulimi i jashtëm i OST-se"** do të thotë pasqyra që përfaqëson shkëmbimin e energjisë ndërmjet OST-ve në zona të ndryshme skedulimi.
77. **"Ndërprerje e detyruar"** do të thotë nxjerrja e paplanifikuar nga shërbimi i një aseti relevant për ndonjë arsye urgjente që nuk është nën kontrollin operacional të operatorit përkatës;
78. "**Skedul gjenerimi**" do të thotë pasqyra që përfaqëson prodhimin e energjisë elektrike të një moduli gjenerues energjie ose të një grupi modulesh gjenerues të energjisë;
79. **Skedulim i brendshëm tregtar komercial"** do të thotë pasqyra që përfaqëson shkëmbimin tregtar të energjisë elektrike brenda një zone skedulimi ndërmjet pjesëmarrësve të ndryshëm të tregut;
80. **"Aset relevant i brendshëm"** nënkupton një aset të rëndësishëm i cili është pjesë e zonës së kontrollit të OST-se ose një aset i rëndësishëm që ndodhet në një sistem shpërndarje, përfshirë një sistem të mbyllur shpërndarje, i cili është i lidhur direkt ose indirekt me atë zonë kontrolli të OST;
81. **"Pozicioni AC i netimit të zonës"** nënkupton agregimin e netimit të të gjitha skeduleve AC-të jashtme të një zone;
82. **"Rajoni i koordinimit të ndërprerjeve"** do të thotë një kombinim i zonave të përgjegjësisë në të cilën OST-të përcaktojnë procedurat për të monitoruar dhe kur është e nevojshme koordinojë statusin e disponueshmërise së aseteve relevante për të gjitha afatet kohore;
83. **"Objekt Relevant Kërkese"** të thotë një objekt kërkese i cili merr pjesë në procesin e koordinimit të ndërprerjeve statusi i disponueshmërise i të cilës ndikon në sigurinë operacionale ndërkufitare;
84. **"Aset relevant"** do të thotë çdo objekt relevant kërkese, modul gjenerimi të energjisë relevant, ose element relevant të rrjetit që marrin pjesë në procesin koordinues të ndërprerjeve;
85. "**Element relevant i rrjetit** nënkupton çdo komponent i rrjetit të transmetimit, përfshirë intekonektoret, ose rrjet të shpërndarjes, përfshirë një sistem të mbyllur të shpërndarjes, qofte edhe një linje të vetme, qarku të vetëm, transformatori të vetëm, transformatori fazues të vetëm, reaktori të vetëm, i cili merr pjesë në procesin koordinues të ndërprerjes duke qene se statusi i disponibilitetit të tij ndikon në sigurinë operacionale nder-kufitare;
86. **"Papajtueshmëria e Ndërprerjeve"** nënkupton gjendjen në të cilën një kombinimi i statusit të disponibilitetit të një ose më shumë elementeve relevantë të rrjetit, moduleve relevante të gjenerimit, dhe / ose objekteve relevante të kërkesës dhe vlerësimit më të mirë të parashikuar të

situatës së rrjetit të energjisë elektrike çon në shkeljen e limiteve të sigurisë operacionale duke marrë parasysh veprimet përmirësuese pa kosto në dispozicion të OST-së;

87. "**Agjenti i Planifikimit të Ndërprerjeve** " do të thotë roli i planifikimit të statusit të disponibilitetit të një moduli relevant të gjenerimit të energjisë, një objekti relevant kërkese ose elementi relevant të rrjetit;
88. **"Moduli Relevant i Gjenerimit"** do të thotë një modul gjenerimi i energjisë i cili merr pjesë në procesin koordinues të ndërprerjeve duke qene së statusi i tij i disponueshmërise ndikon në sigurinë operacionale ndërkufitare;
89. **"Qendra e Koordinimit Rajonal e Sigurisë"** (RSC) nënkupton qendrën e koordinimit rajonal të krijuar në përputhje me nenin 35 të Rregullores (BE)2019/943, siç është përshtatur dhe miratuar me anë të vendimit të Këshillit Ministror 2022/02/MC-EnC entitetin ose entitetet, të zotëruara ose të kontrolluara nga OST-të, në një ose më shumë rajone të llogaritjes së kapaciteteve që kryejnë detyra që lidhen me koordinimin rajonal të OST-se;
90. "**Agjent skedulimi"** do të thotë entiteti ose entitetet me detyrën e sigurimit të skedulit nga pjesëmarrësit e tregut për OST-ne ose për palët e treta kur aplikohet;
91. **"Zone skedulimi"** nënkupton zonën brenda të cilës zbatohen detyrimet e OST-se në lidhje me skedulimin për shkak të nevojave operacionale ose organizative;
92. **"Java në avancë"** do të thotë një javë para javës kalendarike të operimit;
93. **"Viti në avancë"** do të thotë një vit më parë vitit kalendarik të operimit.
94. **"OST e prekur"** nënkupton një OST, për të cilin nevojitet informacion për shkëmbimin e rezervave dhe / ose ndarjen e rezervave dhe / ose procesin e netimit të disbalances dhe / ose procesin e aktivizimit ndërkufitar për analizimin dhe mirëmbajtjen e sigurisë operacionale;
95. **"Kapaciteti rezervë"** do të thotë shuma e FCR, FRR ose RR që duhet të jetë e disponueshme për OST;
96. **"Shkëmbimi i Rezervave"** nënkupton mundësia që i jepet një OST për të pranuar Kapacitetin Rezerve të lidhur në një zonë tjetër LFC, Bllok LFC, ose Zone Sinkrone për të përmbushur sasinë e rezervave të detyrueshme që rezulton nga procesi i saj i dimensionimit të rezervës FCR, FRR ose RR. Këto rezerva janë ekskluzivisht për këtë OST, do të thotë së ata nuk janë marrë parasysh nga ndonjë OST tjetër për të përmbushur sasinë e rezervave të detyrueshme që rrjedhin nga proceset e tyre përkatëse të dimensionimit të rezervës;
97. **"Ndarja e Rezervave"** do të thotë një mekanizëm në të cilin më shumë së një OST merr në konsideratë për të përmbushur kërkesat e tyre përkatëse të rezervës të njëjtin Kapacitet Rezervë FCR, FRR ose RR, i cili ka rezultuar nga proceset e tyre të dimensionimit të rezervës;
98. **"Koha e lëshimit të gjëndjes së alarmit** nënkupton kohën deri kur gjëndja e alarmit bëhet aktive;
99. "**FRR automatike"** do të thotë Rezerva e **Rivendosjes** të Frekuencës, që mund të aktivizohet nga një pajisje kontrolli automatike;
100. **"Vonesa e aktivizimit të FRR automatike"** nënkupton periudhën kohore midis vendosjes së një vlere të re në pikën e punës nga rregullatori i rivendosjes së frekuencës, dhe fillimit të livrimit fizik të rezervës automatike aFRR;
101. "**Koha e plotë e aktivizimit të FRR automatike"** nënkupton periudhën kohore midis vendosjes së një vlere të re në pikën e punës nga rregullatori i rivendosjes së frekuencës, dhe aktivizimit korrespondues apo çaktivizimin automatik të FRR;

102. **"Të dhënat mesatare të FRCE"** nënkuptojnë grupin e të dhënave që përbëhet nga vlera mesatare e FRCE e regjistruar FRCE-se së menjëhershme të një zone ose blloku LFC brenda një periudhe kohe të matur;

103. **"OST-ja dhënëse e Aftësisë Kontrolluese"** do të thotë OST-ja që nxit aktivizimin e kapacitetit rezervë për të kontrolluar aftësinë e OST-se marrëse të aftësisë nen kushtet e një marrëveshje për ndarjen e rezervave.

104. **"OST marrëse e aftësisë kontrolluese"** do të thotë OST që llogarit kapacitetin rezervë që është e mundur të merret nga një OST dhënëse, siguruese e kapacitetit rezervë, nën kushtet e një marrëveshje për ndarjen e rezervave;

105. **"Procesi i aplikimit të kriterit"** nënkupton procesin për llogaritjen e parametrave të synuar të zonës sinkrone të bllokut LFC dhe Zonës LFC bazuar në të dhënat e përftuara nga procesi i mbledhjes dhe shpërndarjes së të dhënave;

106. **"Procesi i Grumbullimi i të Dhënave dhe Dorëzimit"** nënkupton procesin e mbledhjes së setit të të dhënave të nevojshme për të kryer Kriteret e Vlerësimit të Cilësisë së Frekuencës;

107. "**Procesi i aktivizimit ndërkufitar të FRR"** nënkupton një proces të dakorduar ndërmjet OST-ve pjesëmarrëse në procesin që lejon aktivizimin e FRR të lidhur në një zonë të tjetër LFC, duke korrigjuar inputin në të dy kontrollorët sekondarë, respektivisht;

108. **"Procesi i Aktivizimit Ndërkufitar të RR**" nënkupton një proces të rënë dakord ndërmjet OST-ve pjesëmarrëse në proces që lejon për aktivizimin e RR së lidhur në një zonë të ndryshme LFC duke korrigjuar hyrjen e RRP së përfshirë në përputhje me rrethanat;

109. "**Incidenti Dimensionues"** do të thotë Disbalanca e Fuqisë Aktive më e lartë e pritshme e menjëhershme brenda një Blloku LFC në të dy drejtimet, pozitive dhe negative;

110. **"Devijimi i Kohës(ores) Elektrike"** do të thotë diferenca ne kohë mes kohës(ores) sinkrone(elektrike) dhe Kohës(ores) Universale të Koordinuar (UTC);

111. **"Devijimi i Frekuencës së Aktivizimit të Plotë të FCR** do të thotë vlera e caktuar e Devijimit të Frekuencës në të cilën FCR në Zonën Sinkrone aktivizohet plotësisht;

112. **"Koha e Aktivizimit të Plotë të FCR"** nënkupton periudhën kohore ndërmjet ndodhjes së Incidentit Referencës dhe aktivizimit përkatëse të plotë të FCR;

113. **"Detyrimi FCR"** nënkupton pjesën e të gjithë FCR që është nën përgjegjësinë e një OST;

114. **"Procesi i Mbajtjes së Frekuencës (FCP)** nënkupton një proces që synon stabilizimin e Frekuencës së Sistemit duke kompensuar disbalancat me anë të rezervave të përshtatshme;

115. **"Procesi i ciftimit të frekuencës"** nënkupton një proces të dakorduar midis të gjithë OST-ve të dy zonave sinkrone që lejon lidhjen e aktivizimit të FCR-së me ane të përshtatjes së niveleve të flukseve të HVDC në mes të zonave sinkrone;

116. **"Parametrat Përcaktues të Cilësisë së Frekuencës"** nënkupton variablat kryesore të frekuencë së Sistemi që përcaktojnë parimet e Cilësisë së Frekuencës;

117. **"Parametrat Target i Cilësisë së Frekuencës"** nënkupton variablat kryesore target të Frekuencës së Sistemit për të cilat vlerësohet në Gjendje Normale sjellja e proceseve të aktivizimit të FCR, FRR dhe RR;

118. **"Kriteret e Vlerësimit të Cilësisë së Frekuencës"** nënkupton një sërë llogaritjesh që kryhen duke përdorur matje të Frekuencës së Sistemit dhe që lejojnë vlerësimin e cilësinë e Frekuencës së Sistemit kundrejt Parametrave Target të Cilësisë së Frekuencës;

119. **"Të Dhënat e Vlerësimit të Cilësisë së Frekuencës"** nënkuptojnë tërësinë e të dhënave që lejojnë llogaritjen e Kritereve të Vlerësimit të Cilësisë së Frekuencës;

120. <...>;
121. <...>;
122. <...>;
123. **"Parametrat Target të FRCE"** nënkupton variablat kryesor të synuar të Bllokut LFC në bazë të të cilëve janë përcaktuar dhe vlerësohen kriteret e dimensionimit për FRR dhe RR e Bllokut LFC. Këto parametra pasqyrojnë sjelljen Bllokut LFC në operim normal;
124. **"Fuqia e Shkëmbyer e Rivendosjes së Frekuencës"** do të thotë fuqi e cila është shkëmbyer midis zonave LFC gjate Procesit të Aktivizimi Ndërkufitare të FRR;
125. **"Pika e punës së Frekuencës"** do të thotë vlera target e Frekuencës së përdorur në FRP, e përcaktuar si shuma e Frekuencës Nominale të Sistemit dhe një vlere kompensuese të nevojshme për të reduktuar një Devijimin Elektrik të Kohës;
126. **"Kërkesat e Disponueshmërisë së FRR"** nënkupton një sërë kërkesash të përcaktuara nga OST-të e një Blloku LFC në lidhje me disponueshmërinë e FRR;
127. "**Rregullat e Dimensionimit të FRR** do të thotë specifikimet e procesit të dimensionimit të FRR të një Blloku LFC;
128. **"Procesi i Netimit të Disbalancave"** do të thotë një proces i rënë dakord ndërmjet OST-ve të dy ose më shumë zonave LFC brenda një ose më shumë së një Zone Sinkrone që lejon shmangien e aktivizimit të njëkohshëm të FRR në drejtime të kundërta duke marrë parasysh FRCE-te përkatëse, si dhe FRR e aktivizuar, dhe korrigjimin e inputit të FRP-ve të përfshira në përputhje me rrethanat;
129. **"Fuqia e Shkëmbyer e Netimit të Disbalancave"** nënkupton fuqinë e cila është shkëmbyer midis zonave LFC në kuadër të Procesit të Netimit të Disbalancave;
130. **"Detyrimi Fillestar FCR"** do të thotë sasia e FCR së alokuar një OST-je, si pjesë e FCR për zonën sinkrone;
131. **"Të Dhënat e Frekuencës së Çastit"** do të thotë një grup të dhënash të matura të frekuencës së përgjithshme të Sistemit për Zonën Sinkrone me një periudhë matjeje të barabartë ose më të shkurtër se 1 sekondë që përdoret për qëllime të vlerësimit të cilësisë së Frekuencës së Sistemit
132. **"Devijimi i Frekuencës i Çastit"** nënkupton një sërë të dhënash të matura të Devijimit të përgjithshëm të Frekuencës për zonën sinkrone, me një periudhë matjeje të barabartë ose më të shkurtër së 1 sekondë të përdorur për qëllime të vlerësimit të cilësisë së frekuencës;
133. "**Te Dhëna të FRCE të Çastit"** nënkupton një sërë të dhënash të FRCE për një Bllok LFC me një periudhë matjeje të barabartë ose më të shkurtër së 10 sekonda që përdoren për qëllime të vlerësimit të cilësisë së frekuencës së sistemit;
134. **"Diapazoni i Nivelit 1 të FRCE"** do të thotë diapazoni i parë i përdorur për qëllime të vlerësimit të cilësisë së frekuencës së sistemit në nivel Blloku LFC, brenda të cilit FRCE duhet të mbahet për një përqindje të caktuar të kohës;
135. **"Diapazoni i Nivelit 2 të FRCE"** do të thotë diapazoni i dytë i përdorur për qëllime të vlerësimit të cilësisë së frekuencës së sistemit në nivel Blloku LFC, brenda të cilit FRCE duhet të mbahet për një përqindje të caktuar të kohës;
136. **"Marrëveshja Operacionale e Bllokut LFC"** do të thotë një marrëveshje shumëpalëshe në mes të të gjithë OST të një Blloku LFC nëse Blloku LFC përbëhet nga më shumë së një të OST; në qoftë së një Bllok LFC përbëhet vetëm nga një OST kjo do të thotë një deklaratë formale e detyrimeve;

137. **"Fuqia e Shkëmbimit e Zëvendësimit"** nënkupton fuqinë e cila është shkëmbyer midis zonave LFC gjate Procesit të Aktivizimit Ndërkufitar të RR;

138. **"Disbalancat e Bllokut LFC"** nënkuptojnë shumën e FRCE, Aktivizimit FRR dhe Aktivizimit RR brenda Bllokut LFC dhe Shkëmbimit të Fuqisë të Netimit të Disbalancave, Fuqisë së Shkëmbyer të Frekuencës së Rivendosjes dhe Fuqisë së Shkëmbyer të Zëvendësimit ti këtij Blloku LFC me Blloqe të tjera LFC;

139. **"Monitori i Bllokut LFC"** do të thotë një OST përgjegjëse për mbledhjen e të dhënave për Kriteret e Vlerësimit të Cilësisë së Frekuencës dhe aplikimin e Kritereve të Vlerësimit të Cilësisë së Frekuencës për Bllokun LFC;

140. **"Struktura e Kontrolli Fuqi-Frekuencë"** nënkupton strukturën themelore që merr në konsiderate të gjitha aspektet relevante të Kontrollit Fuqi Frekuence, në veçanti në lidhje me përgjegjësitë përkatëse dhe detyrimet, si dhe llojet dhe qëllimet e Rezervave të Fuqisë Aktive;

141. **"Struktura e Procesit të Përgjegjësisë"** do të thotë struktura për të përcaktuar përgjegjësitë dhe detyrimet në lidhje me Rezervat e Fuqisë Aktive në bazë të strukturës së kontrollit të Zonës Sinkrone;

142. **"Struktura e Aktivizimit të Procesit"** do të thotë struktura për kategorizimin e proceseve në lidhje me llojet e ndryshme të Rezervave të Fuqisë Aktive në aspektin e qëllimit dhe aktivizimit;

143. **"Koha Aktivizimit të Plotë të FRR Manuale"** nënkupton periudhën kohore në mes të ndryshimit të pikës së punës dhe aktivizimit korrespondues apo çaktivizimin të FRR manuale;

144. **"Devijimi Maksimal i Frekuencës së Çastit"** do të thotë vlera absolute maksimale e pritshme e një Devijimi të Frekuencës së Çastit pas ndodhjes së një disbalance të barabartë ose më pak se Incidenti Reference, përtej së cilës janë aktivizuar masat emergjente;

145. **"Zona e Monitorimit"** nënkupton një pjesë të Zonës Sinkrone ose e tërë Zona Sinkrone, fizikisht e kufizuar nga pikat e matjes së linjave të ndërlidhura në Zona të tjera të Monitorimit, të operuara nga një ose më shumë OST që përmbushin detyrimet e një Zone Monitorimi;

146. **"Parakualifikimi"** nënkupton procesin për të verifikuar përputhshmërinë e një Njësie të Sigurimit të Rezervës ose një Grupi të Sigurimit të Rezervës FCR, FRR ose RR me kërkesat e përcaktuara nga OST sipas parimeve të parashikuara në këtë rregullore;

147. **"Periudha e ndryshimit linear"** nënkupton një periudhë kohore të përcaktuar nga një pikë fikse e fillimit dhe një interval kohor gjatë së cilit input dhe / ose output i Fuqisë Aktive do të rritet apo ulet.

148. **"OST Udhëzuese e Rezervës"** do të thotë OST përgjegjëse për udhëzimin e Njësisë së Sigurimit të Rezervës ose Grupit të Sigurimit të Rezervës për të aktivizuar FRR dhe / ose RR;

149. "**OSSH Lidhëse e Rezervës"** do të thotë OSSH-ja që është përgjegjës për Sistemin e Shpërndarjes në të cilin është lidhur një Njësi e Sigurimit të Rezervës ose një Grup i Sigurimit të Rezervës, që siguron rezerva për një OST;

150. **"OST Lidhëse e Rezervës"** do të thotë OST përgjegjës për Zonën e Monitorimit në të cilën është i lidhur një Njësi e Sigurimit të Rezervës ose një Grup i Sigurimit të Rezervës;

151. **"OST Marrëse e Rezervës"** do të thotë OST e përfshirë në një shkëmbim me një OST Lidhëse të Rezervës dhe / ose një Njësi të Sigurimit të Rezervës ose një Grupi të Sigurimit të Rezervës të lidhur me një tjetër Zone Monitorimi apo LFC;

152. **"Procesi i Zëvendësimit të Rezervës (RRP)"** është një proces për të rivendosur FRR e aktivizuar.

153. **”Kërkesat e disponueshmerise së RR”** nënkupton një grup kërkesash të përcaktuara nga OST-të e Blokut LFC në lidhje me disponueshmerin e rezervave zëvendësuese;

154. **“Rregullat e Dimensionimit të RR”** do të thotë specifikimet e procesit të dimensionimit të RR të një Blloku LFC;

155. **“Diapazoni i Frekuencave Standard”** do të thotë një interval i përcaktuar dhe simetrik rreth Frekuencës Nominale brenda të cilit supozohet të operohet Frekuenca e Sistemit të një Zone Sinkrone;

156. **“Devijimi Standard i Frekuencës”** do të thotë vlera absolute e devijimit të Frekuencës që kufizon Diapazonin e Frekuencave Standard;

157. **“Devijimi i Frekuencës së Gjendjes së Qëndrueshme”** do të thotë vlera absolute e Devijimit të Frekuencës pas shfaqjes së një disbalance, pasi Frekuenca e Sistemit është stabilizuar;

158. **“Monitorimi i Zonës Sinkron”** do të thotë një OST përgjegjëse për mbledhjen e të dhënave të Kritereve të Vlerësimit të Cilësisë së Frekuencës dhe duke aplikuar Kriteret e Vlerësimit të Cilësisë së Frekuencës për Bllokun LFC;

159. **“Procesi i Kontrollit të Kohës”** do të thotë një proces për kontrollin e kohës, ku kontrollin i kohës është një veprim i kontrollit i kryer për të kthyer Devijimin Elektrik të Kohës ndërmjet kohës sinkrone dhe kohës UTC në zero;

160. **"Shtet Anëtar"** nënkupton një territor të Bashkimit Evropian sipas përcaktimit të nenit 27 të Traktatit.

Neni 4

Objektivat dhe aspektet rregullatore

1. Kjo Rregullore synon në:

a) përcaktimin e kërkesave dhe parimeve të përbashkëta mbi sigurinë operacionale;

b) përcaktimin e parimeve të përbashkëta të planifikimit operacional të sistemit të intekonektuar

c) përcaktimin e proceseve të përbashkëta të rregullimit fuqi-frekuence dhe kontrollit të strukturave;

d) sigurimin e kushteve për mbajtjen e sigurisë operacionale në Komunitetin e Energjisë;

e) sigurimin e kushteve për mbajtjen e nivelit të cilësisë së frekuencës për të gjithë zonën sinkrone në Komunitetin e Energjisë;

f) promovimin e koordinimit të operimit të sistemit dhe të planifikimit operativ;

g) sigurimin dhe rritjen e transparencës dhe besueshmërisë së informacionit mbi operatorin e sistemit të transmetimit

h) kontribuimin në operimin eficient dhe zhvillimin e sistemit të transmetimit si dhe në sektorin e energjisë në Komunitetin e Energjisë

2. Kur zbatojnë këtë Rregullore, Palët Kontraktuese, autoritetet kompetente dhe operatoret e sistemit duhet të :

a) zbatojnë parimin e proporcionalitetit dhe mos-diskriminimit;

b) sigurojnë transparencë;

c) zbatojnë parimin e optimizimit midis eficencës së përgjithshme më të lartë dhe kostove totale me të ulëta për të gjitha palët e përfshira;
d) sigurohen që OST-të të përdorin mekanizmat me bazë tregu për aq sa është e mundur, për të siguruar qëndrueshmërinë dhe sigurinë e sistemit;
e) respektojnë përgjegjësinë e caktuar për OST-në përkatëse në mënyrë që të sigurohet siguria e sistemit, duke përfshirë çfarë kërkohet nga legjislacioni kombëtar;
f) konsultohen me OSSH-të përkatëse dhe marrin parasysh ndikimet potenciale në sistemet e tyre;
g) marrin në konsiderate standardet dhe specifikimet teknike Evropiane, të dakordësuara.

Neni 5.

Termat dhe kushtet ose metodologjitë e OST-ve

1. Kur kjo Rregullore kërkon që OST-të të hartojnë kushtet dhe metodologjitë, ato duhet t'i paraqesin për miratim në Bordin Rregullator të Komunitetit të Energjisë dhe, nëse janë të prekur Shtetet Anëtare, Agjencinë për Bashkëpunimin e Autoriteteve Rregullatore të Energjisë, autoriteteve rregullatore kompetente në përputhje me Nenin 6(3), ose entitetit të caktuar nga Pala Kontraktuese në përputhje me Nenin 6(4) dhe (5), brenda afateve përkatëse të përcaktuara në këtë Rregullore. Në raste përjashtuese, veçanërisht kur një afat nuk mund të përmbushet për shkak të rrethanave jashttë sferës së OST-ve, afatet për kushtet dhe metodologjitë mund të zgjaten nga Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë në kuadër të procedurave sipas Neni 6(2), nga të gjitha autoritetet rregullatore kompetente në kuadër të dispozitave sipas Neni 6(3), dhe nga autoriteti rregullator kompetent në kuadër të procedurave sipas Neni 6(4) dhe (5).
2. Kur propozimi për termat dhe kushtet ose metodologjitë sipas kësaj Rregulloreje duhet të hartohet dhe të dakordohet nga më shumë së një OST, OST-të pjesëmarrëse bashkëpunojnë ngushtësisht. OST-të, me ndihmën e ENTSO-E, do të informojnë rregullisht autoritetet rregullatore, Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë dhe, në rastet kur preken Shtetet Anëtare, Agjencia për Bashkëpunim të Rregullatorëve të Energjisë, për ecurinë e zhvillimit të këtyre termave dhe kushteve apo metodologjitë.
3. <...><...>
4. Kur OST-të vendosin për propozimet për termat dhe kushtet ose metodologjitë në përputhje me nenin 6(3) nuk janë në gjendje të arrijnë një marrëveshje dhe ku janë rajonet në fjalë të përbëra nga më shumë së pesë Palë Kontraktuese dhe/ose Shtete Anëtare, ato do të vendosin nga votimi i shumicës së cilësuar. Një shumicë e cilësuar për propozimet në përputhje me nenin 6(3). kërkojnë një shumicë prej:

    a) OST që përfaqësojnë të paktën 72 % të Palëve Kontraktuese dhe/ose të Shteteve Anëtare të interesuara; dhe
    b) OST që përfaqësojnë Palët Kontraktuese dhe/ose Shtetet Anëtare që përbëjnë të paktën 65 % të popullsisë së rajonit në fjalë.

5. Një pakicë bllokuese për vendimet mbi propozimet për termat dhe kushtet ose metodologjitë e listuara në nenin 6(3) do të përfshijë të paktën një numër minimal të OST-ve që përfaqësojnë

më shumë së 35 % të popullsisë të Palëve Kontraktuese pjesëmarrëse dhe/ose e Shteteve Anëtare, dhe OST-të që përfaqëson të paktën një Palë tjetër Kontraktuese dhe/ose Shtetet Anëtare të interesuara, në rast të dështimit të cilën shumica e cilësuar do të konsiderohet e arritur.

6. OST-të që vendosin mbi propozimet për termat dhe kushtet ose metodologjitë në përputhje me Nenin 6(3) në lidhje me rajonet e përbëra nga pesë Palë Kontraktuese dhe/ose Shtetet Anëtare ose më pak do të vendosin në bazë të një konsensusi
7. Për vendimet e OST-së mbi propozimet për termat dhe kushtet ose metodologjitë në përputhje me paragrafin 5, një votë do të atribuohet për Palën Kontraktuese ose për Shtetin Anëtar. Nëse ka më shumë së një OST në territorin e një Pale Kontraktuese ose Shteti Anëtar, Pala Kontraktuese ose Shteti Anëtar do të ndajnë kompetencat e votimit ndërmjet OST-ve.
8. Kur OST-të dështojnë të paraqesin një propozim<…> për termat dhe kushtet ose metodologjitë tek autoritetet rregullatore në përputhje me nenin 6(3) <…> ose subjekteve të përcaktuara nga Palët Kontraktuese në përputhje me nenin 6(4) brenda afateve të përcaktuara në këtë rregullore, ato do të ofrojnë <…> autoriteteve rregullatore kompetente, Bordit Rregullator të Komunitetit të Energjisë dhe Agjencisë për Bashkëpunim të Rregullatorëve të Energjisë, me draftet e termave dhe kushteve ose metodologjitë dhe të shpjegojnë pse një marrëveshje nuk është arritur. Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë dhe Shtetet Anëtare në rastet kur preken, Agjencia për Bashkëpunim të Rregullatorëve të Energjisë, duke vepruar në përputhje me nenin 2 të Aktit Procedural Nr. 2022/01/MC-EnC do të informojnë Sekretariatin e Komunitetit të Energjisë dhe Komisionin Evropian dhe në bashkëpunim me autoritetet rregullatore kompetente do të hetojnë arsyet e dështimit dhe informojnë Sekretariatin e Komunitetit të Energjisë dhe Komisionin Evropian gjithashtu, Sekretariati i Komunitetit të Energjisë ose në raste kur preken Shtetet Anëtarë, Komisioni Evropian do të ndërmarrë hapat e duhur për të bërë të mundur miratimin e termave dhe kushteve të kërkuara ose metodologjive <…> brenda 4 muajve nga marrja e informacionit.

Neni 6

Miratimi i termave, kushteve dhe metodologjive të OST-ve

1. Çdo autoritet rregullator ose aty ku është e aplikueshme Agjencia, sipas rastit, do të miratojë termat dhe kushtet ose metodologjitë e zhvilluara nga OST-të sipas paragrafit <…> 3. Njësia e caktuar nga Pala Kontraktuese do të miratojë termat dhe kushtet ose metodologjitë zhvilluar nga OST-të sipas paragrafit 4. Subjekti i caktuar do të jetë autoriteti rregullator përveç nëse parashikohet ndryshe nga Pala Kontraktuese. Përpara miratimit të termave dhe kushteve ose metodologjive, autoriteti rregullator ose subjekti i caktuar do të rishikojë propozimet aty ku është e nevojshme, pas konsultimit me OST-të përkatëse, për të siguruar së ato janë në përputhje me qëllimin e kësaj rregulloreje dhe të kontribuojnë në integrimin e tregut, mosdiskriminimi, konkurrencën efektive dhe funksionimin e duhur të tregut.

2. OST-të do të zbatojnë termat dhe kushtet ose metodologjitë e mëposhtme, siç janë miratuar në përputhje me Rregulloren (BE) 2017/1485:
   (a) kërkesat kryesore organizative, rolet dhe përgjegjësitë në lidhje me shkëmbimin e të dhënave për sigurinë operacionale në përputhje me nenin 40(6)

(b) metodologjinë për ndërtimin e modeleve të rrjetit të përbashkët në përputhje me nenin 67(1) dhe nenin 70

(c) metodologjinë për koordinimin e analizave të sigurisë operacionale në përputhje me nenin 75.

(d) metodologjinë për zonën sinkrone të Evropës Kontinentale për përcaktimin e minimumit të inercisë në përputhje me nenin 39(3)(b);

(e) metodologjinë, të paktën për zonë sinkrone, për vlerësimin e rëndësisë së aseteve për koordinimin e ndërprerjeve në përputhje me nenin 84.

(f) metodologjitë, kushtet dhe vlerat e përfshira në zonën sinkrone, marrëveshjet operacionale në lidhje me nenin 118 .

(i) parametrat e përcaktimit të cilësisë së frekuencës dhe parametri i synuar i cilësisë frekuencës në përputhje me Neni 127;

(ii)rregullat e dimensionimit për FCR në përputhje me Nenin 153;

(iii) vetitë shtesë të FCR në përputhje me nenin 154 (2);

(v) për zonën sinkrone të Evropës Kontinentale, periudha minimale e aktivizimit duhet të sigurohet nga ofruesit e FCR në përputhje me nenin 156(10);

(vi) për zonën sinkrone të Evropës Kontinentale, supozimet dhe metodologjinë për një analizë kosto-përfitim në përputhje me nenin 156(11);

(vii) për zonat sinkrone të ndryshme nga Evropa Kontinentale edhe nëse është e aplikueshme, kufijtë për shkëmbimin e FCR ndërmjet OST-ve në përputhje me nenin 163(2);

(ix) kufizimet në sasinë e shkëmbimit të FRR ndërmjet zonave sinkrone të përcaktuara në përputhje me nenin 176(1) dhe kufizimet në sasinë e ndarjes së FRR ndërmjet zonave sinkrone të përcaktuara në përputhje me nenin 177(1);

(x) kufizimet në sasinë e shkëmbimit të FRR ndërmjet zonave sinkrone të përcaktuara në përputhje me nenin 178(1) dhe kufizimet në sasinë e ndarjes së RR ndërmjet zonave sinkrone të përcaktuara në përputhje me nenin 179(1)

(g) Ku blloku LFC përbëhet nga zonat LFC të Shteteve Anëtare dhe Palëve Kontraktuese, metodologjitë dhe kushtet e përfshira në marrëveshjet operacionale të bllokut LFC në përputhje me Nenin 119 në lidhje me:

(i) kufizimet e rritjes së fuqisë aktive në përputhje me nenin 137(3) dhe (4);

(ii) veprimet koordinuese që synojnë të reduktojnë FRCE siç përcaktohet në nenin 152(14)

(iii) masat për të reduktuar FRCE duke kërkuar ndryshime në prodhimin ose konsumin e energjisë aktive e moduleve gjeneruese të energjisë dhe njësive të kërkesës në përputhje me Neni 152(16);

(iv) rregullat e dimensionimit të FRR në përputhje me nenin 157(1);

(h) masat zbutëse për zonën sinkrone në përputhje me nenin 138;

3. Propozimet për termat dhe kushtet e mëposhtme ose metodologjitë ose cilido ndryshim i tyre do t'i nënshtrohet miratimit nga të gjitha autoritetet rregullatore të rajonit përkatës në të cilin Pala Kontraktuese ose Shteti Anëtar mund t'i japë një opinion autoritetit rregullator përkatës:

(a) <..>

(b) dispozitat e përbashkëta për çdo rajon të llogaritjes së kapaciteteve për sigurinë operacionale rajonale në përputhje me nenin 76;

(c) <..>

(d) <..>

(e) ku blloku LFC përbëhet vetëm nga zona LFC të Palëve Kontraktuese, metodologjitë dhe kushtet e përfshira në marrëveshjet operacionale të bllokut të LFC në nenin 119, në lidhje me:

i. kufizimet e rritjes së fuqisë aktive në përputhje me nenin 137(3) dhe (4);

ii. veprimet koordinuese që synojnë të reduktojnë FRCE siç përcaktohet në nenin 152(14);

iii. masat për të reduktuar FRCE duke kërkuar ndryshime në prodhimin ose konsumin e energjisë aktive të moduleve gjeneruese të energjisë dhe njësive të kërkesës në përputhje me nenin 152 (16);

iv. rregullat e dimensionimit të FRR në përputhje me nenin 157(1);

(f) masat zbutëse <…> për bllokun LFC në përputhje me nenin 138;

(g) propozimi i përbashkët <…> për përcaktimin e blloqeve LFC në përputhje me nenin141(2).

4. Nëse nuk përcaktohet ndryshe nga Pala Kontraktuese, termat dhe kushtet e mëposhtme ose metodologjitë dhe çdo ndryshim i tyre do t'i nënshtrohet miratimit individual nga entiteti i përcaktuar në përputhje me paragrafin 1 nga Pala Kontraktuese:
   (a) <..>
   (b) fushëveprimi i shkëmbimit të të dhënave me OSSh-të dhe përdoruesit e rëndësishëm të rrjetit në përputhje me nenin 40(5);
   (c) kërkesat shtesë për grupet siguruese të FCR në përputhje me nenin 154(3);
   (d) përjashtimi i grupeve siguruese të FCR-së nga ofrimi i FCR në përputhje me nenin 154(4);
   (e) për zonën sinkrone të Evropës Kontinentale <…>, propozimi në lidhje me aktivizimin minimal në periudhë të përkohshme që duhet të sigurohet nga ofruesit e FCR-së siç propozohet nga OST në përputhje me nenin 156 (9);
   (f) Kërkesat teknike të FRR të përcaktuara nga OST në përputhje me Nenin 158(3);
   (g) refuzimi i grupeve siguruese të FRR-së nga dispozita e FRR në përputhje me nenin 159(7);
   (h) kërkesat teknike për lidhjen e njësive siguruese të RR-së dhe grupeve siguruese të RR të përcaktuara nga OST në përputhje me nenin 161(3); dhe
   (i) refuzimi i grupeve siguruese të RR-së nga dispozita e RR në përputhje me nenin 162(6)..

5. Kur kërkohet ose lejohet një operator individual i sistemit përkatës ose OST sipas kësaj Rregulloreje për të specifikuar ose rënë dakord për kërkesat që nuk i nënshtrohen paragrafit 4, Palët Kontraktuese mund kërkojnë miratimin paraprak nga autoriteti rregullator kompetent për këto kërkesa dhe ndonjë nga ndryshimet e saj.

6. Propozimi për termat dhe kushtet ose metodologjitë duhet të përfshijë një afat kohor të propozuar për zbatimin e tyre dhe një përshkrim të ndikimit të tyre të pritshëm në objektivat e kësaj Rregulloreje. Propozimet për termat dhe kushtet ose metodologjitë që i nënshtrohen miratimit nga disa ose të gjithë autoritetet rregullatore <…> do t'i dorëzohen Bordit Rregullator

të Komunitetit të Energjisë dhe në rastet kur preken Shtetet Anëtare, Agjencisw për Bashkëpunimin të Rregullatorëve të Energjisë, në të njëjtën kohë që ato dorëzohen autoriteteve rregullatore. <…>. Bazuar në kërkesën e autoriteteve rregullatore kompetente, Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë ose, në rastet kur Shtetet Anëtare preken, Agjencia për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë, duke vepruar në përputhje me nenin 2 të Aktit Procedural Nr. 2022/01/MC-EnC, do të japë një opinion brenda 3 muajve për propozimet për termat dhe kushtet ose metodologjitë.

7. Kur miratimi i termave dhe kushteve ose metodologjive në përputhje me paragrafin 3 ose amendimin në përputhje me nenin 7 kërkon një vendim nga më shumë së një organ rregullator autoriteti në përputhje me paragrafin 3, autoritetet rregullatore kompetente do të konsultohen dhe do të koordinohen dhe bashkëpunojnë me njëri-tjetrin për të arritur një marrëveshje. Ku Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë apo Agjencia për Bashkëpunim të Rregullatorëve të Energjisë nxjerr një opinion, autoritetet rregullatore kompetente do ta marrin parasysh atë opinion. Autoritet Rregullatore, ose kur Bordi Rregullator kompetent i Komunitetit Energjisë ose Agjencia për Bashkëpunimi i Rregullatorëve të Energjisë do të marrë vendime lidhur me kushtet e dorëzuara dhe kushtet ose metodologjitë në përputhje me paragrafin <…> (3), brenda 6 muajve pas datës pranimi i termave dhe kushteve ose metodologjive nga Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë ose Agjencia për Bashkëpunim të Rregullatorëve të Energjisë ose autoriteti rregullator ose, sipas rastit, nga autoriteti i fundit rregullator në fjalë. Periudha do të fillojë në atë ditë pas asaj për të cilën propozimi i është dorëzuar Bordit Rregullator të Komunitetit të Energjisë ose Agjencisë për Bashkëpunim të Rregullatorëve të Energjisë në përputhje me paragrafin 2 ose të autoriteti i fundit rregullator në fjalë në përputhje me paragrafin 3.
8. Kur autoritetet rregullatore nuk kanë mundur të arrijnë një marrëveshje brenda periudhës të cituar në paragrafin 7 ose me kërkesë të tyre të përbashkët, ose me kërkesë të Agjencisë sipas nën paragrafit të tretë të nenit 5(3) të Rregullores (BE) 2019/942, Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë ose, në rastet kur preken Shtetet Anëtare, Agjencia për Bashkëpunimin të Rregullatorëve të Energjisë, duke vepruar në përputhje me nenin 2 të Aktit Procedural Nr.2022/01/MC-EnC do të miratojë një vendim në lidhje me propozimet e paraqitura për kushtet dhe kushtet ose metodologjitë brenda 6 muajve <…>.
9. Kur miratimi i termave dhe kushteve ose metodologjive kërkon një vendim të vetëm subjekti i caktuar në përputhje me paragrafin 4, entiteti i caktuar do të marrë një vendim brenda 6 muajsh pas marrjes së termave dhe kushteve ose metodologjive. Periudha do të fillojë në ditën pas asaj në të cilën propozimi iu dorëzua subjektit të caktuar në përputhje me paragrafin 4 ose autoritetin rregullator kompetent në përputhje me paragrafin 5.
10. Çdo palë mund të ankohet kundër një operatori përkatës sistemi ose OST në lidhje me ose vendimet e operatorit të sistemit ose të obligimeve përkatëse të OST-së sipas kësaj Rregulloreje dhe mund t'i referojë ankesën autoritetit rregullator i cili, duke vepruar si autoritet për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, do të lëshojë një vendim brenda 2 muajve nga marrja e ankesës. Kjo periudhë mund të zgjatet me 2 muaj të tjerë ku kërkohet informacion shtesë nga autoriteti rregullator. Ajo periudhë e zgjatur mund të zgjatet më tej me dakortësinë e ankuesit. Vendimi i autoritetit rregullator do të jetë i detyrueshëm, përveç dhe nëse anullohet në apel.

Neni 7

Amendimet e termave dhe kushteve ose metodologjive të OST-ve

1. Kur <…> të gjitha autoritetet rregullatore kompetente së bashku kërkojnë një ndryshim në mënyrë që të miratojë termat dhe kushtet ose metodologjitë e paraqitura në përputhje me paragrafin <…> 3 të nenit 6 përkatësisht, OST-të përkatëse do të paraqesin një propozim për kushtet e ndryshuara dhe kushtet ose metodologjitë për miratim brenda 2 muajve pas kërkesës nga <…> autoritetet rregullatore. <..> Autoritetet rregullatore kompetente do të vendosin për të ndryshuar termat dhe kushtet ose metodologjitë brenda 2 muajve pas dorëzimit të tyre.
2. Kur një subjekt i caktuar kërkon një amendim në mënyrë që të miratojë termat dhe kushtet ose metodologjitë e paraqitura në përputhje me Nenin 6 (4), OST përkatës do të dorëzojë një propozim për termat dhe kushtet ose metodologjitë e amenduara për miratim brenda 2 muajve pas kërkesës nga subjekti i caktuar. Entiteti i caktuar do të vendosë për termat dhe kushtet ose metodologjitë e ndryshuara brenda 2 muajve nga paraqitja e tyre.
3. Kur autoritetet rregullatore kompetente nuk kanë mundur të arrijnë një marrëveshje për kushtet dhe kushtet ose metodologjitë sipas paragrafit <…> 3 të nenit 6 brenda afatit 2-mujor, ose me kërkesë të përbashkët të tyre, ose me kërkesë të Agjencisë sipas nën-paragrafit të tretë nenit 5(3) të Rregullores (BE) 2019/942, Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë ose, Shtetet Anëtare në rastet kur preken, Agjencia për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë, duke vepruar në përputhje me nenin 2 të Aktit Procedural Nr. 2022/01/MC-EnC do të miratojë një vendim në lidhje me termat dhe kushtet ose metodologjitë e ndryshuara brenda 6 muajve <…>. Nëse OST-të përkatëse dështojnë të paraqesin një propozim për termat dhe kushtet e ndryshuara ose metodologjitë, do të zbatohet procedura e parashikuar në nenin 5(9).
4. Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë ose Shtetet Anëtare, në rastet kur ato preken, Agjencia për Bashkëpunim të Rregullatorëve të Energjisë, autoritetet rregullatore ose të caktuara subjektet, ku ata janë përgjegjës për miratimin e termave dhe kushteve ose metodologjive në përputhje me paragrafët <…> 3 dhe 4 të nenit 6, mund të kërkojë përkatësisht propozime për amendamentet e këtyre termave dhe kushteve ose metodologjive dhe përcaktojnë një afat kohor për paraqitjen e atyre propozimeve. OST-të përgjegjëse për zhvillimin e një propozimi për termat dhe kushtet ose metodologjitë mund t'u propozojnë ndryshime autoriteteve rregullatore dhe Bordit Rregullator të Komunitetit të Energjisë ose, Shteteve Anëtare në rastet kur preken, Agjencisë për Bashkëpunimin Rregullatorëve të Energjisë. Propozimet për ndryshimin e termave dhe kushteve ose metodologjive do t'i nënshtrohen konsultimit nëse është e aplikueshme në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 11 dhe të miratuar në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenet 5 dhe 6.

Neni 8

Publikimi në internet

1. OST-të përgjegjëse për përcaktimin e termave dhe kushteve ose metodologjive në përputhje me këtë Rregullore do t'i publikojnë ato në internet pas aprovimit të Bordit Rregullator të Komunitetit të Energjisë ose nga autoritetet rregullatore kompetente ose, kur nuk kërkohet një

miratim i tillë, sipas specifikimeve të tyre, përveç kur një informacion i tillë konsiderohet konfidencial në përputhje me nenin 12.

2. Gjithashtu do të publikohen :

a) përmirësimet e mjeteve të operimit të rrjetit në përputhje me Nenin 55 (e);
b) parametrat e synuar të FRCE në përputhje me Nenin 128;
c) kufizimet e gradientit të ndryshimit të pjerresisë në nivel të zonës sinkrone në përputhje me nenin 137 (1);
d) kufizimet e gradientit të ndryshimit të bllokut të LFC në përputhje me nenin 137(3);
e) masat e marra në gjendjen e alarmit të sistemit, për shkak të mungesës së rezervave të fuqisë aktive në përputhje me nenin 152 (11); dhe
f) kërkesa për rezervë e OST për një ofrues të FCR-së, për ta bërë informacionin të disponueshëm në kohë reale në përputhje me Nenin 154 (11).

Neni 9

Mbulimi i kostove

1. Kostot e përballuara nga operatorët e sistemit që i nënshtrohen rregullimit të tarifave të rrjetit dhe që rrjedhin nga detyrimet e përcaktuara në këtë rregullore do të vlerësohen nga autoritetet rregullatore përkatëse. Kostot e vlerësuara si të arsyeshme, efikase dhe proporcionale do të mbulohen nëpërmjet tarifave të rrjetit ose mekanizmave të tjerë të përshtatshëm.
2. Nëse kërkohet nga autoritetet rregullatore përkatëse, OST-të referuar paragrafit 1, brenda tre muajve pas kërkesës nga autoritetet rregullatore, sigurojnë informacionin e nevojshëm për të lehtësuar vlerësimin e shpenzimeve të bëra.

Neni 10

Përfshirja e grupeve të interesit

Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë ose Shtetet Anëtare në rastet kur preken, Agjencia për Bashkëpunimin e Rregullatorëve të Energjisë, duke vepruar në përputhje me nenin 2 të Aktit Procedural Nr. 2022/01/MC-EnC, në bashkëpunim të ngushtë me ENTSO për Energji, do të organizojë përfshirjen e grupeve të interesit në lidhje me operimin e sigurtë të sistemit si dhe aspekte të tjera të zbatimit të kësaj Rregulloreje. Një pjesëmarrje e tillë do të përfshijë takime të rregullta me grupet e interesit për të identifikuar problemet dhe për të propozuar përmirësime në lidhje me operimin e sigurtë të sistemit.

Neni 11

Konsultimi Publik

1. OST-të përgjegjëse do të konsultohen me grupet e interesit për paraqitjen e propozimeve mbi termat dhe kushtet ose metodologjitë ose ndryshimet e tyre, në përputhje me këtë Rregullore duke përfshirë autoritetet përkatëse të secilës Palë Kontraktuese dhe Shteti Anëtar, mbi draftin e propozimeve mbi termat dhe kushtet ose metodologjitë e renditura në Nenin 6 <...> (3). Konsultimi do të zgjasë për një periudhë prej jo më pak së 1 muaj.
2. Propozimet <...> mbi termat dhe kushtet ose metodologjitë e paraqitura nga OST-të në nivel rajonal, do të publikohen dhe paraqiten për konsultim publik në nivel rajonal. Palët që paraqesin propozime në nivel dypalësh ose shumëpalësh do të kryejë të paktën një konsultim publik në Palët Kontraktuese dhe Shtetet Anëtare respektive.
3. OST-të përgjegjëse për hartimin e propozimit mbi termat dhe kushtet ose metodologjitë duhet të marrin siç duhet në konsideratë pikëpamjet e grupeve të interesit që dalin nga konsultimet para paraqitjes së tij për miratim rregullator. Në të gjitha rastet do të sigurohet, një justifikim i shëndoshë për përfshirjen ose jo të pikëpamjeve që rrjedhin nga konsultimi së bashku me paraqitjen e propozimit dhe në kohën e duhur përpara ose njëkohësisht me publikimin e propozimit për termat dhe kushtet ose metodologjitë do të publikohet.

Neni 12

Detyrimet e konfidencialitetit

1. Çdo informacion konfidencial i marrë, i shkëmbyer ose i transmetuar sipas kësaj Rregulloreje, i nënshtrohet kushteve të sekretit profesional të përcaktuara në paragrafët 2, 3 dhe 4.
2. Mbi çdo person që i nënshtrohet dispozitave të kësaj rregulloreje do të zbatohet detyrimi i sekretit profesional
3. Informacioni konfidencial i marrë nga personat ose autoritetet rregullatore të përmendura në paragrafin 2, gjatë kryerjes së detyrave të tyre, nuk mund t'i zbulohet asnjë personi ose autoriteti tjetër, përjashtuar rastet e mbuluara nga legjislacioni kombëtar, dispozitat e tjera të kësaj Rregulloreje ose legjislacioni tjetër përkatës kombëtar ose i Komunitetit të Energjisë.
4. Pa paragjykuar rastet e mbuluara nga legjislacioni kombëtar ose i Komunitetit të Energjisë, autoritetet rregullatore, organet ose personat që marrin informacion konfidencial sipas kësaj Rregulloreje, mund ta përdorin atë vetëm për qëllimet e kryerjes së detyrave të tyre sipas kësaj Rregulloreje.

Neni 13

Marrëveshjet me OST-të që nuk janë të detyruara nga kjo Rregullore

Kur një zonë sinkrone shtrihet si mbi Komunitetin e Energjisë dhe OST-të e një vendi të tretë, brenda 18 muajve pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, të gjithë OST-të e Komunitetit të Energjisë në atë zonë sinkrone do të përpiqen të lidhin një marrëveshje me OST-të e vendeve të treta të cilat nuk janë të detyruara nga kjo Rregullore, marrëveshje e cila do përcaktojë bazën e

bashkëpunimit mes tyre në lidhje me operimin e sigurt të sistemit duke bërë edhe rregullimet për pajtueshmërinë e OST-ve të vendeve të treta me detyrimet e përcaktuara në këtë Rregullore.

Neni 14

Monitorimi

1. ENTSO për Energjinë Elektrike në përputhje me Nenin 3 të Aktit Procedural Nr. 2022/01/MC-EnC do të monitorojë zbatimin e kësaj Rregulloreje në zonat e mbuluara nga ky paragraf. Në masën që monitorimi mbulon Palët Kontraktuese të vendosura jashtë zonës sinkrone të Evropës Kontinentale ose jo anëtare të ENTSO për Energjinë Elektrike, Sekretariati i Komunitetit të Energjisë mbledh të dhëna nga operatori i sistemit të transmetimit përkatës. Monitorimi nga ENTSO për Energjinë Elektrike do të mbulojë të paktën çështjet e mëposhtme:
    a) indikatorët e sigurisë operacionale në përputhje me Nenin 15:
    b) kontrollin fuqi-frekuence në përputhje me Nenin 16;
    c) vlerësimin e koordinimit rajonal në përputhje me Nenin 17;
    d) identifikimin e çdo shmangie në zbatimin kombëtar të kësaj Rregulloreje për termat dhe kushtet ose metodologjitë e listuara në Nenin 6(3);
    e) identifikimin e çdo përmirësimi shtesë të mjeteve dhe shërbimeve në përputhje me nën-paragrafët (a) dhe (b) të Nenit 55, përveç përmirësimeve të identifikuara nga OST-të në përputhje me Nenin 55 (e);
    f) identifikimin e çdo përmirësimi të nevojshëm në raportin vjetor mbi shkallën e klasifikimit të incidenteve në përputhje me Nenin 15, të cilat janë të nevojshme me qëllim mbështetjen e qëndrueshmërisë dhe sigurisë operacionale në terma afatgjatë;
    g) identifikimin e çdo vështirësie lidhur me bashkëpunimin në operimin e sigurtë të sistemit me OST-të e vendeve të treta.

2. Agjencia për Bashkëpunim e Rregullatorëve të Energjisë mund të zgjerojë listën e atyre përkatëse informacion në lidhje me Palët Kontraktuese për t'u komunikuar nga ENTSO për Energjisë Elektrike në Agjencinë për Bashkëpunim të Rregullatorëve të Energjisë në pajtim me nenin 32 të Rregullores (BE) 2019/943, e përshtatur dhe miratuar me Vendimin e Këshillit Ministror 2022/03/MC-EnC. Lista e informacionit përkatës mund të jetë subjekt i përditësimeve. ENTSO për Energjinë Elektrike duhet të mbajë një arkiv të dhënash digjitale të formatit gjithëpërfshirës, të standardizuar informacionin e kërkuar nga Agjencia për Bashkëpunim të Rregullatorëve të Energjisë.
3. OST-të respektive do të paraqesin në ENTSO-E informacionin e kërkuar për të kryer detyrat e përmendura sipas paragrafit 1 <..>.
4. Bazuar në kërkesën e autoritetit rregullator, OSSH-të do t'i sigurojnë OST-ve informacionin sipas këtij Neni, përveç nëse informacioni është tashmë i disponueshëm për autoritetet rregullatore, OST-të ose ENTSO-E lidhur me detyrën monitoruese mbi zbatimin, me objektiv shmangien e dublikimit të informacionit.

Neni 15

Raporti vjetor mbi indikatorët e sigurisë operacionale

1. <…> ENTSO për Energjinë Elektrike, duke vepruar në përputhje me nenin 3 të Aktit Procedural Nr 2022/01/MC-EnC, do të zgjerojë raportin vjetor të hartuar në përputhje me nenin 15(1) të Rregullores 2017/1485 për përfshirjen e Palëve Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë. Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë mund të japë opinionin e tij për formatin dhe përmbajtjen e atij vjetor raporti, duke përfshirë shtrirjen gjeografike të incidenteve të raportuara, ndërvarësitë elektrike ndërmjet zonave të kontrollit të OST-ve dhe çdo informacionin historik përkatës.
2. OST-të e çdo **Pale Kontraktuese**, deri me 1 Mars do t'i sigurojnë ENTSO-E, të dhënat dhe informacionin e nevojshëm për përgatitjen e raporteve vjetore bazuar në shkallën e klasifikimit të incidentit sipas paragrafit 1.Të dhënat e siguruara nga OST-të mbulojnë vitin paraprak.
3. Raporti vjetor referuar paragrafit 1, do të përmbajë së paku indikatorët e sigurisë operacionale të mëposhtëm, të rëndësishëm për sigurinë operacionale;
   a) numri i shkyçjeve / vit të elementëve të sistemit për OST;
   b) numri i shkyçjeve / vit, të objekteve gjeneruese për OST;
   c) energjinë e pafurnizuar / vit, për shkak të shkyçjeve të paplanifikuara të objekteve konsumatorë për OST;
   d) kohëzgjatjen dhe numrin e rasteve i të qenit në gjendje alarmi dhe emergjence për OST;
   e) kohëzgjatja dhe numri i incidenteve brenda të cilave ka patur mungese të rezervave të identifikuara për OST;
   f) kohëzgjatja dhe numri i devijimeve të tensionit që tejkalojnë vlerat e dhëna në Tabelat 1 dhe 2 të Shtojcës II, për OST;
   g) numri i minutave jashtë diapazonit të frekuencës standarde dhe numri i minutave ku devijimi maksimali frekuencës i gjendjes së qëndrueshme është më shumë së 50% për zonë sinkrone;
   h) numri i rënieve të sistemit ose numri i gjendjes së black-out lokal; dhe
   i) numri i rënieve të sistemit plotësisht përfshire dy ose me tepër OST.

4. Raporti vjetor i përmendur në paragrafin 1 do të përmbajë indikatorët e sigurisë operacionale të rëndësishëm për planifikimin operacional si më poshtë:

   a) numri i ngjarjeve në të cilat një incident i përfshirë në listën e kontigjencave ka shkaktuar një degradim të gjendjes së operimit të sistemit;
   b) numrin e ngjarjeve të përmendura në pikën (a) në të cilën ka ndodhur një degradim i kushteve të operimit të sistemit si rezultat i mospërputhjeve të papritura nga parashikimi i ngarkesës ose gjenerimit;
   c) numri i ngjarjeve në të cilat ka pasur një degradim në kushtet e operimit të sistemit për shkak të një kontigjence të paparashikuar;

d) numri i ngjarjeve të përmendura në pikën (c) në të cilën ka ndodhur një degradim i kushteve të operimit të sistemit si rezultat i mospërputhjeve të papritura nga parashikimi i ngarkesës ose gjenerimit; dhe

e) numri i ngjarjeve që çojnë në një degradim të kushteve të operimit të sistemit për shkak të mungesës së rezervave të fuqisë aktive.

5. Raportet vjetore duhet të përmbajnë shpjegime mbi shkaqet e incidenteve për shkallët e klasifikimit 2 dhe 3 të sigurisë operacionale, sipas shkallës së klasifikimit të incidenteve të miratuara nga ENTSO-E. Këto shpjegime do të bazohen mbi hetimin e incidenteve nga OST-të, proces i cili do të përcaktohet në shkallën e klasifikimit të incidenteve. OST-të duhet të informojnë autoritetet përkatëse rregullatore për investigimin e incidentit, në kohën e duhur para së të nisë. Autoritetet rregullatore dhe Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë mund të përfshihen në hetim sipas kërkesës së tyre.

Neni 16

Raporti vjetor mbi kontrollin fuqi-frekuencë

1. ENTSO për Energjinë Elektrike, duke vepruar në përputhje me nenin 3 të Aktit Procedural Nr 2022/01/MC- EnC, do të zgjerojë raportin vjetor të hartuar në përputhje me nenin 16(1) të Rregullores 2017/1485 për të përfshirë Palët Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë.<…>
2. Pas përfundimit të afatit për transpozimin e kësaj Rregulloreje, OST-të e secilës Palë Kontraktuese do t'i njoftojë ENTSO për Energjinë Elektrike, brenda datës 1 mars të çdo viti, si vijon informacion për vitin e kaluar:

a) identifikimin e blloqeve LFC, zonave LFC dhe zonat e monitorimit në Palën Kontraktuese ;

b) identifikimin e blloqeve LFC që nuk janë në Palët Kontraktuese por që kanë zona LFC dhe zona monitorimi që janë në Palën Kontraktuese ;

c) identifikimin e zonave sinkrone të cilave çdo vend Palë Kontraktuese iu përket ;

d) te dhëna lidhur me kriterin e vlerësimit të cilësisë së frekuencës për çdo bllok LFC në nën-paragrafët (a), (b) dhe (c) që mbulon çdo muaj prej së paku 2 vitet kalendarike të mëparshme;

e) detyrimin e FRC dhe detyrimin fillestar të FRC për çdo OST që operon brenda Palës Kontaktuese që mbulon çdo muaj prej së paku 2 vitet kalendarike të mëparshme ; dhe

f) përshkrimin dhe datën e implementimit të çdo mase zbutëse dhe kërkese teknike në rritje të marra në vitin e mëparshëm kalendarik, për të lehtësuar devijimet deterministike të frekuencës, në përputhje me nenet 137 dhe 138, në të cilat janë përfshirë OST-të e Palës Kontraktuese

3. Te dhënat e siguruara nga OST-të do të mbulojnë vitin e mëparshëm. Informacionin lidhur me zonat sinkrone, blloqet LFC, zonat LFC dhe zonat e monitorimit në nën-paragrafët (a), (b) dhe

(c) duhet të raportohen një herë. Kur këto zona ndryshojnë, ky informacion do të raportohet deri në 1 Mars të vitit në vijim.

4. Kur është e përshtatshme, të gjithë OST-të e një zone sinkrone ose blloku LFC do të bashkëpunojnë në mbledhjen e të dhënave të listuara në paragrafin 2.

Neni 17

Raport vjetor mbi vlerësimin e koordinimit rajonal

1. ENTSO për Energjinë Elektrike, duke vepruar në përputhje me nenin 3 të Aktit Procedural Nr. 2022/01/MC- EnC, do të zgjasë raportin vjetor të hartuar në përputhje me nenin 17(1) të Rregullores 2017/1485 për përfshirjen e Palëve Kontraktuese të Komunitetit të Energjisë.
2. Deri më 1 mars, çdo qendër e koordinimit rajonal duhet të përgatisë një raport vjetor dhe t'ia paraqesë ENTSO-E, duke dhënë informacionin e mëposhtëm për detyrat që kryen:
   a) numrin e ngjarjeve, kohëzgjatjen mesatare dhe shkaqet e dështimit për të përmbushur funksionet e tij;
   b) statistikat lidhur me kufizimet, përfshirë kohëzgjatjen, vendndodhjen dhe numrin e ngjarjeve së bashku me veprimet përmirësuese të aktivizuara si dhe koston e tyre në rast së ato kanë ndodhur;
   c) numri i rasteve kur OST-të refuzojnë të zbatojnë veprimet përmirësuese të rekomanduara nga qendra e koordinimit rajonal si dhe arsyet e tyre;
   d) numri i papajtueshmërive të ndërprerjeve të zbuluara në përputhje me nenin 80; dhe
   e) një përshkrim të rasteve kur është vlerësuar mungesa e mjaftueshmërisë rajonale dhe një përshkrim i veprimeve përmirësuese të përgatitura.

3. Të dhënat e siguruara për ENTSO-E nga qendra e koordinimit rajonal mbulojnë vitin paraprak.

PJESA II

SIGURIA OPERACIONALE

TITULLI 1

KËRKESAT MBI SIGURINE OPERACIONALE

KAPITULLI 1

Gjendjet e sistemit, veprimet përmirësuese dhe kufijtë e sigurisë operacionale

Neni 18

Klasifikimi i gjendjeve të sistemit

1. Një sistem transmetimi do të jetë në gjendje normale kur përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme:

   a) tensioni dhe flukset e fuqisë janë brenda limiteve të sigurisë operacionale të përcaktuara në Nenin 25;
   b) frekuenca plotëson kriteret e mëposhtme:
      i. Devijimi i frekuencës së sistemit në gjendje të qëndrueshme është brenda kufijve standard të frekuencës; ose
      ii. Vlera absolute e devijimit të frekuencës në gjendje të qëndrueshme nuk është me e madhe së devijimi maksimal i frekuencës në gjendje të qëndrueshme dhe kufijtë e frekuencës së sistemit të përcaktuar për gjendjen e alarmit nuk janë përmbushur;
   c) rezervat e fuqisë aktive dhe reaktive janë të mjaftueshme për të përballuar ngjarjet e paplanifikuara që bëjnë pjesë në listën e kontingjencave të përcaktuar sipas Nenit 33 pa cënuar kufijtë e sigurisë operacionale;
   d) operimin e zonës së përgjegjësisë të OST-së në fjalë është dhe do të mbetet brenda kufijve të sigurisë operacionale edhe pas aktivizimit të veprimeve përmirësuese, pas ndodhjes së një kontigjence nga lista e kontigjencave të përcaktuara në përputhje me Nenin 33.
2. Një sistem transmetimi do të jetë në gjendje alarmi kur:

   a) tensioni dhe flukset e fuqisë janë brenda limiteve të sigurisë operacionale të përcaktuara në Nenin 25;

b) kapaciteti i rezervës së OST-se është reduktuar me më shumë së 20% për më shumë së 30 minuta dhe nuk ka asnjë mjet për të kompensuar atë reduktim në operimin e sistemit në kohë reale; ose

c) frekuenca plotëson kriteret e mëposhtme:

i. vlera absolute e devijimit të frekuencës së sistemit në gjendje të qëndrueshme nuk është me e madhe së devijimi maksimal i frekuencës në gjendje të qëndrueshme; dhe

ii. vlera absolute e devijimit të frekuencës në gjendje të qëndrueshme ka kaluar në mënyrë të vazhdueshme 50% të devijimit maksimal të gjendjes së qëndrueshme për një kohë me të gjate kohë së sa koha e aktivizimit të gjendjes së alarmit ose kufijtë standard të frekuencës për një periudhe kohë më të gjatë së koha për rivendosje të frekuencës ; ose

d) Të paktën një rast nga lista e rasteve të përcaktuar sipas Nenit 33 mund të çojë në devijime nga limitet e sigurisë operacionale të OST-së edhe pas aktivizimit të veprimeve përmirësuese.

3. Një sistem transmetimi do të jetë në gjendje emergjence kur është përmbushur së paku një nga kushtet e mëposhtme:

a) ka të paktën një devijim nga limitet e lejuara të sigurisë operacionale të përcaktuar në përputhje me Nenin 25

b) frekuenca nuk plotëson kriterin për gjendje normale dhe gjendje alarmi të përcaktuar në përputhje me paragrafët 1 dhe 2;

c) është aktivizuar së paku një nga masat e planit të mbrojtjes së OST-së ;

d) ka një humbje të plotë të gjithë mënyrave dhe mjeteve të përcaktuara sipas Nenit 24(1), për me shumë së 30 min.

4. Një sistem transmetimi do të jetë në gjendje black-out kur përmbushet së paku një nga kushtet e mëposhtme:

a) humbje e me shumë së 50% e ngarkesës në zonën e kontrollit të OST-se në fjale;

b) mungesë totale e tensionit për të paktën 3 min. në zonën e përgjegjësisë të OST-se dhe aktivizim të masave të planit të rivendosjes.

<...>

5. Sistemi i transmetimit do të jetë në gjendje rivendosje kur OST-ja e cila ka qene në gjendje emergjence ose black-out ka filluar të aktivizoje masat e planit të rivendosjes.

Neni 19

Monitorimi dhe përcaktimi i gjendjeve të sistemit nga OST-të

1. Çdo OST, në operimin në kohë reale, duhet të përcaktojë gjendjen e sistemit të sistemit të tij të transmetimit.
2. Çdo OST duhet të monitorojë parametrat e mëposhtëm të sistemit të transmetimit në kohë-reale në zonën e tij të kontrollit, bazuar në telematjet në kohë-reale ose në vlerat e llogaritura nga zona e saj e vëzhgimit, duke marrë parasysh të dhënat strukturore dhe në kohë reale në përputhje me Nenin 42:
   a) flukset e fuqisë aktive dhe reaktive;
   b) tensionin në zbara;
   c) frekuencën dhe gabimin e kontrollit të rivendosjes së frekuencës në zonën e saj LFC;
   d) rezervat e fuqisë aktive dhe reaktive; dhe
   e) gjenerimin dhe konsumin

3. Në mënyre që të përcaktohet gjendja e sistemit, çdo OST do të kryejë analizë të kontigjencave së paku një herë në çdo 15 minuta, duke monitoruar parametrat e sistemit të transmetimit të përcaktuar në përputhje me paragrafin 2, kundrejt kufijve të sigurisë operacionale të përcaktuar në përputhje me nenin 25 dhe kritereve për gjendjet e sistemit të përcaktuara në përputhje me Nenin 18. Çdo OST do të monitorojë gjithashtu nivelin e rezervave në dispozicion kundrejt kapacitetit rezervë. Gjatë kryerjes së analizës së kontigjencave çdo OST do të marrë parasysh efektin e veprimeve përmirësuese dhe masat e planit të mbrojtjes së sistemit.

4. Nese sistemi i transmetimit nuk është në gjendje normale dhe nëse kjo gjendje e sistemit klasifikohet si gjendje në shkallë të gjerë, atëherë OST duhet:

   a) informojë të gjithë OST-të për gjendjet e sistemit të tij të transmetimit nëpërmjet mjeteve IT për shkëmbimin të të dhënave në kohë reale në nivel Evropian; dhe
   b) sigurojë informacion shtese mbi elementet e sistemit të transmetimit të cilët janë pjesë e zonës së observimit të OST-ve të tjera, këtyre OST-ve.

Neni 20

Veprimet përmirësuese në operimin e sistemit

1. Çdo OST duhet të përpiqet për tu siguruar që sistemi i tij i transmetimit të mbetet në gjendje normale dhe duhet të jetë përgjegjës për menaxhimin e cënimit të sigurisë operacionale. Për të arritur këtë objektiv, çdo OST do të hartojë, përgatisë dhe aktivizojë veprimet përmirësuese duke marrë parasysh disponueshmërinë e tyre, kohën dhe burimet e nevojshme për aktivizimin e tyre dhe çdo kusht të jashtëm të sistemit të transmetimit të cilat janë relevante për çdo veprim përmirësues.

2. Veprimet përmirësueses të përdorura nga OST-të në operimin e sistemit në përputhje me paragrafin 1 dhe Nenet 21 deri 23 të kësaj Rregulloreje do të jenë në përputhje me veprimet përmirësuese të marra në konsiderate gjate llogaritjes e kapacitetit në përputhje me Nenin 25 të Rregullores (EU) 2015/1222, e përshtatur dhe miratuar me Vendimin e Këshillit Ministror 2022/03/MC-EnC.

Neni 21

Parimet dhe kriteri i zbatueshëm në veprimet përmiresuese

1. Çdo OST gjatë aktivizimit dhe koordinimit të veprimeve përmirësuese në përputhje me Nenin 23 duhet të zbatojë parimet e mëposhtme:

a) Për cënimet e sigurisë operacionale të cilat nuk kanë nevojë të menaxhohen në mënyrë të koordinuar, OST do të hartojë, përgatisë dhe aktivizojë veprimet përmirësuese për të rikthyer sistemin në gjendjen normale dhe për të parandaluar përhapjen e gjendjes së alarmit ose emergjencës jashtë zonës së kontrollit të OST-së sipas kategorive të përcaktuara në nenin 22;

b) Për cenimet e sigurisë operacionale të cilat kane nevoje të menaxhohen në mënyrë të koordinuar, OST do të hartoje, përgatisë dhe aktivizoje veprimet përmirësuese në koordinim me OST-të e tjera në fjale, duke ndjekur metodologjinë për përgatitjen e veprimeve përmirësuese në mënyrë të koordinuar sipas nenit 76(1)(b) dhe duke marrë në konsideratë rekomandimet e qendrës së koordinimit rajonal të sigurisë në përputhje me Nenin 78(4).

2. Gjatë zgjedhjes së veprimeve të përshtatshme përmirësuese, çdo OST zbaton kriteret e mëposhtme:

   a) aktivizoje veprimet përmirësuese më efikase dhe eficente ekonomikisht;
   b) aktivizon veprimet përmirësuese sa më pranë kohës reale duke marrë parasysh kohën e pritshme të aktivizimit dhe urgjencën e situatës së operimit të sistemit që ata synojnë të zgjidhin;
   c) të marrë në konsideratë rrezikun e dështimit në zbatimin e veprimeve përmirësuese në dispozicion dhe ndikimin e tyre në sigurinë operacionale të tilla si:
   d) riskun e dështimit ose lidhjen e shkurtër të shkaktuar nga ndryshimet në topologji;
   e) riskun e ndërprerjeve të shkaktuara nga ndryshimet e fuqisë aktive dhe reaktive në modulet gjenerueses ose objektet e konsumit ; dhe
      i. riskun e keqfunksionimit të shkaktuar nga sjellja e pajisjeve;

   d) t'iu japë përparësi veprimeve përmirësuese që vënë në dispozicion kapacitetin më të madh ndër-zonal për alokimin e kapaciteteve, duke përmbushur të gjitha kufijtë e sigurisë operacionale.

Neni 22

Kategoritë i veprimeve përmirësuese

1. Çdo OST do të përdorë kategoritë e mëposhtme të veprimeve përmirësuese:

(a) modifikojë kohëzgjatjen e një ndërprerjeje të planifikuar ose të kthimit në pune të elementeve të sistemit të transmetimit për të arritur disponueshmërinë operacionale të atyre elementëve të sistemit të transmetimit;

(b) ndikojnë në mënyrë aktive në flukset e fuqisë me anë të:
   (i) pozicioneve të rregullimit (ancafkave) në transformatorët e fuqisë;
   (ii) pozicioneve të rregullimit (ancafkave) në transformatorët fazore
   (iii) modifikimit të topologjisë ;

(c) kontrollon tensionin dhe menaxhon fuqinë reaktive me anë të:
   (i) pozicioneve të rregullimit (ancafkave) në transformatorët e fuqisë ;
   (ii) kyçjes së kapacitorëve dhe reaktorëve;
   (iii) kyçjes së paisjeve elektronike të fuqisë të përdorura për menaxhim të tensionit dhe fuqisë reaktive;
   (iv) duke instruktuar OSSH-të dhe përdoruesit e rëndësishëm të rrjetit të bllokojnë rregullimin automatik të tensionit dhe kontrollit të fuqisë reaktive të transformatorëve ose të aktivizojnë në objektet e tyre veprimet përmirësuese siç përcaktohen në pikat (i) deri (iii) nëse përkeqësimi i tensionit rrezikon sigurinë operacionale ose kërcënon të çojë në kolaps të tensionit në sistemin e transmetimit;
   (v) duke kërkuar ndryshimin e prodhimit të fuqisë reaktive ose pikën e punës së tensionit të moduleve gjeneruese të lidhura sinkrone me transmetimin;
   (vi) duke kërkuar ndryshimin e prodhimit të fuqisë reaktive të konvertorëve të moduleve gjeneruese jo-sinkrone të energjisë të lidhur me transmetimin;

(d) ri-llogaritë kapacitetet ndër-zonale të ditës ne avance dhe brenda ditës në përputhje me Rregulloren (EU) 2015/1222, përshtatur dhe miratuar me Vendimin e Këshillit Ministror 2022/03/MC-EnC pasi të jetë përfshirë dhe miratuar në Komunitetin e Energjisë.
(e) ri-dispeçerojë përdoruesit e lidhur me transmetimin ose shpërndarjen, brenda zonës së kontrollit të OST-se ose ndërmjet dy ose me shumë OST-ve;
(f) Tregtimi me kah të kundërt ndërmjet dy ose më shumë zonave ofertuese;
(g) rregullojë flukset e fuqisë aktive nëpërmjet sistemeve HVDC;
(h) aktivizoje procedurën e menaxhimit të devijimit të frekuencës;
(i) të zvogëlojë, në përputhje me Nenin 16 (2) të Rregullores (BE) 2019/943, e përshtatur dhe miratuar nga Vendimi i Këshillit Ministror 2022/03/MC-EnC, kapacitetin tashme të alokuar për një situatë emergjence, kur përdorimi i atij kapaciteti rrezikon sigurinë operacionale, të gjithë OST-të në një interkoneksion të dhënë bien dakord me një rregullim të tillë, dhe ri-dispeçimi apo Tregtimi me kah të kundërt nuk është i mundur; dhe

(j) aty ku zbatohet, përfshirë gjendjen normale dhe të alarmit, kufizimin manual të kontrolluar të ngarkesës.

2. Kur është e nevojshme dhe justifikohet me qëllim ruajtjen e sigurisë operacionale, çdo OST mund të përgatisë dhe të aktivizojë veprime përmirësuese shtesë. OST do ti raportojë dhe justifikojë këto raste tek autoriteti përkatës rregullator dhe, kur është e zbatueshme, nga Pala Kontraktuese, të paktën një herë në vit, pas aktivizimit të veprimeve shtesë përmirësuese. Raportet dhe arsyetimet përkatëse gjithashtu do të publikohen. Sekretariati i Komunitetit të Energjisë ose Bordi Rregullator i Komunitetit të Energjisë mund të kërkojnë nga autoriteti përkatës rregullator që të ofrojnë informacione shtesë lidhur me aktivizimin e veprimeve përmirësuese shtesë, në ato raste kur ato prekin një sistem transmetimi fqinj.

Neni 23

Përgatitja, aktivizimi dhe koordinimi i veprimeve përmirësuese

1. Çdo OST duhet të përgatisë dhe aktivizojë veprimet përmirësuese në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 21 (2) për të parandaluar përkeqësimin e gjendjes së sistemit në bazë të elementeve të mëposhtëm:

   a) Monitorimin dhe përcaktimin e gjendjeve të sistemit në përputhje me Nenin 19;
   b) Analizën e kontigjencave në operimin në kohë reale në përputhje me Nenin 34;
   c) Analizën e kontigjencave në planifikimin operativ në përputhje me Nenin 72.

2. Kur përgatit dhe aktivizon veprimet përmirësuese, përfshirë ridispeçerimin ose Tregtimi me kah të kundërt në përputhje me Nenet 25 dhe 35 të Rregullores (EU) 2015/1222 siç është përshtatur dhe miratuar me Vendimin e Këshillit Ministror 2022/03/MC-EnC ose një procedurë të Planit të Mbrojtjes së Sistemit të OST-se i cili prek OST-të e tjera, OST-ja respektive do të analizoje, në përputhje me OST-të në fjale, ndikimin e veprimeve ose masave përmirësuese, brenda ose jashtë zonës së saj të kontrollit, në përputhje me Nenin 75 (1), Nenin 76 (1) (b) dhe Nenin 78 (1), (2) dhe (4) dhe do t'i sigurojë OST-të përkatëse informacionin në lidhje me këtë ndikim.
3. Gjatë përgatitjes dhe aktivizimit të veprimeve përmirësuese që kanë ndikim në SGU-të dhe OSSh-të e lidhura me transmetimin, çdo OST duhet, nëse sistemi i saj i transmetimit do të jetë në gjendje normale apo alarmi, do të vlerësojë ndikimin e veprimeve të tilla përmirësuese në koordinim me SGU-të dhe OSSh-të e ndikuara nga këto veprime, dhe zgjedhë veprimet përmirësuese që kontribuojnë në ruajtjen e gjendjes normale dhe operimin e sigurt të të gjitha palëve të përfshira. Çdo SGU dhe OSSH e prekur do t'i ofrojnë OST-së të gjithë informacionin e nevojshëm për këtë koordinim.
4. Kur përgatit dhe aktivizon veprimet përmirësuese çdo OST do të, nëse sistemi i saj i transmetimit nuk është në gjendje normale ose alarmi, të koordinoje në masën e mundshme veprime të tilla përmirësuese me SGO-te dhe OSSHte e prekura për të ruajtur sigurinë operacionale dhe integritetin e sistemit të transmetimit. Kur një OST aktivizon veprimet përmirësuese, çdo SGU dhe OSSH e ndikuar dhe të lidhur në transmetim do të ndjekin udhëzimet e dhëna nga OST.

5. Kur kufizimet kanë pasoja vetëm në gjendjen lokale brenda zonës së kontrollit të OST dhe cenimi i sigurisë operacionale nuk ka nevojë të menaxhohet në mënyrë të koordinuar, OST përgjegjëse për menaxhimin e saj mund të vendosë të mos aktivizojë veprimet përmirësuese me kosto, për t'i lehtësuar ato.

Neni 24

Disponueshmëria e mënyrave, mjeteve dhe pajisjeve të OST-së

1. Çdo OST duhet të sigurojë disponueshmërinë, besueshmërinë dhe rezervat shtesë të elementeve të mëposhtme:

   a) Pajisje për monitorimin e gjendjes së sistemit të transmetimit, duke përfshirë dhe aplikacione për vlerësimin e tij si dhe paisje për kontrollin ngarkesë-frekuence;
   b) Pajisje për kontrollin e elementeve komutues si dhe paisjeve të tjera që shërbejnë për kontrollin e elementeve të sistemit të transmetimit;
   c) Pajisje për komunikimin me qendrat e tjera dispeçer të OST-ve fqinje dhe RSC-ve;
   d) Aplikime për analizën e sigurisë operacionale.
   e) Mjetë dhe paisje komunikimi të nevojshme për OST-të për të lehtësuar tregun ndërkufitar.
2. Kur mjetet dhe pajisjet e përmendura në paragrafin 1 prekin OSSH ose SGU-te të cilët janë të përfshirë në balancim, shërbime ndihmëse, planin e mbrojtjes, planin e rivendosjes ose dërgimin e të dhënave në kohë reale sipas Nenit 44, 47, 50, 51 dhe 52 OST dhe OSSH-të dhe përdoruesit e rëndësishëm do të bashkëpunojnë dhe koordinojnë për sigurimin e disponueshmërisë, besueshmërinë dhe rezervat shtesë të pajisjeve dhe aplikacioneve të mësipërme.
3. Brenda 18 muajve nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje, çdo OST do të adoptojë një plan biznesi për vazhdueshmërinë e operimit të pajisjeve ose aplikacioneve kritike, duke parashikuar mirëmbajtjen, zëvendësimin dhe zhvillimin e pajisjeve dhe aplikacione kritike Ky plan do të rishikohet të paktën një herë në vit dhe do të përditësohet sipas nevojës ose duke qenë në linjë me ndryshimet në pajisjet, aplikacionet dhe kushtet e operimit të Sistemit. Plani do t'i bëhet i njohur dhe do të kooperohet me OSSH dhe përdoruesit e rëndësishëm, deri në masën që ata janë të inkluduar.

Neni 25

Limitet e Sigurisë Operacionale

1. Çdo OST do të specifikoje limitet e sigurisë operacionale për çdo element të sistemit të tij të transmetimit, duke marre në konsiderate së paku karakteristikat fizike të mëposhtme:

   a. limitet e sigurisë operacionale në përputhje me Nenin 27;
   b. Limitet e rrymës se lidhjes së shkurtër në përputhje me Nenin 30; dhe
   c. Limitet e rrymës në përputhje me limitin termik duke përfshirë dhe mbingarkesën e lejuar tranzitore

2. Në përcaktimin e limiteve të sigurisë operacionale, çdo OST do të marrë parasysh aftësitë e kërkuara për përdoruesit e rëndësishëm, në mënyrë që tensioni dhe frekuenca të jenë brenda diapazoneve të gjendjes normale dhe asaj të alarmit dhe mos çojnë në shkyçjen e tyre.
3. Në rastin e ndryshimeve në ndonjë pajisje apo element të sistemit të transmetimit OST do të validojë dhe aty ku lind nevoja përditësojë limitet e sigurisë operacionale.
4. Për çdo interkonektor, çdo OST do të koordinojë me OST-në tjetër përkatëse në përcaktimin e limiteve të përbashkëta të sigurisë operacionale në përputhje me paragrafin 1.

Neni 26

Plani i sigurisë për mbrojtjen e infrastrukturës kritike

1. Çdo OST do të specifikoje, duke marre parasysh Nenet 1(4)(a) dhe 1(5) të Aktit Procedural Nr. 2018/2/MC-EnC dhe Artikujt 4.2(f) dhe 5.1 të Aneksit te tij, një plan sigurie konfidencial që përmban vlerësim të riskut të aseteve në pronësi ose të operuara nga OST, që mbulon skenarë të cenimit fizik ose kibernetik të përcaktuar nga Palët Kontraktuese .
2. Plani i sigurisë do të marre parasysh ndikimin potencial të sistemeve të transmetimit evropiane të interkonektuara, dhe përfshijë masat organizative dhe fizike që synojnë në zbutjen dhe identifikimin e risqeve.
3. Çdo OST duhet rregullisht të rishikoje planin e sigurisë për të adresuar ndryshimet e skenarëve të kërcënimeve dhe që reflektoje zhvillimin e sistemit të transmetimit.

Kapitulli 2

Kontrolli i tensionit dhe menaxhimi i fuqisë reaktive

Neni 27

Detyrimet e të gjithë OST-ve lidhur me limitet e tensionit

1. Çdo OST, në përputhje me Nenin 18, do të beje përpjekjet me të mira për të siguruar që gjate gjendjes normale tensioni në pikën e lidhjes me sistemin e transmetimit mbetet në gjendje të qëndrueshme brenda limiteve të përcaktuara në Tabelën 1 dhe 2 të Aneksit II.
2. <...>
3. Çdo OST do të përcaktojë tensioni bazë për vlerën njësi p.u
4. Çdo OST do të përpiqet të sigurojë që gjatë gjendjes normale dhe pas ndodhjes së një kontingjence, tensioni të mbetet brenda limiteve më të gjera të tensionit për kohë të kufizuara të operimit nëse ka marrëveshje për ato kufij me të gjerë të tensionit me OSSh-të e lidhura në transmetim, pronaret e objekteve gjeneruese në përputhje me Nenin 16 (2) të Rregullores (EU) 2016/631, siç është përshtatur dhe miratuar nga Vendimin i Grupit të Përhershëm i Nivelit të Lartë 2018/03/PHLG-EnC ose pronarët e sistemit HVDC në përputhje me Nenin 18 të Rregullores (EU) 2016/1447, siç është përshtatur dhe miratuar nga Vendimin i Grupit të Përhershëm i Nivelit të Lartë2018/04/PHLG-EnC.

5. Çdo OST do të dakordoje, me OSSH-të e lidhura në transmetim dhe përdoruesit e rëndësishëm të rrjetit të lidhur në transmetim mbi kufijtë e tensionit në pikën e lidhjes poshtë 110 kV nëse këto kufij tensioni janë të rëndësishme për ruajtjen limiteve të sigurisë operacionale. Çdo OST do të përpiqet të sigurojë që tensioni mbetet brenda rangut të dakorduar gjate gjendjes normale edhe pas ndodhjes se një kontigjence.

Neni 28

Detyrimet e përdoruesit të rëndësishëm të rrjetit lidhur me menaxhimin e tensionit dhe fuqisë reaktive gjate operimit të sistemit

1. Tre muaj nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje, të gjithë Përdoruesit e rëndësishëm të Rrjetit që janë module gjenerues të lidhur në transmetim si dhe nuk janë objekt i Nenit 16 të Rregullores (EU) 2016/631, siç është përshtatur dhe miratuar nga Vendimin i Grupit të Përhershëm i Nivelit të Lartë 2018/03/PHLG-EnC ose që janë sisteme HVDC dhe që nuk i nënshtrohet kërkesave të Nenit 18 të Rregullores (BE) 2016/1447, siç është përshtatur dhe miratuar nga Vendimin i Grupit të Përhershëm i Nivelit të Lartë 2018/04/PHLG-EnC do të informojë OST-në e tyre lidhur me aftësitë e tyre krahasuar me kërkesat e tensionit në Nenin 16 të Rregullores (BE) 2016/631, siç është përshtatur dhe miratuar nga Vendimin i Grupit të Përhershëm i Nivelit të Lartë 2018/03/PHLG-EnC ose në Nenin 18 të Rregullores (EU) 2016/1447, siç është përshtatur dhe miratuar nga Vendimin i Grupit të Përhershëm i Nivelit të Lartë 2018/04/PHLG-EnC duke deklaruar aftësitë e tyre për menaxhim të tensionit dhe kohën që mund të përballojnë pa u shkyçur.
2. SGU-të, të cilat janë objektet e kërkesës që i nënshtrohen kërkesave të nenit 3 të Rregullores (EU) 2016/1388, siç është përshtatur dhe miratuar nga Vendimin i Grupit të Përhershëm i Nivelit të Lartë 2018/05/PHLG-EnC nuk do të shkycen për shkak të një defekti brenda kufijve të tensionit të përmendur në nenin 27. Deri 3 muaj pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, SGU-te që janë objekte konsumatore të lidhura me transmetimin dhe që nuk janë objekt i Nenit 3 të Rregullores (EU) 2016/1388, siç është përshtatur dhe miratuar nga Vendimin i Grupit të Përhershëm i Nivelit të Lartë 2018/05/PHLG-EnC duhet të informojnë OST-në e tyre lidhur me aftësitë e tyre në lidhje me kërkesat e tensionit të përcaktuara në Aneksin II të Rregullores (BE) 2016/1388, siç është përshtatur dhe miratuar nga Vendimin i Grupit të Përhershëm i Nivelit të Lartë 2018/05/PHLG-EnC që deklarojnë aftësitë për menaxhimin e tensionin e tyre dhe kohën që mund të përballojnë pa u shkyçur.
3. Çdo Përdorues i rëndësishëm i rrjetit i lidhur në transmetim do të ruajë pikën e punës së fuqisë reaktive, limitet e faktorit të fuqisë dhe pikën e punës së tensionit për kontroll të tensionit në diapazonin e dakorduar me OST në përputhje me Nenin 27.

Neni 29

Detyrimet e të gjithë OST-ve në lidhje me kontrollin e tensionit dhe menaxhimin e fuqisë reaktive gjate operimit të sistemit

1. Nëse tensioni në një Pikë Lidhje në Sistemin e Transmetimit është jashtë kufirit të treguar në tabelën 1 dhe 2 të Aneksit II të kësaj rregulloreje, çdo OST do të zbatojë veprimet përmirësuese për kontroll të tensionit dhe menaxhimin e fuqisë reaktive në përputhje me Nenin 22(1)(c) të kësaj rregulloreje në mënyrë që të rivendoset tensioni brenda kufijve të specifikuar në Aneksin II dhe brenda afatit të përcaktuar në nenin 16 të rregullores së EU 2016/631, siç është përshtatur dhe miratuar nga Vendimin i Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë 2018/03/PHLG-EnC dhe Nenit 13 të Rregullores së EU 2016/1388, siç është përshtatur dhe miratuar nga Vendimin i Grupit të Përhershëm i Nivelit të Lartë 2018/05/PHLG-EnC.
2. Çdo OST do të marrë në konsideratë në analizën e sigurisë operacionale vlerat e tensionit në të cilat mund të SGU-të e lidhura në transmetim që nuk i nënshtrohen kërkesave të Rregullores (BE) 2016/631, siç është përshtatur dhe miratuar nga Vendimin i Grupit të Përhershëm i Nivelit të Lartë 2018/03/PHLG-EnC ose Rregullores (EU) 2016/1388, siç është përshtatur dhe miratuar nga Vendimin i Grupit të Përhershëm i Nivelit të Lartë 2018/05/PHLG-EnC, mund të shkycen.
3. Çdo OST do të sigurohet që rezervat e fuqisë reaktive, në volumin dhe kohën e duhur, me qëllim që të mbahen nivelet e tensionit brenda zonës së kontrollit dhe në interkonektorët brenda limiteve të përcaktuar në Aneksin II.
4. OST-të e interkonektuara nga interkonektoret AC në mënyrë të përbashkët do të specifikojnë regjimin e përshtatshëm të kontrollit të tensionit me qëllim që të sigurojnë që siguria e përbashkët operacionale e përcaktuar në përputhje me Nenin 25(4) respektohet.
5. Çdo OST do të pajtohet me çdo OSSH të lidhur në transmetim për pikën e punës së fuqisë reaktive, diapazonin e faktorit të fuqisë dhe pikën e punës për kontroll të tensionit në pikën e lidhjes ndërmjet OST dhe OSSH në përputhje me Nenin 15 të Rregullores (BE) 2016/1388, siç është përshtatur dhe miratuar nga Vendimin i Grupit të Përhershëm i Nivelit të Lartë 2018/05/PHLG-EnC. Për të siguruar që këto parametra të ruajtur, çdo OSSH e lidhur me transmetimin duhet të përdorë burimet e saj të fuqisë reaktive dhe të ketë të drejtën të japë instruksione për kontrolli të tensionit tek SGU-të e lidhura me Shpërndarje.
6. Çdo OST do të ketë të drejtë të përdorë të gjitha kapacitetet e disponueshme të fuqisë reaktive të lidhur në transmetim brenda zonës së saj të kontrollit për menaxhimin efektiv të fuqisë reaktive dhe mbajtjen e tensionit në vlerat e përcaktuara në Tabelat 1 dhe 2 të Shtojcës II të kësaj Rregulloreje.
7. Çdo OST duhet, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në koordinim me OSSH-në e lidhur në transmetim, kur është e aplikueshme, të operojë burime të energjisë reaktive brenda zonës së saj të kontrollit, duke përfshirë bllokimin e kontrollit automatik të tensionit/kontrollin e fuqisë reaktive të transformatorëve, reduktimin e tensionit dhe shkyçjen e kërkesës me rënien e tension, në mënyrë që të ruajnë kufijtë e sigurisë operacionale dhe të parandalojnë kolapsin e tensionit në sistemin e transmetimit.
8. Çdo OST do të përcaktojë veprimet e menaxhimit të tensionit në koordinim me Përdoruesit e Rëndësishëm të Rrjetit dhe OSSh-të e lidhura me rrjetin e transmetimit dhe me OST-të fqinje.

9. Kur është e rëndësishme për kontrollin e tensionit dhe menaxhimin e fuqisë reaktive të sistemit të transmisionit, një OST mund të kërkojë, në koordinim me një OSSh, një përdoruesit të rëndësishëm të rrjetit të lidhur me shpërndarjen, të ndjeke udhëzimet për kontroll të tensionit.

Kapitulli 3

Menaxhimi i rrymave të lidhjes së shkurtër

Neni 30

Rryma e lidhjes shkurtër

Çdo OST do të përcaktoje:

a) maksimumin e rrymës së lidhjes së shkurtër në të cilën aftësia nominale e çelësave dhe pajisjeve të tjera komutuese tejkalohet dhe

b) rryma minimale e lidhjes së shkurtër për operimin korrekt të pajisjeve të mbrojtjes

Neni 31

Llogaritja e rrymës së lidhjes shkurtër dhe masat përkatëse

1. Çdo OST do të kryejë llogaritjet rrymës së lidhjes të shkurtër për të vlerësuar ndikimin e OST-ve fqinje dhe SGU-të dhe OSSH-të e lidhura në transmetim përfshirë edhe sistemet mbyllura të shpërndarjes mbi nivelin e rrymës së lidhjes së shkurtër në sistemin e transmetimit. Kur një sistem shpërndarje i lidhur me rrjetin e transmetimit përfshirë edhe sistemin e mbyllur të shpërndarjes, ka ndikim në nivelet e rrymës së lidhjes së shkurtër, ai duhet të përfshihet në llogaritjet e rrymës së lidhjes së shkurtër.
2. Ndërkohë që kryen llogaritjet e rrymës së lidhjes së shkurtër, çdo OST duhet:
   a) të përdorë të dhënat me të sakta dhe me cilësinë me të lartë të disponueshme
   b) te marre parasysh standartet ndërkombëtare; dhe
   c) do të marrë në konsideratë kushtet operacionale që japin nivelin më të lartë të mundshëm të rrymave të lidhjes së shkurtër, duke konsideruar gjithashtu edhe kontributin e lidhjes së shkurtër nga sistemet e tjera të transmetimit, ose nga rrjeti i shpërndarjes përfshirë edhe sistemet e mbyllura të shpërndarjes.
3. Çdo OST do të implementojë veprime operacionale ose masa të tjera për të parandaluar devijimin nga limitet maksimale dhe minimale të qarkut të shkurtër referuar në nenin 30, në të gjitha fragmentet e kohës dhe për të gjitha pajisjet mbrojtëse. Nëse ndodh një devijim i tillë, çdo OST do të aktivizojë veprimet përmirësuese ose do të zbatojë masa të tjera për të siguruar që kufijtë e përmendur në nenin 30 të ri-vendosur. Një devijim nga këto kufizime lejohet vetëm gjatë sekuencave të kyçjeve.

Kapitulli 4

Menaxhimi i Flukseve të fuqisë

Neni 32

Kufijtë e Flukseve të fuqisë

1. Çdo OST duhet të mbajë lëvizjen e flukseve brenda kufijve të sigurisë operacionale të përcaktuara kur sistemi është në gjendje normale dhe pas ndodhjes së një kontigjence nga lista e rasteve të paparashikuara të referuara në Nenin 33 (1).
2. Ne situatën (N-1), në gjendje normale çdo OST do të ruaje flukset e fuqisë brenda mbingarkesave të lejuara transitore referuar në Nenin 25(1)(c), pasi ka përgatitur veprime përmirësuese që do të zbatohen dhe ekzekutohen brenda afatit kohor të lejuar për mbingarkesat lejuara tranzitore.

Kapitulli 5

Trajtimi dhe analiza e kontigjencave

Neni 33

Lista e kontigjencave

1. Çdo OST do të krijojë një listë të rasteve të paparashikuara, duke përfshirë edhe rastet e brenda dhe jashtë zonës së saj të observimit, duke analizuar nëse ndonjë prej këtyre rasteve rrezikon sigurinë operacionale të zonës së kontrollit të OST. Lista e kontigjencave duhet të përfshije të dyja rastet, kontigjencat të zakonshme dhe kontigjencat e jashtëzakonshme të identifikuara nga zbatimi i metodologjisë së hartuar në pajtim me nenin 75.
2. Për të krijuar një listë të kontigjencave, çdo OST do të klasifikojë kontigjence në bazë të faktit nëse është i zakonshëm, i jashtëzakonshëm ose i jashtë kufijve, duke marrë parasysh probabilitetin e ndodhjes dhe parimet e mëposhtme:

    a) çdo OST do të klasifikoje kontigjencat për zonën e saj të kontrollit;

    b) nëse kushtet operacionale ose të motit, rrisin në mënyrë domethënëse propabilitetin e një kontigjence të jashtëzakonshme, çdo OST do të përfshijë atë kontigjence të jashtëzakonshme në listën e saj të kontigjencave të jashtëzakonshme ; dhe

    c) për të llogaritur kontigjencat e jashtëzakonshme me ndikimin të lartë në sistemin e saj ose sistemin e transmetimit fqinj, çdo OST do të përfshijë një kontigjence të tille në listën e saj të kontigjencave .

3. Çdo OSSH dhe Përdorues i Rëndësishëm i lidhur me rrjetin e transmetimit i cili është objekt gjenerues i energjisë, duhet të japë të gjitha informacionet e rëndësishme për analizën e

kontigjencave siç kërkohet nga OST, duke përfshirë parashikimet dhe të dhënat në kohë reale, mundësisht me të dhëna të agreguara, në përputhje me Nenin 50 (2).

4. Çdo OST do të bashkërendojë analizën mbi kontigjencat në terma të listës koherente të kontigjencave së paku me OST-të nga zona e saj e observimit në përputhje me nenin 75.
5. Çdo OST do të informoje OST-të në zonën e saj të observimit për kontigjencat e jashtme të përfshira në listën e saj të kontigjencave.
6. Çdo OST do të informoje, mjaftueshëm në kohe, OST-të në zonën e tij të observimit për çdo ndryshim të topologjisë që synohet të behet në elementet e sistemit të transmetimit të tij, të cilët janë të përfshirë si kontigjenca të jashtme në listën e kontigjencave të OST në fjale.
7. Çdo OST duhet të sigurojë që të dhënat në kohë reale janë mjaftueshëm të sakta për të lejuar konvergjencën e llogaritjeve ngarkesës-flukse të cilat kryhen në analizën e kontigjencave.

Neni 34

Analiza e Kontigjencave

1. Çdo OST duhet të kryeje analizat e kontigjencave në zonën e saj të observimit me qëllim identifikimin e kontigjencave të cilat rrezikojnë ose mund të rrezikojnë sigurinë operacionale të zonës së tij të kontrollit si dhe për të identifikuar veprimet përmirësuese që mund të jene të nevojshme për të adresuar kontigjencat, përfshirë zbutjen e impaktit të kontigjencave të jashtëzakonshme.
2. OST do të sigurojë që devijimet e mundshme nga limitet e sigurisë operacionale në zonën e përgjegjësisë, që janë identifikuar nga analiza e kontingjencës nuk e rrezikojnë sigurinë operacionale të sistemit të transmetimit ose të sistemeve fqinje të ndërlidhura.
3. Çdo OST do të kryejë analizën e kontigjencave bazuar në parashikimin në kohë reale të te dhënave operacionale në zonën e saj e observimit. Pika e fillimit për analizat e kontingjencave në situatën – N do të jetë topologjia e përshtatshme e sistemit të transmetimit e cila do te perfshije ndërprerjet e planifikuara ne fazën e planifikimit operacional.

Neni 35

Trajtimi i Kontigjencave

1. OST do të vlerësojë rreziqet që lidhen me efektet e mundshme të kontingjencave dhe do të përgatisë veprimet përmirësuese pas testimit të çdo kontingjence nga lista e kontingjencave, dhe do të vlerësojë nëse mund të mbajë sistemin e transmetimit brenda limiteve të sigurisë operacionale në situatën (N-1).
2. Kur një OST vlerëson së rreziqet lidhur me kontigjencat janë aq të rëndësishme sa që OST nuk mund të jetë në gjendje të përgatisë dhe aktivizoje masat përmirësuese me mënyrën dhe kohën e duhur për të parandaluar papajtueshmërinë lidhur me plotësimin e kriterit (N-1) ose nëse paraqitet një rrezik për përhapjen e avarisë në sistemet e interkonektuara, OST do të përgatisë dhe aktivizoje veprimet përmirësuese për të arritur pajtueshmërinë me kriterin (N-1) sa me shpejt të jetë e mundur.

3. Në rastin e situatës (N-1) te shkaktuar nga një shqetesim, çdo OST do të zbatojë veprimet përmirësuese në mënyrë që të sigurohet rivendosja e sistemit të transmetimit në gjendje normale sa më shpejtë që është e mundur dhe kjo situatë (N-1) do të pershtatet në situatën e re (N).
4. Një OST-je nuk do ti kërkohet të jetë në pajtueshmëri me kriterin (N-1) në rrethanat e mëposhtme:

   a) gjatë sekuencave të shkyçjeve;
   b) gjate kohës së nevojshme për përgatitjen dhe aktivizimin e masave përmirësuese

5. Vetëm nëse një Palë Kontraktuese vendos ndryshe, një OST-je nuk do ti kërkohet që të jetë në pajtueshmëri me kriterin (N-1) për sa kohë që ka vetëm pasoja lokale brenda zonës së përgjegjësisë të OST-së;

Kapitulli 6

Mbrojtja

Neni 36

Kërkesa të përgjithshme mbi mbrojtjen

1. Çdo OST do të operoje sistemin e saj të transmetimit me pajisjet e nevojshme të mbrojtjes si dhe pajisjet rezervë të mbrojtjes, në mënyrë që të parandaloje përhapjen e avarive që mund të rrezikojnë sigurine operacionale të sistemit të saj të transmetimit si dhe sistemit të interkonektuar.
2. Çdo OST, të paktën çdo pesë vjet, do të shqyrtojë dhe të analizoje konceptet dhe strategjinë e mbrojtjes, dhe kur është e nevojshme do të përditesoje funksionet e mbrojtjes për të siguruar operimin e duhur të pajisjeve mbrojtëse dhe ruajtjen e sigurisë operacionale.
3. Pas çdo operimi të mbrojtjes që ka impakt jashtë zonës së saj të përgjegjësisë përfshirë intekonektorët, OST-ja do të vlerësojë nëse sistemi i mbrojtjes në Zonën e saj të Përgjegjësisë punoi sipas planit dhe duhet të ndërmarrë veprime përmirësuese nëse është e nevojshme.
4. Çdo OST do të përcaktoje tarimet (pikën e punës) për mbrojtjen e sistemit të transmetimit të saj, që sigurojnë besueshmëri, shpejtësi dhe selektivitet të pastrimit të avarisë në rast të mosfunksionimit të sistemit kryesor të mbrojtjes.
5. Para futjes në operim të pajisjeve të mbrojtjes kryesore dhe rezerve ose pas ndonjë modifikimi të mundshëm, çdo OST do të koordinojë më OST-të fqinje mbi vlerat e pikës së punës të mbrojtjve për interkonektorët, dhe do të koordinojë me ato, më përpara së të ndryshojë parametrat.

Neni 37

Skemat e veçanta të mbrojtjes

1. Në rastet kur përdoren skema speciale të mbrojtjes së Sistemit, OST do të:

   a) sigurohet që çdo skema speciale mbrojtje vepron në mënyrë selektive, të besueshme dhe efektive.
   b) kur harton një skeme mbrojtje speciale, OST duhet të vlerësojë pasojat për Sistemin e Transmetimit në rastin e ngjarjeve e veprimit të pasaktë të mbrojtjes duke marrë parasysh ndërveprimin me OST-të e prekura;
   c) te verifikojë së skema speciale të mbrojtjes ka një besueshmëri të krahasueshme me sistemin e mbrojtjes të përdorur në mbrojtjen primare të elementeve të sistemit të transmetimit;
   d) operojë sistemin e transmetimit me skema speciale të mbrojtjes brenda limiteve të sigurisë operacionale të përcaktuar, në përputhje me Nenin 25; dhe
   e) koordinojë funksionet e skemës speciale të mbrojtjes, parimet e aktivizimit dhe pikën e punës me OST-të fqinje, me OSSH-të dhe Përdoruesit e Rëndësishëm të Rrjetit të lidhura me rrjetin e transmetimit, përfshire dhe Rrjetat e Mbyllura të Shpërndarjes.

Neni 38

Monitorimi dhe vlerësimi i qëndrueshmërisë dinamike

1. Çdo OST do të monitorojë qëndrueshmërinë dinamike të Sistemit të me studime të kryera off-linene ne përputhje me paragrafin 6. Çdo OST do të shkëmbejë të dhënat relevante mbi monitorimin e qëndrueshmërisë dinamike të sistemit të transmetimit me OST-të e tjera të zonës sinkrone.
2. OST do të kryejë studime për Vlerësimin e Qëndrueshmërisë Dinamike (VQD) së paku një herë në vit, në mënyrë që të identifikohen kufijtë e qëndrueshmërisë dhe problemet e mundshme të stabilitet në sistemin e transmetimit. Të gjitha OST-të e çdo zone sinkrone do të koordinojnë vlerësimet e qëndrueshmërisë dinamike, të cilat do të mbulojnë të gjithë ose pjesë të zonës sinkrone.
3. Kur kryejnë analizat e qëndrueshmërisë dinamike, OST-të në fjalë do të përcaktojnë :

   a. fushën e vlerësimit të koordinuar mbi qëndrueshmërinë dinamike, së paku në terma të modelit të përbashkët të rrjetit
   b. grupi i të dhënave që duhet të shkëmbehet ndërmjet OST-ve përkatëse në mënyrë që të bëhet vlerësimi i koordinuar i qëndrueshmërisë dinamike;
   c. lista e skenarëve të përbashkët të dakorduar lidhur me vlerësimin e koordinuar të qëndrueshmërisë dinamike; dhe
   d. një listë të kontingjencave ose avarive të pranuara bashkërisht, ndikimi i të cilave do të vlerësohet nëpërmjet vlerësimit të koordinuar të qëndrueshmërisë dinamike.

4. Në rastin e problemeve të qëndrueshmërisë për shkak të shuarjes së dobët të oshilimeve ndërzonale që prekin disa OST brenda një zone sinkrone, çdo OST do të marre pjesë në analizat e koordinuara të qëndrueshmërisë dinamike në nivelin e zonës sinkrone si dhe ofroje të dhënat e nevojshme për ate analize sa me shpejt të jetë e mundur praktikisht dhe te siguroje te dhënat e nevojshme per ate analize. Analiza të tilla do të iniciohen dhe kryhen nga OST-të në fjalë ose nga ENTSO-E për Energjinë Elektrike, duke vepruar në përputhje me nenin 3 të Aktit Procedural Nr. 2022/01/MCEnC.
5. Kur OST identifikon ndikim potencial mbi tensionin, qëndrueshmërinë e këndit të rotorit ose qëndrueshmërinë e frekuencës, në lidhje me sistemet e interkonektuara të transmetimit, OST-ja respektive do të koordinojë metodat e përdorura në analizën e qëndrueshmërisë dinamike, duke siguruar të dhënat e nevojshme, dhe planifikuar veprimet e përbashkëta përmirësuese që synojnë në përmirësimin e qëndrueshmërisë, përfshirë procedurat e bashkëpunimit ndërmjet OST-ve.
6. Gjatë përcaktimit të metodave të përdorura në analizën e qëndrueshmërisë dinamike, çdo OST do të zbatojë rregullat e mëposhtme:

    a) në qoftë së në lidhje me listën e kontigjencave, limitet e gjendjes së qëndrueshme janë arritur para limiteve të stabilitetit, OST do të bazojë vlerësimin e qëndrueshmërisë dinamike të saj vetëm në studimet e stabilitetit off-line që kryen në fazën e planifikimit operativ afatgjatë;
    b) nëse, nën kushtet e ndërprerjeve të planifikuara, duke marre në konsiderate listën e kontingjencave, limitet e gjendjes së qëndrueshme dhe limitet e stabilitetit janë të afërta me njëri – tjetrin ose limitet e stabilitetit arrihen para limiteve të gjendjes së qëndrueshme, OST do të kryejë vlerësimin e qëndrueshmërisë dinamike të saj në fazën ë planifikimit operativ te ditës ne avance ndërsa kushtet e ndërprerjes mbeten. OST do të përgatisë veprimet përmirësuese që do të përdoren në në kohë reale

    c) nëse sistemi i transmetimit është në situatën-N në lidhje me listën e kontingjencave dhe limitet e stabilitetit janë arritur para limiteve të gjendjes së qëndrueshme, OST duhet të kryejë vlerësim të qëndrueshmërisë dinamike në të gjitha fazat e planifikimit operativ, dhe të ri-vlerësojë limitet e qëndrueshmërisë, sa më shpejt të jetë e mundur, pas zbulimit të çdo ndryshimi të rëndësishëm në situatën-N.

Neni 39

Menaxhimi i Qëndruëshmërisë dinamike

1. Kur vlerësimi i qëndrueshmërisë dinamike tregon së ekziston një cenim i kufijve të qëndrueshmërisë, OST-të në zonën e kontrollit të së cilës është shfaqur rreziku, duhet të hartojnë, përgatisin dhe aktivizojnë veprimet përmirësuese për të mbajtur sistemin e transmetimit në gjendje të qëndrueshme. Këto veprime përmirësuese mund të përfshijnë Përdoruesit e Rëndësishëm të Rrjetit.
2. Çdo OST do të sigurohet që koha e pastrimit të l.sh., për l.sh. që mund të çojnë në përhapjen e paqëndrueshmërisë në shkalle të gjerë në sistem, është më e vogël së koha kritike e pastrimit

të l.sh. e llogaritur nga OST në studimin e saj të vlerësimit të qëndrueshmërisë dinamike të kryer në përputhje me Nenin 38.

3. Ne lidhje kërkesat për inerci minimale të cilat janë të rëndësishme për qëndrueshmërinë e frekuencës në nivel të zonës sinkrone:

   a) te gjithë OST-të e Zonës Sinkrone, jo me vone së 2 vite pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, do të kryejnë një studim të përbashkët për zonën sinkrone për të identifikuar inercinë minimale të nevojshme duke marre parasysh kostot dhe përfitimet si dhe alternativat e mundshme. Çdo OST do të informoje autoritetin e saj rregullator mbi këto studime të kryera. Të gjithë OST-të, do të rishikojnë periodikisht dhe përditësojnë këto studime çdo dy vjet.
   b) ku studimet sipas pikës (a) demonstrojnë nevojën për të përcaktuar inercinë minimale të nevojshme, të gjithë OST-të nga zona sinkrone përkatëse duhet të zhvillojnë së bashku një metodologji për përcaktimin e inercisë minimale që kërkohet për të ruajtur sigurinë operacionale dhe për të parandaluar cenimin e kufijve të qëndrueshmërisë. Kjo metodologji duhet të respektojë parimet e efikasitetit dhe proporcionalitetit dhe duhet të hartohet brenda 6 muajve pas përfundimit të studimeve të përmendura në pikën (a) dhe do të përditësohet brenda 6 muajve pasi studimet të përditësohen dhe bëhen të disponueshme;
   c) çdo OST duhet të vendosë në operimin në kohë reale inercinë minimale në zonën e saj të kontrollit, sipas metodologjisë së përcaktuar dhe rezultateve të fituara në përputhje me paragrafin (b).

TITULLI 2

SHKEMBIMI I TË DHËNAVE

Kapitulli 1

Kërkesa të përgjithshme mbi shkëmbimin e të dhënave

Neni 40

Organizimi, rolet, përgjegjësitë dhe cilësia e të dhënave të shkëmbyera

1. Shkëmbimi dhe dhënia e të dhënave dhe informacionit në përputhje me këtë Titull do të reflektojë, në masën e mundshme gjendjen në kohë reale dhe të parashikuar të sistemit të transmetimit.
2. Çdo OST do të jetë përgjegjëse për përdorimin dhe sigurimin me cilësi të lartë të të dhënave dhe informacionit të përdorur.
3. Çdo OST do të mbledhë informacionin e mëposhtëm mbi zonën e saj të observimit dhe do ti shkëmbejë këto të dhëna me të gjithë OST-të e tjera në masën që e nevojshme për kryerjen e analizës së sigurisë operacionale në përputhje me Nenin 72:

a) gjenerimi;
b) konsumi;
c) skedulimet;
d) pozicionet e balancës;
e) remontet e planifikuara dhe topologjitë e nënstacioneve; dhe
f) parashikimet e veta.

4. Çdo OST do të përfaqësojë informacionin në paragrafin (3) si injektim dhe tërheqje ne çdo nyje të modelit individual të Sistemit të Transmetimit në përputhje me Nenin 64.
5. Ne bashkëpunim me OSSH-të dhe Përdoruesit e Rëndësishëm të Rrjetit, çdo OST do të përcaktojë fushë-veprimin e shkëmbimit të të dhënave sipas kategorive të mëposhtme:
   a) të dhëna strukturore në përputhje me Nenin 48;

   b) skedulimi dhe të dhënat e parashikimit në përputhje me Nenin 49;

   c) të dhënat në kohë reale në përputhje me Nenin 44,47 dhe 50;

   d) dispozitat në përputhje me Nenin 51, 52 dhe 53;.

6. 6 muaj pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, OST-të do të aplikojnë kërkesat kryesore organizative, rolet dhe përgjegjësitë në lidhje me shkëmbimin e të dhënave, të miratuar në përputhje me Rregulloren (BE) 2017/1485 <...>
7. 18 muaj pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, çdo OST dhe OSSH do të bashkëpunojnë në mënyrë që të përcaktojnë dhe të bien dakord mbi proceset efektive për sigurimin dhe menaxhimin e shkëmbimit të të dhënave midis tyre, duke përfshirë sigurimin e të dhënave të lidhura me rrjetin e shpërndarjes dhe të përdorueseve të rëndësishëm të lidhur në këtë rrjet. Pa cenuar dispozitat e paragrafit 6 (g), çdo OST do të pajtohet me OSSh-të përkatëse mbi formatin për shkëmbimin e të dhënave.
8. Përdoruesit e rëndësishëm të rrjetit të lidhur me transmetimin do të kenë akses në të dhënat e pikës së lidhjes në lidhje me instalimet e rrjetit të tyre të komisionuara.
9. Çdo OST do të bjerë dakord me OSSh-të e lidhura me transmetimin për fushën e informacionit shtesë që do të shkëmbehet ndërmjet tyre në lidhje me instalimet e rrjetit të komisionuara.
10. OSSH-të me pikë lidhje në një sistem transmetimi do të kenë të drejtën të marrin informacionin përkatës strukturor, të skeduluar dhe në kohë reale nga OST-të përkatëse dhe të mbledhin informacionin e rëndësishëm strukturor, të skeduluar dhe në kohë reale nga OSSh-të fqinje. OSSh-të fqinje do të përcaktojnë, në mënyrë të koordinuar, fushëveprimin e informacionit që mund të shkëmbehet.

Kapitulli 2

SHKEMBIMI I TË DHËNAVE NDËRMJET OST-ve

Neni 41

Shkëmbimi i të dhënave strukturore dhe të parashikuara

1. OST do të shkëmbejë me OST-të fqinje informacion strukturor, lidhur me zonën e observimit, duke përfshirë të paktën:

    a) Topologjinë e zakonshme te nënstacioneve dhe të dhëna të tjera përkatëse sipas nivelit të tensionit;

    b) Te dhënat teknike mbi linjat e transmetimit;

    c) Te dhënat teknike mbi transformatorët lidhës me OSSH, dhe përdoruesit e rëndësishëm të rrjetit qe janë objekte konsumatore dhe blloqet e transformimit te përdoruesve te rëndësishëm të rrjetit qe jane objekte gjenerimi;

    d) Maksimumin dhe minimumin e fuqisë aktive dhe reaktive të përdorueseve të rëndësishëm të Rrjetit që janë Module Gjenerimi;

    e) Te dhënat teknike mbi transformatorët e ndryshimit të fazës;

    f) Te dhënat teknike mbi Linjat e tensionit të lartë DC;

    g) Te dhënat teknike mbi reaktorët, kapacitorët dhe kompensatorët statikë VAR; dhe

    h) Limitet e sigurisë operacionale të përcaktuara nga çdo OST, sipas nenit 25.

2. Për të koordinuar pikën e punës ndërmjet sistemeve te transmetimit OST fqinje do të shkëmbejnë pikat e punës (tarimet) te mbrojtjes së linjave per të cilat kontingjencat janë përfshirë si konitigjenca të jashtme në listat e tyre te kontingjencave.
3. Per te koordinuar analizën e sigurisë operacionale dhe krijimin e modeleve të përbashkëta të rrjetit në përputhje me nenet 67,68,69 dhe 70, çdo OST do të shkëmbeje së paku me të gjithë OST-të e tjera të te njëjtës zonës sinkrone, të paktën të dhënat e mëposhtme:
    a) topologjinë e Sistemit të Transmetimit 220 kV e lart, për zonën e saj të kontrollit;

    b) një model ose një ekuivalente të Sistemit të Transmetimit me tension nën 220 kV me ndikim të rëndësishëm në sistemin e tij të transmetimit; dhe

    c) kufijtë termike të elementeve të sistemit të transmetimit; dhe

d) një parashikim real dhe i saktë i sasise totale te injektimit dhe tërheqjes, për burim primar të energjisë, në çdo nyje të sistemit të transmetimit, për periudha të ndryshme kohore.

4. Per te koordinuar vlersimin e Qëndrueshmërisë Dinamike në përputhje me Nenin 38(2) dhe (4), dhe për t'i realizuar ato çdo OST do të shkëmbejë me OST-të tjera të të njëjtës zone sinkrone ose pjesëve relevante të saj, të dhënat e mëposhtme:
   a. të dhëna në lidhje me SGU-të të cilat janë module gjeneruese të energjisë që kanë të bëjnë me, por nuk kufizohen ne:

      i. parametrat elektrikë të alternatorit të përshtatshëm për vlerësimin e stabilitetit dinamik, duke përfshirë inercinë totale;

      ii. modelet e mbrojtjes;

      iii. alternatori dhe forcën lëvizëse primare;

      iv. përshkrim i transformatorëve ngritës;

      v. minimumin dhe maksimumin e energjisë reaktive;

      vi. modelet e rregullatorit të tensionit dhe shpejtësisë; dhe

      vii. modelet e sistemit të eksitimit dhe të lëvizësit primar, të përshtatshme për luhatje të mëdha.

   b. Te dhëna lidhur me tipin e rregullimit dhe diapazonin e rregullimit te tensionit ne lidhje me ndryshimin e ancafkave, përfshirë përshkrimin e njësive ekzistuese me ndryshim te ancafkave ne ngarkese, dhe të dhënave mbi tipin e rregullimit dhe diapazonin e rregullimit te tensionit ne lidhje me transformatoret ngritës dhe te rrjetit; dhe

   c. Te dhëna ne lidhje me sistemet HVDC dhe pajisjet FACTS për modelet dinamike të sistemit ose pajisjes dhe rregullimin e saj të përshtatshëm për luhatje të madhe.

Neni 42

Shkëmbimi i të dhënave në kohë reale

1. Në përputhje me Nenin 18 dhe 19, çdo OST do të shkëmbejë me OST-të e tjera në të njëjtën Zonë Sinkrone të dhënat e nevojshme mbi gjendjen e Sistemit të Transmetimit duke përdorur mjetet IT për shkëmbimin e të dhënave në kohë reale në nivel pan-Evropian, duke përfshirë:
   a) frekuencën;
   b) kontrolli i gabimit të rivendosjes së frekuencës
   c) matjet e fuqisë aktive të shkëmbyer midis zonave LFC;

d) injektimin shumator të gjenerimit;
e) gjendjen e Sistemit në përputhje me nenin 18;
f) pika e punës e caktuar për kontrollin ngarkesë-frekuencë; dhe
g) shkëmbimin e energjisë nëpërmjet Linjave të Interkoneksionit Virtuale.

2. Çdo OST do të shkëmbejë me OST-të nga zona e saj e observimit, të dhënat e mëposhtme të Sistemit të saj të Transmetimit duke përdorur shkëmbimin e të dhënave në kohë reale nëpërmjet sistemeve SCADA dhe sistemeve te menaxhimit të energjisë të tyre:
   a) topologjinë aktuale të nënstacioneve;
   b) fuqinë aktive dhe reaktive në traktin (daljen) e linjës, duke përfshirë transmetimin, shpërndarjen dhe linjat që lidhin përdoruesit e rëndësishëm të rrjetit;
   c) fuqinë aktive dhe reaktive në traktin (daljen) e transformatorit, duke përfshirë transmetimin, shpërndarjen dhe transformatorët lidhës të përdorueseve të rëndësishëm të rrjetit;
   d) fuqinë aktive dhe reaktive në traktin (daljen) e objektit të fuqisë gjeneruese;
   e) pozicionet e rregullimit (ancafkave) të transformatorëve, duke përfshirë transformatorët e rregullimit fazor;
   f) tensionin e matur ose të vlerësuar të zbarave;
   g) fuqinë reaktive në daljen e reaktorit, kondensatorit ose nga një kompensator statik VAR; dhe
   h) kufizimet në aftësisë furnizuese të fuqisë aktive dhe reaktive, në lidhje me zonën e observimit

3. Çdo OST ka të drejtë të kërkojë nga të gjithë OST-të nga zona e saj e observimit që të ofrojnë fotografi (snapshoot) në kohë reale të të dhënave të vlerësuara të gjendjes nga ajo zonë kontrolli e OST-se nëse kjo është e rëndësishme për sigurinë operacionale të sistemit të transmetimit të OST-së që i kërkon.

Kapitulli 3

Shkëmbimi i të dhënave ndërmjet OST dhe OSSH brenda zonës së kontrollit të OST-së

Neni 43

Shkëmbimi i të dhënave strukturore

1. Çdo OST do të përcaktojë zonën e observimit të rrjetit të shpërndarjes të lidhur në transmetim, që është e nevojshme për OST-ne, për të përcaktuar me saktësi dhe në mënyrë efikase gjendjen e Sistemit, bazuar në metodologjinë e hartuar në përputhje me Nenin 75.
2. Nëse një OST konsideron se një sistem shpërndarjeje jo i lidhur me transmetimin ka një ndikim të rëndësishëm në lidhje me tensionin, flukset e fuqisë ose parametra të tjerë elektrikë për

paraqitjen e sjelljes se sistemit te transmetimit, një sistem i tillë shpërndarjeje do të përcaktohet nga OST si pjesë e zonës se vëzhgimit në përputhje me nenin 75.

3. Informacioni strukturor në lidhje me zonën e vëzhgimit të përmendur në paragrafët 1 dhe 2 të ofruar nga çdo OSSH për OST-në duhet të përfshijë të paktën::

    a) nënstacionet sipas tensionit;
    b) linjat që lidhin nënstacionet referuar nga pika (a);
    c) transformatorët e nënstacioneve referuar nga pika (a);
    d) përdoruesit e rëndësishëm të rrjetit; dhe
    e) reaktorët dhe kapacitorët e lidhur me nënstacionet referuar nga pika (a).

4. Çdo OSSH e lidhur në rrjetin e transmetimit, do ti sigurojë për OST-së informacion strukturor të përditësuar në përputhje me paragrafin 3 së paku çdo gjashtë muaj.

5. Të paktën një herë në vit, çdo OSSH e lidhur me rrjetin e transmetimin duhet ti ofrojë OST-se, sipas burimeve primare të energjisë, kapacitetin gjenerues total të gjenerimit nga modulet gjeneruese të tipit A që i nënshtrohen kërkesave të Rregullores (EU) 2016/631 siç është përshtatur dhe miratuar nga Vendimi i Grupit te Përhershëm te Nivelit të Lartë 2018/03/PHLG-EnC dhe vlerësimet më të mira të mundshme të kapacitetit gjenerues të moduleve gjeneruese të tipit A që nuk i nënshtrohen ose janë të përjashtuara nga Rregullorja (BE) 2016/631, siç është përshtatur dhe miratuar nga Vendimi i Grupit të Perhershem te Nivelit të Lartë 2018/03/PHLG-EnC, të lidhura me sistemin e saj të shpërndarjes si dhe informacionin përkatëse lidhur me sjelljen e tyre ndaj frekuencës.

Neni 44

Shkëmbimi i të dhënave në kohë reale

Përveç nëse parashikohet ndryshe nga OST, çdo OSSH do t'i sigurojë OST-së, në kohë reale, informacionin që lidhet me zonën e vëzhgimit të OST-së siç referohet në Nenin 43 (1) dhe (2), duke përfshirë:

a) Topologjia aktuale e nënstacioneve;
b) Fuqinë aktive dhe reaktive në traktin e linjës;
c) Fuqinë aktive dhe reaktive në traktin e transformatorit;
d) Fuqinë aktive dhe reaktive të injektuar në traktin e objektit gjenerues;
e) Pozicionet e ancafkave të transformatorëve të lidhur me Sistemin e Transmetimit;
f) Tensionet e zbarave;
g) Fuqinë reaktive në traktin e reaktorit dhe kondensatorit;
h) Të dhënat më të mira në dispozicion për gjenerimin e agreguar per burim primar te energjisë në zonën e OSSH; dhe
i) Të dhënat më të mira në dispozicion për konsumin e agreguar në zonën e OSSH.

Kapitulli 4

Shkëmbimi i të dhënave ndërmjet OST-ve, pronarëve të interkonektoreve apo linjave të tjera dhe Moduleve të Gjenerimit të lidhur me Sistemin e Transmetimit

Neni 45

Shkëmbimi i të dhënave strukturore

1. Çdo SGU që është pronar i një objekti gjenerues të një moduli gjenerues të energjisë elektrike të tipit D, i lidhur në sistemin e transmetimit duhet të sigurojë për OST-në, të paktën të dhënat e mëposhtme:

   a) të dhënat të përgjithshme të modulit të gjenerimit te energjisë, duke përfshirë kapacitetin e instaluar dhe burimin primar të energjisë;
   b) të dhëna për aftësinë e turbinës dhe gjeneratorit, përfshirë kohën për lëshimin në gjendje të ftohtë dhe të ngrohtë;
   c) të dhënat për llogaritjen e rrymës se lidhjes së shkurtër;
   d) të dhënat e transformatorit të objektit gjenerues të energjisë;
   e) të dhëna për rezervën e mbajtjes së frekuencës për objektet e gjenerimit që e ofrojnë ose sigurojnë këtë shërbim, në përputhje me Nenin 154;
   f) të dhëna për rezervën e rivendosjes së frekuencës, për modulet e gjenerimit të fuqisë që që e ofrojnë ose sigurojnë këtë shërbim në përputhje me Nenin 158
   g) të dhëna për rezervën zëvendësuese për modulet e gjenerimit të fuqisë që e ofrojnë ose sigurojnë këtë shërbim në përputhje me nenin 161
   h) të dhënat e nevojshme për rivendosjen e sistemit te transmetimit;
   i) të dhënat dhe modelet e nevojshme për kryerjen e simulimeve dinamike;
   j) të dhënat e mbrojtjes;
   k) të dhënat e nevojshme për përcaktimin e kostove të veprimeve përmirësuese në përputhje me nenin 78(1)(b); kur një OST përdor mekanizma të bazuar në treg në përputhje me Nenin 4(2)(d), ofrimi i çmimeve që duhet të paguhen nga OST do të konsiderohet i mjaftueshëm;
   l) aftësia e kontrollit të tensionit dhe fuqisë reaktive.
2. Çdo përdorues i rëndësishëm i rrjetit i cili është pronar i një objekti gjenerimi te energjisë i tipit B ose C te moduleve gjenerues te energjisë i lidhur në rrjetin e transmetimit, do të sigurojë për OST-ne së paku të dhënat e mëposhtme:
   a) të dhënat të përgjithshme të modulit të gjenerimit te energjisë, duke përfshirë kapacitetin e instaluar dhe burimin primar të energjisë;
   b) të dhënat për llogaritjen e rrymës se lidhjes se shkurtër;
   c) të dhëna për rezervën e mbajtjes së frekuencës për objektet e gjenerimit që e ofrojnë ose sigurojnë këtë shërbim, sipas përcaktimeve dhe kërkesave të Nenit 173;

d) të dhëna për rezervën e rivendosjes së frekuencës, për modulet e gjenerimit të fuqisë që e ofrojnë ose sigurojnë këtë shërbim;
e) të dhëna për rezervën zëvendësuese për modulet e gjenerimit të fuqisë që e ofrojnë ose sigurojnë kete shërbim;
f) të dhënat e mbrojtjes; dhe
g) aftësia e kontrollit të fuqisë reaktive.
h) të dhënat e nevojshme për përcaktimin e kostove të veprimeve përmirësuese në përputhje me nenin 78(1)(b); kur një OST përdor mekanizma të bazuar në treg në përputhje me Nenin 4(2)(d), ofrimi i çmimeve që duhet të paguhen nga OST do të konsiderohet i mjaftueshëm;
i) të dhëna të nevojshme për kryerjen e analizave të qëndrueshmërisë dinamike në përputhje me Nenin 38.

3. OST mund t'i kërkojë çdo pronari të një objekti gjenerues te moduit gjenerues te energjise, të lidhur me Sistemin e Transmetimit, të sigurojë të dhëna të mëtejshme kur eshte e nevojshme për Analizën e Sigurisë Operacionale në përputhje me Titullin 2 të Pjesës III.
4. Çdo pronar interkonektori ose linje HVDC do t'i sigurojë OST-së, të paktën të dhënat e mëposhtme në lidhje me sistemin HVDC:
   a) të dhënat e targetes së instalimit;
   b) të dhënat e transformatorëve;
   c) të dhënat për filtrat dhe bateritë e filtrave;
   d) të dhënat e kompensimit te fuqisë reaktive;
   e) aftësia e kontrollit të fuqisë aktive;
   f) aftësia e kontrollit të fuqisë reaktive dhe tensionit;
   g) mënyra e prioritetit operacional aktive ose reaktive, nëse ekziston;
   h) aftësia për përgjigje ndaj frekuencës;
   i) modelet dinamik për simulimet dinamike;
   j) të dhënat e mbrojtjes; dhe
   k) aftësia për FRT ()

5. Çdo pronar interkonektori AC do t'i sigurojë OST-së, të paktën të dhënat e mëposhtme:

   a) të dhënat e targetes së instalimit;
   b) parametrat elektrike; dhe
   c) mbrojtjet shoqeruese.

Neni 46

Shkëmbimi i të dhënave të skeduluara

1. Çdo Përdorues i rëndësishëm i rrjetit që është pronar i një objekti gjenerimi të energjisë të tipit B, C ose D, te moduleve gjenerues të energjisë të lidhur me rrjetin e transmetimit duhet t'i sigurojë OST-së të paktën të dhënat e mëposhtme:
   a) prodhimin e fuqisë aktive dhe sasinë e rezervave te fuqisë aktive dhe disponueshmërinë, me bazë diten ne avance dhe brenda ditës;

b) pa vonesa, çdo padisponueshmeri të planifikuar ose kufizim të fuqisë aktive;
c) çdo kufizim të parashikuar në aftësinë për kontroll të fuqisë reaktive; dhe
d) si përjashtim nga pikat (a) dhe (b), në rajonet me sistem qendror dispeçerimi, të dhënat e kërkuara nga OST për përgatitjen e skedulit të prodhimit të fuqisë aktive.

2. Çdo operator i sistemit HVDC duhet t'i sigurojë TSO-ve të paktën të dhënat e mëposhtme:
   a) skedulin e fuqisë aktive dhe disponueshmëria në baza ditë ne avance dhe brenda-ditës;
   b) pa vonesë, padisponueshmërinë e tij të planifikuar ose kufizim të fuqisë aktive dhe
   c) çdo kufizim të parashikuar në aftësinë për kontroll të fuqisë reaktive ose tensionit.
3. Çdo interkonektor AC ose operator linjë do ti sigurojë OST-ve, padisponueshmërinë e planifikuar ose kufizimet e të dhënave mbi të fuqise aktive.

Neni 47

Shkëmbimi i të dhënave në kohë reale

1. Përveç rasteve kur nga OST parashikohet ndryshe, çdo përdorues i rëndësishëm i rrjetit i cili është pronar i objektit gjenerues te energjisë i tipit B,C ose D, te moduleve gjenerues te energjisë, do t'i sigurojë OST-së në kohë reale informacionin e mëposhtëm:

   a) pozicionin e çelësave në pikën e lidhjes, ose një tjetër pikë ndërveprimi të rënë dakord me OST-në;
   b) fuqinë aktive dhe reaktive në pikën e lidhjes, ose një tjetër pikë ndërveprimi të rënë dakord me OST-në;
   c) në rast të nje objekti gjenerues te energjise me konsum tjetër përveç atij të nevojave vetjake, fuqinë aktive dhe reaktive.

2. Përveç rasteve kur nga OST parashikohet ndryshe, çdo pronar sistemi HVDC ose interkonektori AC do te siguroje, në kohë reale të paktën të dhënat e mëposhtme në lidhje me pikën e lidhjes së sistemit HVDC ose interkonektorin AC me OST-të:
   a) pozicionin e çelësave;
   b) statusin e operimit; dhe
   c) fuqinë aktive dhe reaktive.

Kapitulli 5

Shkembimi i të dhënave ndërmjet OST-ve OSSH-ve dhe moduleve gjeneruese të energjise te lidhura në shpërndarje

Neni 48

Shkembimi i të dhënave strukturore

1. Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga OST, çdo pronar i një objekti gjenerimi te energjise te nje moduli te gjenerimit te energjise që është përdorues i rëndësishëm i rrjetit në përputhje me Nenin 2(1)(a) dhe nga agregimi i përdoruesve te rëndësishëm te rrjetit në përputhje me Nenin 2(1)(e) te lidhur me rrjetin e shpërndarjes, do t'i sigurojë OST-së dhe OSSH-së në të cilën ai ka pikën e lidhjes, së paku të dhënat e mëposhtme:

   a) Të dhënat e përgjithshme për modulet e gjenerimit, duke përfshirë kapacitetin e instaluar dhe burimin primar të energjisë ose llojin e karburantit;
   b) Të dhënat për rezervën e mbajtjes së frekuencës ne përputhje përkufizimet dhe kerkesat e nenit 173 për objektet gjeneruese te energjise të cilat e ofrojnë ose sigurojne shërbimin FCR;
   c) Të dhënat për rezervën e rivendosjes së frekuencës për objketet gjeneruese te energjise që ofrojnë ose sigurojne shërbim FRR;
   d) Të dhënat për rezervën zëvendësuese për modulet gjeneruese te energjise që ofrojnë ose sigurojne shërbim RR;
   e) Të dhënat e mbrojtjes;
   f) Mundësinë e kontrollit të fuqisë reaktive;
   g) Mundësinë e kontrollit në distancë të çelësave;
   h) Të dhënat e nevojshme për kryerjen e simulimit dinamikne përputhje me Rregulloren e EU 2016/631; siç është përshtatur dhe miratuar nga Vendimi i Grupit të Perhershem te Nivelit të Lartë 2018/03/PHLG-EnC;dhe
   i) Nivelin e tensionit dhe vendndodhjen e çdo moduli gjenerues te energjise.

2. Çdo pronar i një objekti gjenerimi te energjisë te modulit gjenerues te energjisë që është përdorues i rëndësishëm i rrjetit në përputhje me Nenin 2(1)(a) dhe (e) do te informoje OST-së dhe OSSH-së në të cilën ai ka pikën e lidhjes, brenda afatit të rënë dakord por para komisionimit të parë ose përpara çdo ndryshimi në instalimin ekzistues, për çdo ndryshim në fushështrirjen dhe përmbajtjen e të dhënave të listuara në paragrafin 1.

Neni 49

Shkëmbimi i të dhënave të skeduluara

1. Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga OST, çdo pronar i një objekti gjenerimi te energjisë te modulit gjenerues te energjisë që është përdorues i rëndësishëm i rrjetit në përputhje me Nenin 2(1)(a) dhe Nenin 2(1)(e) i cili është i lidhur me rrjetin e shpërndarjes

do t'i sigurojë OST-së dhe OSSH-së në të cilën ai ka pikën e lidhjes, së paku të dhënat e mëposhtme:

a) padisponueshmërinë e planifikuar, kufizimet e planifikuara të fuqisë aktive dhe prodhimin e fuqisë aktive në pikën e lidhjes;
b) Çdo kufizim të parashikuar në aftësinë për kontroll të fuqisë reaktive; dhe
c) si përjashtim nga paragrafët (a) dhe (b), në rajonet me sistem qendror të dispeçerimit, të dhënat e kërkuara nga OST për përgatitjen e skedulit të prodhimit të energjisë aktive.

Neni 50

Shkëmbimi i të dhënave në kohë reale

1. Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga OST, çdo pronar i një objekti gjenerimi te energjisë te modulit gjenerues te energjisë që është përdorues i rëndësishëm i rrjetit në përputhje me Nenin 2(1)(a) dhe (e) i cili është i lidhur me rrjetin e shpërndarjes do t'i sigurojë në kohë reale OST-së dhe OSSH-së në të cilën ai ka pikën e lidhjes, së paku të dhënat e mëposhtme:
   a) Statusin e pajisjeve komutuese dhe çelësave në pikën e lidhjes; dhe
   b) Flukset e fuqisë aktive dhe reaktive, rrymën, dhe tensionin në Pikën e Lidhjes.

2. Çdo OST do të përcaktojë në koordinim me OSSH-në përgjegjëse, cilët përdorues të rëndësishëm të rrjetit mund të përjashtohen nga dërgimi i të dhënave në kohë reale te listuara ne paragrafin 1, direkt tek OST-së. Në raste të tilla OST përgjegjëse dhe OSSH do të dakordojnë mbi të dhënat e agreguara në kohe-reale të përdoruesve të rëndësishëm te prekur të rrjetit që do ti jepen OST-se.

Neni 51

Shkëmbimi i të dhënave ndërmjet OST-ve dhe DSO-ve në lidhje me modulet e rëndësishme të gjenerimit te energjisë

1. Përveç nëse nga OST parashikohet ndryshe, çdo OSSH do t'i sigurojë OST-së informacionin e specifikuar në nenet 48, 49 dhe 50 në shpështësine e dhe nivelin e detajimit te kërkuar nga OST.
2. Çdo OST do të vë në dispozicion të OSSH-së, në sistemin e shpërndarjes së të cilës janë të lidhur përdoruesit e rëndësishëm të rrjetit, informacionin e specifikuar në nenet 48, 49 dhe 50 siç kërkohet nga OSSh.
3. OST mund të kërkojë të dhëna të mëtejshme nga një pronar i një objekti gjenerues te energjise te modulit gjenerues te energjise i cili është përdorues i rëndësishme i rrjetit në përputhje me Nenin 2 (1) (a) dhe (e) i lidhur me sistemin e shpërndarjes, nëse është e nevojshme për analizën e sigurisë operacionale dhe validimin e modeleve,

KAPITULLI 6

Shkëmbimi i të dhënave ndërmjet OST-ve dhe objekteve konsumatorë

Neni 52

Shkëmbimi i të dhënave ndërmjet OST-ve dhe objekteve konsumatorë të lidhura në transmetim

1. Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga OST, çdo pronar i një objekti konsumator të lidhur me rrjetin e transmetimit duhet të sigurojë në OST të dhënat strukturore në vijim:
   a) të dhënat elektrike të transformatorëve të lidhur me sistemin e transmetimit;
   b) karakteristikat e ngarkesës së objektit konsumator; dhe
   c) karakteristikat e kontrollit të fuqisë reaktive.
2. Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga OST, çdo pronar i një objekti konsumator të lidhur me rrjetin e transmetimit duhet të sigurojë në OST të dhënat në vijim:

   a) skedulimin e konsumit aktiv dhe parashikimin e konsumit reaktiv në bazën e "ditës ne avance" dhe "Brenda-Ditës", duke përfshirë çdo ndryshim të këtyre skedulimieve apo parashikimeve;
   b) çdo kufizim te parashikuar te aftësisë se kontrollit të fuqisë reaktive;
   c) ne rastet kur merr pjesë në grupin e konsumatorëve rregullues, nje skedul në lidhje me minimumin dhe maksimumin struktural te diapazonit te fuqisë që mund të kufizohet; dhe
   d) duke përjashtuar piken (a), në rajonet me dispeçerim qëndror, të dhënat e kërkuara nga OST për përgatitjen e skedulit të prodhimit të saj të fuqisë aktive.

3. Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga OST, çdo pronar i objektit konsumator do të sigurojë në kohë reale për OST-në të dhënat e mëposhtme:

   a) fuqinë aktive dhe reaktive në pikën e lidhjes; dhe
   b) minimumin dhe maksimumin e diapazonit te fuqisë që do të mund të kufizohet.

4. Çdo pronar i një objekti konsumator të lidhur me transmetimin do të përshkruajë për OST-në e tij sjelljen e tij në diapzonet e tensioneve të përmendura në Nenin 27.

Neni 53

Shkëmbimi i të dhënave mes OST-ve dhe objekteve konsumatore të lidhura me shpërndarjen ose palëve të treta që marrin pjesë në përgjigjen e ngarkeses.

1. Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga OST, çdo Përdorues i Rëndësishëm i Rrjetit (SGU) që është një objekt konsumator i lidhur me shpërndarjen dhe që merr pjesë në përgjigjen e kërkesës, përveçse përmes një pale të tretë, duhet të sigurojë të dhënat e mëposhtme të planifikuara dhe në kohë reale për OST-në dhe për OSSH:

a) fuqia strukturale aktive minimale dhe maksimale e disponueshme për përgjigjen e ngarkesës dhe kohëzgjatja maksimale dhe minimale e çdo përdorimi të mundshëm të kësaj fuqie për përgjigjen e ngarkesës;
b) një parashikim i fuqisë aktive të pakufizuar që është disponibël për përgjigje të ngarkesës dhe cdo përgjigje e ngarkesës e planifikuar;
c) fuqia aktive dhe reaktive në kohë reale në pikën e lidhjes; dhe
d) një konfirmim që janë zbatuar vlerësimet e vlerave aktuale të përgjigjes së ngarkesës.

2. Përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe nga OST, çdo Përdorues i Rëndësishëm i Rrjetit (SGU) që është palë e tretë dhe merr pjesë në përgjigjen e ngarkesës siç përcaktohet në Nenin 27 të Rregullores (BE) 2016/1388, siç është përshtatur dhe miratuar me Vendimin e Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë 2018/05/PHLG-EnC, duhet t'i sigurojë OST-së dhe OSSH në ditën në avancë dhe afër kohës reale, në emër të të gjitha objekteve të ngarkesës të lidhura me shpërndarjen, të dhënat e mëposhtme:
   a) fuqia strukturale aktive minimale dhe maksimale e disponueshme për përgjigjen e ngarkesës dhe kohëzgjatja maksimale dhe minimale e çdo aktivizimi të mundshëm të përgjigjes së ngarkesës në një zonë gjeografike specifike të përcaktuar nga OST dhe OSSH;
   b) një parashikim i fuqisë aktive të pakufizuar të disponueshme për përgjigjen e ngarkesës dhe çdo nivel i planifikuar i përgjigjes së ngarkesës në një zonë gjeografike specifike të përcaktuar nga TSO dhe OSSH;
   c) fuqia aktive dhe reaktive në kohë reale; dhe
   d) një konfirmim që janë zbatuar vlerësimet e vlerave aktuale të përgjigjes së ngarkesës.

.

TITULLI 3

PAJTUESHMERIA

Kapitulli 1

Rolet dhe përgjegjësitë

Neni 54

Përgjegjësia e Përdoruesve të Rëndësishëm të Rrjetit

1. Çdo përdorues i rëndësishëm i rrjetit do të njoftojë OST-në ose OSSH-në, në të cilën ka një pikë lidhje, për çdo modifikim të planifikuar të kapaciteteve të tij teknike që mund të ketë ndikim në pajtueshmërinë e tij me kërkesat e kësaj Rregulloreje, para së të realizohet.
2. Çdo përdorues i rëndësishëm i rrjetit duhet të njoftojë OST-në ose OSSH-në, në të cilën ka një pikë lidhje, për çdo shqetesim operacional në objektin e tij që mund të ketë ndikim në

pajtueshmërinë e tij me kërkesat e kësaj Rregulloreje, sa më shpejt të jetë e mundur pas ndodhisë së saj.

3. Çdo përdorues i rëndësishëm i rrjetit duhet të njoftojë OST-në ose OSSH-në, në të cilën ka një pikë lidhje, për oraret dhe procedurat e planifikuara të testimeve që do të ndiqen për verifikimin e pajtueshmërisë së objektit të tij me kërkesat e kësaj Rregulloreje, në kohën e duhur dhe para fillimit të tyre. OST ose OSSH duhet të miratojnë paraprakisht dhe në mënyrë të duhur oraret dhe procedurat e testimeve të planifikuara dhe miratimi nuk duhet të refuzohet pa arsye. Kur SGU ka një pikë lidhje me OSSH-në dhe ndërvepron, në përputhje me paragrafin 2, vetëm me OSSH, OST ka të drejtë të kërkojë nga OSSH çdo rezultat të testimeve të pajtueshmërisë që janë të rëndësishme për sigurinë operacionale të sistemit të tij të transmetimit.

4. Në përputhje me kërkesën e OST-së ose OSSH-së, sipas nenit 41(2) të Rregullores (BE) 2016/631, të përshtatur dhe miratuar nga Vendimi i Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë 2018/03/PHLG-EnC dhe nenit 35(2) të Rregullores (BE) 2016/1388, të përshtatur dhe miratuar nga Vendimi i Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë 2018/05/PHLG-EnC, përdoruesi i rëndësishëm i rrjetit do të kryejë teste dhe simulime për pajtueshmëri në përputhje me këto Rregullore në çdo kohë gjatë jetës së objektit të tij dhe në veçanti pas çdo defekti, modifikimi ose zëvendësimi të çdo pajisjeje, që mund të ketë ndikim në pajtueshmërinë e objektit me kërkesat e kësaj Rregulloreje lidhur me aftësinë e objektit për të arritur vlerat e deklaruara, kërkesat për kohën të aplikueshme për ato vlera dhe disponueshmërinë ose ofrimin e kontraktuar të shërbimeve ndihmëse. Palët e treta që ofrojnë përgjigje të ngarkesës drejtpërdrejt për OST-në, siguruesit e ridispecimit te moduleve të gjenerimit të energjisë ose objekteve të ngarkesës përmes agregatimit, dhe siguruesve të rezervave të fuqisë aktive, do të sigurojnë që objektet në portofolin e tyre të përputhen me kërkesat e kësaj Rregulloreje.

Neni 55

Detyrat e OST-së në lidhje me operimin e sistemit

1. Çdo OST është përgjegjëse për sigurinë operacionale në zonën e vet të kontrollit në aspektin e:

   a) zhvillimit dhe përdorimit të mjeteve te operimit te rrjetit te rëndësishme per zonë e saj të kontrollit dhe ne lidhje me operimin në kohë reale dhe planifikimin operacional;

   b) zhvillimit dhe vendosjen e mjeteve dhe zgjidhjeve për parandalimin dhe riparimin e shqetesimeve;

   c) përdorimit e sherbimeve të siguruara nga palë te treta, permes prokurimit kur eshte e aplikueshme, si ri-dispeçimi ose tregetimit te kundërt, shërbimit te menaxhimin te kongjestioneve, rezervave gjeneruese dhe shërbimeve të tjera ndihmëse;

   d) përputhshmerise me shkallën e klasifikimit të incidenteve të miratuar nga ENTSO për <...> dhe paraqitjes ne ENTSOE-E te informacionit te kërkuar për të kryer detyrën për nxjerrjen e shkallës së klasifikimit të incidenteve; dhe

e) monitorimin çdo vit te përshtatshmërisë se mjeteve të operimit të rrjetit të vendosura sipas pikave (a) dhe (b) të nevojshme për të ruajtur sigurinë operacionale. Çdo OST do të identifikojë përmirësimet e duhura të këtyre mjeteve të operimit të rrjetit, duke marrë parasysh raportet vjetore të përgatitura nga ENTSO-E, bazuar në shkallën e klasifikimit të incidenteve në përputhje me Neninin 15. Çdo përmirësim i identifikuar duhet të zbatohet më pas nga OST.

Kapitulli 2

Testimi operacional

Neni 56

Qëllimi dhe përgjegjësitë

1. Çdo OST, dhe cdo OSSH ose përdorues të rëndësishëm të rrjetit me pikë lidhje direkte në rrjetin e transmetimit, mund të kryejnë testime operacionale respektivisht të elementëve të tyre të sistemit të transmetimit dhe të objekteve te tyre nën kushte të simululuara operacionale dhe për një kohë të kufizuar. Kur veprojnë kështu, para fillimit të testimit ata duhet të japin njoftimin në kohën e duhur dhe do të minimizojnë efektin në operimin e sistemit në kohë reale. Testimi operacional do të synojë të sigurojë:

   a) dështminë e pajtueshmërisë me të gjitha dispozitat teknike, organizative dhe operacionale të kësaj Rregulloreje për një element të ri të sistemit të transmetimit në hyrjen e tij të parë në veprim;
   b) dështminë e pajtueshmërisë me të gjitha dispozitat teknike, organizative dhe operacionale të kësaj Rregulloreje për një objekt të ri të përdoruesit të rëndësishëm të rrjetit ose OSSH, në hyrjen për herë të parë në operim;
   c) dështminë e pajtueshmërisë me të gjitha dispozitat teknike, organizative dhe operacionale të kësaj Rregulloreje mbi çdo ndryshim të elementëve të sistemit të transmetimit ose objekti të një përdoruesi të rëndësishëm të rrjetit ose të OSSH-së, e cila është e rëndësishme për operimin e sistemit;
   d) vlerësimin e efekteve të mundshme negative të një avarie, lidhje të shkurtër ose incidente të tjera të paplanifikuara dhe të papritura në operimin e sistemit, mbi elementet e sistemit të transmetimit, ose në objektin e përdoruesit të rëndësishëm të rrjetit ose të OSSH-së.

2. Rezultatet e testimit operacional të përmendur në paragrafin 1 do të përdoren nga OST, OSSH ose përdorues i rëndësishëm i rrjetit, në mënyrë që:

   a) OST-të të sigurojnë funksionimin në mënyrë korrekte të elementeve të Sistemit të Transmetimit;
   b) OSSH dhe Përdoruesit e Rëndësishëm të Rrjetit të sigurojnë funksionimin korrekt të sistemeve dhe objekteve të tyre;

c) OST, OSSH dhe Përdoruesit e Rëndësishëm të Rrjetit të mirëmbajnë dhe zhvillojnë procedurat ekzistuese dhe të reja operacionale;
d) OST të sigurojë përmbushjen e detyrimeve mbi shërbimet ndihmëse;
e) OST, OSSH dhe Përdoruesit e Rëndësishëm të Rrjetit të marrin informacion mbi performancën e elementëve të sistemit të transmetimit, pajisjeve të përdoruesit të rëndësishëm të rrjetit, dhe OSSH-së, nën çdo rrethanë dhe në përputhje me dispozitat operacionale te kësaj Rregulloreje në terma të:
    i. aplikimit te kontrolluar të variacioneve të frekuencës ose tensionit duke synuar mbledhjen e informacionit mbi sjelljen e sistemit të transmetimit dhe elementeve të tij; dhe
    ii. testet e praktikave operacionale në gjendje emergjence dhe gjendje restaurimi.

3. Çdo OST do të sigurohet që testimet operacionale nuk rrezikojnë sigurinë operacionale të Sistemit të tij të Transmetimit. Çdo testim operacional mund të shtyhet ose ndërpritet nën kushte të paplanifikuara të sistemit, ose për shkak të sigurisë së personelit, të centralit ose aparaturave që testohen, ose të elementëve të sistemit të transmetimit ose të objekteve të OSSH ose Përdoruesit të Rëndësishëm të Rrjetit.
4. Në rast të përkeqësimit të gjendjes së Sistemit, në kohën që po kryhet testimi, OST ka të drejtën ta ndërpresë menjëherë testimin. Nëse kryerja e një testi prek një OST tjetër dhe gjendja e tij e sistemit përkeqësohet, OST ose SGU ose OSSH që kryen testin, pasi të informohet nga OST-ja përkatëse, do të ndërpresë menjëherë testin operacional.
5. Çdo OST do të sigurohet që rezultatet e testeve operacionale të kryera bashkë me të gjitha analizat përkatëse janë:

    a) të përfshira në procesin e trajnimit dhe certifikimit të punonjësve të ngarkuar me operimin në kohë reale;
    b) të përdoren si të dhëna hyrëse për proceset e kërkim zhvillimit të ENTSO-E; dhe
    c) të përdoren për përmirësimin e procedurave operacionale përfshirë këtu dhe ato te gjendjes se emergjencës dhe rivendosjes.

Neni 57

Kryerja e testeve operacionale dhe analiza e tyre

1. Çdo OST ose OSSH në të cilën Përdoruesi i Rëndësishëm i Rrjetit ka pikë lidhje, ka të drejtën për të testuar pajtueshmërinë e SGU me kërkesat e kësaj rregulloreje, input ose output e pritshëm të Përdoruesit të Rëndësishëm të Rrjetit dhe ofrimin e shërbimeve ndihmëse të kontraktuara nga Përdoruesi i Rëndësishëm i Rrjetit, në çdo kohë gjatë gjithë jetëgjatësisë së objektit. Procedura për këto teste operacionale duhet t'i njoftohet Përdoruesit të Rëndësishëm të Rrjetit nga OST ose OSSH në kohën e duhur përpara fillimit të testit operativ.

2. OST ose OSSH, aty ku Përdoruesi i Rëndësishëm i Rrjetit ka pikën e lidhjes, do të publikojnë listën e informacionit dhe dokumenteve që duhet të ofrohen, si dhe kërkesat që duhet të

përmbushen nga Përdoruesi i Rëndësishëm i Rrjetit për testimin e pajtueshmërisë operacionale. Lista duhet të mbulojë së paku informacionin e mëposhtëm:

a) Të gjithë dokumentacionin dhe certifikatat e pajisjeve për tu siguruar nga Përdoruesi i Rëndësishëm i Rrjetit;
b) Detaje të të dhënave teknike të objektit të Përdoruesit të Rëndësishëm të Rrjetit për operimin e sistemit;
c) Kërkesat për modelet për vlerësimin e qëndrueshmërisë dinamike; dhe
d) Studime nga Përdoruesi i Rëndësishëm i Rrjetit që demonstrojnë rezultatet e pritshme të vlerësimit të qëndrueshmërisë dinamike, aty ku mund të zbatohet;

3. Aty ku zbatohet, çdo OST ose OSSH do të publikojë caktimin e përgjegjësive të Përdoruesit të Rëndësishëm të Rrjetit dhe të OST ose OSSH për testimin e pajtueshmërisë operacionale.

Titulli 4

Trajnimi

Neni 58

Programi i trajnimit

1. 18 muaj pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, çdo OST do të zhvillojë dhe miratojë:
   a) një program trajnimi fillestar për certifikimin dhe një program periodik për trajnimin e vazhdueshëm të punonjësve të tij, përgjegjës për operimin në kohë reale të sistemit të transmetimit;
   b) një program trajnimi për punonjësit e tij përgjegjës për planifikimin operativ. Çdo OST do të kontribuojë në zhvillimin dhe miratimin e programeve të trajnimit për punonjësit e qendrës përkatëse të koordinimit rajonal.
   c) një program trajnimi për punonjësit e tij, përgjegjës për balancimin.

2. Programet e trajnimit të OST duhet të përfshijnë njohjen e elementëve të sistemit të transmetimit, operimin e sistemit të transmetimit, përdorimin e sistemeve dhe proceseve në vendin e punës, operimet ndërmjet OST-ve, marrëveshjet e tregut, njohjen dhe reagimin ndaj situatave të jashtëzakonshme në operimin e sistemit, aktivitetet dhe mjetet e planifikimit operativ.
3. Punonjësit e OST-së, të ngarkuar me operimin në kohë reale të sistemit të transmetimit, si pjesë e trajnimit fillestar, i nënshtrohen trajnimit mbi çështjet e ndërveprimit midis sistemeve të transmetimit të bazuara në përvojat operacionale dhe reagimet nga trajnimi i përbashkët i kryer me OST-të fqinjë në përputhje me Nenin 63. Ky trajnim mbi çështjet e ndërveprimit duhet të përfshijë përgatitjen dhe aktivizimin e veprimeve përmirësuese të koordinuara të kërkuara në të gjitha gjendjet e sistemit.

4. Çdo OST do të përfshijë në programin e tij të trajnimit për punonjësit përgjegjës për operimin në kohë reale të sistemit të transmetimit, frekuencën e trajnimeve dhe komponentët e mëposhtëm:

   a) Përshkrim të elementeve të sistemit të transmetimit;
   b) Operimin e sistemit të transmetimit në të gjitha gjendjet e sistemit përfshirë rivendosjen;
   c) përdorimin e sistemeve dhe proceseve në punë;
   d) bashkëpunimin dhe koordinimin midis OST-ve dhe marrëveshjeve të tregut;
   e) njohjen dhe përgjigjen ndaj situatave të jashtëzakonshme operacionale;
   f) fushat përkatëse të inxhinierisë së energjisë elektrike;
   g) aspekte të rëndësishme të tregut të brendshëm të energjisë në Komunitetin e Energjisë;
   h) aspekte të rëndësishme të kësaj rregulloreje ose udhëzimeve të miratuara sipas Neneve 59 dhe 61 të Rregullores (BE) 2019/943, siç janë përshtatur dhe miratuar nga Vendimi i Këshillit Ministerial 2022/03/MC-EnC;
   i) masat e mbrojtjes dhe sigurinë së personave, pajisjet bërthamore dhe pajisjeve të tjera në operimin e sistemit të transmetimit;
   j) bashkëpunimin dhe koordinimin midis OST-ve në operimin në kohë reale dhe të planifikimit operativ në nivelin e qendrave kryesore të kontrollit, në gjuhen angleze nqs nuk specifikohet ndryshe,;
   k) trajnimi i përbashkët me kompaninë e shpërndarjes dhe përdoruesit e rëndësishëm të rrjetit me pikë lidhje direkt në ST, kur konsiderohet e përshtatshme.
   l) aftësitë të sjelljes me fokus të veçantë në menaxhimin e stresit, të veprimit njerëzor në situata kritike, përgjegjësisë dhe aftësive motivuese ; dhe
   m) praktikat dhe mjetet e planifikimit operativ, duke përfshirë ato që përdoren me qendrat përkatëse të koordinimit të sigurisë rajonale në planifikimin operacional.

5. Programi i trajnimit për punonjësit përgjegjës për planifikimin operativ duhet të përfshijë të paktën aspektet në pikat (c), (f), (g), (h), (j) dhe (m) të paragrafit 4.
6. Programi i trajnimit për punonjësit përgjegjës për balancimin duhet të përfshijë të paktën aspektet në pikat (c), (g) dhe (h) të paragrafit 4
7. Çdo OST duhet të mbajë regjistrime mbi programet e trajnimit të punonjësve për periudhën e punësimit. Me kërkesë të autoritetit rregullator përkatës, çdo OST do të ofrojë fushëveprimin dhe përmbajtjen e programeve të tij të trajnimit.
8. Çdo OST do të rishikojë programet e tij të trajnimit të paktën një herë në vit ose pas ndryshimeve të rëndësishme të bëra në sistemi. Çdo OST do të rishikojë programet e tij të trajnimit për të reflektuar ndryshimet në rrethanat operacionale, rregullat e tregut, konfigurimin e rrjetit dhe karakteristikat e sistemit, me fokus të veçantë në teknologjitë e reja, ndryshimin e modeleve të gjenerimit dhe ngarkesave si dhe zhvillimet e tregut.

Neni 59

Kushtet e Trajnimit

1. Çdo program trajnimi i OST-se për punonjësit përgjegjës për operimin në kohë reale duhet të përfshijë trajnimin në vendin e punës dhe trajnimin offline. Trajnimi në vendin e punës do të kryhet nën mbikëqyrjen e një punonjësi me përvojë i cili është përgjegjës për operimin në kohë reale. Trajnimi offline do të kryhet në një ambient që simulon dhomën e kontrollit dhe me detajet e modelimit të rrjetit në një nivel të përshtatshëm për detyrat që trajnohet.
2. Çdo OST do të kryeje trajnime për punonjësit përgjegjës për operimin në kohë reale duke u bazuar në një model të plotë të bazës së të dhënave të rrjetit të tyre me të dhënat përkatëse nga rrjetet e tjera të së paku zonës së observimit, në një nivel të detajuar që është i mjaftueshëm për të perserise çështje operacionale midis OST-ve. Skenarët e trajnimit duhet të bazohen në kushte reale dhe kushte të simuluara të sistemit. Aty ku është e rëndësishme, roli i OST-ve të tjera, OSSh-ve dhe përdoruesve të rëndësishëm të rrjetit duhet të simulohen gjithashtu nëse ato nuk mund të përfaqësohen drejtpërdrejtë në trajnime të përbashkëta.
3. Çdo OST do të koordinojë trajnimin offline të punonjësve përgjegjës për operimin në kohë reale me OSSH-të dhe përdoruesit e rëndësishëm të rrjetit me pikë lidhje në transmetim, në lidhje me ndikimin e objekteve të tyre në operimin në kohë reale të sistemit të transmetimit, në një mënyrë gjithëpërfshirëse dhe proporcionale, duke pasqyruar topologjinë e përditësuar të rrjetit dhe karakteristikat e pajisjeve sekondare. Kur është e rëndësishme, OST-të, OSSh-të e transmetimit dhe përdoruesit e rëndësishëm të rrjetit me pikelidhje në rrjetin e transmetimit, do të kryejne workshop ose simulime të përbashkëta trajnimi offline.

Neni 60

Koordinatorët e trajnimit dhe trajnerët

1. Përgjegjësitë e koordinatorit të trajnimit përfshijnë hartimin, monitorimin dhe përditësimin e programeve të trajnimit, si dhe përcaktimin e:
   a) kualifikimeve dhe procesit të përzgjedhjes për punonjësit e TSO që do të trajnohen;
   b) trajnimit të kërkuar për certifikimin e punonjësve të operatorit të sistemit që janë përgjegjës për operimin në kohë reale;
   c) proceseve, duke përfshirë dokumentacionin përkatës, për programet e trajnimit fillestar dhe ato të vazhdueshëm;
   d) procesit për certifikimin e punonjësve të operatorit të sistemit që janë përgjegjës për operimin në kohë reale; dhe
   e) procesit për zgjerimin e periudhës së trajnimit dhe periudhës së certifikimit për punonjësit e operatorit të sistemit që janë përgjegjës për operimin në kohë reale.

2. Çdo OST do të përcaktojë aftësitë dhe nivelin e kompetencës së trajnerëve në vendin e punës. Trajnerët në vendin e punës duhet të kenë një nivel të duhur përvoje operacionale pas certifikimit të tyre.
3. Çdo OST do të ketë një regjistër të punonjësve të operatorit të sistemit që janë përgjegjës për operimin në kohë reale dhe që kryejnë funksionet e trajnerëve në vendin e punës, dhe do të

rishikojë aftësinë e tyre për të ofruar trajnim praktik kur të vendosë për zgjatjen e certifikimit të tyre.

Neni 61

Certifikimi i punonjësve të operatorit të sistemit, përgjegjës për operimin në kohë reale

1. Një individ mund të bëhet një punonjës i operatorit të sistemit i ngarkuar me operimin në kohë reale me kusht që ai ose ajo të jetë trajnuar dhe më pas të jetë certifikuar nga një përfaqësues i emëruar nga OST-ja e tij ose saj për detyrat përkatëse brenda afatit të përcaktuar në programin e trajnimit. Punonjësi i operatorit të sistemit, i ngarkuar me operimin në kohë reale, nuk duhet të punojë pa mbikëqyrje në dhomën e kontrollit përveç nëse ai ose ajo është certifikuar.
2. 18 muaj pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, çdo OST do të përcaktojë dhe zbatojë procesin për certifikimin e punonjësve të operatorit të sistemit, përgjegjës për operimin në kohë reale, duke përfshirë nivelin e kompetencës.
3. Punonjësit e OST-së të ngarkuar me operimin në kohë reale do të certifikohen pas vlerësimit formal të suksesshëm i cili duhet të përfshijë një provim me gojë dhe/ose me shkrim dhe/ose një vlerësim praktik me kritere të paracaktuara të suksesit.
4. OST do të mbajë një kopje të certifikatës së lëshuar dhe rezultateve formale të vlerësimit. Me kërkesë nga autoriteti rregullator, OST do të sigurojë një kopje të shënimeve të provimit të certifikimit.
5. Çdo OST do të regjistrojë kohën e vlefshmërisë së certifikimit të lëshuar për çdo punonjës përgjegjës për operimin në kohë reale.

6. Çdo OST do të përcaktojë periudhën maksimale të certifikimit, e cila nuk duhet të kalojë 5 vjet, por që mund të zgjatet në bazë të kritereve të përcaktuara nga çdo OST dhe mund të marrë parasysh pjesëmarrjen e punonjësve përgjegjës për operimin në kohë reale në një program trajnimi të vazhdueshëm me përvojë të mjaftueshme praktike.

Neni 62

Gjuha e përbashkët për komunikim ndërmjet punonjësve të operatorit të sistemit, përgjegjës për operimin në kohë reale

1. Nëse nuk është rënë dakord ndryshe, gjuha e përbashkët e komunikimit ndërmjet punonjësve të një OST dhe atyre të OST-së fqinje duhet të jetë anglisht.
2. Çdo OST do të trajnojë punonjësit e saj të operimit të sistemit aq sa të arrijnë aftësi të mjaftueshme të gjuhës së dakorduar për komunikim me OST-të fqinje.

Neni 63

Bashkëpunimi ndërmjet OST-ve gjatë trajnimit

1. Çdo OST do të organizojë sesione trajnimi të rregullta me OST-të e saj fqinje për të përmirësuar njohjen e karakteristikave të sistemit të transmetimit fqinj si dhe komunikimin dhe koordinimin midis punonjësve të OST-ve fqinje të ngarkuar me operimin në kohë reale. Trajnimi ndërmjet OST-ve do të përfshijë njohuri të detajuara të veprimeve të koordinuara që kërkohen në secilin gjendje të sistemit.
2. Çdo OST do të përcaktojë, në bashkëpunim me të paktën OST fqinje, nevojën dhe periodicitetin për seancat e përbashkëta të trajnimit, duke përfshirë përmbajtjen minimale dhe fushëveprimin e këtyre sesioneve, duke marrë parasysh nivelin e ndikimit të ndërsjellë dhe bashkëpunimin operacional të nevojshëm. Ky trajnim ndërmjet OST-ve mund të përfshijë seminare të përbashkëta trajnuese dhe seanca të trajnimeve të përbashkëta me simulator.
3. Çdo OST do të marrë pjesë me OST-të e tjera, të paktën një herë në vit, në sesione trajnimi për menaxhimin e çështjeve ndërmjet OST-ve në operimin në kohë reale. Periodiciteti duhet të përcaktohet duke marrë parasysh nivelin e ndikimit të ndërsjellë të sistemeve të transmetimit dhe tipin e lidhjeve në interkoneksion - DC / AC.
4. Çdo OST do të shkëmbejë përvoja nga operimi në kohë reale, duke përfshirë vizita dhe shkëmbimin e përvojave ndërmjet punonjësve të operatorit të sistemit që janë përgjegjës për operimin në kohë reale, me OST-të e tyre fqinje, me çdo OST me të cilin ka ose ka pasur ndërveprim operacional ndër-OST dhe me qendrat përkatëse të koordinimit të sigurisë rajonale.

PJESA 3

PLANIFIKIMI OPERACIONAL

TITULLI 1

Të dhënat mbi analizat e sigurisë operacionale në planifikimin operacional

Neni 64

Dispozita të përgjithshme për modelin e rrjetit individual dhe të përbashkët

1. Për të realizuar analizën e sigurisë operacionale në përputhje me Titullin 2 të këtij Kapitulli, çdo OST do të përgatisë modele individuale të rrjetit në përputhje me metodat e përcaktuara në zbatimin e Nenit 17 të Rregullores (BE) 2015/1222, siç është përshtatur dhe miratuar nga Vendimi i Këshillit Ministerial 2022/03/MC-EnC, dhe Nenit 18 të Rregullores (BE) 2016/1719, siç është adaptuar dhe miratuar nga Vendimi i Këshillit Ministerial 2022/03/MC-EnC, për secilën nga periudhat e mëposhtme të kohës, duke aplikuar formatin e të dhënave të përcaktuar sipas Nenit 114(1) të Rregullores 2017/1485:

   a) një vit përpara, në përputhje me Nenet 66, 67 dhe 68;
   b) kur është e aplikueshme, një javë përpara, në përputhje me Nenin 69;

c) një ditë përpara, në përputhje me Nenin 70; dhe
d) brenda ditës, në përputhje me Nenin 70.

2. Modeli individual i rrjetit do të përfshijë informacion strukturor dhe të dhëna në përputhje me Nenin 41.
3. Çdo OST do të ndihmojë në ndërtimin e modeleve individuale të rrjetit dhe çdo qendër koordinimi rajonale do të kontribuojë në ndërtimin e modeleve të përbashkëta të rrjetit duke aplikuar formatin e të dhënave të përcaktuar sipas Nenit 114(1) të Rregullores 2017/1485.

Neni 65

Skenarët e vitit në avancë

1. Të gjithë OST-të do të krijojnë një listë të përbashkët të skenarëve kundrejt të cilëve do të vlerësohet nga OST-të funksionimi i sistemeve të ndërlidhura për vitin pasues. Këto skenarë do të lejojnë identifikimin dhe vlerësimin e ndikimit në sigurinë e operimit të sistemit të transmetimit të interkonektuar. Këto skenarë do të përfshijë variablat e mëposhtme:
   a) kërkesën;
   b) kushtet që kanë të bëjnë me kontributin e burimeve të rinovueshme të energjisë;
   c) pozicionet e përcaktuara të importit/eksportit, përfshirë rakordimin e vlerave referencë të cilat lejojnë bashkimin e modelit të rrjetit;
   d) modelin e gjenerimit duke e konsideruar parkun e prodhimit plotësisht në dispozicion;
   e) zhvillimin e rrjetit një-vit para.

2. Kur hartojnë listën e përbashkët të skenarëve, OST-të do të marrin parasysh elementet e mëposhtëm:
   a) modelet tipike të shkëmbimit ndërkufitar për nivele të ndryshme të konsumit dhe të burimeve të rinovueshme të energjisë dhe gjenerimit konvencional;
   b) probabilitetin e ndodhjes së skenarëve;
   c) potencialin për devijimet e mundshme nga kufijtë e sigurisë operacionale që lidhen me çdo skenar; dhe
   d) sasinë e energjisë së gjeneruar dhe të konsumuar nga objektet e gjenerimit të energjisë dhe objektet e ngarkesës të lidhur në rrjetet e shpërndarjes.

3. Kur OST-të nuk kanë sukses në krijimin e listës së përbashkët të skenarëve të përmendur në paragrafin 1, ato do të përdorin skenarët e parazgjedhur si më poshtë:

   a) Pikun e dimrit, të mërkurën e 3-të të janarit, ora 10:30 CET;
   b) Minimumin e dimrit, e diela e dytë e janarit e vitit aktual ora 03:30 CET;
   c) Piku i pranverës, të mërkurën e tretë të prillit të vitit aktual, ora 10:30 CET;
   d) Minimumi i pranverës, e diela e dytë e Prillit e vitit aktual, 03:30 CET;
   e) Piku i verës, e Mërkura e tretë e Korrikut e vitit të mëparshëm, ora 10:30 CET;
   f) Minimumi i verës, e diela e dytë e korrikut të vitit paraardhës 03:30 CET;
   g) Piku i vjeshtës, e mërkura e tretë e tetorit të vitit paraardhës, ora 10:30 CET;

h) Minimumi i vjeshtës, e diela e dytë e Tetorit e vitit paraardhës, ora 03:30 CET.

4. OST-të e Palëve Kontraktuese do të aplikojnë listën e përbashkët të skenarëve të përcaktuar për vitin pasardhës dhe të miratuar në përputhje me Rregulloren (BE) 2017/1485.

Neni 66

Modelet individuale të rrjetit për vitin në avancë

1. Çdo OST do të përcaktojë një model individual të rrjetit për vitin e ardhshëm për secilin nga skenarët e zhvilluar në përputhje me Nenin 65, duke përdorur vlerësimet më të mira të tij për variablat e përcaktuara në Nenin 65(1). Çdo OST do të publikojë modelet e tij individuale të rrjetit për vitin e ardhshëm në mjedisin e të dhënave për planifikimin operativ të ENTSO-E <…>.
2. Kur hartohen modelet individuale të rrjetit çdo OST do të:
   a) rakordojë fluksin e parashikuar të energjisë në interkonektorët DC, që lidhin zonat e kontrollit;
   b) balancojë shumën për çdo skenar:
      i. shkëmbimet neto të linjave AC;
      ii. fluksin e vlerësuar të energjisë në sistemet HVDC;
      iii. kërkesën, duke përfshirë një vlerësim të humbjeve; dhe
      iv. gjenerimin.
3. Çdo OST do të përfshijë në modelet individuale të rrjetit të vitit në avancë, shumatoren e prodhimit të energjisë (agregate) për objektet e gjenerimit të energjisë të lidhura në rrjetin e shpërndarjes. Ky prodhim shumator duhet të:
   a) jetë në përputhje me të dhënat strukturore të parashikuara në kërkesat e Nenit 41, 43, 45 dhe 48;
   b) jetë në përputhje me skenarët e përcaktuar në Nenin 65; dhe
   c) diferencojë llojin e burimit primar të energjisë.

Neni 67

Modelet e përbashkëta të rrjetit për vitin në avancë

1. Për 6 muaj pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, <…> OST-të do të aplikojnë metodologjinë për ndërtimin e modeleve të përbashkëta të rrjetit për vitin e ardhshëm nga modelet individuale të rrjetit të përcaktuara në përputhje me Nenin 66(1) dhe për ruajtjen e tyre. <…>
2. Çdo OST ka të drejtë të kërkojë nga një OST tjetër informacion mbi modifikimet në topologjinë e rrjetit ose në marrëveshjet operacionale, si pikat e punës të mbrojtjeve ose skemat e mbrojtjes së sistemit, konfigurimin e nënstacioneve ose modeleve shtesë të rrjetit të rëndësishme për sigurimin e një përfaqësimi të saktë të sistemit të transmetimit për të ndërmarrë analiza të sigurisë operacionale.

Neni 68

Përditësime të modelit individual dhe të përbashkët të rrjetit në vitin në avancë

1. Kur një OST modifikon ose njofton një modifikim të vlerësimeve më të mira të tij për variablet e përdorur për përcaktimin e modelit individual të tij të rrjetit të vitit në avancë të përcaktuar në përputhje me Nenin 66 (1), i cili është i rëndësishëm për sigurinë operacionale, duhet të përditësojë modelin individual të rrjetit të tij të vitit në avancë dhe ta publikojë atë në ENTSO-E për mjedisin e të dhënave të planifikimit operacional.
2. Sa herë që përditësohet një model individual i rrjetit, modeli i rrjetit i vitit në avancë do të përditësohet në përputhje me rrethanat duke zbatuar metodologjinë e përcaktuar në përputhje me Nenin 67 (1).

Neni 69

Modelet individuale dhe të përbashkëta të rrjetit të javës në avancë

1. Kur dy ose më shumë OST e konsiderojnë të nevojshme, ata do të përcaktojnë skenarët më përfaqësues për koordinimin e analizës së sigurisë operacionale të sistemit të tyre të transmetimit për kornizën kohore të javës në avancë dhe do të hartojnë një metodologji për shkrirjen e modeleve të rrjetit individual, të ngjashme me metodologjinë për ndërtimin e modelit të përbashkët të rrjetit të vitit në avancë nga modelet individuale të rrjetit të vitit në avancë në përputhje me Nenin 67 (1).
2. Secili OST i përmendur në paragrafin 1 do të krijojë ose përditësojë modelet tij të rrjetit individual të javës në avancë, në përputhje me skenarët e përcaktuar në përputhje me paragrafin 1.
3. OST-të e përmendura në paragrafin 1 ose palët e treta në të cilat është deleguar detyra e përmendur në paragrafin 1, duhet të ndërtojnë modelet e përbashkëta të rrjetit të javës në avancë duke ndjekur metodologjinë e zhvilluar në përputhje me paragrafin 1 dhe duke përdorur modelet e rrjetit individual të krijuar në përputhje me paragrafin 2.

Neni 70

Metodologjia për ndërtimin e modelit të përbashkët të rrjetit për ditën në avancë (D-1) dhe brenda ditës

1. Për 6 muaj pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, <…> OST-të do të aplikojnë metodologjinë për ndërtimin e modeleve të përbashkëta të rrjetit për ditën në avancë dhe brenda ditës nga modelet individuale të rrjetit dhe për ruajtjen e tyre. <…>
2. Çdo OST do të krijojë modele të rrjetit individual të ditës në avancë dhe brenda ditës në përputhje me paragrafin 1 dhe do t'i publikojë ato në mjedisin e të dhënave të planifikimit operacional të ENTSO-E.
3. Kur krijohen modelet e rrjetit individual të ditës në avancë ose brenda ditës, të përmendura në paragrafin 2, çdo OST duhet të përfshijë:

   a) parashikimet e ngarkesës dhe gjenerimit të përditësuar;
   b) rezultatet e disponueshme të proceseve të tregut të ditës në avancë dhe brenda ditës;

c) rezultatet e disponueshme të detyrave të skedulimit të përshkruara në Titullin 6 të Pjesës III;

d) për objektet e gjenerimit të energjisë të lidhura me rrjetin e shpërndarjes, shumatore të fuqisë aktive të diferencuara sipas llojit të burimit primar të energjisë në përputhje me të dhënat e siguruara sipas Nenit 40,43,44,48,49 dhe 50.

e) topologjinë e sistemit të transmetimit të përditësuar.

4. Të gjitha veprimet përmirësuese të përcaktuara tashmë duhet të përfshihen në modelet e rrjetit individual të ditës në avancë dhe brenda ditës dhe duhet të dallohen qartësisht nga injektimet dhe tërheqjet e përcaktuara në përputhje me Nenin 40 (4) dhe topologjinë e rrjetit pa veprime përmirësuese të aplikuara.

5. Çdo OST do të vlerësojë saktësinë e variablave në paragrafin 3 duke i krahasuar variablet me vlerat e tyre aktuale, duke marrë parasysh parimet e përcaktuara në përputhje me Nenin 75 (1) (c).
6. Nëse, pas vlerësimit të përmendur në paragrafin 5, OST e konsideron saktësinë e variablave të përmendur në pikën (5) të jenë të pamjaftueshme në lidhje me sigurinë operacionale, OST do të kryejë analizën e përcaktimit të shkaqeve të pasaktësisë. Nëse shkaqet varen nga proceset e OST për krijimin modeleve individuale të rrjetit, OST do të rishikojë proceset në mënyrë që të krijoje rezultate më të sakta. Nëse shkaqet varen nga variablat e ofruara nga pjesëmarrës të tjerë, OST dhe palët e tjera do të bëjnë përpjekje për të siguruar variabla të sakta.

Neni 71

Kontrolli i cilësisë për modelet e rrjetit

1. Kur përcaktojnë kontrollet e cilësisë në përputhje me nenet 67 (1) (b) dhe 70 (1) (c), të gjithë OST-të së bashku do të përcaktojnë kontrollet që synojnë së paku verifikimin e:
   a) Koherencës së statusit të lidhjes së interkonektorëve;
   b) vlerave të tensionit nëse janë brenda vlerave të zakonshme operacionale për ato elemente të sistemit të transmetimit që kanë ndikim në zonën tjetër të kontrollit
   c) Koherencës së mbingarkesave kalimtare të lejuara te interkonektoreve; dhe
   d) Që fuqia aktive dhe injektimi i fuqisë reaktive ose tërheqjet janë në përputhje me vlerat e zakonshme operacionale.

TITULLI 2

ANALIZAT E SIGURISË OPERACIONALE

Neni 72

Analizat e sigurisë operacionale në planifikimin operativ

1. Çdo OST do të kryejë analiza të koordinuara të sigurisë operacionale të paktën në horizontet kohore të mëposhtme:

a) Viti në avancë;
b) Java në avancë, kur është e aplikueshme sipas Nenit 69;
c) Dita në avancë; dhe
d) Brenda ditës.

2. Kur kryen analiza të koordinuara të sigurisë operacionale, OST do të zbatojë metodologjinë e adoptuar në përputhje me Nenin 75.
3. Për të kryer analiza të koordinuara të sigurisë operacionale, çdo OST duhet që në situatën (N), të simulojë çdo kontingjencë nga lista e kontingjencave të percaktuara në përputhje me Nenin 33 duke verifikuar që, në situatën (N-1) kufijtë e sigurisë operacionale të përcaktuara në përputhje me Nenin 25, në zonën e saj të kontrollit nuk janë tejkaluar.
4. Çdo OST do të kryejë analiza të sigurisë operacionale duke përdorur së paku modelet e përbashkëta të rrjetit, të përcaktuara në përputhje me nenet 67, 68, 70 dhe, kur është e zbatueshme 69, si dhe do të marrë parasysh ndërprerjet e planifikuara gjatë kryerjes së këtyre analizave.
5. 5. Çdo OST do të ndajë rezultatet e analizës së tij të sigurisë operacionale me të paktën OST-të, elementët e të cilëve përfshihen në zonën e vëzhgimit të OST-së dhe janë prekur sipas asaj analize të sigurisë operacionale, në mënyrë që t'i lejojë ato OST të verifikojnë se kufijtë e sigurisë operacionale janë respektuar brenda zonave të tyre të kontrollit.

Neni 73

Analiza të sigurisë operacionale të vitit në avancë deri në dhe duke përfshirë javën në avancë

1. Çdo OST duhet të kryej analiza të sigurisë operacionale për vitin në avancë dhe kur zbatohet për javën në avancë me qëllim që të zbulojë së paku kufizimet e mëposhtme:

   a) flukset e energjisë dhe tensionet mbi kufijtë e sigurisë operacionale;
   b) shkelje të kufijve të stabilitetit në sistemin e transmetimit të identifikuara në përputhje me Nenin 38(2) dhe (6); dhe
   c) shkelja e limiteve të qarkut të shkurtër të sistemit të transmetimit

2. Kur një OST zbulon kufizimet e mundshme, atëherë do të përgatisë veprime përmirësuese në përputhje me Nenet nga 20 deri 23. nëse veprimet përmirësuese pa kosto nuk janë në dispozicion dhe kufizimi është i lidhur me padisponueshmërinë e planifikuar të disa aseteve relevante, kufizimi do të përbejë një papajtueshmëri të planifikimit të ndërprerjeve dhe OST do të iniciojë koordinimin e ndërprerjeve në pajtim me Nenin 95 ose 100 në varësi të kohës së vitit kur ky veprim është iniciuar.

Neni 74

Analiza e sigurisë operacionale se ditës ne avance, brenda ditës dhe afër kohës reale

1. Çdo OST do të kryejë analiza të sigurisë operacionale në ditën ne avance, brenda ditës dhe në afërsi të kohës-reale për të zbuluar kufizimet e mundshme si dhe për të përgatitur dhe aktivizuar veprimet përmirësuese me çdo OST të interesuar dhe nëse është e zbatueshme me OSSH-të e prekura ose Përdoruesit e Rëndësishëm të Rrjetit.
2. Çdo OST do të monitorojë parashikimin e ngarkesës dhe gjenerimit. Kur këto parashikime tregojnë devijime të rëndësishme në ngarkesë dhe gjenerim, OST duhet të përditësojë analizën e sigurisë operacionale.

3. Kur kryen analiza të sigurisë operacionale pranë kohës reale në zonën e saj të observimit, çdo OST do të përdorë vlerësimin e gjendjes dhe situatës.

Neni 75

Metodologjia për koordinimin e analizave të sigurisë operacionale

1. Për 12 muaj pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, <…> OST-të do të aplikojnë metodologjinë për koordinimin e analizës së sigurisë operacionale. <…>
2. <…>
3. <…>
4. <…>
5. <…>
6. <…>

Neni 76

Propozimi për koordinimin rajonal të sigurisë operacionale

1. 3 muaj pas aplikimit të metodologjisë për koordinimin e analizës së sigurisë operacionale në Nenën 75(1), të gjithë OST-të e çdo rajoni të llogaritjes së kapacitetit, siç është përcaktuar në përputhje me Nenin 15(1) të Rregullores (BE) 2015/1222, siç është adaptuar dhe miratuar nga Vendimi i Këshillit të Ministerial 2022/03/MC-EnC, do të zhvillojnë së bashku një propozim për dispozita të përbashkëta për koordinimin e sigurisë operacionale rajonale, që do të aplikohet nga qendrat e koordinimit rajonal dhe OST-të e rajonit të llogaritjes së kapacitetit. Propozimi duhet të respektojë metodologjitë për koordinimin e analizës së sigurisë operacionale të zhvilluara në përputhje me Nenin 75(1) dhe, ku është e nevojshme, të plotësojë metodologjitë e zhvilluara në përputhje me Nenet 35 dhe 74 të Rregullores (BE) 2015/1222, siç është adaptuar dhe miratuar nga Vendimi i Këshillit të Ministerial 2022/03/MC-EnC. Propozimi do të përcaktojë:

   a) kushtet dhe frekuencën e koordinimit brenda ditës të analizës të sigurisë operacionale dhe përditësimit të modelit të rrjetit të përbashkët nga qendrat e koordinimit rajonal të sigurisë;

b) metodologjinë për përgatitjen e masave përmirësuese që menaxhohen në një mënyrë të koordinuar, duke marrë parasysh rëndësinë e tyre nderkufitare, siç është përcaktuar në përputhje me Nenin 35 të Rregullores (BE) 2015/1222, siç është adaptuar dhe miratuar nga Vendimi i Këshillit të Ministerial 2022/03/MC-EnC, duke marrë parasysh kërkesat në Nenet 20 deri në 23 dhe duke përcaktuar të paktën:
   i. proçedurën për shkëmbimin e informacionit për veprimet përmirësuese në dispozicion, ndërmjet OST-ve përkatëse dhe qendrës së koordinimit rajonal të sigurisë;
   ii. klasifikimin e kufizimeve dhe veprimeve përmirësuese në përputhje me nenin 22;
   iii. identifikimin e veprimeve përmirësuese më efektive dhe ekonomike në rast të shkeljeve të sigurisë operacionale të përmendur në nenin 22;
   iv. përgatitjen dhe aktivizimin e veprimeve përmirësuese në përputhje me nenin 23 (2);
   v. ndarja e kostove të masave përmirësuese të përmendura në Nenin 22, duke plotësuar, kur është e nevojshme, metodologjinë e përbashkët të zhvilluar në përputhje me Nenin 74 të Rregullores (BE) 2015/1222, siç është adaptuar dhe miratuar nga Vendimi i Këshillit të Ministrave 2022/03/MC-EnC. Si një parim i përgjithshëm, kostot e ngarkesave që nuk kanë rëndësi përtej kufijve do të mbulohen nga OST përgjegjës për zonën e caktuar të kontrollit dhe kostot e lehtësimit të ngarkesave që kanë rëndësi përtej kufijve do të mbulohen nga OST-të përgjegjës për zonat e kontrollit, në përpjesëtim me ndikimin agravues të shkëmbimit të energjisë mes zonave të kontrollit të caktuara mbi elementin e ngarkuar të rrjetit.

2. Në përcaktimin nëse konxhestioni ka rëndësi ndërkufitare, OST-të do të marrin në konsideratë kongjestionin që do të shfaqet në mungesë të shkëmbimeve të energjisë midis zonave të kontrollit.

Neni 77

Organizimi për koordinimin rajonal të sigurisë operacionale

<...>

Neni 78

Koordinimi rajonal i sigurisë operacionale

1. Çdo OST do t'i sigurojë qendrës së koordinimit rajonal të gjithë informacionin dhe të dhënat e nevojshme për të kryer vlerësimin e koordinuar rajonal të sigurisë operacionale, duke përfshirë të paktën:
   a) listën e përditësuar të kontigjencave, të vendosur sipas kritereve të përcaktuara në metodologjinë për koordinimin e analizës së sigurisë operacionale të miratuar në përputhje me nenin 75 (1);

b) lista e përditësuar e masave përmirësuese të mundshme, mes kategorive të renditura në Nenin 22, dhe kostot e tyre të parashikuara të ofruara në përputhje me Nenin 35 të Rregullores (BE) 2015/1222, siç është adaptuar dhe miratuar nga Vendimi i Këshillit të Ministerial 2022/03/MC-EnC, nëse një masë përmirësuese përfshin redispecimin ose tregtimin e kundert, me qellim për të kontribuar në lehtësimin e çdo kufizimi të identifikuar në rajon; dhe
c) kufijtë e sigurisë operacionale të përcaktuar në përputhje me nenin 25.

2. Çdo qendër e koordinimit rajonal:
   a) kryen vlerësimin e sigurisë operacionale rajonale të koordinuar në përputhje me nenin 76 mbi bazën e modeleve të përbashkët rrjetit, të krijuar në përputhje me nenin 79, listën e kontigjencave dhe kufijtë e sigurisë operacionale të siguruara nga çdo OST në paragrafin 1. Ai do të shpërndajë rezultatet e vlerësimit të sigurisë operacinale rajonale të koordinuar të paktën për të gjithë OST-të e rajonit të llogaritjes së kapacitetit. Aty ku zbulon një kufizim, ai do t'i rekomandojë OST-ve përkatëse veprimet përmirësuese më efektive dhe ekonomikisht eficiente dhe gjithashtu mund të rekomandojë veprime të tjera përmirësuese, përveç atyre të siguruara nga OST-të. Ky rekomandim për veprimet përmirësuese duhet të shoqërohet me shpjegime lidhur me arsyetimin e tij;
   b) të koordinojë përgatitjen e veprimeve përmirësuese me dhe midis OST-ve në përputhje me Nenin 76 (1) (b), për të mundësuar OST-të të arrijnë një aktivizim të koordinuar të veprimeve përmirësuese në kohë reale.
3. Gjatë kryerjes së vlerësimit të sigurisë operacionale rajonale të koordinuar dhe identifikimit të veprimeve të përshtatshme përmirësuese, çdo qendër e koordinimit rajonal do të koordinojë me qendrat e tjera të koordinimit rajonal.

4. Kur një OST merr nga qendra e koordinimit rajonal të sigurisë rezultatet e vlerësimit të sigurisë operacionale rajonale të koordinuar me një propozim për një veprim përmirësues, OST do të vlerësojë veprimin përmirësues të rekomanduar për elementet e përfshirë në atë veprim përmirësues me vendndodhje në zonën e tij të kontrollit . Duke vepruar kështu, do të zbatojë dispozitat e Nenit 20. OST do të vendosë nëse do të zbatojë veprimin përmirësues të rekomanduar. Kur vendos të mos zbatojë veprimin përmirësues të rekomanduar, ai duhet tia arsyetoje këtë vendim RSC-së. Kur OST vendos të zbatojë veprimin përmirësues të rekomanduar, ai do të zbatojë këtë veprim për elementet me vendndodhje në zonën e tij të kontrollit, me kusht që të jetë në përputhje me kushtet në kohë reale.

Neni 79

Ndërtimi i modelit të rrjetit të përbashkët

1. Çdo qendër e koordinimit rajonal do te kontrolloje cilësinë e modeleve individuale të rrjetit me qëllim që të kontribuojë në ndërtimin e modelit të rrjetit të përbashkët për secilën kornizë kohore të përmendur në përputhje me metodologjitë e përmendura në nenet 67 (1) dhe 70 (1).

2. Secili OST do të vendosë në dispozicion të qendrës së koordinimit rajonal modelin individual të rrjetit të nevojshëm për të ndërtuar modelin e rrjetit të përbashkët për çdo kornizë kohore nëpërmjet mjedisit të të dhënave të planifikimit operacional të ENTSO-E.
3. Kur është e nevojshme, çdo qendër e koordinimit rajonal do të kërkojë nga OST-të në fjalë, të pwrmirwsojnwë modelet individuale të rrjetit të tyre, në mënyrë që të arrijnë pajtueshmërinë me kontrollet e cilësisë dhe përmirësimin e tyre.
4. Secili OST do të përmirwsojw modelet individuale të rrjetit të tij, pasi të verifikojë nevojën për pwrmirwsim nëse është e aplikueshme, në bazë të kërkesave të qendrës së koordinimit rajonal ose një OST-je tjetër.
5. Në përputhje me metodologjitë e përmendura në nenet 67 (1) dhe 70 (1), dhe në përputhje me Nenin 28 të Rregullores (EU) 2015/1222, siç është adaptuar dhe miratuar nga Vendimi i Këshillit të Ministerial 2022/03/MC-EnC, një qendër e koordinimit rajonal do të caktohet nga të gjithë OST-të për të ndërtuar modelin e përbashkët të rrjetit për secilën kornizë kohore dhe ta ruajë atë në mjedisin e të dhënave të planifikimit operacional të ENTSO-E.

Neni 80

Koordinimi rajonal i ndërprerjeve

1. Rajonet e koordinimit të ndërprerjeve, brenda të cilave OST-të do të vazhdojnë me koordinimin e ndërprerjeve, do të jenë të paktën të barabarta me rajonet e llogaritjes së kapacitetit, siç janë përcaktuar në përputhje me Nenin 15(1) të Rregullores (BE) 2015/1222, siç është përshtatur dhe miratuar nga Vendimi i Këshillit të Ministerial 2022/03/MC-EnC.

2. OST-të e dy ose më shumë rajoneve të koordinimit të ndërprerjeve mund të bien dakord t'i bashkojnë ato në një rajon unik të koordinimit të ndërprerjeve. Në këtë rast ata do të identifikojnë qendrën e koordinimit rajonal që kryen detyrat e përmendura në nenin 77 (3) të Rregullores 2017/1485.

3. Çdo OST do t'i sigurojë qendrës së koordinimit rajonal informacionin e nevojshëm për zbulimin dhe zgjidhjen e papajtueshmërive te planifikimit rajonal të ndërprerjeve, duke përfshirë së paku:

    a) planet e disponueshmërisë së elementeve të brendshëm të rëndësishëm të tij, të ruajtura në në mjedisin e të dhënave të planifikimit operativ të ENTSO-E.

    b) planet më të fundit të disponueshmërisë për të gjithë elementet jo-relevante të zonës së tij të kontrollit të cilat janë:

        i. të aftë të ndikojnë në rezultatet e analizës së papajtueshmërisë së planifikimit të ndërprerjeve;

        ii. modeluar në modelet individuale të rrjetit të cilat përdoren për vlerësimin e papajtueshmërisë së ndërprerjeve

c) skenarët mbi të cilët papajtueshmëritë e ndërprerjeve të planifikuara duhet të hetohen dhe përdoren për të ndërtuar modelet respektive të përbashkëta të rrjetit, që rrjedhin nga modelet e përbashkëta të rrjetit për korniza të ndryshme kohore të përcaktuara në përputhje me nenet 67 dhe 79.

4. Çdo qendër e koordinimit rajonal do të kryejë analiza të sigurisë operacionale rajonale në bazë të informacionit të dhënë nga OST-të respektive në mënyrë që të zbulojë ndonjë papajtueshmëri në planifikimin e ndërprerjeve. Ai do ti sigurojë të gjithë OST-ve të rajonit të koordinimit të ndërprerjeve listën e papajtueshmërive të ndërprerjeve të planifikuara të zbuluara si dhe zgjidhjet që propozon për të zgjidhur këto papajtueshmëri të ndërprerjeve të planifikuara.

5. Në kryerjen e detyrimeve të tyre sipas paragrafit 4, çdo qendër e koordinimit rajonal do të koordinojë analizat e tij me qendrat e tjera të koordinimit rajonal.

6. Në zbatim të detyrimeve të tyre në përputhje me Nenin 98 (3) dhe Nenin 100 (4) (b), të gjithë OST-të do të marrin parasysh rezultatet e vlerësimit të siguruar nga qendra e koordinimit rajonal në përputhje me paragrafin 3 dhe paragrafin 4.

Neni 81

Vlerësimi i mjaftueshmërisë rajonale

1. Çdo qendër e koordinimit rajonal do të kryejë vlerësime rajonale të mjaftueshmërisë për të paktën afatin kohor një-javë para.

2. Çdo OST do t'i sigurojë qendrës së koordinimit rajonal informacionin e nevojshëm për të kryer vlerësimet rajonale të mjaftueshmërisë të referuara në paragrafin 1, duke përfshirë:

   a) ngarkesa totale e pritshme dhe burimet në dispozicion për përgjigjen e ngarkesës;
   b) disponueshmëria e moduleve gjeneruese të energjisë; dhe
   c) kufijtë e sigurisë operacionale.

3. Çdo qendër koordinimi rajonal do të kryejë vlerësime të mjaftueshmerie bazuar në informacionin e ofruar nga OST-të përkatëse me qëllim të zbulimit të situatave ku pritet një mungesë mjaftueshmerie në ndonjë nga zonat e kontrollit ose në nivel rajonal, duke marrë parasysh shkëmbimet ndërkufitare të mundshme dhe kufijtë e sigurisë operacionale. Ajo do të dorëzojë rezultatet së bashku me veprimet që propozon për të reduktuar rreziqet për OST-të e rajonit të llogaritjes së kapacitetit, siç është përcaktuar në përputhje me Nenin 15(1) të Rregullores (BE) 2015/1222, siç është adaptuar dhe miratuar nga Vendimi i Këshillit të Ministerial 2022/03/MC-EnC. Këto veprime do të përfshijnë propozime për masa përmirësuese që lejojnë rritjen e shkëmbimeve ndërkufitare.
4. Kur kryen vlerësim të mjaftueshmërisë rajonale, çdo qendër e koordinimit rajonal i sigurisë do të koordinojë me qendrat e tjerë të sigurisë rajonale.

TITULLI 3
KORDINIMI I NDËRPRERJEVE

Kapitulli 1

Rajonet e koordinimit të ndërprerjeve, asetet e rëndësishme

Neni 82

Objektivi i koordinimit të ndërprerjeve

1. Për rastet e specifikuara në këtë Rregullore, me mbështetjen e qendrës se koordinimit rajonal, çdo OST, kryen koordinimin e ndërprerjeve në përputhje me parimet e këtij Titulli me qëllim monitorimin e statusit të disponueshmërisë së aseteve përkatëse dhe koordinimin e planeve të disponueshmërisë për të siguruar sigurinë operacionale të sistemit të transmetimit.

Neni 83

Koordinimi rajonal

1. Të gjithë OST-të e një rajoni të koordinimit të ndërprerjeve, do të hartojnë së bashku një procedure operacionale rajonale të koordinuar, e cila synon vendosjen e aspekteve operacionale për zbatimin e ndërprerjeve të koordinuara për çdo rajon, i cili përfshin:

   a) Frekuencën, fushë-veprimin dhe tipin e koordinimit i cili do të zhvillohet të paktën për horizontin kohor të vitit në avancë dhe javës në avancë;
   b) dispozitat në lidhje me përdorimin e vlerësimeve të kryera nga qendra e koordinimit rajonal në përputhje me nenin 80;
   c) rregullime praktike për vlefshmërinë e planeve të disponueshmërisë së elementeve të rrjetit për vitin në avancë, siç kërkohet në nenin 98.

2. Çdo OST do të marrë pjesë në procesin e koordinimit të ndërprerjeve të Rajonit te koordinimit te ndërprerjeve dhe zbatojë procedurat e koordinimit operacionale rajonal të përcaktuara në përputhje me paragrafin (1).
3. Nëse lindin papajtueshmëri gjatë planifikimit të ndërprerjeve midis rajoneve të ndryshme të koordinimit të ndërprerjeve, të gjithë OST-të dhe qendrat e koordinimit rajonal të atyre rajoneve duhet të koordinohen për të zgjidhur ato papajtueshmëri të planifikimit të ndërprerjeve.
4. Çdo OST do t'i sigurojë të gjithë OST-ve nga i njëjti rajon i koordinimit te nderprejeve, të gjithë informacionin përkatës në dispozicion të saj, mbi projektet në infrastrukturë në lidhje me sistemin e transmetimit, sistemin e shpërndarjes, sistemin e mbyllur të shpërndarjes, modulet gjeneruese te energjisë, ose objektet e kërkesës që ndikojnë në operimin e zonës së përgjegjësisë të një OST-je tjetër brenda rajonit te koordinimit te ndërprerjeve.

5. Çdo OST do të sigurojë për OSSH-në e lidhura ne transmetim qe gjendet në zonën e saj të përgjegjësisë, të gjithë informacionin në dispozicion të saj në projektet e infrastrukturës të sistemit të transmetimit, që mund të kenë ndikim në operimin e sistemit të shpërndarjes të këtyre OSSH-ve.
6. Çdo OST do të sigurojë për Operatoret e Sistemit të Mbyllur të Shpërndarjes të lidhur në rrjetin e transmetimit, që gjendet në zonën e saj të përgjegjësisë, të gjithë informacionin në dispozicion të saj në projektet e infrastrukturës të sistemit të transmetimit, që mund të kenë ndikim në operimin e sistemit te mbyllur të shpërndarjes të këtyre OSSH-ve.

Neni 84

Metodologjia për Vlerësimin e Rëndësisë së Aseteve për Koordinimin e Ndërprerjeve

1. Për 12 muaj pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, <…> OST-të do të aplikojnë metodologjinë të paktën për çdo zonë sinkrone, për vlerësimin e rëndësisë për koordinimin e ndërprerjes të moduleve të prodhimit të energjisë, impianteve të kërkesës dhe elementeve të rrjetit të vendosura në një sistem transmetimi ose në një sistem shpërndarjeje, përfshirë sistemet e shpërndarjes të mbyllura.

2. <...>

3. <...>

Neni 85

Lista moduleve te rëndësishme gjeneruese dhe objekteve te rëndësishme të kërkesës

1. Për 3 muaj pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, të gjithë OST-të e çdo rajoni të koordinimit të ndërprerjeve do të vlerësojnë së bashku rëndësinë e moduleve të gjeneruese të energjisë dhe impianteve të kërkesës për koordinimin e ndërprerjeve, bazuar në metodologjinë e përmendur në Nenin 84(1), dhe do të krijojnë një listë të vetme, për secilin rajon të koordinimit të ndërprerjeve, të moduleve te rëndësishme të gjenerimit të energjisë dhe impianteve te rëndësishme të kërkesës.
2. Të gjithë OST-të e një rajoni të koordinimit të ndërprerjeve, do të bëjnë të disponueshme së bashku listën e moduleve te rendesishme gjeneruese te energjise dhe listën objekteve te rendesishme të kërkesës të atij rajoni të koordinimit të ndërprerjeve, në mjedisin e të dhënave të planifikimit operacional të ENTSO-E.
3. Çdo OST duhet të njoftojë autoritetin e tij rregullator për listën e moduleve gjeneruese të rëndësishme të energjisë dhe objekteve të kërkesës të rëndësishme për çdo rajon të koordinimit të ndërprerjeve në të cilet merr pjesë.
4. Për çdo aset të rëndësishëm të brendshëm i cili është modul gjenerues i energjise ose objekt kërkese, OST duhet të:

   a) Informojë pronarin e modulit te rendesishme gjenerues te energjise dhe të objektit te rendesishem të kërkesës për përfshirjen e tyre në listë;

b) Informojë OSSH-të mbi modulet të rëndësishme gjeneruese te energjise dhe objektet e rendesishme te kërkesës të lidhur në sistemin e tyre te shpërndarjes; dhe
c) Informojë OSSH-në e mbyllur për modulet gjeneruese të rëndësishme dhe objektet e kërkesës të rëndësishme të lidhur në sistemin e mbyllur të shpërndarjes.

Neni 86

Përditësimi i listës se moduleve te rëndësishme gjeneruese dhe objekteve te rëndësishme të kërkesës

1. Para 1 korrikut të çdo viti kalendarik, të gjithë OST-të e secilit rajon të koordinimit të ndërprerjeve do të ri-vlerësojnë së bashku rëndësinë e moduleve gjeneruese dhe objekteve të kërkesës për koordinimin e ndërprerjeve bazuar në metodologjinë e hartuar në përputhje me Nenin 84 (1).
2. Kur është e nevojshme, përpara datës 1 gusht të çdo viti kalendarik, të gjithë OST-të e secilit rajon të koordinimit të ndërprerjeve, së bashku do të vendosin të përditësojnë listën e moduleve gjeneruese të rëndësishme dhe objekteve të kërkesës të rëndësishme, të atij rajoni të koordinimit të ndërprerjeve.
3. Të gjithë OST-të e rajonit të koordinimit të ndërprerjeve do të bëjnë të disponueshme në mjedisin e të dhënave të planifikimit operacional të ENTSO-E listën e përditësuar të atij rajoni të koordinimit të ndërprerjeve.
4. Çdo OST i një rajoni të koordinimit të ndërprerjeve duhet të informojë palët e përmendura në nenin 85 (4) për përmbajtjen e listës së përditësuar .

Neni 87

Lista e elementeve të rëndësishëm të rrjetit

1. Për 3 muaj pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, të gjithë OST-të e çdo rajoni të koordinimit të ndërprerjeve do të vlerësojnë së bashku, në bazë të kësaj metodologjie, rëndësinë për koordinimin e ndërprerjes së elementeve të rrjetit të vendosura në një sistem transmetimi ose në një sistem shpërndarjeje, përfshirë një sistem shpërndarjeje të mbyllur, dhe do të krijojnë një listë të vetme, për secilin rajon të koordinimit të ndërprerjeve, të elementeve të rrjetit te rëndësishëm.
2. Lista e elementeve të rëndësishëm të rrjetit të një rajoni të koordinimit të ndërprerjeve duhet të përmbajë të gjithë elementet e te nje sistemi transmetimi ose sistemi shpërndarje perfshire nje sistemi te mbyllur shpërndarje i ndodhur ne rajonin e koordinimit te nderprejeve të cilët identifikohën si te rëndësishëm nga zbatimi i metodologjisë referuar ne nenin 84 (1).
3. Të gjithë OST-të e rajonit të koordinimit të ndërprerjeve do të bëjnë të disponueshme në mjedisin e të dhënave të planifikimit operacional të ENTSO-E listën e përditësuar të elementeve të rëndësishëm të rrjetit.
4. Çdo OST duhet të informojë autoritetin rregullator për listën e elementeve të rëndësishëm të rrjetitper secilin rajon te koordinimit te nderprejeve ne te te cilin merr pjese:
5. Për çdo aset te brendshëm të rëndësishëm i cili është element i rrjetit, OST duhet të:

a) Informojë pronarin e elementit të rëndësishëm të rrjetit për përfshirjen e tij në listë;
b) Informojë OSSH-të për elementet e rëndësishëm të rrjetit të cilët janë të lidhur në sistemin e shpërndarjes;
c) Informojë OSSH-të e mbyllura për elementet e rëndësishëm të rrjetit të cilët janë të lidhur në sistemin e mbyllur të shpërndarjes;

Neni 88

Përditësimi i listës së elementëve të rëndësishëm të rrjetit

1. Para 1 korrikut të çdo viti kalendarik, të gjithë OST-të e secilit rajon të koordinimit të ndërprerjeve, do të rivlerësojnë së bashku, bazuar në metodologjinë e përcaktuar në përputhje me nenin 84 (1), rëndësinë për koordinimin e ndërprerjeve të elementëve të rrjetit që gjenden në një sistem transmetimi ose një sistem shpërndarjeje përfshirë edhe një sistem të mbyllur të shpërndarjes.
2. Kur është e nevojshme, përpara 1 gushtit të çdo viti kalendarik, të gjithë OST-të e një rajoni të koordinimit të ndërprerjeve, do të vendosin së bashku të përditësojnë listën e elementeve të rëndësishëm rrjetit të atij rajoni të koordinimit të ndërprerjeve.
3. Te gjithë OST-të e një rajoni të koordinimit të ndërprerjeve do të bëjnë të disponueshme listën e përditësuar në mjedisin e të dhënave të planifikimit operacional të ENTSO-E.
4. Çdo OST i një rajoni të koordinimit të ndërprerjeve duhet të informojë palët e përmendura në nenin 85 (4) për përmbajtjen e listës së përditësuar.

Neni 89

Caktimi i agjentëve të planifikimit te ndërprerjeve

1. Çdo OST vepron si Agjent i Planifikimit të Ndërperjeve për çdo Element Relevant të Rrjetit që operohet nga ana e tij.
2. Për çdo aset tjetër të rëndësishëm, pronari do të caktojë ose do të veprojë si agjent i planifikimit të ndërprerjeve për asetin e rëndësishëm përkatës dhe do te informojë OST për caktimin e tij.

Neni 90

Trajtimi i Aseteve Relevante qe ndodhen në sistemin e shpërndarjes ose sistemin e mbyllur të shpërndarje

1. Çdo OST do të koordinojë me OSSH planifikimin e ndërprerjeve të aseteve të brendshme te rendesishme të lidhura me sistemin e saj të shpërndarjes.
2. Çdo OST do të koordinojë me OSSH e Mbyllur planifikimin e ndërprerjeve të aseteve të brendshme të lidhura me sistemin e mbyllur të shpërndarjes së saj.

Kapitulli 2

Hartimi dhe përditësimi i planeve të disponueshmërisë së aseteve të rëndësishme

Neni 91

Ndryshimet në afatet për koordinimin të ndërprerjeve te vitit ne avance

1. Të gjithë OST-të brenda një zone sinkrone mund të bien dakord bashkërisht për të miratuar dhe zbatuar një kornizë kohore për koordinimin e ndërprerjeve të vitit në avancë që ndryshon nga afati kohor i përcaktuar në nenet 94, 97 dhe 99, me kusht që të mos ndikohet në koordinimin e ndërprerjeve të zonave të tjera sinkrone.

Neni 92

Dispozita të përgjithshme mbi planet e disponueshmerise

1. Statusi i disponueshmërisë së një aseti të rëndësishëm do të jetë një nga gjendjet e mëposhtme:

    a) I disponueshëm: aseti relevant është i aftë dhe i gatshëm për ofrimin e shërbimit pavarësisht nëse është ose jo në operim;
    b) I pa-disponueshëm: aseti relevant nuk është i aftë ose i gatshëm për ofrimin e shërbimit;
    c) Në testim: aftësia e asetit relevant po testohet për ofrimin e shërbimit.

2. Statusi i disponueshmërisë "testim" do të përdoret në rast te ndikimit te mundshem në Sistemin e Transmetimit ne periudhat e mëposhtme kohore:

    a) ndërmjet lidhjes fillestare dhe komisionimit final të asetit te rendesishem; dhe
    b) menjëherë pas periudhës së mirëmbajtjes së asetit te rendesishem.

3. Planet e disponueshmërisë do të përmbajnë së paku informacionin e mëposhtëm:
    a) Shkakun për statusin "i padisponueshëm" të asetit të rëndësishëm
    b) aty ku identifikohen këto kushte, kushtet që duhet të plotësohen para së të zbatohet statusi 'i padisponueshëm' i një aseti të rëndësishëm në kohë reale;
    c) Koha e nevojshme për rikthimin e asetit të rëndësishëm në perseri ne shërbim kur është e nevojshme me qëllim ruajtjen e sigurisë operacionale.
4. Statusi i disponueshmërisë për çdo aset të rëndësishëm në horizontin kohor për vitin në avancë do të sigurohet me bazë ditore.

5. Për periudhat e kohës kur skedulimi i gjenerimit dhe i konsumit i janë paraqitur OST-së në përputhje me Nenin 111, detajimi kohore i statuseve të disponueshmërisë duhet të jetë në përputhje me ato skedule.

Neni 93

Plani Tregues i Disponueshmërisë në terma afatgjatë

1. 2 vite para fillimit të çdo koordinimi të ndërprerjes për vitin ne avance, çdo OST do të vlerësojë planet përkatëse treguese të disponueshmërisë për asetet e brendshme te rendesishme, të ofruara nga agjentët e planifikimit të ndërprerjeve në përputhje me Nenet 4, 7 dhe 15 të Rregullores (BE) Nr. 543/2013, siç është përshtatur dhe miratuar nga Vendimi i Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë 2015/01/PHLG-EnC, dhe do të ofrojë komentet e tij paraprake, duke përfshirë çdo papajtueshmëri të zbuluar të planifikimit të ndërprerjeve, për të gjithë agjentët e prekur të planifikimit të ndërprerjeve.
2. Çdo OST do të kryeje vlerësimin e planit tregues të disponueshmërisë për asetet e brendshme te rendesishme të përmendura në paragrafin 1, çdo vit, deri në fillimin të koordinimit të ndërprerjeve të vitit në avancë.

Neni 94

Propozimi i Planve të Disponueshmërisë për Vitin në Avancë.

1. përpara 1 Gushtit të çdo viti kalendarik, një agjent i planifikimit të ndërprerjeve i ndryshëm nga OST-ja që merr pjesë në rajonin e koordinimit të ndërprerjeve, një OSSH ose një OSSH e Mbyllur, do të paraqesin në OST(të) që merr pjesë në një rajon të koordinimit të ndërprerjeve, dhe kur është e rëndësishme në OSSH(të) ose OSSH(të) e Mbyllura, një plan disponueshmerie që mbulon vitin pasues kalendarik për secilin element të rëndesishëm të tij.

2. OST(të) të cilave iu referohet paragrafi (1) do të bëjnë përpjekjet më të mira për të shqyrtuar kërkesat për ndryshime në një planin e disponueshmerise të marre. Kur kjo nuk është e mundur, OST do të shqyrtoje kerkesen për ndryshime në planin e disponueshmerise pasi është finalizuar plani i koordinuar i ndërprerjeve për vitin në avancë.
3. OST(të) të cilave iu referohet paragrafi (1) do të trajtojë(në) kërkesat për ndryshime të planit të disponueshmërisë, pasi të jetë finalizuar procesi i koordinimit të vitit në avancë, në këtë mënyrë:
    a) duke respektuar radhën me të cilën është bërë kërkesa për ndryshim; dhe
    b) duke ndjekur një proceduren në pajtim me Nenin 100.

Neni 95

Koordinimi i Statusit të Disponueshmërisë të Aseteve te rendesishme për Vitin në Avancë për të cilin Agjenti i Koordinimit të Ndërprerjeve nuk është një OST që merr pjesë në rajonin e kordinimit të ndërprerjeve, as OSSH dhe as OSSH e Mbyllur

1. Çdo OST do të vlerësojë, ne nje korize kohore viti në avancë, nëse shfaqen papajtueshmëri nga planet e disponueshmërisë te marra në përputhje me Nenin 94.
2. Në rastet kur janë zbuluar papajtueshmëri të planifikimit te ndërprerjeve, OST, do të zbatojë procesin e mëposhtëm:
   a) Do të informojë çdo agjent të ndërprerjeve të planifikuara, për kushtet që duhet të përmbushen për të lehtësuar papajtueshmëritë e ndërprerjeve të zbuluara;
   b) OST mund të kërkojë që një ose më shumë agjentë të planifikimit të ndërprerjeve të paraqesin një alternativë të planit të disponueshmërisë, që përmbush kushtet e përmendura në piken (a); dhe
   c) OST do të përsërisë vlerësimin në pajtim me pikën (1) për të përcaktuar nëse mbeten ende papajtueshmëri të ndërprerjeve.

3. ne vijim te kërkesës së OST-së në përputhje me piken (b) të paragrafit 2 nese agjenti i planifikimit te nderprerjeve, nuk arrin te paraqese ndonjë plan alternativ disponueshmërie që synon zbutjen e të gjitha papajtueshmërive te planifikimit te ndërprerjeve, OST do të hartoje një plan alternativ të disponueshmërisë i cili:

   a) Do të marrë parasysh ndikimin e raportuar nga agjentët e ndërprerjeve të planifikuara, si dhe OSSH-të ose OSSH-të e mbyllura kur është e rëndësishme;
   b) Do të kufizoje ndryshimet në planet alternative të disponueshmërisë në atë çfarë është e domosdoshme për të lehtësuar papajtueshmëritë e planifikimit te ndërprerjeve; dhe
   c) të informojë auroritetin Rregullator, OSSH-të, OSSH-të e mbyllura dhe agjentët e ndërprerjeve te prekur, për planin alternativ të disponueshmërisë, përfshirë arsyet që motivuan hartimin e këtij po aq sa dhe impaktin e raportuar nga agjentet e planifikimit të ndërprerjeve te ndikuar, kur është e rëndësishme nga OSSH-të ose OSSH-të e mbyllura.

Neni 96

Koordinimi i Statusit të Disponueshmërisë të Aseteve te rendesishme për Vitin në Avancë, për të cilin agjenti i planifikimit të ndërprerjeve është OST që merr pjesë në një rajon të koordinimit të ndërprerjeve, OSSH-ë ose OSSH e Mbyllur

1. Çdo OST do të planifikoje statusin e disponueshmërisë së elementeve të rëndësishëm të rrjetit që lidhin zonat të ndryshme të kontrollit, për të cilat OST vepron si agjent i koordinimit të ndërprerjeve me OST-të e tjera të të njëjtit rajon të Koordinimit të Ndërprerjeve.

2. Secili OST, OSSH dhe OSSH e Mbyllur duhet të planifikoj statusin e disponueshmërisë së elementeve të rëndësishme të rrjetit për të cilet kryen detyrat e agjentëve të planifikimit të ndërprerjeve dhe që nuk ndërlidhin zona të ndryshme kontrolli, duke përdorur si bazë planet e disponueshmërisë të hartuara në përputhje me paragrafin 1.
3. Kur përcakton statusin e disponueshmerisë së elementëve të rëndësishëm të rrjetit në përputhje me paragrafin 1 dhe 2, OST, OSSH dhe OSSH e Mbyllur do të:

   a) Minimizimizojë ndikimit në treg, ndërkohë që ruan sigurinë operacionale; dhe

   b) përdor si bazë planet e disponueshmërisë të propozuara dhe hartuara në pajtim me Nenin 94.
4. Kur një OST zbulon një papajtueshmëri në planifikimin e ndërprerjeve, OST do të ketë të drejtën të propozojë një ndryshim në planet e disponueshmërisë të aseteve të brendshme të rëndësishme për të cilat agjenti i planifikimit të ndërprerjeve nuk është as OST-ja që merr pjesë në një rajon koordinimi të ndërprerjeve, dhe as një OSSh ose një OSSH e Mbyllur si dhe do të gjeje një zgjidhje në koordinim me agjentët e planifikimit të ndërprerjeve, OSSh-të dhe OSSH-të e Mbyllura te interesuara, duke përdorur mjetet në dispozicion të tij.
5. Kur statusi i padisponueshëm i elementit te rendesishem të rrjetit, nuk është planifikuar pas marrjes së masave në paragrafin 4, dhe mungesa e planifikimit te padisponueshmërisë do të cënonte Sigurinë Operacionale, atëherë OST do të:

   a) ndërmarrë veprime të tilla siç ajo e konsideron të nevojshme për të planifikuar statusin e padisponueshmerise, nderkohe qe siguron sigurinë operacionale, duke marre ne konsiderate ndikimin e raportuar tek OST nga agjentet e planifikimit te ndërprerjeve te ndikuar;
   b) njoftojë për veprimet e referuara ne piken (a) të gjitha palëve te ndikuara; dhe
   c) informoje autoritetet përkatëse rregullatore, OSSh-të ose OSSH-të e mbyllura te prekura nëse ka dhe agjentët e planifikimit të ndërprerjeve të prekura për veprimet e ndërmarra, duke përfshirë arsyetimin për veprime të tilla, ndikimin e raportuar nga agjentët e planifikimit të ndërprerjeve të prekura dhe OSSh-të ose OSSH-të e mbyllura, sipas rasti.

6. Çdo OST do të beje të disponueshëm në Portalin e të Dhënave të Planifikimit Operacional të ENTSO-E, të gjithë informacionin në dispozicion për kushte të rrjetit që duhet të përmbushen, dhe veprimet përmirësuese që duhet të ndërmerren dhe aktivizohen, para ekzekutimit të statusit" i padisponueshëm" ose "testim" i elementit të rëndësishëm të rrjetit.

Neni 97

Sigurimi i Planit paraprak të Disponueshmërisë për Vitin në Avancë

1. Para 1 Nëntorit të çdo viti kalendarik, çdo OST do të sigurojë te gjitha OST te tjera, nëpërmjet Portalin e ENTSO-E për të dhënat e Planifikimit Operativ, Planet paraprake të

Disponueshmërisë te vitit ne avance per vitin pasues kalendarik për të gjithë asetet e brendshme te rëndësishëm.

2. Para 1 Nëntorit të çdo viti kalendarik, për çdo Aset te brendshëm te rëndësishëm të lokalizuar në sistemin e shpërndarjes, OST do t'i sigurojë OSSH-së planin paraprak të disponueshmërisë për vitin në avancë.

3. Para 1 Nëntorit të çdo viti kalendarik, për çdo aset të brendëshëm te rendesishem të lokalizuar në një sistem të mbyllur shperndarje, OST do ti sigurojë OSSH-së së mbyllur planin paraprak të disponueshmërisë për vitin në avancë.

Neni 98

Vlefshmëria e Planeve të Disponueshmërisë për Vitin në Avancë brenda Rajonit të Koordinimit të ndërprerjeve

1. Çdo ost do të analizojë nëse shfaqen papajtueshmëri të planit te ndërprerjeve, kur merren ne konsiderate të gjitha planet paraprake të disponueshmërisë për vitin në avancë.
2. Në mungesë të papajtueshmërive të planifikimit të ndërprerjeve, të gjithë OST-të e një rajoni të koordinimit të ndërprerjeve së bashku do të validojnë planet e disponueshmërisë për vitin në avancë për të gjithë asetet e rëndësishme te atij rajoni të koordinimit të ndërprerjeve.
3. Nëse një OST zbulon një papajtueshmëri në planifikimin e ndërprerjeve, OST-të e përfshira në rajonin(et) e koordinimit të ndërprerjeve së bashku do të gjejne një zgjidhje në koordinim me agjentët përkatës të planifikimit të ndërprerjeve, OSSh-të dhe OSSh-të e mbyllura duke përdorur mjetet në dispozicion të tyre, dhe duke respektuar sa të jetë e mundur planet e disponueshmerise të paraqitura nga agjentet e planifikimit të ndërprerjeve, të cilet nuk janë as OST që marrin pjesë në një rajon koordinimi të ndërprerjeve, dhe as OSSh ose OSSh të mbyllura dhe të zhvilluara në përputhje me Nenet 95 dhe 96. Kur gjendet një zgjidhje, të gjithë OST-të në rajonin(et) respektiv(e) të koordinimit të ndërprerjeve do të përditësojnë dhe miratojnë planet e disponueshmërisë për vitin në avancë për të gjithë asetet përkatëse.
4. Kur nuk gjendet zgjidhje për një papajtueshmëri të planifikimit të ndërprerjeve secila OST e prekur, subjekt i miratimit nga autoriteti rregullator kompetent ku Pala Kontraktuese siguron, duhet te:
   a) imponojnë statusin "i disponueshëm" për të gjitha statuset " i padisponueshëm" ose "testim" për asetet e rëndësishme të perfshira në një papajtueshmeri të planifikimit të ndërprerjeve gjate periudhes në fjale; dhe
   b) njoftojnë autoritetin rregullator respektiv, OSSH-të ose OSSH-të e mbyllura, nëse ka, dhe agjentet e planifikimit të ndërprerjeve për masat e marra, përfshirë arsyetimin për ndermarrjen e veprimeve të tilla, impaktit të raportuar nga agjentet e planifikimit të ndërprerjeve dhe OSSH-të ose OSSH-të e mbyllura kur është e rëndësishme.

5. Të gjithë OST-të e rajoneve përkatëse të koordinimit të ndërprerjeve rrjedhimisht do të përditësojnë dhe miratojnë planin e disponueshmërisë për vitin në avancë për të gjithë asetet përkatëse.

Neni 99

Planet finale të disponueshmërisë së vitit në avancë

1. Përpara 1 dhjetorit të çdo viti kalendarik, çdo OST do të:

   a) finalizoje koordinimin e ndërprerjeve të vitit ne avance te aseteve të brendshme te rendesishme; dhe
   b) finalizojë planet e disponueshmërisë për asetet e brendshme përkatëse për vitin ne avance dhe t'i ruajë ato në mjedisin e të dhënave të planifikimit operacional të ENTSO për Energjinë Elektrike.

2. Para 1 Dhjetorit të çdo viti kalendarik, OST do t'i konfirmojë Agjentit të Planifikimit të Ndërprerjeve, planin final te disponueshmërisë për vitin në avancë, për çdo Aset të brendëshëm te rendesishem.
3. Para 1 Dhjetorit të çdo viti kalendarik, OST do t'i ofrojë OSSH-së përkatëse planin e disponueshmërisë për vitin ne avance për çdo aset të brendshëm te rendesishem të vendosur në një sistem shpërndarje.
4. Para 1 dhjetorit të çdo viti kalendarik, OST do t'i ofrojë OSSH-së se mbyllur përkatëse planin e disponueshmërisë për vitin ne avance për çdo aset të brendshëm te rendesishem të vendosur në një sistem shpërndarje te mbyllur.

Neni 100

Përditësimet e planeve finale të disponueshmërisë për vitin në avancë

1. Një agjent i planifikimit të ndërprerjeve do të jetë në gjendje të nisë një procedurë për ndryshimin e planit përfundimtar të disponueshmërisë për vitin në avance në kohën ndërmjet përfundimit të koordinimit të ndërprerjeve të vitit ne avance dhe ekzekutimit të tij në kohë reale.
2. Agjenti i planifikimit të ndërprerjeve, i cili nuk është një OST që merr pjesë në një rajon të koordinimi të ndërprerjeve, duhet të jetë në gjendje t'i paraqesë OST(ve) përkatëse një kërkesë për ndryshimin e planit të disponueshmërisë për vitin në avancë të aseteve te rëndësishme nën përgjegjësinë e tij.
3. Në rast të një kërkese për ndryshim në përputhje me paragrafin 2, do të zbatohet procedura e mëposhtme:

   a) OST-ja pranuese do të pranojë kërkesën dhe do të vlerësojë sa më shpejt të jetë e mundur praktikisht nëse ndryshimi çon në papajtueshmëri të planifikimit të ndërprerjeve ;
   b) në rastin e zbulimit të papajtueshmërive të ndërprerjeve, OST-të e përfshira të rajonit të koordinimit të ndërprerjeve, së bashku do të gjejnë një zgjidhje në koordinim me

agjentet e planifikimit të ndërprerjeve në fjalë dhe nëse është e rëndësishme përfshijnë OSSH-në dhe OSSH-të e mbyllura duke përdorur mjetet në dispozicion të tyre;

c) në rastin kur nuk është konstatuar ndonjë papajtueshmëri në planifikimin e ndërprerjeve, ose nëse nuk mbetet asnjë papajtueshmëri në planifikimin e ndërprerjeve, OST që merr kërkesën do të validoje (pranoje) ndryshimin e kërkuar dhe OST-të respektive rrjedhimisht do të njoftojnë të gjitha palët e prekura dhe do të përditësojnë planin e disponueshmërisë së vitit në avancë në portalin e të dhënave të planifikimit operacional të ENTSO-E; dhe

d) nëse nuk gjendet asnjë zgjidhje për papajtueshmëritë e planit të ndërprerjeve, OST marrëse e kërkesës refuzon kërkesën për ndryshim.

4. Kur një OST që merr pjesë në një rajon të koordinimit të ndërprerjeve synon të ndryshojë planin e disponueshmërisë së vitit në avancë për një nga asetet relevante për të cilin vepron si agjent i planifikimit të ndërprerjes, do të iniciojë procedurën e mëposhtme:

a) OST kërkuese, do të përgatisë një propozim për ndryshimin e planit të disponueshmërisë të vitit në avancë, duke përfshirë vlerësimin nëse ai mund të çojë në papajtueshmëri në planifikimin e ndërprerjeve dhe duhet të paraqesë propozimin e tij tek të gjithë OST-të e tjera të rajonit(eve) të tij të koordinimit të ndërprerjeve;

b) në rastin e zbulimit të papajtueshmërive te planifikimit të ndërprerjeve, OST-të e përfshira të rajonit të koordinimit të ndërprerjeve, së bashku do të gjejnë një zgjidhje në koordinim me agjentet e planifikimit të ndërprerjeve në fjalë dhe nëse është e rëndësishme, do të përfshijnë OSSH-në dhe OSSH-të e mbyllura duke përdorur mjetet në dispozicion të tyre.

c) ne rastin kur nuk është konstatuar ndonjë papajtueshmëri në planifikimin e ndërprerjeve, ose kur është gjetur një zgjidhje për papajtueshmërite në planifikimin e ndërprerjeve, OST-të respektive do të validojnë (pranojne) ndryshimin e kërkuar dhe për rrjedhoje do të njoftojnë të gjitha palët e prekura dhe do të përditësojnë planin final të disponueshmërisë së vitit në avancë në portalin e të dhënave të planifikimit operacional të ENTSO-E; dhe

d) ne rastet kur nuk gjendet zgjidhje për papajtueshmëritë në planifikimin e ndërprerjeve, OST-ja kërkuese do të tërheqë procedurën për ndryshim.

Kapitulli 3

Ekzekutimi i planeve të disponueshmërisë

Neni 101

Menaxhimi i statusit "testim" të aseteve te rendesishme

1. Agjenti i planifikimit të ndërprerjeve të një aseti përkatës, statusi i disponueshmërisë së të cilit është deklaruar si "testim" duhet t'i sigurojë OST-së dhe, nëse është i lidhur me një sistem shpërndarjeje, duke përfshirë sistemet e mbyllura të shpërndarjes, OSSH ose OSSH se mbyllur, brenda 1 muaji përpara fillimit të statusit të "testimit", si vijon:

    a) Një plan testimi të detajuar;
    b) një skedul tregues të prodhimit ose konsumit nëse aseti i rendesishem përkatës është një modul i rendesishem i gjenerimit të energjisë ose një objekt i rendesishem i kërkesës; dhe
    c) ndryshimet në topologjinë e sistemit të transmetimit ose të sistemit të shpërndarjes nëse aseti i rendesishem në fjalë është element i rendesishem i rrjetit.

2. Agjentët e planifikimit të ndërprerjeve duhet të përditësojnë informacionin e përmendur në paragrafin 1 menjëherë pasi të jetë subjekt i ndonjë ndryshimi.

3. OST-ja e një aseti te rendesishem, statusi i disponueshmërisë së të cilit është deklaruar si "testim" duhet të sigurojë informacionin e marrë në përputhje me paragrafin 1 për të gjitha OST-të e tjera rajoni(et) të koordinimit të tij të ndërprerjeve, sipas kërkesës së tyre.

4. Në rast së aseti i rendesishem referuar paragrafit (1) është element i rendesishem i rrjetit që lidh dy ose me shume zona kontrolli, OST-të përkatëse të zonave të kontrollit do të bien dakord mbi sigurimin e informacionit në përputhje me paragrafin (1).

Neni 102

Procedura për trajtimin e ndërprerjeve të detyruara

1. Çdo OST do të hartojë një procedure për të adresuar rastet kur një ndërprerje e detyruar rrezikon sigurinë e saj operacionale. Procedura do të lejoje OST-ne të sigurojë që statusi "i disponueshëm" ose "i padisponueshëm" për asetet e tjera te rendesishme në zonën e saj të kontrollit, mund të ndryshohet respektivisht në "i padisponueshëm" ose " i disponueshëm".

2. OST do të ndjekë procedurën e përmendur në paragrafin 1 vetëm kur nuk arrihet marrëveshje me agjentët e planifikimit të ndërprerjeve në lidhje me zgjidhjet për ndërprerjet e detyrueshme. OST do të njoftojë autoritetin rregullator në përputhje me rrethanat.

3. Kur ndërmerr një procedure, OST duhet të respektojë, deri në masën e mundshme, kufijtë teknik të aseteve te rendesishem.

4. Agjenti i planifikimit të ndërprerjeve duhet të njoftojë për ndërprerjen e detyrueshme të një ose më shumë aseteve te rendesishme të saj, OST-në dhe nëse asetet janë të lidhur me sistemin e shpërndarjeje ose me një sistemin e mbyllur të shpërndarjes, OSSH ose OSSH e mbyllur respektivisht, sa më shpejt që të jetë e mundur, pas fillimit te ndërprerjes së detyruar.
5. Kur njofton ndërprerjen e detyruar, agjenti i planifikimit të ndërprerjeve duhet të japë informacionin e mëposhtëm:
    a) shkakun e ndërprerjes së detyruar;
    b) kohëzgjatjen e pritshme të ndërprerjes së detyruar; dhe
    c) nëse eshte e aplikueshme, ndikimin e ndërprerjes së detyruar në statusin e disponueshmërisë të aseteve te tjera te rendesishme për të cilet është agjent i planifikimit të ndërprerjeve.

6. Kurdo që OST dikton që një ose disa ndërprerje të detyruara të përmendura në paragrafin 1, kanë potencial të çojnë sistemin e transmetimit jashtë gjendjes normale, do të informojë agjentin(et) e planifikimit te nderprejeve te prekur, për afatin në të cilën siguria operacionale nuk mund të mbahet përveç nëse asetet e tyre përkatëse në ndërprerje të detyruar kthehen në statusin e "disponueshëm" . Agjentët e planifikimit të ndërprerjeve duhet të informojnë OST nëse ata janë në gjendje ta respektojnë atë afat dhe do të japin justifikime të arsyetuara kur nuk janë në gjendje respektojne atë afat.
7. Pas çdo ndryshimi të planit të disponueshmërisë për shkak të ndërprerjeve të detyrueshme dhe në përputhje me afatin kohor të përcaktuar në Nenet 7, 10 dhe 15 të Rregullores (BE) Nr. 543/2013, siç është adaptuar dhe miratuar nga Vendimi i Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë 2015/01/PHLG-EnC, OST-i i prekur do të përditësojë mjedisin e të dhënave për planifikimin operativ të ENTSO për Elektricitet me informacionin më të fundit.

Neni 103

Ekzekutimi i planeve të disponueshmërisë në kohë reale

1. Çdo pronar i njësive gjeneruese te energjise do të sigurojë që modulet gjeneruese te energjise te rendesishem qe zoteron, të cilat janë deklaruar 'të disponueshme' janë gati të prodhojnë energji në përputhje me kapacitet teknike të tyre te deklaruara kur nevojiten për mbajtjen e sigurisë operacionale, përveç rasteve të ndërprerjeve të detyruara.
2. Çdo pronar i njësive gjeneruese te energjisë do të sigurojë që modulet gjeneruese te energjisë te rëndësishëm qe zoteron, të cilat janë deklaruar 'të padisponueshme', nuk prodhojnë energji.
3. Çdo pronar objekti kërkese do të siguroj që të gjitha objektet e rendesishem te kërkesës qe zoteron, të cilat janë deklaruar 'të padisponueshme' nuk konsumojnë energji elektrike.
4. Çdo pronar i elementeve te rendesishme të rrjetit, do të sigurojë që të gjithë elementet e rendeishme te rrjetit qe zoteron, që janë të deklaruar 'të disponueshme', janë të gatshëm të transmetojnë energji në përputhje me kapacitetet teknike të deklaruara, kur nevojiten për të mbajtur sigurinë operacionale, përveç rasteve të ndërprerjeve të detyruara.

5. Çdo pronar i elementeve te rendesishme të rrjetit, do të sigurojë që të gjithë elementet e rrjetit qe zoteron, që janë të deklaruar 'të padisponueshëm', nuk transmetojnë energji.
6. Nëse aplikohen kushte të veçanta të ne lidhje me rrjetin për ekzekutimin e statusit 'i padisponueshëm' ose 'testim' të nje elementit te rendesishem të rrjetit, në pajtim me Nenin 96(6), OST, OSSH ose OSSH e mbyllur perkatese, do të vlerësojnë nëse këto kushte janë përmbushur para ekzekutimit te statusit. Nëse këto kushte nuk janë plotësuar, do te instruktohet pronari i elementit te rëndësishëm te rrjetit për të mos ekzekutuar statusin 'i padisponueshëm' ose 'testim' ose një pjesë të tij.
7. Kur OST identifikon që ekzekutimi i statusit "i padisponueshëm" ose 'testimi' i një aseti përkatës çon ose mund të çojë sistemin e transmetimit jashtë gjendjes normale, ai duhet të udhëzojë pronarin e asetit përkatës kur ai është i lidhur me sistemin e transmetimit, ose OSSH ose OSSH e mbyllur nëse është i lidhur me një sistem shpërndarjeje ose në një sistem të mbyllur shpërndarjeje të shtyjë ekzekutimin e statusit "i padisponueshëm" ose "testim" të atij aseti përkatës sipas udhëzimeve të tij dhe në masën e mundshme, duke respektuar kufijtë teknike dhe te sigurisë.

TITULLI 4

MJAFTUESHMERIA

Neni 104

Parashikimi për analizat e mjaftueshmërisë së zonës së kontrollit

1. Çdo OST do të vendose çdo parashikim të përdorur për analizat e mjaftueshmërisë së zonës së kontrollit në përputhje me nenet 105 dhe 107 në dispozicion të të gjithë OST-ve të tjera përmes portalit të të dhënave të ENTSO-E mbi planifikimin operacional.

Neni 105

Analizat e mjaftueshmërisë së zonës së kontrollit

1. Çdo OST do të kryejë analizën e mjaftueshmërisë së zonës së kontrollit duke vlerësuar mundësinë që shuma e gjenerimit brenda zonës së tij të kontrollit dhe aftësive të importit ndërkufitar të përmbushë ngarkesën totale brenda zonës së tij të kontrollit sipas skenarëve të ndryshëm operacional, duke marrë parasysh nivelin e kërkuar të rezervave të fuqisë aktive të përcaktuar në nenet 118 dhe 119.
2. Kur kryen analiza të mjaftueshmërisë së zonës së kontrollit në përputhje me paragrafin 1, çdo OST do të:
   a) përdorë planet më të fundit të disponueshmërisë dhe të dhënat më të fundit të disponueshme për:
      i. aftësinë e moduleve gjeneruese te energjisë te siguruara në përputhje me Nenin 43(5), Nenin 45 dhe Nenin 51;
      ii. kapacitetet ndërkufitare;

iii. përgjigje e mundshme te kërkesës e ofruar sipas neneve 52 dhe 53; ;

b) marrë në konsideratë kontributin e gjenerimit nga burimet e rinovueshme të energjisë dhe kërkesën për energji elektrike;
c) vlerësojë probabilitetin dhe kohëzgjatjen e mundshme të mungesës së mjaftueshmërisë dhe energjinë e pafurnizuar si rezultat i kësaj mungese.

3. Sa më shpejt të jetë e mundur, pas vlerësimit të mungesës së mjaftueshmërisë brenda zonës së saj të kontrollit, çdo OST do të njoftoje per mungesën autoritetin rregullator ose kur parashikohet shprehimisht në ligjin kombëtar, një autoritet tjetër kompetent dhe kur është e zbatueshme, çdo palë të prekur.
4. Sa më shpejt që të jetë e mundur, pas analizës së mungesës së mjaftueshmërisë brenda zonës së tij të kontrollit, çdo OST do të informojë të gjithë OST-të nëpërmjet mjedisin e të dhënave të planifikimit operativ të ENTSO-E.

Neni 106

Mjaftueshmëria e zonës së kontrollit deri/dhe përfshirë javën në avancë

1. Çdo OST do të kontribuojë në perspektivat vjetore pan-evropiane të mjaftueshmërisë së gjenerimit të verës dhe dimrit duke zbatuar metodologjinë e miratuar nga ENTSO për Energjinë Elektrike <...>.
2. Dy herë në vit, çdo OST do të kryejë një analizë të mjaftueshmërisë së zonës së kontrollit për verën e ardhshme dhe dimrin respektivisht, duke marrë parasysh skenarët pan-evropianë në përputhje me perspektivat vjetore pan-evropiane e mjaftueshmërisë së gjenerimit të verës dhe dimrit
3. Çdo OST do të përditësojë analizat e mjaftueshmërisë së zonës së kontrollit nëse zbulon ndonjë ndryshim të mundshëm në statusin e disponueshmërisë të moduleve gjeneruese të energjisë, vlerësimet e ngarkesës, vlerësimet e burimeve të energjisë së rinovueshme ose kapacitetet nderzonale që mund të ndikojnë ndjeshëm në mjaftueshmerine e pritshme.

Neni 107

Mjaftueshmëria e zonës së kontrollit në ditën ne avance dhe brenda ditës

1. Çdo OST do të kryejë analiza të mjaftueshmërisë në zonën e saj te kontrollit për ditën në avancë dhe brenda ditës, bazuar në:

a) skedulimet e sipas Nenit 111;
b) parashikimin e kërkesës;
c) parashikimin e gjenerimit nga burimet e energjisë së rinovueshme;
d) rezervat e fuqisë aktive në pajtim me të dhënat e siguruara në përputhje me Nenin 46(1)(a);

e) kapacitetet e importit dhe eksportit të zonës së kontrollit, në përputhje me kapacitetet ndërzonale të llogaritura, ku është e aplikueshme, në përputhje me Nenin 14 të

Rregullores (BE) 2015/1222, siç është adaptuar dhe miratuar nga Vendimi i Këshillit të Ministerial 2022/03/MC-EnC;

f) aftësitë e moduleve gjeneruese te energjise në përputhje me të dhënat e siguruara në pajtim me Nenin 43(4) dhe Nenin 45 dhe 51 dhe statuseve të tyre të disponueshmërisë; dhe
g) aftësitë e njësive të kërkesës me përgjigje te kerkeses në përputhje me të dhënat e siguruara sipas Nenit 52 dhe 53 dhe statuseve të tyre të disponueshmërisë.

2. Çdo OST do të vlerësojë:

a) nivelin minimal importues dhe nivelin maksimal eksportues në përputhje me mjaftueshmërinë e zonës së saj te kontrollit;
b) kohëzgjatjen e pritshme të mungesës potenciale të mjaftueshmërisë; dhe
c) energjinë e pritshme të pafurnizuar në mungesë të mjaftueshmërisë.

3. Nëse në përputhje me analizat referuar pikës (1) mjaftueshmëria nuk përmbushet, çdo OST do të informojë mungesën e mjaftueshmerise tek autoriteti i tij rregullator ose autoritetin përkatëse kompetent. OST do ti sigurojë autoritetit te tij rregullator ose autoriteteve përkatëse kompetente një analizë të shkaqeve të mungesës së mjaftueshmërisë dhe do te propozoje masat zbutëse.

TITULLI 5

Shërbimet ndihmese

Neni 108

Shërbimet Ndihmese

1. Çdo OST do të monitorojë disponueshmërinë e shërbimeve ndihmëse.

2. Lidhur me fuqinë aktive dhe shërbimet ndihmese të fuqisë reaktive, në koordinim me OST-të e tjera kur eshte e përshtatshme, çdo OST do të:
   a) dizenjojë, vendosë dhe menaxhoje procedura për prokurimin e shërbimeve ndihmëse;
   b) monitorojë në bazë të të dhënave në pajtim me Titullin 2 të Pjesës II, nëse niveli dhe vendndodhja e shërbimeve ndihmëse të disponueshme lejon përmbushjen e kushteve të sigurisë operacionale;
   c) të përdorë të gjitha mjetet e mundshme ekonomikisht efikase dhe të realizueshme për të siguruar nivelin e nevojshëm të shërbimeve ndihmëse. .

3. OST do të bëjë publike nivelin e kërkuar të rezervave të fuqisë aktive për te ruajtur sigurinë operacionale
4. OST do të bëjë publike nivelin e kërkuar të rezervave të fuqisë aktive për OST-të e tjera sipas kerkeses së tyre.

Neni 109

Shërbimet ndihmese të fuqisë reaktive

1. Për çdo kornizë kohore të planifikimit operacional, çdo OST do të vlerësojë, kundrejt parashikimeve të tyre, nëse shërbimet ndihmëse të disponueshme të fuqisë reaktive janë të mjaftueshme për të ruajtur sigurinë operacionale të sistemit të transmetimit.

2. Me qëllim rritjen e eficencës në operimin e elementëve të sistemit të transmetimit, OST do të monitorojë:

   a) kapacitetet e disponueshme të fuqisë reaktive të objekteve gjeneruese te energjise;
   b) kapacitet e disponueshme të fuqisë reaktive të objekteve të kërkesës të lidhur në sistemin e transmetimit;
   c) kapacitet e disponueshme të fuqisë reaktive të OSSH-ve;
   d) pajisjet e disponueshme të lidhura në transmetim të dedikuara për të ofruar fuqi reaktive; dhe
   e) raportin fuqisë aktive dhe reaktive në ndërfaqen midis sistemit të transmetimit dhe sistemit të shpërndarjes.

3. Kur niveli i shërbimeve ndihmëse të fuqisë reaktive nuk është i mjaftueshëm për mbajtjen e sigurisë operacionale, çdo OST do të:
   a) informojë OST-të fqinje
   b) përgatit dhe aktivizon veprime përmirësuese ne përputhje me Nenin 23.

TITULLI 6

SKEDULIMI

Neni 110

Krijimi i Proceseve të Skedulimit

1. Kur krijon një proces skedulimi, OST duhet të marrë parasysh dhe plotësojë aty ku është e nevojshme kushtet operacionale të metodologjisë së të dhënave të gjenerimit dhe të ngarkesës të hartuar në përputhje me Nenin 16 të Rregullores (EU) 2015/1222.
2. Kur një zonë ofertuese mbulon vetëm një zonë kontrolli, fushëveprimi gjeografik i zonës së skedulimit është i barabarte me zonën e ofertimit. Kur një zonë kontrolli mbulon disa zona ofertimi, fushëveprimi gjeografik i zonës së skedulimit eshte i barabarte me zonën e ofertimit. Kur një zonë ofertuese mbulon disa zona kontrolli, OST-të brenda asaj zone ofertuese mund të vendosin së bashku për të operuar një proces të përbashkët skedulimi, përndryshe, çdo zonë kontrolli brenda asaj zone ofertuese konsiderohet një zonë e veçantë skedulimi.

3. Për çdo objekt gjenerues të energjisë dhe objekt te kërkesës që i nënshtrohen kërkesave për skedulim te përcaktuara në termat dhe kushtet kombëtare, pronari në fjalë do të emërojë ose të veprojë si agjent skedulimi.
4. Çdo pjesmarrës tregu dhe agjent transferimi, subjekt i kërkesave për skedulim te përcaktuara në termat dhe kushtet kombëtare, do të emërojë ose të veprojë si agjent skedulimi.
5. Çdo OST që operon një zonë skedulimi do të vendose rregullimet e nevojshme për të përpunuar skedulet e ofruara nga agjentët e skedulimit.
6. Kur një zone skedulimi mbulon me shumë se një zone kontrolli, OST-të përgjegjëse për zonat e kontrollit do të bien dakord së cila OST do të operoje zonën e skedulimit.

Neni 111

Njoftimi i skeduleve brenda zonës së skedulimit

1. Çdo agjent skedulimi, me përjashtim të agjentëve të skedulimit të agjentëve të transferimit, duhet t'i dorëzojë OST-së që operon zonen e skedulimitt, nëse kërkohet nga OST, dhe, sipas rastit, për palët e treta, skedulet e mëposhtme:
   a) Skedulet e Gjenerimit;
   b) Skedulet e Konsumit;
   c) Skedulet e transaksioneve të brendëshme tregtare; dhe
   d) Skedulet e transaksioneve të jashtme tregtare.

2. Çdo agjent skedulimi i një agjenti transferimi ose, kur është e aplikueshme, një palë tjetër qendrore do t'i paraqesë OST-së që operon një zonë skedulimi të mbuluar nga bashkimi i tregut, nëse kërkohet nga OST-ja përkatëse, dhe kur është e zbatueshme për palën e tretë, skedulet e mëposhtme
   a) Skedulet e transaksioneve të jashtme tregtare, si:
      i. shkëmbime shumëpalëshe ndërmjet zonës së skedulimit dhe një grupi tjetër të zonave të skedulimit; ose
      ii. shkëmbime dypalëshe ndërmjet zonës së skedulimit dhe një zone tjetër skedulimi;

   b) Skedulet tregtare të brendëshme ndërmjet agjentëve te transferimit dhe palëve qendrore respektive;
   c) Skedulet tregtare të brendëshme ndërmjet agjentëve te transferimit dhe agjenteve të tjerë te transferimit

Neni 112

Koherenca e Skeduleve

1. Çdo OST që operon një zonë skedulimi do të kontrollojë nëse gjenerimi, konsumi, skedulet e tregtisë së jashtme tregtare dhe skedulet e OST-ve të jashtme në zonën e tij të planifikimit janë në total të balancuara.

2. Për skedulimet e jashtme të OST, çdo OST do të dakordojë mbi vlerat e skedulit me OST përkatëse. Në mungesë të marrëveshjes, do të zbatohet vlera më e ulët.
3. Për shkëmbime bilaterale midis dy zonave të skedulimit, secila OST do të bjerë dakord mbi skedulet e tregtimit komercial të jashtëm me OST përkatëse. Në mungesë të një marrëveshjeje për vlerat e skedulit komercial të tregtitimit, do të zbatohet vlera më e ulët.
4. Të gjithë OST-të që operojnë një zonat e skedulimit do të verifikojnë nëse të gjitha skedulet e jashtme neto të agreguara ndërmjet të gjitha zonave të skedulimit brenda zonës sinkrone janë të balancuara. Nëse ndodh një mospërputhje dhe OST-të nuk pajtohen mbi vlerat e skedulit të jashtëm neto të agreguar, do të zbatohen vlerat më të ulëta.
5. Çdo agjent skedulimi i një agjenti transferimi ose, kur është e zbatueshme, një palë tjetër qendrore duhet të sigurojë OST-të, me kërkesën e tyre, me vlerat e skeduleve të tregtisë së jashtme tregtare të çdo zone skedulimi te përfshirë në bashkimin e tregut në formën e skeduleve të jashtme të agreguara të neto .
6. Secili llogaritës të shkëmbimit te skeduluar do t'i ofrojë OST-ve, sipas kërkesës së tyre, vlerat e shkëmbimeve të skeduluara në lidhje me zonat e skedulimit të përfshira në bashkimin e tregut në formën e skedulit të jashtëm neto të agreguar, duke përfshirë shkëmbimet dypalëshe mes dy zonave të skedulimit.

Neni 113

Sigurimi i informacionit për OST-të e tjera

1. Me kërkesë të një OST-je tjetër, OST-se të cilës i kërkohet do të llogarisë dhe japë:

   a) Skedulet e jashtme neto të agreguara; dhe
   b) Pozicionin neto të zonës AC, kur zona e skedulimit është e ndërlidhur me zonat e tjera të skedulimit nëpërmjet linjave të transmetimt AC.

2. Kur kërkohen për krijimin e modeleve të përbashkëta te rrjetit, në përputhje me Nenin 70(1), çdo OST që operon në një zonë skedulimi do ti japë informacionin OST-së që e kërkon lidhur me:

   a) skedulet e gjenerimit; dhe
   b) skedulet e konsumit.

TITULLI 7

Portali i të Dhënave të Planifikimit Operacional të ENTSO-E

Nenin 114

Dispozita të përgjithshme për portalin e të dhënave të planifikimit operacional të ENTSO-E

1. <…>

2. <…>

3. Të gjithë OST-të dhe qendrat e koordinimit rajonal do të kenë akses në të gjitha informacionet që përmban mjedisi i të dhënave për planifikimin operacional të ENTSO për Elektricitet.

4. <…>

5. <…>

Neni 115

Modelet individuale te rrjetit, modelet e perbashketa të rrjetit dhe analizat e sigurisë operacionale

1. Mjedisi i të dhënave për planifikimin operativ të ENTSO për Elektricitet do të ruajë të gjitha modelet individuale të rrjetit dhe informacionet përkatëse për të gjitha afatet kohore relevante të përcaktuara në këtë Rregullore, në Nenin 14(1) të Rregullores (BE) 2015/1222, siç është adaptuar dhe miratuar nga Vendimi i Këshillit të Ministerial 2022/03/MC-EnC dhe në Nenin 9 të Rregullores (BE) 2016/1719, siç është adaptuar dhe miratuar nga Vendimi i Këshillit të Ministrerial 2022/03/MC-EnC.
2. Informacioni mbi modelet individuale të rrjetit në portalin e të dhënave të ENTSO-E do të lejojë bashkimin me modelet e përbashkët të rrjetit.
3. Modeli i përbashkët i rrjetit i përcaktuar për çdo periudhë kohore do të vihet ne dispozicion në Portalin e të Dhënave të Planifikimit Operacional të ENTSO-E.
4. Për periudhën kohore te vitit në avancë, do të bëhet i disponueshëm në Portalin e të Dhënave të Planifikimit Operacional, informacioni i mëposhtëm
   a. Modelet individuale të rrjetit për vitin në avancë dhe për cdo OST dhe per cdo skenar te përcaktuar në përputhje me Nenin 66; dhe
   b. Modeli i përbashkët i rrjetit për vitin në avancë, për cdo skenar te përcaktuar në Nenin 67
5. Për horizontet kohore te ditës në avancë dhe brenda-ditës, do të bëhet i disponueshëm në Portalin e të Dhënave të Planifikimit Operacional, informacioni i mëposhtëm:
   a) Modelet individuale të rrjetit për ditën në avancë dhe brenda ditës, për çdo OST në përputhje me rezolucionin kohor të përcaktuar sipas Nenin 70(1);

b) Shkëmbimet e skeduluara në rastet relevante të kohës për çdo zonë e skedulimi ose për çdo kufi të zonës së skedulimit, cilido qoftë që konsiderohet i rëndësishëm për OST-ne dhe për çdo sistemin HVDC që lidh zonat e skedulimit;
c) Modelet e përbashkëta të rrjetit për ditën në avancë dhe brenda ditës në përputhje me rezolucionin kohor të përcaktuar sipas Nenit 70(1); dhe
d) Një listë tëe përgatitur dhe rakorduar të veprimeve përmirësuese, të identifikuara për tu përballur me kufizimet me rëndësi ndër-kufitare.

Neni 116

Koordinimi i ndërprerjeve

1. Portali i të Dhënave të Planifikimit Operacional të ENTSO-E ENTSO-E do të përfshijë një modul për ruajtjen dhe shkëmbimin e të gjithë informacionit të rëndësishëm lidhur me koordinimin e ndërprerjeve.
2. Informacioni i përmendur në paragrafin 1 duhet të përfshijë së paku statusin e disponueshmërisë së aseteve të rëndësishme dhe informacionin mbi planet e disponueshmërisë të përmendura në Nenin 92.

Neni 117

Mjaftueshmëria e Sistemit

1. Portali i të Dhënave të Planifikimit Operacional të ENTSO-E do të ruajë të gjithë informacionin relevant për kryerjen e analizave të kordinuara të Mjaftueshmërisë.
2. Informacioni i përmendur në paragrafin 1 do të përfshijë së paku:
   a) të dhënat e mjaftueshmërisë së sistemit për stinën në avancë, të siguruara nga çdo OST;
   b) raport të analizës së mjaftueshmërisë të zonës sinkrone Evropiane, për stinën në avancë;
   c) parashikimet e përdorura për mjaftueshmërinë në pajtim me Nenin 104; dhe
   d) informacionin në lidhje me mungesën e mjaftueshmërisë në pajtim me Nenin 105(4).

PJESA IV
KONTROLLI NGARKESË - FREKUENCE DHE REZERVAT

TITULLI I

MARRËVESHJET OPERACIONALE

Neni 118

Marrëveshjet operacionale të zonës sinkrone

1. Jo më vonë së 12 muaj pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, të gjithë OST-të e secilës zonë sinkrone, përveç nëse është miratuar tashmë mbi baza kontraktuale,, do të hartojnë së bashku propozime të përbashkëta për:

a) rregullat e dimensionimit për FCR në përputhje me Nenin 153;

b) veti shtesë të FCR në përputhje me Nenin 154 (2);

c) parametrat përcaktues të cilësisë së frekuencës dhe parametrat e synuar të cilësisë së frekuencës në përputhje me Nenin 127;

d) për Evropën Kontinentale ("EK") <...> parametrat e synuar të gabimit të kontrollit të rivendosjes së frekuencës për secilën bllok LFC në përputhje me Nenin 128;

e) metodologjinë për të vlerësuar rrezikun dhe evoluimin e rrezikut të ezaurimit të FCR të zonës sinkrone në përputhje me Nenin 131 (2);

f) monitorimin e zonës sinkrone në përputhje me Nenin 133;

g) llogaritjen e programit të kontrollit nga pozicioni AC i zonës së netuar e një periudhë të zakonshme rampimi për llogaritjen e ACE për një zonë sinkrone me më shumë së një zonë LFC në përputhje me Nenin 136.

h) nëse është e aplikueshme, kufizime për output e fuqisë aktive të interkonektorëve HVDC ndërmjet zonave sinkrone në përputhje me Nenin 137;

i) strukturën e LFC-së në përputhje me Nenin 139;

j) nëse është e aplikueshme, metodologjinë për të zvogëluar devijimin elektrik të kohës në përputhje me Nenin 181;

k) kur zona sinkrone është operuar nga më shumë se një OST, ndarjen specifike të përgjegjësive ndërmjet OST-ve në përputhje me Nenin 141;

l) proçedurat operacionale në rast të ezaurimit të FCR në pajtim me Nenin 152 (7) **të Rregullores 2017/1485;**

m) <...>

n) procedurat operacionale për të reduktuar devijimin e frekuencës së sistemit për të rikthyer gjendjen e sistemit në gjendje normale dhe për të kufizuar rrezikun e hyrjes në gjendje emergjente në përputhje me Nenin 152 (10);

o) rolet dhe përgjegjësitë e OST-ve për implementimin e një procesi netimi të disbalancave, një proces aktivizimi FRR ndërkufitar ose nje proces aktivizimit ndërkufitare të RR-ve në përputhje me Nenin 149 (2);

p) kërkesat lidhur me disponueshmërinë, besueshmërinë dhe rezervat shtesë të infrastrukturës teknike në përputhje me Nenin 151 (2);

q) rregullat e përbashkëta për operimin në gjendjen normale dhe gjendjen alarmi në përputhje me Nenin 152 (6) dhe veprimet e përmendura në nenin 152 (15);

r) për zonen sinkrone të EK <...>, periudha e aktivizimit minimal per tu siguruar nga ofruesit e FCR në përputhje me Nenin 156 (10);

s) për zonen sinkrone të EK <...>, supozimet dhe metodologjitë për një analizë kosto-përfitim në përputhje me Nenin 156 (11) **të Rregullores 2017/1485**;

t) nëse është e aplikueshme, për zonat sinkrone të ndryshme nga EK, kufijtë për shkëmbimin e FCR midis OST-ve në përputhje me Nenin 163 (2);

u) rolet dhe përgjegjësitë e OST-ve lidhëse të rezervës, OST marrëse të rezervës dhe OST-të e prekura sa i përket shkëmbimit të FRR dhe RR të përcaktuar në përputhje me Nenin 165 (1);

v) rolet dhe përgjegjësitë OST-të që ofrojnë aftësinë kontrolluese, OST-të që marrin aftësinë kontrolluese dhe OST e prekur për ndarjen e FRR dhe RR të përcaktuar në përputhje me Nenin 166 (1);

w) rolet dhe përgjegjësitë e OST të e lidhur me rezervën, OST që merr rezervën dhe OST-në e prekur për shkëmbimin e rezervave ndërmjet zonave sinkrone dhe OST-të që ofrojnë aftësinë kontrolluese, OST-të që merr aftësinë kontrolluese dhe OST të prekur për ndarjen e rezervave midis zonave sinkrone të përcaktuara në përputhje me Nenin 171 (2);

x) metodologjinë për të përcaktuar limitet mbi shumën e shkëmbimit të FCR midis zonave sinkrone të përcaktuara në përputhje me Nenin 174 (2);

y) **<...>**

z) metodologjinë për të përcaktuar kufijtë në shumën e shkëmbimit të FRR midis zonave sinkrone të përcaktuara në përputhje me Nenin 176 (1) dhe metodologjinë për të përcaktuar kufijtë në sasinë e ndarjes së FRR ndërmjet zonave sinkrone të përcaktuara në përputhje me Nenin 177 (1); dhe;

aa) metodologjinë për të përcaktuar kufijtë në sasinë e shkëmbimit të RR midis zonave sinkrone të përcaktuara në përputhje me Nenin 178 (1) dhe metodologjinë për të përcaktuar kufijtë në sasinë e ndarjes së RR ndërmjet zonave sinkrone të përcaktuara në përputhje me Nenin 179 (1).

2. Të gjithë OST-të e çdo zone sinkrone do të dorëzojnë metodologjitë dhe kushtet e renditura në Nenin 6 (3)(d) për miratim nga të gjitha autoritetet rregullatore të zonës sinkrone përkatëse. Brenda një muaji pas miratimit të këtyre metodologjive dhe kushteve, të gjithë OST-të e secilës zonë sinkrone do të lidhin një marrëveshje operacionale të zonës sinkrone e cila do të hyjë në fuqi brenda 3 muajve pas miratimit të metodologjive dhe kushteve.

Neni 119

Marrëveshjet operacionale të bllokut LFC

1. Jo me vonë së 12 muaj pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, të gjithë OST-të e secilit bllok LFC së bashku do të zhvillojnë propozime të përbashkëta për:

a) kur blloku LFC përbëhet nga më shumë së një zonë LFC, parametrat e synuar të FRCE për secilën zonë LFC të përcaktuar në përputhje me Nenin 128 (4);

b) Monitorimi i bllokut të LFC në përputhje me Nenin 134 (1);

c) kufizimet në lidhje me rampimin në prodhimin e energjisë aktive në përputhje me Nenin 137 (3) dhe (4);

d) ku blloku LFC operohet nga më shumë së një OST, alokimi specifik i përgjegjësive ndërmjet OST-ve brenda bllokut të LFC-së në përputhje me Nenin 141 (9);

e) nëse është e aplikueshme, përcaktimi i OST-së përgjegjës për detyrat në Nenin 145 (6);

f) kërkesat shtesë për disponueshmërinë, besueshmërinë dhe rezervat shtesë të infrastrukturës teknike të përcaktuar në përputhje me Nenin 151 (3);

g) procedurat operacionale në rast të FRR të ezauruar ose RR në përputhje me Nenin 152 (8);

h) rregullat e dimensionimit të FRR të përcaktuara në përputhje me Nenin 157 (1);

i) rregullat e dimensionimit RR të përcaktuara në përputhje me Nenin 160 (2);

j) ku blloku i LFC-së operohet nga më shumë së një OST, ndarja specifike e përgjegjësive të përcaktuara në përputhje me Nenin 157 (3) dhe, nëse është e zbatueshme, ndarja specifike e përgjegjësive të përcaktuara në përputhje me Nenin 160 (6);

k) procedurën e përshkallëzimit të përcaktuar në përputhje me Nenin 157 (4) dhe, nëse është e zbatueshme, procedurën e përshkallëzimit të përcaktuar në përputhje me Nenin 160 (7);

l) kërkesat e disponueshmërisë së FRR, kërkesat për cilësinë e kontrollit të përcaktuar në përputhje me Nenin 158 (2) dhe nëse është e zbatueshme, kërkesat e disponueshmërisë së RR-së dhe kërkesat për cilësinë e kontrollit të përcaktuar në përputhje me Nenin 161 (2);

m) nëse është e aplikueshme, çdo kufizim në shkëmbimin e FCR midis zonave LFC të blloqeve LFC të ndryshme brenda zonës sinkrone EK dhe shkëmbimin e FRR ose RR midis zonave LFC të një blloku LFC të një zone sinkrone që përbëhet nga më shumë së një bllok LFC të përcaktuara në përputhje me Nenin 163 (2), Nenin 167 dhe Nenin 169 (2);

n) rolet dhe përgjegjësitë e OST të lidhur me rezervën, OST që merr rezervën dhe OST e prekur për shkëmbimin e FRR dhe / ose RR me OST -të e blloqeve të tjera të LFC të përcaktuara në përputhje me Nenin 165 (6);

o) rolet dhe përgjegjësitë e OST që ofrojë aftësinë kontrolluese, OST që merr aftësinë kontrolluese dhe OST e prekur për ndarjen e FRR dhe RR të përcaktuar në përputhje me Nenin 166 (7);

p) rolet dhe përgjegjësitë e OST që ofrojnë aftësinë kontrolluese, OST që merr aftësinë kontrolluese dhe OST e prekur për ndarjen e FRR dhe RR midis zonave sinkrone në përputhje me Nenin 175 (2);

q) veprimet e koordinuara që synojnë reduktimin e FRCE siç përcaktohet në Nenin 152 (14); dhe;

r) masat për të reduktuar FRCE duke kërkuar ndryshime në prodhimin ose konsumin e energjisë aktive të moduleve gjeneruese të energjisë dhe njësive konsumatore në përputhje me Nenin 152 (16).

2. Të gjithë OST-të e secilit bllok LFC do të dorëzojnë metodologjitë dhe kushtet e renditura në Nenin 6 (3) (e) për miratim nga të gjitha autoritetet rregullatore të bllokut përkatës LFC. Brenda një muaji pas miratimit të këtyre metodologjive dhe kushteve, të gjithë OST-të e secilit bllok LFC do të lidhin një marrëveshje operacionale të bllokut LFC, i cili hyn në fuqi brenda 3 muajve pas miratimit të metodologjive dhe kushteve.

Neni 120

Marrëveshja operacionale e zonës LFC

Deri në 12 muaj pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, të gjithë OST-të e secilës zonë LFC do të krijojnë një marrëveshje operacionale të zonës LFC që përfshin së paku:

a) ndarjen specifike të përgjegjësive ndërmjet OST-ve brenda zonës LFC në përputhje me Nenin 141 (8);

b) caktimin e OST-së përgjegjës për zbatimin dhe operimin e procesit të rivendosjes së frekuencës në përputhje me Nenin 143 (4).

Neni 121

Marrëveshja operacionale e zonës së monitorimit

Deri në 12 muaj pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, të gjithë OST-të e secilës zonë të monitorimit do të krijojnë një marrëveshje operacionale për zonën e monitorimit, e cila duhet të përfshijë të paktën ndarjen e përgjegjësive ndërmjet OST-ve në të njëjtën zonë monitorimi, në përputhje me Nenin 141 (7).

Neni 122

Marrëveshja e netimit të disbalancave

Të gjithë OST-të që marrin pjesë në të njëjtin proces të netimit të disbalancave do të krijojnë një marrëveshje për netimin e disbalancave që së paku do të përfshijë rolet dhe përgjegjësitë e OST-ve në përputhje me Nenin 149 (3).

Neni 123

Marrëveshja për aktivizimin ndërkufitar të FRR

Të gjithë OST-të që marrin pjesë në procesin e përbashkët të aktivizimit ndërkufitar të FRR do të krijojnë një marrëveshje të aktivizimit ndërkufitar të FRR që duhet të përfshijë të paktën rolet dhe përgjegjësitë e OST-ve në përputhje me Nenin 149 (3).

Neni 124

Marrëveshja e aktivizimit ndërkufitar të RR

Të gjithë OST-të që marrin pjesë në procesin e njëjtë të aktivizimit ndërkufitar të RR-së do të krijojnë një marrëveshje të aktivizimit ndërkufitar të RR-së që do të përfshijë të paktën rolet dhe përgjegjësitë e OST-ve në pajtim me Nenin 149 (3).

Neni 125

Marrëveshja e ndarjes

Të gjithë OST-të që marrin pjesë në të njëjtin proces të ndarjes së FCR, FRR ose RR do të krijojnë një marrëveshje ndarjeje që duhet të përfshijë të paktën:

a) në rast të ndarjes së FRR ose RR brenda një zone sinkrone, rolet dhe përgjegjësitë e aftësisë se kontrollit të OST marrëse, aftësinë e kontrollit te OST ofruese dhe OST-të e prekura, në përputhje me Nenin 165 (3); ose

b) në rast të ndarjes së rezervave ndërmjet zonave sinkrone, rolet dhe përgjegjësitë e aftësive të kontrollit te OST marrese dhe aftësinë e kontrollit të OST ofruese në përputhje me Nenin 171 (4) dhe procedurat në rast së ndarja e rezervave midis zonave sinkrone nuk ekzekutohet në kohë reale në përputhje me Nenin 171 (9).

Neni 126

Marrëveshja e shkëmbimit

Të gjithë OST-të që marrin pjesë në të njëjtin shkëmbim të FCR, FRR ose RR do të krijojnë një marrëveshje shkëmbimi që përfshin të paktën:

a) në rast të shkëmbimit të FRR ose RR brenda një zone sinkrone, rolet dhe përgjegjësitë e OST-së lidhese dhe marrese të rezervës në përputhje me Nenin 165 (3); ose

b) në rast të shkëmbimit të rezervave ndërmjet zonave sinkrone, rolet dhe përgjegjësitë e OST lidhese dhe marrëse te rezervës në përputhje me Nenin 171 (4) si dhe procedurat në rast se shkëmbimi i rezervave ndërmjet zonave sinkrone nuk ekzekutohet në kohë reale në përputhje me nenin 171 (9).

TITULLI 2

CILËSIA E FREKUENCËS

Neni 127

Përcaktimi i cilësisë së frekuencës dhe parametrat e synuar

1. Parametrat përcaktues të cilësisë së frekuencës do të jenë:

a) frekuenca nominale për të gjitha zonat sinkrone;

b) diapazoni i frekuencave standarde për të gjitha zonat sinkrone;

c) devijimi maksimal i menjëhershëm i frekuencës për të gjitha zonat sinkrone;

d) devijimi maksimal i frekuencës në gjendje të qëndrueshme për të gjitha zonat sinkrone;

e) koha për të rivendosur frekuencën për të gjitha zonat sinkron;

f) <.>

g) <.>

h) <.>

i) koha e shkaktimit të gjendjes së alarmit për të gjitha zonat sinkron.

2. Frekuenca nominale do të jetë 50 Hz për të gjitha zonat sinkrone.
3. Vlerat e paracaktuara të parametrave përcaktues të cilësisë së frekuencës të renditura në paragrafin 1 janë paraqitur në Tabelën 1 të Shtojcës III në lidhje me zonën sinkrone të Evropës Konitnentale. **OST-të e Palëve Kontraktuese** që veprojnë në zona të tjera sinkrone përjashtohen nga detyrimi për të arritur këto vlera dhe për të operuar sipas rregullave të këtyre zonave sinkrone.
4. Parametri i cilësisë së synuar së frekuencës do të jetë numri maksimal i minutave jashtë intervalit të frekuencës standarde në vit për zonën sinkrone dhe vlera e tij e paracaktuar për zonën sinkrone, janë paraqitur në Tabelën 2 të Shtojcës III.
5. Vlerat e parametrave përcaktues të cilësisë së frekuencës në Tabelën 1 të Aneksit III dhe parametri i synuar i cilësisë së frekuencës në Tabelën 2 të Shtojcës III do të zbatohen përveç nëse të gjithë OST-të e një zone sinkrone propozojnë vlera të ndryshme në përputhje me paragrafët 6, 7 dhe 8.
6. Të gjithë OST-të e Evropës Kontinentale <..> kanë të drejtën të propozojnë në marrëveshjen operacionale të zonës sinkrone, vlera të ndryshme nga ato të paraqitura në Tabelat 1 dhe 2 të Aneksit III në lidhje me:

    a) kohën e nxitjes së gjendjes alarmit;

    b) numrin maksimal të minutave jashtë intervalit të frekuencës standarde.

7. <.>

8. Propozimi për modifikimin e vlerave në përputhje me paragrafin 6 <...> do të bazohet në një vlerësim të vlerave të regjistruara të frekuencës së sistemit për një periudhë prej së paku një viti dhe zhvillimit të zonës sinkrone dhe ajo duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

    a) modifikimi i propozuar i parametrave përcaktues të cilësisë së frekuencës në Tabelën 1 të Aneksit III ose parametri i synuar i cilësisë së frekuencës në Tabelën 2 të Shtojcës III merr parasysh:

    i. madhësinë e sistemit, bazuar në konsumin dhe gjenerimin e zonës sinkrone dhe inercinë e zonës sinkrone;
    ii. incidentin referent;

    iii. strukturën e rrjetit dhe/ose topologjinë e rrjetit;

iv. sjellja e ngarkesës dhe gjenerimit;

v. numrin dhe përgjigjen e moduleve gjeneruese te energjise në modalitet të ndjeshëm ndaj frekuencës së kufizuar — mbi frekuencë dhe modalitet të ndjeshëm ndaj frekuencës së kufizuar — nën frekuencë siç përcaktohet në Nenin 13 (2) dhe Nenin 15 (2) (c) të Rregullores (BE) 2016/631 siç është përshtatur dhe miratuar me Vendimin e Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë 2018/03/PHLG-EnC;.

vi. numrin dhe përgjigjen e njësive konsumatore që operojnë me kontrollin e frekuencës së sistemit të përgjigjes së kërkesës së aktivizuar ose kontrollin e fuqisë aktive shumë të shpejtë të përgjigjes së kërkesës siç përcaktohet në Nenet 29 dhe 30 të Rregullores (EU) 2016/1388 të përshtatur dhe miratuar me anë të Vendimit 2018/05/PHLG-EnC e Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë ; dhe

vii. aftësitë teknike të moduleve gjeneruese te energjisë dhe njësive konsumatore;

b) të gjithë OST-të e zonës sinkrone do të kryejnë një konsultim publik në lidhje me ndikimin tek palët e interesit të modifikimeve të propozuar të parametrave përcaktues të cilësisë së frekuencës në Tabelën 1 të Aneksit III ose parametrat e synuar të cilësisë së frekuencës në Tabelën 2 të Shtojcës III.

9. Të gjithë OST-të do të përpiqen të jenë në përputhje me vlerat për parametrat përcaktues të cilësisë së frekuencës ose për parametrin e synuar të cilësisë së frekuencës. Të gjithë OST-të duhet të verifikojnë përmbushjen e parametrit të synuar të cilësisë së frekuencës së paku një herë në vit.

Neni 128

Parametrat e synuar të FRCE

1. Të gjithë OST-të e zones sinkrone të EK <.> duhet të specifikojnë në marrëveshjen operacionale të zonës sinkrone diapazonin e vlerave të nivelit 1 të FRCE dhe të diapazonit te nivelit 2 të FRCE për çdo bllok LFC të zones sinkrone të EK <.> të paktën një herë në vit.
2. Të gjithë OST-të zonës sinkrone te EK <...>, nëse përbëhen nga më shumë se një bllok LFC, duhet të sigurojnë që diapazoni i vlerave të nivelit 1 dhe diapazoni i vlerave të nivelit 2 të FRCE të blloqeve LFC të atyre zonave sinkrone të jatë proporcional me rrënjën katrore të shumës të detyrimeve fillestare te FCR të OST-ve që përbëjnë blloqet LFC në përputhje me Nenin 153.
3. Të gjithë OST-të zonës sinkrone te EK <...> do të përpiqen të përmbushin parametrat e mëposhtëm të synuar të FRCE për secilin bllok LFC të zonës sinkrone:

a) numri i intervaleve kohore në vit jashtë diapazonit te nivelit 1 të FRCE brenda intervalit kohor të barabartë me kohën për të rivendosur frekuencën duhet të jetë më pak së 30% e intervaleve kohore të vitit; dhe

b) numri i intervaleve kohore në vit jashtë diapazonit te nivelit 2 të FRCE brenda intervalit kohor të barabartë me kohën për të rivendosur frekuencën duhet të jetë më pak së 5% e intervaleve kohore të vitit.

4. Kur një bllok LFC përbëhet nga më shumë së një zonë LFC, të gjithë OST-të e bllokut LFC duhet të specifikojnë në marrëveshjen operacionale të bllokut LFC, vlerat e parametrave të synuar të FRCE për secilën zonë LFC.

<...>

<...>

5. Të gjithë OST-të duhet të verifikojnë, së paku një herë në vit, se parametrat e synuar të FRCE janë përmbushur.

Neni 129

Proçesi i aplikimit të kritereve

Procesi i aplikimit të kritereve do të përfshijë:

a) mbledhjen e të dhënave të vlerësimit të cilësisë së frekuencës; dhe

b) llogaritjen e kritereve të vlerësimit të cilësisë së frekuencës.

Neni 130

Të dhënat e vlerësimit të cilësisë së frekuencës

1. Të dhënat e vlerësimit të cilësisë së frekuencës do të jenë:

a) për zonën sinkrone:

i. të dhënat e frekuencës të çastit; dhe

ii. të dhënat e devijimit të frekuencës së çastit;

b) për çdo bllok LFC të zonës sinkrone, të dhënat e çastit të FRCE.

2. Saktësia e matjes së të dhënave të frekuencës të çastit dhe të të dhënave të FRCE të çastit, kur maten në Hz, duhet të jetë 1 mHz ose më e mirë.

Neni 131

Kriteret e vlerësimit të cilësisë së frekuencës

1. Kriteret e vlerësimit të cilësisë së frekuencës do të përfshijnë:

a) për zonën sinkrone gjatë operimit në gjendje normale ose gjendje alarmi, sipas përcaktimeve të Nenit 18 (1) dhe (2), në baza mujore, për të dhënat e frekuencës së çastit:

i. vlerën mesatare;
ii. devijimin standard;
iii. 1-, 5-, 10-, 90-, 95- dhe 99-përqindje;

iv. kohën e përgjithshme në të cilën vlera absolute e devijimit të frekuencës së çastit ishte më e madhe së devijimi standard i frekuencës, duke bërë dallimin ndërmjet devijimeve negative dhe pozitive të frekuencës së çastit;

v. kohën totale në të cilën vlera absolute e devijimit të frekuencës së çastit është më e madhe së devijimi maksimal i frekuencës së çastit, duke bërë dallimin ndërmjet devijimeve negative dhe pozitive të frekuencës së çastit;

vi. numri i ngjarjeve në të cilat vlera absolute e devijimit të frekuencës së çastit të zonës sinkrone tejkalon 200% të devijimit standard të frekuencës dhe devijimi i çastit i frekuencës nuk u kthye në 50% të devijimit standard të frekuencës për zonën sinkrone të EK <...>, brenda kohës për të rivendosur frekuencën. Të dhënat duhet të bëjnë dallimin midis devijimeve negative dhe pozitive të frekuencës;

vii. <.>

b) për çdo bllok LFC të zones sinkrone të EK <....> gjatë operimit në gjendjen normale ose ne gjendjen e alarmit në përputhje me Nenin 18 (1) dhe (2), në baza mujore:

i. për një grup të dhënash që përmban vlerat mesatare të FRCE të bllokut LFC përgjatë intervaleve kohore të barabarta me kohën e rivendosjes së frekuencës:

- vlerën mesatare,
- devijimin standard,
- 1-, 5-, 10-, 90-, 95- dhe 99-përqindje,

- numri i intervaleve kohore në të cilat vlera mesatare e FRCE ishte jashtë diapazonit te Nivelit 1 te FRCE, duke bërë dallimin ndërmjet FRCE negative dhe pozitive dhe

- numri i intervaleve kohore në të cilat vlera mesatare e FRCE ishte jashtë diapazonit te Nivelit 2 te FRCE, duke dalluar FRCE negative dhe pozitive;

ii. për një set të dhënash që përmban vlerat mesatare të FRCE të bllokut LFC gjatë intervaleve kohore me kohëzgjatje prej një minuti: numri i ngjarjeve në bazë mujore për të cilat FRCE ka tejkaluar 60% të kapacitetit rezervë të FRR dhe nuk është kthyer në 15% të kapacitetit rezervë të kapacitetit të FRR brenda kohës së rivendosjes së frekuencës, duke bërë dallimin ndërmjet FRCE negative dhe pozitive;

c) <.>

3. Të gjithë OST-të e secilës zonë sinkrone do të specifikojnë në marrëveshjen operacionale të zonës sinkrone një metodologji të përbashkët për të vlerësuar rrezikun dhe evoluimin e rrezikut të shterimit të FCR në zonën sinkrone. Kjo metodologji duhet të kryhet të paktën një herë në vit dhe duhet të bazohet së paku në të dhënat historike të frekuencës së çast të sistemit për jo më pak së 1 vit. Të gjithë OST-të e çdo zone sinkrone do të sigurojnë të dhënat e kërkuara për këtë vlerësim.

Neni 132

Mbledhja e të dhënave dhe procesi i dërgimit

1. Procesi i mbledhjes dhe dërgimit të të dhënave duhet të përmbajë:

a) matjet e frekuencës së sistemit;

b) llogaritjen e të dhënave të vlerësimit të cilësisë së frekuencës; dhe

c) dërgimin e të dhënave të vlerësimit të cilësisë së frekuencës për procesin e aplikimit të kritereve.

2. Mbledhja e të dhënave dhe procesi i dërgimit duhet të zbatohen nga monitoruesi i zonës sinkrone të caktuar në përputhje me Nenin 133.

Neni 133

Monitorimi i zonës sinkrone

1. Të gjithë OST-të e një zone sinkrone do të caktojnë një OST të asaj zone sinkrone në marrëveshjen operacionale të zonës sinkrone si monitorues të zonës sinkrone.

2. Monitoruesi i zonës sinkrone do të zbatojë procesin e grumbullimit dhe të dërgimit të të dhënave të zonës sinkrone të përmendur në Nenin 132.

3. Monitoruesi i zonës sinkrone do të zbatojë procesin e aplikimit të kritereve të referuara në Nenin 129.

4. Monitoruesi i zonës sinkrone do të mbledhë të dhënat e vlerësimit të cilësisë së frekuencës në zonën sinkrone dhe do të kryejë procesin e aplikimit të kritereve, duke përfshirë llogaritjen e kritereve të vlerësimit të cilësisë së frekuencës, një herë në çdo tre muaj dhe brenda 3 muajve pas përfundimit të periudhës së analizuar.

Neni 134

Monitorimi i bllokut LFC

1. Të gjithë OST-të e një blloku LFC do të caktojnë një OST të atij blloku LFC në marrëveshjen operaacionale të bllokut LFC si monitorues i bllokut LFC.

2. Monitorimi i bllokut të LFC-së duhet të mbledhë të dhënat e vlerësimit të cilësisë së frekuencës për bllokun LFC në përputhje me procesin e aplikimit të kritereve të përmendura në Nenin 129.

3. Çdo OST i një zone LFC do t'i sigurojë monitoruesit të bllokut LFC, matjet e zonës LFC, për mbledhjen e të dhënave të nevojshme për vlerësimin e cilësisë së frekuencës për bllokun LFC.

4. Monitoruesi i bllokut të LFC duhet të dorëzojë të dhënat e vlerësimit të cilësisë së frekuencës të bllokut LFC dhe zonat e tij LFC çdo 3 muaj dhe brenda 2 muajve pas përfundimit të periudhës së analizuar.

Neni 135

Informacion mbi sjelljen e ngarkesës dhe gjenerimit

1. Në përputhje me nenin 40, çdo OST lidhëse do të ketë të drejtën të kërkojë informacionin e nevojshëm nga përdoruesit e rëndësishëm të rrjetit (SGU-të) për të monitoruar sjelljen e ngarkesës dhe gjenerimit që lidhet me disbalancat. Ky informacion mund të përfshijë:

   a) pika e punës e fuqisë aktive me stampim të kohës për operim në kohë reale dhe në të ardhmen;

b) prodhimin total i fuqisë aktive me stampim të kohës.

Neni 136

Periudha e rampimit brenda zonës sinkrone

Të gjithë OST-të e secilës zonë sinkrone, me më shumë së një zonë LFC do të specifikojnë në marrëveshjen operacionale të zonës sinkrone një periudhë të përbashkët rampimi të skeduleve të agreguara të netuara nderrmjet zonave LFC në zonën sinkrone. Llogaritja e programit të kontrollit nga pozicioni i zonës se netuar AC për llogaritjen e ACE duhet të kryhet në periudhën e zakonshme të rampimit.

Neni 137

Kufizimet e rampimit për prodhimin e fuqisë aktive

1. Të gjithë OST-të e dy zonave sinkrone, do të kenë të drejtën të specifikojnë në marrëveshjen operacionale të zonës sinkrone kufizimet për prodhimin e fuqisë aktive të interkonektorëve HVDC ndërmjet zonave sinkrone për të kufizuar ndikimin e tyre në përmbushjen e parametrave të synuar të cilësisë së frekuencës së zonës sinkrone, duke përcaktuar një shkallë të kombinimit të rampimit maksimal për të gjithë interkonektorët HVDC që lidhin një zonë sinkrone në një zonë tjetër sinkrone.

2. Kufizimet në paragrafin 1 nuk do të zbatohen për netimin e disbalancave, bashkmin e frekuencave, si dhe aktivizimin ndërkufitar të FRR dhe RR nëpërmjet interkonektorëve HVDC.

3. Të gjithë OST-të që lidhin një interkonektor HVDC do të kenë të drejtën të përcaktojnë në marrëveshjen operacionale të bllokut LFC kufizime të përbashkëta për prodhimin e fuqisë aktive të atij interkonektori HVDC, për të kufizuar ndikimin e tij në përmbushjen e parametrit të synuar të FRCE të blloqeve LFC, duke dakorduar mbi periudhat e rampimit dhe/ose normat maksimale të rampimit për këtë interkonektor HVDC. Këto kufizime të përbashkëta nuk zbatohen për netimin e disbalancave, bashkimin e frekuencave, si dhe aktivizimin ndërkufitar të FRR dhe RR me anë të interkonektorëve HVDC. Të gjithë OST-të e një zone sinkrone do t'i bashkërendojnë këto masa brenda zonës sinkrone.

4. Të gjithë OST-të e një blloku LFC kanë të drejtë të përcaktojnë në marrëveshjen operacionale të bllokut LFC masat e mëposhtme për të mbështetur përmbushjen e parametrit të synuar të FRCE të bllokut LFC dhe për të lehtësuar devijimet përcaktuese të frekuencës, duke marrë parasysh kufizimet teknologjike të moduleve gjeneruese dhe njësive të ngarkesës:

   a) detyrimet për periudhat e rampimit dhe / ose normat maksimale të rampimit për modulet gjeneruese të energjisë dhe / ose njësitë e ngarkesës;

b) detyrimet mbi kohët e fillimit individual të rampimit për modulet gjeneruese të energjisë dhe/ose njësitë e ngarkesës brenda bllokut të LFC; dhe

c) koordinimi i rampimit midis moduleve gjeneruese të energjisë, njësive të ngarkesës dhe konsumit të energjisë aktive brenda bllokut LFC.

Neni 138

Masat zbutëse

Kur vlerat e llogaritura për periudhën e një viti kalendarik në lidhje me parametrat e synuara të cilësisë së frekuencës ose parametrat e synuar të FRCE janë jashtë objektivave të përcaktuar për zonën sinkrone ose për bllokun LFC, të gjithë OST-të e zonës përkatëse sinkrone ose të bllokut përkatës LFC duhet:

a) të analizojnë nëse parametrat e synuar të cilësisë së frekuencës ose parametrat e synuar të FRCE do të mbeten jashtë objektivave të përcaktuara për zonën sinkrone ose për bllokun e LFC dhe në rast të një rreziku të justifikuar se kjo mund te ndodhe, të analizojnë shkaqet dhe të hartojnë rekomandime;

b) të zhvillojnë masa lehtësuese për të siguruar që objektivat për zonën sinkrone ose për bllokun LFC mund të plotësohen në të ardhmen.

TITULLI 3

STRUKTURA E KONTROLLIT NGARKESË - FREKUENCË

Neni 139

Struktura themelore

1. Të gjithë OST-të e çdo zone sinkrone do të specifikojnë strukturën e kontrollit ngarkesë-frekuencë për zonën sinkrone, në marrëveshjen operacionale të zonës sinkrone. Secili OST do të jetë përgjegjës për zbatimin e strukturës së kontrollit ngarkese- frekuencës te zonës se saj sinkrone dhe të operoje në përputhje me të.

2. Struktura e kontrollit ngarkese- frekuencës e secilës zonë sinkrone do të përfshijë:
   a) një strukturë të aktivizimit të procesit në përputhje me Nenin 140; dhe
   b) një strukturë të përgjegjësisë së procesit në përputhje me Nenin 141.

3. Dispozitat në lidhje me strukturën e kontrollit ngarkesë-frekuencë do të zbatohen vetëm në operatorët e sistemit të transmetimit që operojnë në zonën sinkrone të Evropës Kontinentale. OST-të e Palëve Kontraktuese që operojnë në zonat e tjera sinkrone përjashtohen nga obligimi për të arritur objektivat e përcaktuara në këto nga dispozitat brenda Titullit 3 dhe për të vepruar sipas rregullave të këtyre zonave sinkrone..

4.

Neni 140

Struktura e aktivizimit te procesit

1. Struktura e aktivizimit të procesit do të përfshijë:

   a) një FCP në pajtim me Nenin 142;

   b) një FRP në pajtim me Nenin 143; dhe

   c) për zonën sinkrone CE, një proces kontrolli kohor në përputhje me Nenin 181.

2. Struktura e aktivizimit të procesit mund të përfshijë:

   a) një RRP në pajtim me Nenin 144;

   b) një proces të netimit të disbalancave në përputhje me Nenin 146;

   c) procesi i aktivizimit ndërkufitar të FRR në përputhje me Nenin 147;

   d) një proces të aktivizimit ndërkufitar të RR në përputhje me Nenin 148; dhe

   e) **<...>**

Neni 141

Struktura e përgjegjësisë së procesit

1. Kur specifikon strukturën e përgjegjësisë së procesit, të gjithë OST-të e çdo zone sinkrone do të marrin parasysh të paktën kriteret e mëposhtme:

   a) madhësinë dhe inercinë e përgjithshme, duke përfshirë inercinë sintetike, të zonës sinkrone;

   b) strukturen e rrjetit dhe / ose topologjinë e rrjetit; dhe

   c) sjelljen e ngarkesës, gjenerimin dhe HVDC.

2. Brenda 4 muajve pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, të gjithë OST-të e një zone sinkrone do të zhvillojnë së bashku një propozim të përbashkët lidhur me përcaktimin e blloqeve LFC, të cilat duhet të jenë në përputhje me kërkesat e mëposhtme:

a) një zonë monitorimi korrespondon ose është pjesë e vetëm një zone LFC;

b) një zonë LFC korrespondon ose është pjesë e vetëm një blloku LFC;

c) një bllok LFC korrespondon ose është pjesë e vetëm i një zone sinkron; dhe

d) secili element i rrjetit është pjesë e vetëm një zone monitorimi, vetëm një zonë LFC dhe vetëm një bllok LFC.

3. Të gjithë OST-të e çdo zone monitorimi duhet të llogarisin dhe monitorojnë vazhdimisht shkëmbimin e fuqisë aktive ne kohe reale në zonën e monitorimit.

4. Të gjithë OST-të e secilës zonë LFC duhet:

a) monitorojnë vazhdimisht fFRCE e zonës LFC;

b) të zbatojë dhe të operojë një FRP për zonën LFC;

c) të përpiqet të përmbushë parametrat e synuar të FRCE të zonës LFC siç përcaktohet në Nenin 128; dhe

d) kanë të drejtë të zbatojnë një ose disa nga proceset e përmendura në Nenin 140 (2).

5. Të gjithë OST-të e secilit bllok LFC duhet:

a) përpiqen të përmbushin parametrat e synuar të FRCE të bllokut LFC siç përcaktohet në Nenin 128; dhe

b) pajtohen me rregullat e dimensionimit të FRR në përputhje me Nenin 157 dhe rregullat e dimensionimit RR në përputhje me Nenin 160.

6. Të gjithë OST-të e çdo zone sinkrone do:

a) të zbatojnë dhe të operojne një FCP për zonën sinkrone;

b) të jenë në përputhje me rregullat e dimensionimit të FCR në përputhje me Nenin 153; dhe

c) të përpiqen të përmbushin parametrat e synuar të cilësisë së frekuencës në përputhje me Nenin 127.

7. Të gjithë OST-të e çdo zone monitorimi duhet të specifikojnë në marrëveshjen operacionale të zonës së operimit ndarjen e përgjegjësive ndërmjet OST-ve në zonën e monitorimit për zbatimin e detyrimit të përcaktuar në paragrafin 3.

8. Të gjithë OST-të e secilës zonë të LFC duhet të specifikojnë në marrëveshjen operacionale të LFC-së ndarjen e përgjegjësive ndërmjet OST-ve në zonën LFC për zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në paragrafin 4.

9. Të gjithë OST-të e secilit bllok LFC do të specifikojnë në marrëveshjen operacionale të bllokut LFC ndarjen e përgjegjësive ndërmjet OST-ve në bllokun LFC për zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në paragrafin 5.

10. Të gjithë OST-të e secilës zonë sinkrone do të specifikojnë në marrëveshjen operacionale të zonës sinkrone ndarjen e përgjegjësive ndërmjet OST-ve në zonën sinkrone për zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në paragrafin 6.

11. Të gjithë OST-të e dy ose me shumë zonave LFC të lidhura nga interkoneksionet do të kenë të drejtë të formojnë një bllok LFC nëse plotësohen kërkesat për bllokun LFC të paraqitur në paragrafin 5.

Neni 142

Procesi i mbajtjes së frekuencës

1. Objektivi i kontrollit të FCP do te jete stabilizimi i frekuencës së sistemit me anë të aktivizimit të FCR.

2. Karakteristika e përgjithshme për aktivizimin e FCR në një zonë sinkrone do të pasqyrojë një rënie graduale të aktivizimit FCR si funksion i devijimit të frekuencës.

Neni 143

Procesi i rivendosjes së frekuencës

1. Objektivi i kontrollit të FRP do të jetë:

   a) të rregullojë FRCE drejt zero brenda kohës së rivendosjes së frekuencës;

   b) për zonat sinkrone të EK <...>, për të zëvendësuar në mënyrë progresive FCR e aktivizuar duke aktivizuar FRR në përputhje me Nenin 145.

2. FRCE është:

   a) ACE e një zone LFC, ku ka më shumë së një zonë LFC në një zonë sinkrone; ose

b) devijimi i frekuencës, ku një zonë LFC korrespondon me bllokun LFC dhe zonën sinkrone.

3. ACE e një zone LFC do të llogaritet si shuma e prodhimit të Faktorit – K të zonës LFC me devijimin e frekuencës plus zbritjen e:

   a) Totalit te flukseve të fuqisë aktive, në interkonektor dhe linjat virtuale; dhe

   b) programit te kontrollit në përputhje me Nenin 136.

4. Kur një zonë LFC përbëhet nga më shumë së një zonë monitorimi, të gjithë OST-të e zonës LFC do të caktojnë një OST në marrëveshjen operacionale të zones LFC-së, si përgjegjëse për zbatimin dhe funksionimin e procesit të rivendosjes së frekuencës.
5. Kur një zonë LFC përbëhet nga më shumë së një zonë monitorimi, procesi i rivendosjes së frekuencës së kësaj zone të LFC-së do të mundësojë kontrollin e shkëmbimit të fuqisë aktive të secilës zonë të monitorimit, në vlerën e përcaktuar si të sigurtë, bazuar në një analizë të sigurisë operacionale në kohë reale.

Neni 144

Procesi i zëvendësimit të rezervës

1. Objektivi i kontrollit të RRP do të jetë të përmbushë të paktën një nga qëllimet e mëposhtme duke aktivizuar RR:

a) në mënyrë progresive rivendos FRR e aktivizuar;

b) mbështetet aktivizimin e FRR;

c) <.>

2. RRP do të operohet nëpërmjet udhëzimeve për aktivizimin manual të RR në mënyrë që të përmbushë objektivin e kontrollit në përputhje me paragrafin 1.

Neni 145

Procesi i rivendosjes së frekuencës automatike dhe manuale

1. Secili OST i secilës zonë LFC duhet të zbatojë një proces të rivendosjes automatik të frekuencës ('aFRP') dhe një proces të rivendosjes manual të frekuencës ('mFRP').

2. <...>.

3. Nëse një zonë LFC përbëhet nga më shumë së një zonë monitorimi, të gjithë OST-të e zonës LFC do të përcaktojnë një proces për zbatimin e një aFRP dhe një mFRP në marrëveshjen operacionale të zonës LFC. Kur një bllok LFC përbëhet nga më shumë së një zonë LFC, të gjithë OST-të e zonave LFC duhet të përcaktojnë një proces për zbatimin e një mFRP në marrëveshjen operacionale të bllokut LFC.

4. Rezerva aFRP do të operohet në një mënyrë të mbyllur ku FRCE është një input dhe pika e punës për aktivizimin automatik të FRR është output. Pika e punës për aktivizimin automatik të FRR do të llogaritet nga një kontrollues i vetëm i rivendosjes së frekuencës i operuar nga një OST brenda zonës së tij të LFC. Për zonen sinkrone EK <.>, kontrolluesi i rivendosjes së frekuencës duhet:

    a) të jetë një pajisje automatike e kontrollit e projektuar për të zvogëluar FRCE në zero;

    b) te kete nje sjellje proporcionale-integrale;

    c) të ketë një algoritëm të kontrollit i cili pengon termin integral të kontrolluesit proporcional-integral nga akumulimi i gabimit të kontrollit dhe tejkalimi; dhe

    d) te ketë funksionalitete për modalitete të jashtëzakonshme operimi për gjendjen e alarmit dhe të emergjencës.

5. mFRP do të operohet nëpërmjet udhëzimeve për aktivizimin manual të FRR me qëllim të përmbushjes së objektivit të kontrollit në përputhje me Nenin 143 (1).

6. Përveç zbatimit të aFRP në zonat LFC, të gjithë OST-të e një blloku LFC që përbëhet nga më shumë së një zonë LFC, do të kenë të drejtën të caktojnë një OST të bllokut LFC në marrëveshjen operacionale të bllokut LFC për:

    a) llogaritjen dhe monitorimin e FRCE të gjithë bllokut LFC; dhe

    b) të marrë parasysh FRCE e të gjithë bllokut LFC për llogaritjen e vlerës së përcaktuar për aktivizimin aFRR në përputhje me Nenin 143 (3) përveç FRCE të zonës së tij LFC.

Neni 146

Procesi i netimit të disbalancave

1. Objektivi i kontrollit të procesit të netimit të disbalancave do të synojë të zvogëlojë sasine e kundërveprimit te njëkohshem të aktivizimit të FRR të zonave LFC të ndryshme pjesëmarrëse, nepermjet nettimit te disbalancave te shkëmbimit të fuqisë.

2. Çdo OST do të ketë të drejtën të zbatojë procesin e netimit të disbalancave për zonat LFC në të njëjtin bllok LFC, ndërmjet blloqeve të ndryshme të LFC ose midis zonave të ndryshme sinkrone, duke lidhur një marrëveshje për netimin e disbalancave.
3. OST-të do të zbatojnë procesin e netimit të disbalancave në mënyrë që mos ndikojë në:

    a) stabilitetin e FCP-së të zonës sinkrone ose zonave sinkrone të përfshira në procesin e netimit të disbalancave;
    b) qëndrueshmërinë e FRP dhe RRP të secilës zonë LFC të operuar nga OST-të pjesëmarrëse ose të prekura; dhe
    c) sigurinë operacionale.

4. OST-të duhet të zbatojnë netimin e disbalancave të shkëmbimit të fuqisë ndërmjet zonave të LFC-së të një zone sinkrone në të paktën një nga mënyrat e mëposhtme:

    a) duke përcaktuar rrjedhjen e flukseve të fuqisë aktive për një linjë virtuale e cila do të jetë pjesë e llogaritjes së FRCE;
    b) duke rregulluar rrjedhjen e flukseve të fuqisë aktive në interkonektorët HVDC.

5. OST-të duhet të zbatojnë netimin e disbalancave të shkëmbimit të fuqisë ndërmjet zonave LFC të zonave të ndryshme sinkrone, duke rregulluar flukset e fuqisë aktive në interkonektorët HVDC.
6. OST-të duhet të zbatojë netimin e disbalancave të shkëmbimit të fuqisë së një zone LFC-së në mënyrë të tillë që nuk tejkalon sasinë aktuale të aktivizimit të FRR të nevojshme për të rregulluar FRCE e asaj zone LFC-së në zero, pa netimin e disbalancave të shkëmbimit të fuqisë.
7. Të gjithë OST-të që marrin pjesë në të njëjtin proces të netimit të disbalancave do të sigurojnë që shuma e të gjitha netimeve të disbalancave të shkëmbimit të fuqisë të jetë zero.
8. Procesi i netimin të disbalancave do të përfshijë një mekanizëm rezervë, i cili do të sigurojë që netimi i disbalancave të shkëmbimit të fuqisë të secilës zonë LFC të jetë zero ose të kufizohet në një vlerë për të cilën mund të garantohet siguria operacionale.
9. Kur një bllok LFC përbëhet nga më shumë së një zonë LFC dhe kapaciteti rezervë i FRR, si dhe kapaciteti rezervë i RR llogaritet në bazë të disbalancave të bllokut LFC-së, të gjithë OST-të e të njëjtit bllok LFC duhet të zbatojnë një proces i netimit të disbalancave dhe shkëmbejnë sasite maksimale të fuqisë së netimit te disbalancave, të përcaktuara në paragrafin 6 me zonat e tjera të LFC të të njëjtit bllok LFC.
10. Kur një proces i netimit të disbalancave zbatohet për zonat LFC të zonave të ndryshme sinkrone, të gjithë OST-të shkëmbejnë sasinë maksimale të fuqisë së netimit te disbalancave, të përcaktuar në paragrafin 6 me TSO-të e tjera të zonës sinkrone që marrin pjesë në atë proces netimi të disbalancës.
11. Kur procesi i netimit të disbalancës zbatohet për zonat LFC të cilat nuk janë pjesë e të njëjtit bllok LFC, të gjithë OST-të e blloqeve LFC të përfshira duhet të përmbushin detyrimet në Nenin 141 (5) pavarësisht shkëmbimit të fuqisë se netimit të disbalancave.

Neni 147

Procesi i aktivizimit ndërkufitar të FRR

1. Qëllimi i kontrollit të procesit të aktivizimit ndërkufitar të FRR është që t'iu mundësojë OST-ve të kryejnë procesin e FRP me anë të shkëmbimit të fuqisë ndërmjet zonave LFC për rivendosjen e frekuencës.
2. Secili OST ka të drejtë të zbatojë procesin e aktivizimit ndërkufitar të FRR për zonat LFC brenda të njëjtit bllok të LFC, midis blloqeve të ndryshme të LFC ose midis zonave të ndryshme sinkrone, duke përmbyllur një marrëveshje të aktivizimit ndërkufitar të FRR.
3. OST-të do të zbatojnë procesin e aktivizimit ndërkufitar të FRR në mënyrën që nuk ndikon:

   a) stabilitetin e FCP-së të zonës sinkrone ose zonave sinkrone të përfshira në procesin e aktivizimit ndërkufitar të FRR;

   b) qëndrueshmërinë e FRP dhe RRP të secilës zonë LFC të operuar nga OST-të pjesëmarrëse ose të prekura; dhe

   c) sigurinë operacionale.

4. OST-të duhet të zbatojnë ndërshkëmbimin e fuqisë për rivendosjen e frekuencës ndërmjet zonave të LFC-së të zonës së njëjtë sinkrone përmes njërit prej veprimeve të mëposhtme:

   a) duke përcaktuar rrjedhjen e flukseve të fuqisë aktive mbi një linjë virtuale e cila do të jetë pjesë e llogaritjes së FRCE, ku aktivizimi i FRR është i automatizuar;
   b) rregullimin e një programi kontrolli ose përcaktimin e nje fluks të fuqisë aktive mbi një interkonektor virtual ndërmjet zonave LFC ku aktivizimi i FRR është manual; ose
   c) rregullimin e flukseve të fuqisë aktive mbi interkonektorët HVDC.

5. OST-të duhet të zbatojnë shkëmbimin e fuqisë për rivendosjen e frekuencës ndërmjet zonave LFC të zonave të ndryshme sinkrone, duke rregulluar flukset e fuqisë aktive në interkonektorët HVDC.
6. Të gjithë OST-të që marrin pjesë në procesin e përbashkët të aktivizimit ndërkufitar të FRR do të sigurohen që shuma e të gjitha shkëmbimeve të fuqisë së rivendosjes së frekuencës është e barabartë me zero.
7. Procesi i aktivizimit ndërkufitar të FRR do të përfshijë një mekanizëm rezervë i cili do të sigurojë që shkëmbimi i fuqisë për rivendosjen e frekuencës në secilën zonë LFC të jetë zero ose të kufizohet në një vlerë për të cilën mund të garantohet siguria operacionale.

Neni 148

Procesi i aktivizimit ndërkufitar të RR-ve

1. Objektivi i kontrollit të procesit të aktivizimit ndërkufitar të RR-së do të synojë që ti mundësojë një OST të kryejë RRP përmes programit të kontrollit ndërmjet zonave të LFC-së.
2. Secili OST ka të drejtë të zbatojë procesin e aktivizimit ndërkufitar të RR, për zonat LFC brenda bllokut të njëjtë të LFC-së, ndërmjet blloqeve të ndryshme të LFC-së ose ndërmjet zonave të ndryshme sinkrone, duke përmbyllur një marrëveshje të aktivizimit ndërkufitar të RR-së.
3. OST-të do të zbatojnë procesin e aktivizimit ndërkufitar të RR në një mënyrë që nuk ndikon:

    a) në qëndrueshmërinë e FCP së zonës sinkrone ose zonave sinkrone që përfshihen në procesin e aktivizimit ndërkufitar të RR;

    b) në qëndrueshmërinë e FRP dhe RRP të secilës zonë LFC të operuar nga OST-të pjesëmarrëse ose të prekura; dhe

    c) sigurinë operacionale.

4. OST-të duhet të zbatojnë programin e kontrollit ndërmjet zonave të LFC-së të të njëjtës zone sinkrone duke kryer të paktën një nga veprimet e mëposhtme:

    a) përcaktimin e flukseve të fuqisë aktive mbi një linjë virtuale e cila do të jetë pjesë e llogaritjes së FRCE;

    b) rregullimin e një programi kontrolli; ose

    c) rregullimi i flukseve të fuqisë aktive mbi interkonektorët HVDC.

5. OST-të duhet të zbatojnë programin e kontrollit ndërmjet zonave LFC të zonave të ndryshme sinkrone duke rregulluar flukset e fuqisë aktive mbi interkonektorët HVDC.
6. Të gjithë OST-të që marrin pjesë në të njëjtin proces ndërkufitar të aktivizimit të RR-së do të sigurojnë që shuma e të gjitha programeve të kontrollit është e barabartë me zero.
7. Procesi i aktivizimit ndërkufitar të RR-së do të përfshijë një mekanizëm rezerve, i cili do të sigurojë që programi i kontrollit të secilës zonë LFC të jetë zero ose të kufizohet në një vlerë për të cilën mund të garantohet siguria operacionale.

Neni 149

Kërkesa të përgjithshme për proceset ndërkufitare të kontrollit

1. Të gjithë OST-të që marrin pjesë në shkëmbimin ose ndarjen e FRR ose RR do të zbatojnë një proces të aktivizimit ndërkufitar të FRR ose proces të aktivizimit ndërkufitar të RR, sipas rastit.

2. Të gjithë OST-të e një zone sinkrone do të specifikojnë në marrëveshjen e operimit të zonës sinkrone rolin dhe përgjegjësitë e OST-ve duke implementuar një proces të netimit të disbalancave, një proces të aktivizimit ndërkufitar të FRR ose një proces të aktivizimit ndërkufitar të RR midis zonave LFC të blloqeve të ndryshme LFC ose të zonave të ndryshme sinkrone.
3. Të gjithë OST-të që marrin pjesë në të njëjtin proces të netimit të disbalancave, në të njëjtin proces të aktivizimit ndërkufitar të FRR ose në të njëjtin proces të aktivizimit ndërkufitar në RR, duhet të specifikojnë në marrëveshjet përkatëse, rolet dhe përgjegjësitë e të gjithë OST-ve duke përfshirë:
    a) sigurimin e të gjitha të dhënave hyrëse të nevojshme për:
        i. llogaritjen e shkëmbimit të energjisë duke respektuar kufijtë e sigurisë operacionale; dhe
        ii. kryerjen e analizave të sigurisë së operacionale në kohë reale nga OST-të pjesëmarrëse dhe ato të prekura;
    b) përgjegjësinë e llogaritjes së shkëmbimit të energjisë; dhe
    c) implementimin e procedurave operacionale për të siguruar sigurinë operacionale.
4. Pa rënë ndesh me Nenin 146 (9), (10) dhe (11) dhe si pjesë e marrëveshjeve të përmendura në nenet 122, 123 dhe 124, të gjithë OST-të që marrin pjesë në të njëjtin proces të netimit të disbalancave, proces të aktivizimit ndërkufitar të FRR ose proces të aktivizimit ndërkufitar të RR do të kenë të drejtën të specifikojnë një metodë për llogaritjen e shkëmbimit të energjisë. Llogaritja sekuenciale e shkëmbimit të energjisë duhet të lejojë çdo grup të OST-ve që operojnë në zonat LFC ose blloqet LFC të lidhura nga interkoneksionet për të shkëmbyer fuqinë për netimin e disbalancave, fuqinë e rivendosjes se frekuencës ose te rezerves se zëvendësimit ndërmjet tyre, para së të shkëmbejnë me OST-të e tjera.

Neni 150

Njoftimi i OST-ve

1. OST-të që synojnë të ushtrojnë të drejtën për të implementuar një proces të netimit të disbalancave, një proces të aktivizimit ndërkufitar të FRR, një proces të aktivizimit ndërkufitar të RR, një shkëmbim rezervash ose një ndarje rezervash, 3 muaj përpara së të ushtrojnë këtë të drejtë, njoftojnë OST-të e tjera të së njëjtës zonës sinkrone për:

    a) OST-të e përfshira;

    b) sasinë e pritshme të shkëmbimit të energjisë për shkak të procesit të netimit të disbalancave, procesit të aktivizimit ndërkufitar të FRR ose procesit të aktivizimit ndërkufitar të RR;

    c) llojin e rezervës dhe sasinë maksimale të shkëmbimit ose ndarjes së rezervave; dhe

d) afatin kohor të shkëmbimit ose ndarjes së rezervave.

2. Kur një proces i netimit të disbalancave, një proces i aktivizimit ndërkufitar të FRR ose një proces i aktivizimit ndërkufitar të RR implementohet për zonat LFC që nuk janë pjesë e të njëjtit bllok LFC, secili OST i zonave sinkrone përkatëse ka të drejtë të deklarojë veten si një OST i prekur për të gjithë OST-të e zonës sinkrone bazuar në një analizë të sigurisë së operacionale dhe brenda një muaji pas marrjes së njoftimit në përputhje me paragrafin 1.

3. OST e prekur ka të drejtën të:

   a) kërkojë sigurimin e vlerave në kohë reale të shkëmbimit të fuqisë për netimin e disbalancave, të shkëmbimit të fuqisë për rivendosjen e frekuencës dhe programit të kontrollit të nevojshëm për analizën e sigurisë së operacionale në kohë reale; dhe

   b) kërkojë implementimin e një procedure operacionale që i mundëson OST-së së prekur të caktojë kufizime për shkëmbimin e fuqisë për netimin e disbalancave, për shkëmbimin e fuqisë për rivendosjen e frekuencës si dhe për programin e kontrollit midis zonave LFC bazuar në një analizë të sigurisë së operacionale në kohë reale.

Neni 151

Infrastruktura

1. Të gjithë OST-të do të vlerësojnë së çfarë infrastrukture teknike është e nevojshme për implementimin dhe operimin e proceseve të përmendura në Nenin 140 dhe konsiderohen kritike në përputhje me planin e sigurisë të përmendur në Nenin 26.
2. Të gjithë OST-të e një zone sinkrone do të specifikojnë, në marrëveshjen e operimit të zonës sinkrone, kërkesat minimale për disponueshmërinë, besueshmërinë dhe rezervën shtesë të infrastrukturës teknike të përmendur në paragrafin 1 duke përfshirë:

   a) saktësinë, rezolucionin, disponueshmërinë dhe rezervën shtesë të matjeve të flukseve të fuqisë aktive dhe linjave virtuale;
   b) disponueshmërinë dhe rezervën shtesë të sistemeve digjitale të kontrollit;
   c) disponueshmërinë dhe rezervën shtesë të infrastrukturës së komunikimit; dhe
   d) protokollet e komunikimit.

3. Të gjithë OST-të e një blloku LFC mund të përcaktojnë kërkesa shtesë për disponueshmërinë, besueshmërinë dhe rezervën shtesë të infrastrukturës teknike në marrëveshjen e operimit të bllokut LFC.

4. Çdo OST i një zone LFC duhet:

a) të sigurojë një cilësi dhe disponueshmëri të mjaftueshme të llogaritjes së FRCE;
b) të kryejë në kohë reale monitorimin e cilësisë së llogaritjes së FRCE;
c) të ndërmarrë veprime në rastin e keq llogaritjes së FRCE; dhe
d) kur FRCE përcaktohet nga ACE, të kryejë ex-post një monitorim të cilësisë së llogaritjes së FRCE duke e krahasuar FRCE me vlerat e referencës të paktën një herë në vit.

TITULLI 4

OPERIMI I KONTROLLIT NGARKESË- FREKUENCË

Neni 152

Gjendja e sistemit lidhur me frekuencën e sistemit

1. Çdo OST do të operojë zonën e tij të kontrollit me rezerva të mjaftueshme të fuqisë aktive për rritje dhe ulje, që mund të përfshijnë rezervat e ndara ose të shkëmbyera, për të përballuar disbalancat midis kërkesës dhe furnizimit brenda zonës së tij të kontrollit. Çdo OST do të kontrollojë FRCE siç përcaktohet në nenin 143 në mënyrë që të arrihet cilësia e kërkuar e frekuencës brenda zonës sinkrone në bashkëpunim me të gjithë OST- të e së njëjtës zonë sinkrone.

2. Çdo OST do të monitorojë afërsisht në kohë reale skedulimet e gjenerimit dhe shkëmbimit, flukset e fuqisë, injektimet dhe tërheqjet në nyje si dhe parametrat e tjerë brenda zonës së tij të kontrollit, të rëndësishme për parashikimin e riskut të devijimit të frekuencës dhe në koordinim me OST-të e tjera të zonës sinkrone duhet të marrë masa për të kufizuar efektet e tyre negative në balancën midis gjenerimit dhe konsumit.
3. Të gjithë OST-të e zonës sinkrone do të specifikojnë një shkëmbim të të dhënave në kohë reale në përputhje me Nenin 42 të cilat përfshijnë:

   a) gjendjen e sistemit të transmetimit në përputhje me Nenin 18; dhe

   b) të dhënat e matjes në kohë reale të FRCE së blloqeve LFC dhe zonave LFC të zonës sinkrone.

4. Monitoruesi i zonës sinkrone do të përcaktojë gjendjen e sistemit në lidhje me frekuencën e sistemit në përputhje me Nenin 18(1) dhe (2) Monitoruesi i zonës sinkrone do të sigurojë që të gjithë OST-të e të gjitha zonave sinkrone të informohen në rast së devijimi i frekuencës së sistemit përmbush një nga kriteret për gjendjen e alarmit të referuar në Nenin 18.
5. Të gjithë OST-të e zonës sinkrone do të përcaktojnë në marrëveshjen e operimit të zonës sinkrone rregullat e përbashkëta për operimin e kontrollit ngarkesë-frekuencë në gjendjen normale dhe gjendjen e alarmit
6. <.>
7. Të gjithë OST-të e një blloku LFC duhet të specifikojnë procedurat operacionale për rastet e shterimit të FRR ose RR në marrëveshjen e operacionale të bllokut LFC. Në këto procedura

operacionale, OST-të e një blloku LFC do të kenë të drejtë të kërkojnë ndryshime në prodhimin ose konsumin e energjisë aktive të moduleve gjeneruese te energjisë dhe njësive konsumatore.

8. OST-të e një blloku LFC do të përpiqen të shmangin FRCE që zgjasin më shumë së koha për rivendosjen e frekuencës.

9. Të gjithë OST-të e një zone sinkrone do të specifikojnë në marrëveshjen operacionale të zonës sinkrone procedurat operacionale për gjendjen e alarmit për shkak të cënimit të kufijve të frekuencës së sistemit. Procedurat operacionale do të synojnë reduktimin e devijimit të frekuencës së sistemit në mënyrë që të rivendosë gjendjen e sistemit në gjendjen normale dhe të kufizojnë rrezikun e hyrjes së sistemit në gjendjen e emergjencës. Procedurat operacionale përfshijnë të drejtën e OST-ve për të devijuar nga detyrimi i përcaktuar në Nenin 143 (1).
10. Nëse gjendja e sistemit është në gjendje alarmi për shkak të rezervave të pamjaftueshme të fuqisë aktive në përputhje me Nenin 18, OST-të e blloqeve përkatëse LFC, në bashkëpunim të ngushtë me OST-të e tjerë të zonës sinkrone dhe OST e zonave sinkrone te tjera, veprojnë për të rivendosur dhe zëvendësuar nivelet e nevojshme të rezervave të fuqisë aktive. Për këtë qëllim, OST-të e një blloku LFC kanë të drejtë të kërkojnë ndryshime në prodhimin ose konsumin e fuqisë aktive të moduleve gjeneruese te energjisë ose njësive konsumatore brenda zonës së tij të kontrollit për të reduktuar ose për të hequr cënimet (mosplotësimin) e kërkesave lidhur me rezervën e fuqisë aktive.
11. Nëse mesatarja 1 minutëshe e FRCE e një blloku LFC është më e lartë së diapazoni i FRCE e Nivelit 2, të paktën gjatë kohës së nevojshme për rivendosjen e frekuencës dhe kur OST-të e një blloku LFC nuk presin që FRCE të reduktohet në mënyrë të mjaftueshme duke ndërmarrë veprimet në paragrafin 15, OST-të kanë të drejtë të kërkojnë ndryshime në prodhimin ose konsumin e energjisë aktive të moduleve gjeneruese të energjisë dhe njësive konsumatore brenda zonave të tyre përkatëse për të zvogëluar FRCE siç është specifikuar në paragrafin 16.
12. Për zonen sinkrone të EK <.>, ku FRCE e një blloku LFC tejkalon 25% të incidentit referent të zonës sinkrone për më shumë së 30 minuta vijues dhe nëse OST-të e atij blloku LFC nuk presin të reduktojnë në mënyrë të mjaftueshme FRCE me veprimet e ndërmarra në përputhje me paragrafin 15, OST-të do të kërkojnë ndryshime në prodhimin ose konsumin e energjisë aktive të moduleve gjeneruese të energjisë dhe njësive konsumatore brenda zonave të tyre përkatëse për të zvogëluar FRCE siç është specifikuar në paragrafin 16.
13. Monitoruesi i bllokut të LFC-së është përgjegjës për identifikimin e çdo shkelje të limiteve në paragrafët 12 dhe 13 dhe:

    a) do të informojë OST-të e tjera të bllokut të LFC-së; dhe

    b) së bashku me OST-të e bllokut të LFC-së do të zbatojnë veprime të koordinuara për të reduktuar FRCE, të cilat do të specifikohen në marrëveshjen operacionale të bllokut LFC.

14. Për rastet e përmendura në paragrafët 11 deri 13, të gjithë OST-të e secilës zonë sinkrone do të specifikojnë në marrëveshjen operacionale të zonës sinkrone veprimet për t'i mundësuar OST-ve të një blloku LFC, që në mënyrë aktive të zvogëlojnë devijimin e frekuencës me aktivizimin ndërkufitar të rezervave. Në rastet e përmendur në paragrafët nga 11 deri në 13, OST-të e zonës

sinkrone do të përpiqen t'i mundësojnë OST-ve të bllokut përkatës LFC të zvogëlojnë FRCE-në e tyre.

15. OST-të e një blloku LFC do të përcaktojnë në marrëveshjen operacionale të bllokut LFC, masat për të reduktuar FRCE me anë të ndryshimeve në prodhimin ose konsumin e energjisë aktive të moduleve gjeneruese të energjisë dhe njësive konsumatore brenda zonës së tyre.

Titulli 5

REZERVAT E MBAJTJES SË FREKUENCËS

Neni 153

Dimensionimi i FCR

1. Të gjithë OST-të e çdo zone sinkrone do të përcaktojnë, të paktën një herë në vit, kapacitetin rezervë për FCR të kërkuar për zonën sinkrone dhe detyrimin fillestar të FCR të secilit OST në përputhje me paragrafin 2.

2. Të gjithë OST-të e çdo zone sinkrone do të specifikojnë rregullat e dimensionimit në marrëveshjen e operacionale të zonës sinkrone në përputhje me kriteret e mëposhtme:

   a) kapaciteti rezervë për FCR që kërkohet për zonën sinkrone duhet të mbulojë të paktën incidentin e referencës dhe për zonën sinkrone të EK <.>, rezultatet e qasjes së dimensionimit probabilistik për FCR të kryera në përputhje me pikën (c);
   b) madhësia e incidentit referent do të përcaktohet në përputhje me kushtet e mëposhtme:

      i. për zonën sinkrone të EK, incidenti referent do të jetë 3 000 MW në drejtim pozitiv dhe 3 000 MW në drejtim negativ;

      ii. <.>

   c) për zonën sinkrone të EK <.>, të gjithë OST-të e zonës sinkrone do të kenë të drejtën të përcaktojnë një qasje probabilistike të dimensionimit për FCR duke marrë parasysh modelin e ngarkesës, gjenerimit dhe inercisë, duke përfshirë inercinë sintetike, si dhe mjetet e disponueshme për vendosjen e inercisë minimale në kohë reale në përputhje me metodologjinë e përmendur në Nenin 39, me qëllim të reduktimit të probabilitetit të FCR se pamjaftueshme në më pak ose të barabartë me një herë në 20 vjet; dhe
   d) *pjesët* e kapacitetit rezervë të FCR të kërkuar për secilin OST si obligim fillestar i FCR do të bazohen në shumën e gjenerimit dhe konsumit neto të zonës së tij të kontrollit të ndarë nga shuma e gjenerimit dhe konsumit neto të zonës sinkrone gjatë një periudhe 1 vjeçare.

Neni 154

Kërkesat minimale teknike të FCR

1. Çdo OST që lidh rezervë do të sigurojë që FCR të përmbushë veçoritë e listuara për zonën sinkrone në Tabelën e Shtojcës V.

2. Të gjithë OST-të e një zone sinkrone do të kenë të drejtën të specifikojnë, në marrëveshjen operacionale të zonës sinkrone, veçoritë e përbashkëta shtesë të FCR që kërkohen për të siguruar sigurinë operacionale në zonën sinkrone, me anë të një grupi parametrash teknike dhe brenda intervaleve në Nenin 15 (2) (d) të Rregullores (BE) 2016/631 **siç është përshtatur dhe miratuar me Vendimin e Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë 2018/03/PHLG-EnC** dhe Nenet 27 dhe 28 të Rregullores (BE) 2016/1388 **siç është përshtatur dhe miratuar me Vendimin e Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë 2018/05/PHLG-EnC**. Këto veçori të përbashkëta shtesë të FCR duhet të marrin parasysh kapacitetin e instaluar, strukturën dhe modelin e konsumit dhe gjenerimin e zonës sinkrone. OST-të do të aplikojnë një periudhë kalimtare për futjen e veçorive shtesë, të përcaktuara në konsultim me ofruesit e prekur të FCR.
3. OST ku lidhet rezerva ka të drejtë të përcaktojë kërkesa shtesë për grupet e FCR që ofrojnë grupe brenda intervaleve në Nenin 15 (2) (d) të Rregullores (EU) 2016/631 **siç është përshtatur dhe miratuar me Vendimin e Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë 2018/03/PHLG-EnC** dhe Nenet 27 dhe 28 të Rregullores (EU) 2016/1388 **siç është përshtatur dhe miratuar me Vendimin e Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë 2018/05/PHLG-EnC** në mënyrë që të sigurohet siguria operacionale. Këto kërkesa shtesë duhet të bazohen në arsye teknike si shpërndarja gjeografike e moduleve gjeneruese të energjisë ose njësive të kërkesë që i përkasin një grupi sigurues të FCR. Ofruesi i FCR duhet të sigurojë që monitorimi i aktivizimit të FCR të njësive që ofrojnë FCR brenda një grupi ofrues të rezervës është e mundur.
4. OST ku lidhet rezerva do të ketë të drejtën të përjashtojë grupet ofruese të FCR nga ofrimi i FCR në mënyrë që të sigurojë sigurinë e operacionale. Ky përjashtim do të bazohet në arsye teknike të tilla si shpërndarja gjeografike e moduleve gjeneruese te energjisë ose njësive konsumatore që i përkasin një grupi ofrues të FCR.
5. Çdo njësi ofruese e FCR dhe çdo grup ofrues i FCR duhet të ketë vetëm një OST-në ku lidhet rezerva.
6. Çdo njësi ofruese e FCR dhe çdo grup ofrues FCR duhet të jetë pajtueshëm me veçoritë e kërkuara për FCR në Tabelën e Aneksit V dhe me çdo veçori ose kërkesë shtesë të specifikuara në përputhje me paragrafët 2 dhe 3 si dhe duhet të aktivizojë FCR e rënë dakord me anë të një rregullatori proporcional që reagon në devijimet e frekuencave ose në mënyrë alternative bazuar në një karakteristikë lineare monotone të karakteristikës fuqi-frekuencë në rast të aktivizimit të FCR me rele. Ato duhet të jenë në gjendje të aktivizojnë FCR brenda diapazonit të frekuencës të përcaktuar në Nenin 13 (1) të Rregullores (BE) 2016/631 siç është përshtatur dhe miratuar me Vendimin e Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë 2018/03/PHLG-EnC.
7. Çdo OST e zonës sinkrone te KE do të sigurojë që reagimi i kombinuar i FCR i një zone LFC të jetë në përputhje me kërkesat e mëposhtme:

a) aktivizimi i FCR nuk duhet të vonohet artificialisht dhe duhet të fillojë sa më shpejt të jetë e mundur pas një devijimi të frekuencës;

b) në rast të një devijimi të frekuencës të barabartë ose më të madh së 200 mHz, të paktën 50% të kapacitetit të plotë të FCR duhet të furnizohet jo më vonë së 15 sekonda;

c) në rast të një devijimi të frekuencës të barabartë ose më të madh së 200 mHz, 100% e kapacitetit të plotë të FCR duhet të furnizohet jo më vonë së 30 sekonda;

d) në rast të devijimit të frekuencës të barabartë ose më të madh së 200 mHz, aktivizimi i kapacitetit të plotë FCR do të rritet të paktën linearisht nga 15 në 30 sekonda; dhe

e) në rast të një devijimi të frekuencës më të vogël së 200 mHz, kapaciteti përkatës i FCR së aktivizuar duhet të jetë të paktën proporcional me të njëjtën sjellje kohore të përmendur në pikat (a) deri (d).

8. Çdo OST ku lidhet rezerva do të monitorojë kontributin e tij në FCP dhe aktivizimin e FCR duke respektuar detyrimin e tij për FCR, duke përfshirë njësitë ofruese të FCR dhe grupet ofruese të FCR. Çdo ofrues i FCR do të vendosë në dispozicion OST ku lidhet rezerva, për çdo njësi të tij ofruese të FCR dhe grupet ofruese të FCR, të paktën informacionin e mëposhtëm:

   a) statusin me stampimin e kohës duke treguar nëse FCR është aktive ose jo;
   b) të dhënat e fuqisë aktive të stampuar në kohë, të nevojshme për të verifikuar aktivizimin e FCR;
   c) rënia (droop) e rregullatorit për modulet gjeneruese të tipit C dhe D siç përcaktohet në nenin 5 të Rregullores (BE) 2016/631 **siç është përshtatur dhe miratuar me Vendimin e Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë 2018/03/PHLG-EnC** që vepron si njësi ofruese e FCR, ose parametri i tij ekuivalent për grupet ofruese të FCR që përbëhen nga modulet gjeneruese të tipit A dhe /ose tipit B siç përcaktohen në nenin 5 të Rregullores (BE) 2016/631 **siç është përshtatur dhe miratuar me Vendimin e Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë 2018/03/PHLG-EnC** dhe/ose njësitë konsumatore me kontrollin e fuqisë aktive për përgjigjen ndaj ngarkesës siç përcaktohet në **Nenin 28 të Rregullores (EU) 2016/1388 siç është përshtatur dhe miratuar me Vendimin e Grupit të Përhershëm të Lartë 2018/05/PHLG-EnC**.

9. Çdo ofrues i FRC do të ketë të drejtën të mbledhë të dhënat përkatëse për më shumë së një njësi ofruese të FCR nëse fuqia maksimale e njësive të agreguara është nën 1,5 MW dhe është e mundur një verifikim i qartë i aktivizimit të FCR.Me kërkesë të OST ku lidhet rezerva, ofruesi i FCR do të vendosë në dispozicion informacionin e listuar në paragrafin 9 në kohë reale, me një zgjidhje kohore prej të paktën 10 sekondash.

10. Me kërkesë t ë OST ku lidhet rezerva dhe aty ku është e nevojshme për verifikimin e aktivizimit të FCR, një ofrues i FCR duhet të vendosë në dispozicion të dhënat e listuara në paragrafin 9 lidhur me instalimet teknike që janë pjesë e të njëjtës njësi të FCR.

Neni 155

Procesi i parakualifikimit të FCR

1. Brenda 12 muajve pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, çdo OST-të do të zhvillojnë një proces parakualifikues të FCR dhe do të bëjnë publike detajet e procesit të parakualifikimit të FCR.
2. Një ofrues i mundshëm i FCR do t'i demonstrojë OST ku lidhet rezerva nëse është në përputhje me kërkesat teknike dhe shtesë të përcaktuara në Nenin 154 duke plotësuar me sukses procesin e parakualifikimit të njësive te mundshme ofruese të FCR ose grupeve ofruese të FCR, të përshkruara në paragrafët 3 deri 6 të këtij neni.
3. Një ofrues i mundshëm i FCR do të paraqesë një aplikim formal tek OST ku lidhet rezerva së bashku me informacionin e kërkuar të njësive të mundshme ofruese të FCR ose grupeve ofruese të FCR. Brenda 8 javëve nga marrja e aplikimit, OST ku lidhet rezerva do të konfirmojë nëse aplikimi është i plotë. Kur OST ku lidhet rezerva e konsideron që aplikimi është i paplotë, ofruesi i mundshëm i FCR duhet të dorëzojë informacionin shtesë të kërkuar brenda 4 javëve nga marrja e kërkesës për informacion shtesë. Kur ofruesi i mundshëm FCR nuk e dërgon informacionin e kërkuar brenda këtij afati, aplikimi do të konsiderohet i tërhequr.
4. Brenda 3 muajve nga konfirmimi s e aplikimi është i plotë, OST k u l i d h e t r e z e r v a do të vlerësojë informacionin e ofruar dhe do të vendosë nëse njësitë e mundshme ofruese të FCR ose grupet ofruese të FCR përmbushin kriteret për një parakualifikim të FCR. OST ku lidhet rezerva do të njoftojë vendimin e saj për ofruesin e mundshëm të FCR.
5. Kur pajtueshmëria me kërkesat e caktuara të kësaj rregulloreje, është tashmë e verifikuar nga OST ku lidhet rezerva, parakualifikimi do të konsiderohet i njohur.
6. Kualifikimi i njësive ofruese të FCR ose grupet ofruese të FCR do të rivlerësohen:

   a) të paktën një herë në 5 vjet;

   b) në rast së kanë ndryshuar kushtet teknike, disponueshmëria ose pajisjet; dhe

   c) në rast të modernizimit të pajisjeve që lidhen me aktivizimin e FCR.

Neni 156

Sigurimi i FCR

1. Çdo OST duhet të sigurojë disponueshmërinë e të paktën detyrimeve të FCR të rënë dakord midis të gjithë OST-ve të te njëjtës zonë sinkrone në përputhje me nenet 153, 163, 173 dhe 174.

2. Të gjithë OST-të e zonës sinkrone do të përcaktojnë, të paktën në baza vjetore, madhësinë e faktorit K të zonës sinkrone, duke marrë parasysh të paktën faktorët e mëposhtëm:

   a) kapacitetin rezervë në FCR pjesëtuar me devijimin maksimal të frekuencës së gjendjes së qëndrueshme;

   b) auto-kontrollin e gjenerimit;

   c) vetë-rregullimin e ngarkesës, duke marrë parasysh kontributin në përputhje me Nenet 27 dhe 28 të Rregullores (BE) 2016/1388 siç është përshtatur dhe miratuar me Vendimin e Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë 2018/05/PHLG-EnC

   d) përgjigjen e frekuencës së interkonektorëve HVDC sipas Nenit 172; dhe

   e) aktivizimin i LFSM dhe FSM në përputhje me Nenet 13 dhe 15 të Rregullores (BE) 2016/631 siç është përshtatur dhe miratuar me Vendimin e Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë 2018/05/PHLG-EnC

3. Të gjithë OST-të e zonës sinkrone, qe përbëhet nga me shume se një zone LFC në marrëveshjen e operimit të zonës sinkrone, do të përcaktojnë ndarjet e faktorit K për secilën zonë LFC, që duhet të bazohet të paktën në:

   a) detyrimet fillestare të FCR;
   b) auto-kontrollin e gjenerimit;
   c) vetë-rregullimin i ngarkesës;
   d) bashkimin e frekuencës nëpërmjet HVDC ndërmjet zonave sinkrone;

   e) shkëmbimin e FCR.

4. Një ofrues i FCR do të garantojë disponueshmërinë e vazhdueshme të FCR, me përjashtim të një ndërprerjeje të detyruar të një njësie ofruese të FCR, gjatë periudhës kohore në të cilën është i detyruar të ofrojë FCR.
5. Çdo ofrues i FCR duhet të informojë OST ku lidhet rezerva, sa më shpejt të jetë e mundur, lidhur me ndryshimet në disponueshmërinë aktuale në tërësi ose pjesërisht të njësisë së tij ofruese të FCR dhe/ose grupit të tij ofrues të FCR që janë të rëndësishme për rezultatet e parakualifikimit.
6. Çdo OST do të siguroje dhe kërkojë nga ofruesit e tij të FCR që të sigurojnë që humbja e një njësie ofruese të FCR nuk rrezikon sigurinë e operacionale duke:

   a. kufizuar ndarjen e FCR së ofruar për çdo njësi ofruese të FCR në 5% të kapacitetit rezervë të FCR të kërkuar për gjithë zonën sinkrone të EK <.>;

   b. <.>

   c. zëvendësimi i FCR i cili është bërë i padisponueshëm për shkak të një ndërprerjeje të detyruar ose të padisponueshmërisë së një njësie siguruese te FCR ose grupi

sigurues te FCR, sa më shpejt të jetë e mundur teknikisht dhe në përputhje me kushtet që do të përcaktohen nga OST-ja lidhëse e rezervës.

7. Një njësi ofruese e FCR ose një grup ofrues FCR me një rezervuar të energjisë që nuk kufizon aftësinë e tij për të ofruar FCR duhet të aktivizojë FCR-në e saj për aq kohë sa devijimi i frekuencës vazhdon. <.>.
8. Një njësi ofruese e FCR ose një grup ofrues i FCR me një rezervuar të energjisë që kufizon aftësinë e tij për të ofruar FCR duhet të aktivizojë FCR-në e tij për aq kohë sa devijimi i frekuencës të vazhdojë, përveç nëse rezervari i saj i energjisë ka shteruar në drejtimin pozitiv ose negativ.<.> Për zonën sinkrone të EK <.>, çdo ofrues i FCR duhet të sigurojë që FCR nga njësitë e tij ofruese te FCR ose grupet me rezerva të kufizuara të energjisë janë në gjendje të disponueshme gjatë gjendjes normale. Për zonën sinkrone EK <...>, që nga shkaktimi i gjendjes së alarmit dhe gjatë gjendjes së alarmit, çdo ofrues i FCR-së duhet të sigurojë që njësitë e tije ofruese te FCR ose grupet me rezervuarë të kufizuar të energjisë, janë në gjendje të aktivizojnë plotësisht FCR në mënyrë të vazhdueshme për një periudhë kohore që do të përcaktohet sipas paragrafëve 10 dhe 11. Kur nuk është përcaktuar asnjë afat në përputhje me paragrafët 10 dhe 11, çdo ofrues i FCR duhet të sigurojë që njësitë e veta ofruese te FCR ose grupet me rezerva të kufizuara të energjisë, janë në gjendje të aktivizojnë plotësisht FCR vazhdimisht për të paktën 15 minuta ose, në rast të devijimeve të frekuencës që janë më të vogla së një devijim i frekuencës që kërkon aktivizim të plotë FCR, për një gjatësi të barabartë kohore ose për një periudhë të përcaktuar nga secili OST, i cili nuk duhet të jetë më i madh së 30 ose më i vogël së 15 minuta.
9. Për zonën sinkrone CE <...>, të gjithë OST-të do të zbatojnë metodologjinë në lidhje me periudhën minimale të aktivizimit që do të sigurohet nga ofruesit e FCR-së të miratuar sipas Rregullores (BE)2017/1485.<...>
10. <...>
11. Ofruesi i FCR duhet të specifikojë kufizimet e rezervuarit të energjisë të njësive të veta ofruese të FCR ose grupeve ofruese të FCR në procesin e parakualifikimit në përputhje me Nenin 155.
12. Një ofrues i FCR që përdor njësi ofruese të FCR ose grupe ofruese të FCR me rezervuar të energjisë që kufizon aftësinë e tyre për të ofruar FCR duhet të sigurojë rikuperimin e rezervuarit të energjisë në drejtim pozitive ose negative sa më shpejt që të jetë e mundur, në përputhje me kriteret e mëposhtme:

    a) <...>

    b) Për zonën sinkrone të EK <... >, ofruesi i FCR-së duhet të sigurojë rikuperimin e rezervuarëve të energjisë sa më shpejt që të jetë e mundur, minimalisht brenda 2 orëve pas përfundimit të gjendjes së alarmit.

TITULLI 6

Rezervat e rivendosjes së frekuencës

Neni 157

Dimensionimi i FRR

1. Të gjithë OST-të e një blloku LFC do të përcaktojnë rregullat e dimensionimit të FRR në marrëveshjen e operimit të bllokut LFC.
2. Rregullat e dimensionimit të FRR duhet të përfshijnë të paktën sa më poshtë:

   a) Të gjithë OST-të e një blloku LFC në zonën sinkrone të EK <.>do të përcaktojnë kapacitetin rezervë të kërkuar të FRR të bllokut LFC bazuar në të dhënat historike të njëpasnjëshme që përfshijnë të paktën vlerat historike të disbalancës së bllokut LFC. Marrja e mostrave të këtyre të dhënave historike duhet të mbulojë të paktën kohën për rivendosjen e frekuencës. Periudha kohore e shqyrtuar për këto të dhëna do të jetë përfaqësuese dhe do të përfshijë të paktën një periudhë të vitit të plotë që përfundon jo më herët së 6 muaj para datës së llogaritjes;

   b) Të gjithë OST-të e një blloku LFC në zonën sinkrone të EK **<...> do të** përcaktojnë kapacitetin rezervë të kërkuar të FRR të bllokut LFC i mjaftueshëm për të respektuar parametrat aktual të synuar të FRCE në Nenin 128 për periudhën kohore të përmendur në pikën (a) bazuar të paktën në një metodologji probabilitare. Në përdorimin e kësaj metodologjie probabilitare, OST- të do të marrin në konsideratë kufizimet e përcaktuara në marrëveshjet për ndarjen ose shkëmbimin e rezervave për shkak të cënimeve të mundshme të sigurisë operacionale dhe kërkesave të disponueshmërisë së FRR. Të gjithë OST-të e bllokut LFC duhet të marrin parasysh çdo ndryshim të pritur të rëndësishëm në shpërndarjen e disbalancave të bllokut LFC ose do të marrin në konsideratë faktorët e tjerë ndikues të rëndësishëm lidhur me periudhën kohore të shqyrtuar;

   c) Të gjithë OST-të e bllokut LFC do të përcaktojnë shkallën e FRR automatike, FRR manuale, kohën e aktivizimit të plotë të FRR automatike dhe kohën e aktivizimit të plotë të FRR manuale në mënyrë që të jenë pajtueshëm me kërkesat e paragrafit (b). Për këtë qëllim, koha e aktivizimit të plotë të FRR automatike të një blloku LFC dhe koha e aktivizimit të plotë të FRR manuale të bllokut LFC nuk duhet të jetë më e madhe së koha për rivendosjen e frekuencës;

   d) OST-të e bllokut LFC do të përcaktojnë madhësinë e incidentit të referencës, i cili do të jetë disbalanca më e madhe që mund të rezultojë nga një ndryshim i menjëhershëm i fuqisë aktive të një moduli të vetëm gjenerues, një objekt i vetëm konsumator ose një interkonektori të vetëm HVDC ose nga stakimi i një linje AC brenda bllokut LFC;

   e) Të gjithë OST-të e bllokut LFC do të përcaktojnë kapacitetin rezervë pozitiv të FRR, i cili nuk duhet të jetë më i vogël së incidenti pozitiv i dimensionimit të bllokut LFC;

   f) Të gjithë OST-të e bllokut LFC do të përcaktojnë kapacitetin rezervë negativ të FRR, i cili nuk duhet të jetë më i vogël së incidenti negativ i dimensionimit të bllokut LFC;

   g) Të gjithë OST-të e bllokut LFC do të përcaktojnë kapacitetin rezervë të FRR të një blloku LFC, çdo kufizim të mundshëm gjeografik për shpërndarjen e tij brenda bllokut LFC dhe

çdo kufizim të mundshëm gjeografik për çdo shkëmbim rezervash ose ndarjen e rezervave me blloqe të tjera LFC për të qenë pajtueshëm me kufijtë e sigurisë operacionale

h) Të gjithë OST-të e bllokut LFC duhet të sigurojnë që kapaciteti rezervë pozitiv i FRR ose një kombinim i kapacitetit rezervë të FRR dhe RR është i mjaftueshëm për të mbuluar disbalancat pozitive të bllokut LFC për të paktën 99% të kohës, bazuar në të dhënat historike të përmendura në pikën (a);

i) Të gjithë OST-të e bllokut LFC do të sigurojnë që kapaciteti rezervë negativ i FRR ose një kombinim i kapacitetit rezervë të FRR dhe RR është i mjaftueshëm për të mbuluar disbalancat negative të bllokut LFC për të paktën 99% të kohës, bazuar në të dhënat historike të përmendura në pikën (a);

j) Të gjithë OST-të e bllokut LFC mund të zvogëlojnë kapacitetin rezervë pozitiv të FRR të bllokut LFC që rezulton nga procesi i dimensionimit të FRR duke nënshkruar një marrëveshje ndarjeje të FRR me blloqet e tjera LFC në përputhje me dispozitat në Titullin 8. Në Marrëveshjen për ndarjen e rezervave do të aplikohen kriteret si më poshtë:

   i. Për zonën sinkrone të EK<...>, reduktimi i kapacitetit rezervë pozitiv të FRR të një blloku LFC do të kufizohet në diferencën, nëse është pozitive, midis madhësisë së incidentit pozitiv të dimensionimit dhe kapacitetit rezervë të FRR që kërkohet për të mbuluar disbalancat pozitive të bllokut LFC gjatë 99% të kohës, bazuar në të dhënat historike të përmendura në pikën (a). Reduktimi i kapacitetit rezervë pozitiv nuk duhet të kalojë 30% të madhësisë së incidentit pozitiv të dimensionimit;

   ii. **<...>**

k) Të gjithë OST-të e bllokut LFC mund të zvogëlojnë kapacitetin rezervë negativ të FRR të bllokut LFC, që rezulton nga procesi i dimensionimit të FRR duke përfunduar një marrëveshje ndarjeje të FRR me blloqe të tjera të LFC në përputhje me dispozitat e Titullit 8. Në marrëveshjen e ndarjes do të zbatohen kërkesat e mëposhtme:

   i. Për zonën sinkrone të EK **<...>**reduktimi i kapacitetit rezervë negativ të FRR të një blloku LFC do të kufizohet në diferencën, nëse është pozitive, midis madhësisë së incidentit negativ të dimensionimit dhe kapacitetit rezervë të FRR që kërkohet për të mbuluar disbalancat negative të bllokut LFC gjatë 99% të kohës, bazuar në të dhënat historike të përmendura në pikën (a).

   ii. **<...>**

3. Të gjithë OST-të e bllokut LFC ku blloku LFC përfshin më shumë se një OST do të përcaktojnë në marrëveshjen e operimit të bllokut LFC, ndarjen specifike të përgjegjësive ndërmjet OST-ve të zonave LFC për zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në paragrafin 2.

4. Të gjithë OST-të e bllokut LFC duhet të kenë kapacitet rezervë të FRR të mjaftueshëm në çdo kohë në përputhje me rregullat e dimensionimit të FRR. OST-të e bllokut LFC do të specifikojnë në marrëveshjen e operimit të bllokut LFC një procedurë të përshkallëzuar për rastet e riskut te larte të pamjaftueshmerisë së kapacitetit rezervë të FRR në bllokun LFC.

Neni 158

Kërkesat teknike minimale të FRR

1. Kërkesat minimale teknike të FRR-së janë:

   a) secila njësi ofruese e FRR dhe çdo grup ofrues i FRR duhet të lidhet vetëm me një OST ku lidhet rezerva;
   b) njësia ofruese e FRR ose grupi ofrues i FRR do të aktivizojë FRR në përputhje me pikën e dhënë të punës e parashikuar nga OST urdhëruese e rezervës;
   c) OST urdhëruese e rezervës është OST ku lidhet rezerva ose një OST e caktuar nga OST ku lidhet rezerva në një marrëveshje të shkëmbimit të FRR në përputhje me Nenin 165(3) ose 171(4);
   d) një njësi ofruese e FRR ose një grup ofrues i FRR, për FRR automatike do të ketë vonesë të aktivizimit të FRR automatike që nuk i kalon 30 sekonda;
   e) një ofrues i FRR do të sigurojë që aktivizimi i FRR i njësive ofruese të FRR brenda një grupi ofrues të rezervës mund të monitorohet. Për këtë qëllim, ofruesi i FRR duhet të jetë në gjendje të vendosë në dispozicion të OST ku lidhet rezerva dhe OST urdhëruese të rezervës, matjet në kohë reale të pikës së lidhjes ose një pike tjetër ndërveprimi të rënë dakord me OST ku lidhet rezerva, lidhur me:

      i. prodhimin e fuqisë aktive të skeduluar me stampim kohe;
      ii. fuqinë aktive e çastit me stampim kohe për:
         - çdo njësi ofruese të FRR,
         - çdo grup ofrues të FRR, dhe
         - çdo modul gjenerues ose njësi konsumatore të një grupi ofrues të FRR me një fuqi maksimale të fuqisë aktive më të madhe ose të barabartë me 1,5 MW;
   f) një njësi ofruese e FRR ose grupi ofrues i FRR për FRR automatike duhet të jetë në gjendje të aktivizojë kapacitetin e saj të plotë të rezervës të FRR automatike brenda kohës së aktivizimit të plotë të FRR automatike;
   g) një njësi ofruese e FRR ose grupi ofrues i FRR për FRR manuale duhet të jetë në gjendje të aktivizojë kapacitetin e saj të plotë të rezervës të FRR manuale brenda kohës së aktivizimit të plotë të FRR manuale;
   h) një ofrues i FRR duhet të përmbushë kërkesat e disponueshmërisë së FRR; dhe
   i) një njësi ofruese e FRR ose grupi ofrues i FRR do të përmbushë kërkesat e normës së rampimit të bllokut LFC.

2. Të gjithë OST-të e bllokut LFC duhet të specifikojnë kërkesat e disponueshmërisë së FRR dhe kërkesat për cilësinë e kontrollit të njësive ofruese të FRR dhe grupeve ofruese të FRR për bllokun e tyre LFC në marrëveshjen e operacionale të bllokut LFC në përputhje me Nenin 119.
3. OST ku lidhet rezerva do të miratojë kërkesat teknike për lidhjen e njësive ofruese të FRR dhe grupeve ofrues të FRR për të siguruar shpërndarjen e sigurtë të FRR.
4. Çdo ofrues i FRR duhet të:

a. sigurojë që njësitë e tij ofruese të FRR-së dhe grupet që ofrojnë FRR-në përmbushin kërkesat teknike minimale të FRR, kërkesat e disponueshmërisë së FRR dhe kërkesat e normës së rampimit në paragrafët 1 deri 3; dhe

b. informojë OST urdhëruese të rezervës për një zvogëlim të disponueshmërisë aktuale të njësisë së tij ofruese të FRR ose grupit të tij ofrues të FRR-së ose një pjesë të grupit të tij ofrues të FRR sa më shpejt të jetë e mundur.

5. Çdo OST urdhëruese e rezervës duhet të sigurojë monitorimin e pajtueshmërisë me kërkesat teknike minimale të FRR në paragrafin 1, kërkesat e disponueshmërisë së FRR në paragrafin 2, kërkesat e shkallës e rampimit në paragrafin 1 dhe kërkesat e lidhjes në paragrafin 3 nga njësitë e tij ofruese të FRR dhe grupet e tij ofruese të FRR.

Neni 159

Procesi i parakualifikimit të FRR

1. 12 muaj pas hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, çdo OST do të zhvillojë një proces parakualifikimi të FRR si dhe do të sqarojë dhe do të bëjë publike detajet e tij.
2. Një ofrues i mundshëm i FRR duhet t'i demonstrojë OST ku lidhet rezerva ose OST të caktuar nga OST ku lidhet rezerva në marrëveshjen e shkëmbimit të FRR, që ai është në pajtueshmëri me kërkesat teknike minimale të FRR të përcaktuara në Nenin 158 (1), kërkesat e disponueshmërisë së FRR të përcaktuara në Nenin 158 (2), kërkesat e shkallës së rampimit të përcaktuara në Nenin 158 (1) dhe kërkesat e lidhjes të përcaktuara në Nenin 158 (3), duke plotësuar me sukses procesin e parakualifikimit të njësive ofruese të FRR ose grupeve ofruese të FRR, të përshkruara në paragrafët 3 deri 6 të këtij Neni.
3. Një ofrues i mundshëm i FRR duhet të paraqesë një aplikim formal në OST ku lidhet rezerva ose në OST e caktuar, së bashku me informacionin e kërkuar të njësive të mundshme ofruese të FRR ose grupeve ofruese të FRR. Brenda 8 javëve nga marrja e aplikimit, OST ku lidhet rezerva ose OST e caktuar do të konfirmojnë nëse aplikimi është i plotë. Kur OST ku lidhet rezerva ose OST e caktuar konsideron së aplikimi është jo i plotë, ata do të kërkojnë informacion shtesë dhe ofruesi i mundshëm i FRR do të dorëzojë informacionin shtesë të kërkuar brenda 4 javëve nga marrja e kërkesës. Kur ofruesi i mundshëm i FRR nuk jep informacionin e kërkuar brenda këtij afati, aplikimi do të konsiderohet i tërhequr.

4. Brenda 3 muajve pasi OST ku lidhet rezerva ose OST e caktuar konfirmon së aplikimi është i plotë, OST ku lidhet rezerva ose OST e caktuar do të vlerësojë informacionin e ofruar dhe do të vendosë nëse njësitë ose grupet ofruese të FRR plotësojnë kriteret për një parakualifikim të FRR. OST ku lidhet rezerva ose OST e caktuar duhet ta njoftojë vendimin e tyre tek ofruesi i mundshëm i FRR.

5. Kualifikimi i njësive ofruese të FRR ose grupeve ofruese të FRR nga OST ku lidhet rezerva ose OST e caktuar do të jenë të vlefshme për të gjithë bllokun LFC.

6. Kualifikimi i njësive ofruese të FRR ose grupeve ofruese të FRR duhet të rivlerësohen:

a. të paktën një herë në 5 vjet; dhe

b. kur kërkesat teknike ose ato të disponueshmërisë ose pajisjet kanë ndryshuar.

7. Për të garantuar sigurinë e operacionale, OST ku lidhet rezerva do të ketë të drejtën të përjashtojë grupet ofruese të FRR nga ofrimi i FRR bazuar në argumente teknike të tilla si shpërndarja gjeografike e moduleve gjeneruese te energjise ose njësitë konsumatore që i përkasin një grupi ofrues të FRR.

TITULLI 7

Rezervat zëvendësuese

Neni 160

Dimensionimi i RR

1. Të gjithë OST-të e bllokut LFC kanë të drejtë të implementojnë një proces zëvendësimi të rezervës.
2. Për të qenë në pajtueshmëri me parametrat e synuar të FRCE të përmendura në Nenin 128, OST-të e bllokut LFC me një RRP, që kryejnë një proces të kombinuar të dimensionimit të FRR dhe RR për të përmbushur kërkesat e Nenit 157 (2), do të përcaktuar rregullat e dimensionimit të RR në marrëveshjen e operacionale të bllokut LFC.

3. Rregullat e dimensionimit të RR duhet të përmbajnë të paktën kërkesat e mëposhtme:

   a) Për zonën sinkrone të EK <...> duhet të ketë kapacitet rezervë pozitiv të mjaftueshëm të RR për të rivendosur sasinë e kërkuar të FRR pozitive;<...>
   b) Për zonën sinkrone të EK <...> duhet të ketë kapacitet rezervë negativ të mjaftueshëm të RR për të rivendosur sasinë e kërkuar të FRR negative;<.>
   c) do të ketë kapacitet rezervë të mjaftueshëm të RR, kur kjo merret parasysh për dimensionimin e kapacitetit rezervë të FRR, në mënyrë që të respektojë objektivin e cilësisë së FRCE për periudhën kohore në fjalë; dhe
   d) pajtueshmëria me sigurinë operacionale brenda bllokut LFC për të përcaktuar kapacitetin rezervë në RR.

4. Të gjithë OST-të e bllokut LFC mund të zvogëlojnë kapacitetin rezervë pozitiv të RR të bllokut LFC, që rezulton nga procesi i dimensionimit të RR, duke zhvilluar një marrëveshje për ndarjen e RR për atë kapacitet rezervë pozitiv të RR me blloqet e tjera LFC në përputhje me dispozitat e Titullit 8 të Pjesës IV. OST që merr aftësinë e kontrollit do të kufizojë zvogëlimin e kapacitetit rezervë pozitiv të tij të RR për të:

   a) garantuar së ai ende mund të plotësojë parametrat e synuar të FRCE të përcaktuara në nenin 128;
   b) siguruar që siguria operacionale nuk është e rrezikuar; dhe
   c) siguruar që reduktimi i kapacitetit rezervë pozitiv të RR nuk e tejkalon kapacitetin rezervë pozitiv të mbetur të RR të bllokut LFC.

5. Të gjithë OST-të e bllokut LFC mund të reduktojnë kapacitetin rezervë negativ të RR të bllokut LFC, që rezulton nga proçesi i dimensionimit të RR, duke zhvilluar një marrëveshje për ndarjen e RR për atë kapacitet rezervë negativ të RR me blloqe të tjera LFC në përputhje me dispozitat e Titullit 8 të Pjesës IV. OST që merr aftësinë e kontrollit do të kufizojë zvogëlimin e kapacitetit rezervë negativ të tij të RR për të:

    a. garantuar së ai ende mund të plotësojë parametrat e synuar të FRCE të përcaktuara në Nenin 128;
    b. siguruar qe siguria operacionale nuk është e rrezikuar; dhe
    c. siguruar që reduktimi i kapacitetit rezervë negativ të RR nuk e tejkalon kapacitetin rezervë negativ të mbetur të RR të bllokut LFC.

6. Kur një bllok LFC operohet nga me shume se një OST dhe nëse procesi është i nevojshëm për bllokun LFC, te gjitha OST-të e bllokut LFC duhet të specifikojnë në marrëveshjen operacionale të bllokut LFC alokimin e përgjegjësive ndërmjet OST-ve të zonave të ndryshme LFC për zbatimin e rregullave të dimensionimit të përcaktuara në paragrafin 3.
7. Çdo OST do të ketë kapacitet të mjaftueshëm rezervë të RR në përputhje me rregullat e dimensionimit të RR në çdo kohë. OST-të e bllokut LFC do të specifikojnë në marrëveshjen operacionale të bllokut LFC një procedurë përshkallëzimi për rastet e riskut të lartë të pamjaftueshmerisë së kapacitetit rezervë të RR në bllokun LFC.

Neni 161

Kërkesat teknike minimale të RR

1. Njësitë ofruese RR dhe grupet ofruese të RR duhet të përmbushin kërkesat teknike minimale si në vijim:

    a) lidhje me vetëm një OST ku lidhet rezerva;
    b) aktivizimi i RR sipas pikës së caktuar të marrë nga OST urdhëruese e rezervës;
    c) OST urdhëruese e rezervës duhet të jetë OST ku lidhet rezerva ose OST i caktuar nga OST ku lidhet rezerva në marrëveshjen e shkëmbimit të RR në përputhje me Nenin 165 (3) ose 171(4);
    d) aktivizimi i kapacitetit rezervë të plotë të RR brenda kohës së aktivizimit të përcaktuar nga OST urdhëruese e rezervës;
    e) de-aktivizimi i RR sipas pikave të parashikuara nga OST urdhëruese e rezervës;
    f) një ofrues i RR duhet të sigurojë që aktivizimi i RR të njësive ofruese të RR brenda një grupi ofrues të rezervës mund të monitorohet. Për këtë qëllim ofruesi i RR duhet të jetë në gjendje të furnizojë OST ku lidhet rezerva dhe OST urdhëruese të rezervës matjet në kohë reale të pikës së lidhjes ose një pikë tjetër ndërveprimi të rënë dakord me OST ku lidhet rezerva lidhur me:

        i. prodhimin e skeduluar të fuqisë aktive me stampim kohe, për çdo njësi dhe grup ofrues të RR dhe për çdo modul gjenerues te energjisë ose

njësi konsumatore të një grupi ofrues të RR me një prodhim maksimal të fuqisë aktive më të madh ose të barabartë me 1,5 MW;

ii. prodhimin e fuqisë aktive të çastit me stampim kohe, për çdo njësi dhe grup ofrues të RR dhe për çdo modul gjenerues te energjisë ose njësi konsumatore të një grupi ofrues të RR me një prodhim maksimal të fuqisë aktive më të madh ose të barabartë me 1,5 MW;

g) përmbushjen e kërkesave të disponueshmërisë të RR.

2. Te gjitha OST-të e bllokut LFC duhet të specifikojnë kërkesat e disponueshmërisë së RR dhe kërkesat për cilësinë e kontrollit të njësive ofruese të RR dhe grupeve ofruese të RR në marrëveshjen operacionale të bllokut LFC.
3. OST ku lidhet rezerva do të miratojë kërkesat teknike për lidhjen e njësive ofruese të RR dhe grupeve ofruese të RR për të siguruar livrimin e sigurtë të RR në përshkrimin e procesit të parakualifikimit.
4. Çdo ofrues i RR do të:

   a. sigurojë që njësitë ofruese të RR dhe grupet ofruese të RR të përmbushin kërkesat teknike minimale të RR dhe kërkesat e disponueshmërisë së RR të përmendura në paragrafët 1 deri 3; dhe

   b. informojnë OST urdhëruese të rezervës për një reduktim të disponueshmërisë aktuale ose një ndërprerje të detyruar të njësisë së tij ofruese të RR ose grupit të tij ofrues të RR ose një pjesë të grupit të tij ofrues të RR sa më shpejt që të jetë e mundur.

5. Çdo OST urdhëruese e rezervës do të sigurojë pajtueshmërinë me kërkesat teknike të RR, kërkesat e disponueshmërisë së RR dhe kërkesat e lidhjes të përmendura në këtë nen lidhur me njësitë ofruese të RR dhe grupet ofruese të RR.

Neni 162

Procesi i parakualifikimit të RR

1. Secili OST i bllokut LFC që ka implementuar një RRP do të zhvillojë një proces parakualifikimi të RR, brenda 12 muajve të hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje ku duhet të sqarojë dhe t'i bëjë publike detajet e tij.
2. Një ofrues i mundshëm i RR do t'i demonstrojë OST ku lidhet rezerva ose OST të caktuar nga OST ku lidhet rezerva në marrëveshjen e shkëmbimit të RR, që ai është në pajtueshmëri me kërkesat teknike minimale të RR, kërkesat e disponueshmërisë së RR dhe kërkesat e lidhjes të përmendura në Nenin 161 duke plotësuar me sukses procesin e parakualifikimit të njësive ofruese të RR ose grupeve ofruese të RR, të përshkruara në paragrafët 3 deri 6.
3. Një ofrues i mundshëm i RR duhet të paraqesë një aplikim formal të OST ku lidhet rezerva ose të OST i caktuar bashkë me informacionin e kërkuar të njësive të mundshme ofruese të RR ose grupeve ofruese të RR. Brenda 8 javëve nga marrja e aplikimit, OST ku lidhet rezerva ose OST i caktuar do të konfirmojë nëse aplikimi është i plotë. Kur OST ku lidhet rezerva ose OST i caktuar konsideron së aplikimi është jo i plotë, ata do të kërkojnë informacion shtesë dhe ofruesi i mundshëm i RR do të dorëzojë informacionin shtesë të kërkuar brenda 4 javëve nga marrja e

kërkesës. Kur ofruesi i mundshëm i RR nuk jep informacionin e kërkuar brenda këtij afati, aplikimi do të konsiderohet i tërhequr.

4. Brenda 3 muajve pasi OST ku lidhet rezerva ose OST i caktuar konfirmon së aplikimi është i plotë, OST ku lidhet rezerva ose OST i caktuar do të vlerësojë informacionin e ofruar dhe do të vendosë nëse njësitë ose grupet ofruese të RR plotësojnë kriteret për një parakualifikim të RR. OST ku lidhet rezerva ose OST i caktuar duhet ta njoftojë vendimin e tyre te ofruesi i mundshëm i RR.
5. Kualifikimi i njësive ofruese të FRR ose grupeve ofruese të RR duhet të rivlerësohen:

    a. të paktën një herë në 5 vjet; dhe
    b. kur kërkesat teknike ose ato të disponueshmërisë ose pajisjet kanë ndryshuar.

6. Për të garantuar sigurinë e operimit, OST ku lidhet rezerva do të ketë të drejtën të përjashtojë grupet ofruese të RR nga ofrimi i RR bazuar në argumente teknike të tilla si shpërndarja gjeografike e moduleve gjeneruese ose njësitë konsumatore që i përkasin një grupi ofrues të RR.

TITULLI 8

SHKËMBIMI DHE NDARJA E REZERVAVE

Kapitulli 1

Shkëmbimi dhe ndarja e rezervave brenda një zone sinkrone

Neni 163

Shkëmbimi i FCR brenda një zone sinkrone

1. Të gjithë OST-të e përfshirë në shkëmbimin e FCR brenda një zone sinkrone do të jenë në pajtueshmëri me kërkesat e përcaktuara në paragrafët 2 deri 9. Shkëmbimi i FCR nënkupton transferimin e një detyrimi të FCR nga OST që merr rezervën tek OST ku lidhet rezerva për kapacitetin rezervë korrespondues të FCR.
2. Të gjithë OST-të e përfshirë në shkëmbimin e FCR brenda një zone sinkrone do të respektojnë kufijtë dhe kërkesat për shkëmbimin e FCR brenda zonës sinkrone të specifikuar në Tabelën e Aneksit VI.
3. Në rast të shkëmbimit të FCR, OST ku lidhet rezerva dhe OST që merr rezervën do ta njoftojnë këtë shkëmbim në përputhje me Nenin 150.
4. Çdo OST ku lidhet rezerva, OST që merr rezervën ose OST e prekur e përfshirë në shkëmbimin e FCR mund të refuzojë shkëmbimin e FCR nëse do të rezultonte që flukset e fuqisë cënojnë kufijtë e sigurisë operacionale kur aktivizojnë kapacitetin rezervë të FCR, subjekt i shkëmbimit të FCR.
5. Secili OST i prekur do të verifikojë që marxhina e tij e besueshmërisë, e vendosur në përputhje me nenin 22 të Rregullores BE 2015/1222 e përshtatur dhe miratuar me Vendimin 2022/03/MC-EnC të Këshillit Ministerial, është e mjaftueshme për të pranuar flukset e fuqisë që rezultojnë nga aktivizimi i kapacitetit rezervë të FCR, subjekt i shkëmbimit të FCR.

6. Të gjithë OST-të e një zone LFC duhet të rregullojnë parametrat e llogaritjes së tyre të FRCE për shkëmbimin e FCR.
7. OST ku lidhet rezerva do të jetë përgjegjës për kërkesat e përmendura në Nenet 154 dhe 156 për sa i përket kapacitetit rezervë të FCR, subjekt i shkëmbimit të FCR.
8. Njësia ose grupi ofrues i FCR do të jetë përgjegjës ndaj OST ku lidhet rezerva për aktivizimin e FCR.
9. OST-të respektive duhet të sigurojnë që shkëmbimi i FCR nuk pengon ndonjë OST të përmbushë kërkesat e rezervës në Nenin 156.

Neni 164

Ndarja e FCR brenda një zone sinkrone

Një OST nuk duhet të ndajë FCR me OST-të e tjera të zonës sinkrone për të përmbushur detyrimet e tij të FCR dhe për të zvogëluar sasinë totale të FCR të zonës sinkrone në përputhje me Nenin 153.

Neni 165

Kërkesat e përgjithshme për shkëmbimin e FRR dhe RR brenda një zone sinkrone

1. Të gjithë OST-të e zonës sinkrone do të përcaktojnë në marrëveshjen e operacionale të zonës sinkrone rolet dhe përgjegjësitë e OST ku lidhet rezerva, OST që merr rezervën dhe OST e prekur për shkëmbimin e FRR dhe/ose RR.

2. Kur ndodh një shkëmbim i FRR/RR, OST ku lidhet rezerva dhe OST që merr rezervën duhet të njoftojnë këtë shkëmbim në përputhje me kërkesat e Nenit 150.

3. OST ku lidhet rezerva dhe OST që merr rezervën që marrin pjesë në shkëmbimin e FRR/RR duhet të specifikojnë në marrëveshjen e shkëmbimit të FRR ose RR rolet dhe përgjegjësitë e tyre, duke përfshirë:

   a) përgjegjësinë e OST urdhëruese të rezervës për kapacitetin rezervë të FRR dhe RR, subjekt i shkëmbimit të FRR/RR;
   b) sasinë e kapacitetit rezervë të FRR dhe RR, subjekt i shkëmbimit të FRR/RR;
   c) implementimin e procesit të aktivizimit ndërkufitar të FRR/RR në përputhje me Nenet 147 dhe 148;
   d) kërkesat teknike minimale të FRR/RR lidhur me procesin e aktivizimit ndërkufitar të FRR/RR kur OST ku lidhet rezerva nuk është OST urdhëruese e rezervës;
   e) implementimin e parakualifikimit të FRR/RR për kapacitetin rezervë të FRR dhe RR subjekt i shkëmbimit në përputhje me Nenet 159 dhe 162;
   f) përgjegjësinë për të monitoruar përmbushjen e kërkesave teknike të FRR/RR dhe kërkesave të disponueshmërisë së FRR/RR për kapacitetin rezervë të FRR dhe RR, subjekt i shkëmbimit në përputhje me Nenet 158 (5) dhe 161 (5); dhe
   g) procedurat për të siguruar që shkëmbimi i FRR/RR nuk çon në flukse fuqie që cënojnë kufijtë e sigurisë operacionale.

4. Çdo OST ku lidhet rezerva, OST që merr rezervën ose OST e prekur të përfshira në shkëmbimin e FRR ose RR mund të refuzojë shkëmbimin e përmendur në paragrafin 2, nëse rezulton në flukse fuqie që cënojnë kufijtë e sigurisë operacionale kur aktivizojnë kapacitetin rezervë të FRR dhe RR, subjekt i shkëmbimit të FRR ose RR.

5. OST-të përkatëse do të sigurojnë që shkëmbimi i FRR/RR nuk pengon ndonjë OST që të përmbushë kërkesat e rezervës të përcaktuara në rregullat e dimensionimit të FRR ose RR në Nenet 157 dhe 160.

6. Të gjithë OST-të e një blloku LFC duhet të specifikojnë në marrëveshjen e operimit të bllokut LFC rolet dhe përgjegjësitë e OST ku lidhet rezerva, OST që merr rezervën ose OST e prekur për shkëmbimin e FRR dhe/ose RR me OST-të e blloqeve të tjera LFC.

Neni 166

Kërkesa të përgjithshme për ndarjen e FRR dhe RR brenda një zone sinkrone

1. Të gjithë OST-të e një zone sinkrone do të specifikojnë në marrëveshjen operacionale të zonës sinkrone, rolet dhe përgjegjësitë e OST që ofron aftësinë kontrolluese, OST që merr aftësinë kontrolluese dhe OST e prekur për ndarjen e FRR/RR.

2. Kur bëhet ndarja e FRR/RR, OST që ofron aftësinë kontrolluese dhe OST që merr aftësinë kontrolluese do të njoftojnë ndarjen sipas kërkesave të Nenit 150.

3. OST që ofron aftësinë kontrolluese dhe OST që merr aftësinë kontrolluese të përfshira në ndarjen e FRR/RR duhet të specifikojnë në marrëveshjen për ndarjen e FRR ose RR rolet dhe përgjegjësitë e tyre, duke përfshirë:

   a) sasinë e kapacitetit rezervë të FRR dhe RR, subjekt i ndarjes së FRR/RR;

   b) implementimin e procesit të aktivizimit ndërkufitar të FRR/RR në përputhje me Nenet 147 dhe 148;

   c) procedurat për të siguruar që aktivizimi i kapacitetit rezervë të FRR dhe RR, subjekt i ndarjes së FRR/RR, nuk do të çojë në flukse fuqie që shkelin kufijtë e sigurisë operacionale.

4. Çdo OST që ofron aftësinë kontrolluese dhe OST që merr aftësinë kontrolluese ose OST e prekur të përfshira në ndarjen e FRR/RR mund të refuzojë ndarjen e FRR/RR nëse do të rezultonin flukse fuqie që cënojnë kufijtë e sigurisë operacionale kur aktivizojnë kapacitetin rezervë të FRR dhe RR, subjekt i ndarjes së FRR/RR.

5. Në rast të ndarjes së FRR/RR, OST që ofron aftësinë kontrolluese do të vendosë në dispozicion të OST që merr aftësinë kontrolluese një pjesë të kapacitetit të vet rezervë të FRR dhe RR të kërkuar për të përmbushur kërkesat e tij rezervë të FRR dhe/ose RR që rezultojnë nga rregullat e dimensionimit të FRR/RR në Nenet 157 dhe 160. OST që ofron aftësinë kontrolluese mund të jetë:

a) OST urdhëruese e rezervës për kapacitetin rezervë të FRR dhe RR, subjekt i ndarjes së FRR/RR; ose
b) OST që ka qasje në kapacitetin e vet rezervë të FRR dhe RR, duke iu nënshtruar ndarjes së FRR/RR përmes një procesi të aktivizimit ndërkufitar të FRR/RR, si pjesë e një marrëveshjeje shkëmbimi të FRR/RR.

6. Çdo OST që merr aftësinë kontrolluese do të jetë përgjegjës për përballimin e incidenteve dhe disbalancave në rast së kapaciteti rezervë i FRR dhe RR subjekt i ndarjes së FRR/RR nuk është i disponueshëm për shkak të:

a) kufizimeve për rivendosjen e frekuencës ose rregullimin e programit të kontrollit lidhur me sigurinë operacionale; dhe
b) përdorimit të pjesshëm ose të plotë të kapacitetit rezervë të FRR dhe RR nga OST që ofron aftësinë kontrolluese.

7. Të gjithë OST-të e bllokut LFC do të specifikojnë në marrëveshjen operacionale të bllokut LFC rolet dhe përgjegjësitë e OST që ofron aftësinë kontrolluese, OST që merr aftësinë kontrolluese dhe OST e prekur për ndarjen e FRR dhe RR me OST-të e blloqeve të tjera LFC.

Neni 167

Shkëmbimi i FRR brenda një zone sinkrone

Të gjithë OST-të në një zonë sinkrone të përbërë nga më shumë së një bllok LFC të përfshirë në shkëmbimin e FRR brenda zonës sinkrone duhet të jenë në përputhje me kërkesat dhe kufijtë për shkëmbimin e FRR të paraqitur në Tabelën e Aneksit VII.

Neni 168

Ndarja e FRR brenda një zone sinkrone

Çdo OST i një blloku LFC do të ketë të drejtën të ndajë FRR me blloqet e tjera LFC të zonës sinkrone brenda kufijve të përcaktuar nga rregullat e dimensionimit të FRR në Nenin 157 (1) dhe në përputhje me Nenin 166.

Neni 169

Shkëmbimi i RR brenda një zone sinkrone

Të gjithë OST-të në një zonë sinkrone të përbërë nga më shumë së një bllok LFC të përfshirë në shkëmbimin e RR brenda zonës sinkrone do të jenë në përputhje me kërkesat dhe kufijtë për shkëmbimin e RR të paraqitur në Tabelën e Aneksit VIII.

Neni 170

Ndarja e RR brenda një zone sinkrone

Çdo OST i një blloku LFC do të ketë të drejtën të ndajë RR me blloqet e tjera LFC të zonës sinkrone brenda kufijve të përcaktuar nga rregullat e dimensionimit të RR në Nenin 160 (4) dhe (5) dhe në përputhje me Nenin 166.

Kapitulli 2

Shkëmbimi dhe ndarja e rezervave midis zonave sinkrone

Neni 171

Kërkesa të përgjithshme

1. Çdo operator dhe/ose pronar i një interkonektori HVDC i cili ndërlidh zonat sinkrone duhet t'u sigurojë OST-ve lidhëse aftësinë për të kryer shkëmbimin dhe ndarjen e FCR, FRR dhe RR nëse kjo teknologji është instaluar.
2. Të gjithë OST-të e zonës sinkrone duhet të specifikojnë në marrëveshjen operacionale të zonës sinkrone rolet dhe përgjegjësitë e OST-së lidhëse të rezervës, OST-së marrëse të rezervës, dhe OST-së së prekur për shkëmbimin e rezervave si dhe OST ofruese të aftësisë kontrolluese, OST marrëse të aftësisë kontrolluese dhe OST-së së prekur për ndarjen e rezervave midis zonave sinkrone.
3. OST lidhëse e rezervës, OST marrëse e rezervës ose OST ofruese të aftësisë kontrolluese dhe OST marrëse të aftësisë kontrolluese do të njoftojnë shkëmbimin ose ndarjes e FCR, FRR ose RR në përputhje me Nenin 150.
4. OST lidhëse e rezervës dhe OST marrëse e rezervës, të përfshira në shkëmbimin e rezervave do të specifikojnë në një marrëveshje shkëmbimi, rolet de përgjegjësitë e tyre, përfshirë:

    a) përgjegjësitë e OST-se udhëzuese të rezervës për kapacitetin rezervë të shkëmbimit të rezervës;

    b) sasinë e kapacitetit rezerve subjekt i shkëmbimit të rezervave

    c) zbatimin e procesit ndërkufitar të aktivizimit të FRR/RR në përputhje me Nenet 147 dhe 148; dhe

    d) zbatimi i parakualifikimit për kapacitetin rezervë që i nënshtrohet shkëmbimit të rezervave në përputhje me Nenet 155, 159 dhe 162;

    e) përgjegjësinë për të monitoruar respektimin e kërkesave teknike dhe kërkesave mbi disponueshmërinë e kapacitetit rezervë subjekt i shkëmbimit të rezervave sipas Neneve 158(5) dhe 161(5); dhe

    f) procedurat që sigurojnë që shkëmbimi i rezervave nuk çon në flukse fuqie që cënojnë kufijtë e sigurisë operacionale;

5. OST ofruese dhe marrëse të aftësisë kontrolluese të përfshira në ndarjen e rezervës, do të specifikojnë rolet dhe përgjegjësitë e tyre në marrëveshjen për ndarjen duke përfshirë:

    a) sasinë e kapacitetit rezervë subjekt i ndarjes së rezervës;
    b) zbatimin e procesit ndërkufitar të aktivizimit të FRR/RR në përputhje me Nenet 147 dhe 148; dhe
    c) procedurat që sigurojnë që shkëmbimi i rezervave nuk çon në flukse fuqie që cënojnë kufijtë e sigurisë operacionale;

6. OST lidhëse e rezervës dhe OST marrëse e rezervës të përfshirë në shkëmbimin e rezervave, ose OST ofruese dhe marrëse të aftësisë kontrolluese të përfshirë në ndarjen e rezervave, do të zhvillojnë dhe miratojnë një marrëveshje operacionale dhe koordinimi të HVDC me operatorët dhe/ose pronarët e interkonektorëve HVDC ose me subjekte ligjore që përfaqësojnë pronarët e interkonektorëve të HVDC dhe/ose operatorët e HVDC, duke përfshirë:

    a) ndërveprimin përgjatë gjithë periudhave të kohës, përfshirë planifikimin dhe aktivizimin;
    b) faktori i ndjeshmërisë MW/Hz, lineariteti/dinamika ose statike/funksioni i reagimit me hapa të çdo interkonektori HVDC që lidh zonat sinkrone; dhe
    c) ndarja/bashkëveprimi i këtyre funksioneve përgjatë HVDC të shumta ndërmjet zonave sinkrone.

7. Çdo OST lidhëse e rezervës, OST marrëse e rezervës, OST ofruese të aftësinë kontrolluese të rezervës, OST marrëse të aftësisë kontrolluese të rezervës ose OST e prekur të përfshirë në shkëmbimin ose ndarjen e rezervave mund të refuzojnë shkëmbimin ose ndarjen e rezervës nëse do te rezultojnë ne flukse te energjisë qe cenojnë kufijtë e sigurisë operacionale nëse aktivizon kapacitetin rezervë subjekt i shkëmbimit ose ndarjes së rezervës.
8. OST-të e përfshira do të sigurohen që shkëmbimi i rezervave midis zonave sinkrone të mos pengojë asnjë OST të përmbushë kërkesat mbi rezervat në Nenet 153, 157 dhe 160.
9. OST lidhëse e rezervës, OST marrëse e rezervës, OST ofruese e aftësisë kontrolluese të rezervës, OST marrëse të aftësisë kontrolluese të rezervës do të specifikojnë në marrëveshjen e shkëmbimit ose të ndarjes së rezervave rastet kur shkëmbimi ose ndarja e rezervave në zonat sinkrone nuk mund të ekzekutohet në kohë reale.

Neni 172

Bashkimi i frekuencës ndërmjet zonave sinkrone

1. Të gjithë OST-të e zonave sinkrone të lidhura nëpërmjet një interkonektori HVDC do të kenë të drejtën të zbatojnë një proces bashkimi të frekuencës për të siguruar përgjigje të lidhur ndaj frekuencës. Procesi i bashkimit të frekuencës mund të përdoret nga OST-të për të mundësuar shkëmbimin dhe/ose ndarjen e FCR midis zonave sinkrone.
2. Të gjithë OST-të e secilës zonë sinkrone do të specifikojnë projektin teknik të procesit të bashkimit të frekuencave në marrëveshjen operacionale të zonës sinkrone. Procesi i bashkimit të frekuencave duhet të marrë parasysh:

a) impaktin operacional midis zonave sinkron;
b) qëndrueshmërinë e FCP e zonës sinkron;
c) aftësia e OST-ve të zonës sinkrone për përmbushjen e parametrave te synuar të cilësisë së frekuencës të përcaktuar në përputhje me Nenin 127; dhe
d) sigurinë operacionale.

3. Çdo operator interkonektori HVDC do të kontrollojë flukset aktive të energjisë mbi interkonektorin HVDC në përputhje me procesin e implementuar të bashkimit të frekuencës.

Neni 173

Shkëmbimi i FCR midis zonave sinkrone

1. Të gjithë OST-të e një zone sinkrone të përfshirë në një proces bashkimi të frekuencës do të kenë të drejtën të përdorin procesin e shkëmbimit të FCR për të shkëmbyer FCR midis zonave sinkrone.
2. Të gjithë OST-të e zonave sinkrone të përfshira në shkëmbimin e FCR midis zonave sinkrone do të organizojnë shkëmbimin në mënyrë që OST-të e një zone sinkrone të marrin nga një zonë tjetër sinkrone një pjesë të kapacitetit të përgjithshëm rezervë të FCR të kërkuar për zonën e tyre sinkrone sipas Nenit 153.
3. Pjesa e kapacitetit total të rezervës për FCR që kërkohet për zonën sinkrone në të cilën ajo shkëmbehet duhet të sigurohet në zonën e dytë sinkrone krahas kapacitetit total të rezervës me FCR të kërkuar për atë zonë të dytë sinkrone në përputhje me Nenin 153.
4. Të gjithë OST-të e zonës sinkrone do të specifikojnë në marrëveshjen operacionale të zonës sinkrone kufizimet për shkëmbimin e FCR.
5. Të gjithë OST-të e zonave sinkrone të përfshira duhet të hartojnë një marrëveshje shkëmbimi për FCR në të cilën duhet të përcaktojnë kushtet për shkëmbimin e FCR.

Neni 174

Ndarja e FCR midis zonave sinkrone

1. Të gjithë OST-të e një zone sinkrone të përfshirë në një proçes bashkimi të frekuencave do të kenë të drejtën e përdorimit të këtij proçesi për të ndarë FCR midis zonave sinkron.
2. Të gjithë OST-të e zonës sinkrone do të specifikojnë kufijtë për ndarjen e FCR në marrëveshjen operacionale të zonës sinkron, në përputhje me kriteret e mëposhtme:
   a) për zonën sinkrone të EK **<...>,** të gjithë OST-të duhet të sigurojnë që shuma e FCR që sigurohet brenda zonës sinkrone dhe nga zonat e tjera sinkrone si pjesë e shkëmbimit të FCR mbulon të paktën incidentin referues;
   b) **<...>**

3. Të gjithë OST-të e zonave sinkrone të përfshira duhet të specifikojnë kushtet për ndarjen e FCR midis zonave sinkrone të përfshira në marrëveshjet operacionale të zonave sinkrone përkatëse.

Neni 175

Kërkesa të përgjithshme për ndarjen e FRR dhe RR midis zonave sinkrone

1. Në rast të ndarjes së FRR ose RR, OST që ofron aftësinë kontrolluese do të vejë në dispozicion të OST që merr aftësinë kontrolluese një pjesë të kapacitetit të saj rezervë në FRR dhe RR të kërkuara për të përmbushur kërkesat e rezervës për FRR dhe / ose RR që rezultojnë nga rregullat e dimensionimit të FRR / RR të referuara në Nenet 157 dhe 160. OST që ofron aftësinë kontrolluese mund të jetë një:
   a) OST që udhëzon rezervën për kapacitetin e rezervës në FRR dhe RR subjekt i ndarjes së FRR / RR; ose
   b) OST që ka qasje në kapacitetin e vet rezervë në FRR dhe RR, duke iu nënshtruar ndarjes së FRR / RR përmes një procesi të aktivizimit ndërkufitar të FRR / RR, si pjesë e një marrëveshjeje shkëmbimi të FRR / RR.

2. Të gjithë OST-të e një blloku LFC do të specifikojnë në marrëveshjen operacionale të bllokut LFC rolet dhe përgjegjësitë OST që ofron aftësinë kontrolluese, OST që merr aftësinë kontrolluese dhe TSO-së së prekur për ndarjen e FRR dhe RR me OST-të e blloqeve të tjera LFC në zonat sinkron.

Neni 176

Shkëmbimi i FRR midis zonave sinkrone

1. Të gjithë OST-të e çdo zone sinkrone do të specifikojnë në marrëveshjen operacionale të zonës sinkrone një metodë për të përcaktuar kufijtë për shkëmbimin e FRR me zonat e tjera sinkron. Kjo metodë do të marrë parasysh:
   a) impaktin operacional midis zonave sinkron;
   b) stabilitetin e FRP të zonës sinkron;
   c) aftësinë e OST-ve të zonës sinkrone që të përputhet me parametrat e synuar të cilësisë së frekuencës të përcaktuar në përputhje me Nenin 127 dhe parametrat e synuar të FRCE të përcaktuara në përputhje me Nenin 128; dhe
   d) sigurinë operacionale.

2. Të gjithë OST-të e blloqeve LFC të përfshirë në shkëmbimin e FRR midis zonave sinkrone do të organizojnë shkëmbimin në mënyrë që OST-të e një blloku LFC në zonën e parë sinkrone mund të marrin një pjesë të kapacitetit total të rezervës në FRR e kërkuar për bllokun e tyre LFC siç përcaktohet në përputhje me Nenin 157 (1) nga një bllok LFC në zonën e dytë sinkrone.
3. Pjesa e kapacitetit total të rezervës në FRR që kërkohet për bllokun LFC në zonën sinkrone ku ajo shkëmbehet duhet të sigurohet nga blloku LFC në zonën e dytë sinkron, krahas kapacitetit të përgjithshëm rezervë të FRR që kërkohet për atë bllok të dytë LFC në përputhje me Nenin 157 (1).
4. Secili operator i një interkonektori HVDC duhet të kontrollojë flukset mbi interkonektorin e HVDC-së, duke ndjekur udhëzimet e dhëna nga OST ku lidhet rezerva ose OST marrëse të rezervës në përputhje me kërkesat minimale teknike të FRR të përmendura në Nenin 158.

5. Të gjithë OST-të e blloqeve LFC të cilave u përkasin OST-të e lidhura me rezervën dhe OST-të marrëse të rezervës duhet të specifikojë kushtet për shkëmbimin e FRR në një marrëveshje shkëmbimi të FRR.

Neni 177

Ndarja e FRR midis zonave sinkrone

1. Të gjithë OST-të e secilës zonë sinkrone do të specifikojnë në marrëveshjen operacionale të zonës sinkrone një metodologji për të përcaktuar kufijtë për ndarjen e FRR me zonat e tjera sinkrone. Kjo metodologji do të marrë parasysh:
    a) impaktin operacional midis zonave sinkrone;
    b) stabilitetin e FRP të zonës sinkrone;
    c) reduktimin maksimal të FRR që mund të merret parasysh në dimensionimin e FRR në përputhje me Nenin 157 si rezultat i ndarjes së FRR;
    d) aftësinë e zonës sinkrone në përputhje me parametrat e synuar të cilësisë së frekuencës të përcaktuara në përputhje me Nenin 127 dhe parametrat e synuar të FRCE të përcaktuara në përputhje me Nenin 128; dhe
    e) sigurinë operacionale.

2. Të gjithë OST-të e blloqeve LFC të përfshirë në ndarjen e FRR midis zonave sinkrone do të organizojnë ndarjen në mënyrë që OST-të e një blloku LFC në zonën e parë sinkrone mund të marrin një pjesë të kapacitetit total rezervë në FRR të kërkuar për bllokun e tyre LFC siç përcaktohet në përputhje me Nenin 157 (1) nga një bllok LFC në zonën e dytë sinkrone.
3. Secili operator i një interkonektori HVDC duhet të kontrollojë flukset e fuqisë aktive mbi interkonektorin HVDC duke ndjekur udhëzimet e dhëna nga OST që ofron aftësinë kontrolluese dhe OST që merr aftësinë kontrolluese në përputhje me kërkesat minimale teknike të FRR në Nenin 158 (1).
4. Të gjithë OST-të e blloqeve LFC të cilave u përkasin OST-të që ofrojnë aftësinë kontrolluese dhe OST-të që marrin aftësitë kontrolluese duhet të specifikojë kushtet për ndarjen e FRR në një marrëveshje ndarjeje të FRR.

Neni 178

Shkëmbimi i RR midis zonave sinkron

1. Të gjithë OST-të e secilës zonë sinkrone do të përcaktojnë në marrëveshjen operacionale të zonës sinkrone, një metodë për të përcaktuar kufijtë për shkëmbimin e RR me zonat e tjera sinkrone. Kjo metodë do të marrë parasysh:
    a) impaktin operacional midis zonave sinkrone;
    b) qëndrueshmërinë e RRP në zonën sinkrone;
    c) aftësinë e zonës sinkrone për të përmbushur parametrat e synuar të cilësisë së frekuencës të përcaktuar në përputhje me Nenin 127 dhe parametrat e synuar të FRCE të përcaktuar në përputhje me Nenin 128; dhe
    d) sigurinë operacionale.

2. Të gjithë OST-të e blloqeve LFC të përfshirë në shkëmbimin e RR midis zonave sinkrone do të organizojnë shkëmbim në mënyrë të tillë që OST-të e një blloku LFC në zonën e parë sinkrone të mund të marrin një pjesë të kapacitetit total të rezervës së RR të kërkuar, për bllokun e tyre LFC siç përcaktohet në Nenin 160 (2) nga një bllok LFC që gjendet në zonën e dytë sinkrone.
3. Pjesa e kapacitetit total të rezervës së RR që kërkohet për bllokun LFC në zonën sinkrone ku ajo shkëmbehet, duhet të sigurohet nga blloku LFC në zonën e dytë sinkrone, krahas kapacitetit total të rezervës së RR të kërkuar për atë bllok të dytë LFC, në pajtim me Nenin 160 (2).
4. Çdo operator i një interkonektori HVDC duhet të kontrollojë flukset mbi interkonektorin HVDC duke ndjekur udhëzimet e dhëna nga OST ku lidhet rezerva ose OST marrëse e rezervës në përputhje me kërkesat minimale teknike të RR në Nenin 161.
5. Të gjithë OST-të e blloqeve LFC të cilave u përkasin OST-të ku lidhet rezerva ose OST-të marrëse të rezervës duhet të specifikojnë kushtet për shkëmbimin e RR në një marrëveshje shkëmbimi të RR.

Neni 179

Ndarja e RR midis zonave sinkrone

1. Të gjithë OST-të e çdo zone sinkrone do të përcaktojnë në marrëveshjen operacionale të zonës sinkrone një metodë për përcaktimin e kufijve për ndarjen e RR me zona të tjera sinkrone. Kjo metodë do të marrë parasysh:
    a) impaktin operacional midis zonave sinkrone;
    b) qëndrueshmërinë e RRP në zonës sinkrone;
    c) reduktimin maksimal të RR që mund të merret parasysh në rregullat e dimensionimit të RR në përputhje me Nenin 160 si rezultat i ndarjes së RR-së;
    d) aftësinë e OST-ve të zonës sinkrone të përmbushin parametrat e synuar të cilësisë së frekuencës të përcaktuara në përputhje me Nenin 127 dhe aftësinë e blloqeve të LFC-së që të jenë në përputhje me parametrat e synuar të gabimit të FRCE të përcaktuara në përputhje me Nenin 128; dhe
    e) sigurinë operacionale.

2. Të gjithë OST-të e blloqeve LFC të përfshira në ndarjen e RR midis zonave sinkrone do të organizojnë ndarjen në mënyrë të tillë që OST-të e një blloku LFC në zonën e parë sinkrone, të mund të marrin një pjesë të kapacitetit total të rezervës të RR së kërkuara për bllokun e tyre LFC siç përcaktohet në dispozitat e Nenit 160 (2) nga një bllok LFC në zonën e dytë sinkrone.
3. Çdo operator i një interkonektori HVDC duhet të kontrollojë flukset mbi interkonektorin HVDC duke ndjekur udhëzimet e dhëna nga OST që ofron aftësinë kontrolluese ose OST që merr aftësinë kontrolluese në përputhje me kërkesat minimale teknike të RR në Nenin 161.
4. Të gjithë OST-të e secilit bllok LFC të cilave u përkasin OST-të që ofrojnë aftësinë kontrolluese dhe OST-të që marrin aftësinë kontrolluese, duhet të specifikojnë kushtet për ndarjen e RR-së në një marrëveshje për ndarjen e RR-së.

Kapitulli 3

Procesi i aktivizimit ndërkufitar për FRR / RR

Neni 180

Procesi i aktivizimit ndërkufitar për FRR / RR

Të gjithë OST-të e përfshira në aktivizimin ndërkufitar të FRR dhe RR në zonat sinkrone të njëjta ose të ndryshme duhet të përmbushin kërkesat e përcaktuara në Nenet 147 dhe 148.

TITULLI 9

PROÇESI I KONTROLLIT TË KOHËS

Neni 181

Procesi i kontrollit të kohës

1. Objektivi i kontrollit i procesit të kontrollit kohës elektrike do të jetë kontrolli i vlerës mesatare të frekuencës së sistemit në frekuencën nominale.
2. Ku është e aplikueshme, të gjithë OST-të e zonës sinkrone do të përcaktojnë në marrëveshjen e opereracionale të zonës sinkrone metodologjinë për korrigjimin e devijimit të kohës elektrike, i cili duhet të përfshijë:

    a) Diapazonet e kohëzgjatjes brenda të cilave OST-të do të përpiqen të mbajnë devijimin e kohës elektrike;
    b) "pika e punës" e frekuencës për të rikthyer devijimin e kohës elektrike në zero; dhe
    c) veprimet për të rritur ose ulur frekuencën mesatare të sistemit me anë të rezervave të fuqisë aktive;

3. Monitoruesi i zonës sinkrone do të:

    a) monitorojë devijimin e kohës elektrike;
    b) llogarisë madhësinë së pikë së punës të frekuencës; dhe
    c) koordinojë veprimet e procesit të kontrollit të kohës

TITULLI 10

BASHKËPUNIMI ME OSSH

Neni 182

Grupet ofruese të rezervës ose njësitë e lidhura me rrjetin e OSSH

1. OST-të dhe OSSh-të do të bashkëpunojnë në mënyrë që të lehtësojnë dhe mundësojnë shpërndarjen e rezervave të fuqisë aktive nga grupet ofruese të rezervës ose njësitë ofruese të rezervës në sistemin e shpërndarjes.
2. Për qëllimet e proceseve të parakualifikimit për FCR në Nenin 155, FRR në Nenin 159 dhe RR në Nenin 162, çdo OST do të hartojë dhe specifikojë, në një marrëveshje me OSSH ku lidhet rezerva dhe OSSH-të e ndërmjetme, kushtet e shkëmbimit të informacionit të kërkuar për këto procese të parakualifikimit për njësitë ose grupet ofruese të rezervës në sistemin e shpërndarjes dhe për shpërndarjen e rezervave të fuqisë aktive. Proceset e parakualifikimit për FCR në Nenin 155, FRR në Nenin 159 dhe RR në Nenin 162 do të specifikojnë informacionin që duhet të sigurohet nga njësitë ose grupet e mundshme ofruese të rezervës, të cilat përfshijnë:
    a) nivelet e tensionit dhe pikat e lidhjes së njësive ose grupeve ofruese të rezervës;
    b) lloji i rezervave të fuqisë aktive;
    c) kapacitetin rezervë maksimal të ofruar nga njësitë ose grupet ofruese të rezervës në çdo pikë lidhje; dhe
    d) shkallën maksimale të ndryshimit të fuqisë aktive për njësitë ose grupet ofruese të rezervës.
3. Procesi i parakualifikimit do të mbështetet në afatet kohore të rëna dakord dhe rregullat në lidhje me shkëmbimin e informacionit dhe shpërndarjen e rezervave të fuqisë aktive midis OST, OSSH ku lidhet rezerva dhe OSSH-të e ndërmjetme. Procesi i parakualifikimit do të ketë një kohëzgjatje maksimale prej 3 muajsh nga dorëzimi i një aplikimi formal të plotë nga njësia ose grupi ofrues i rezervës.
4. Gjatë parakualifikimit të një njësie ose grupi ofrues të rezervës që lidhet me sistemin e shpërndarjes OSSH, çdo OSSH ku lidhet rezerva dhe çdo OSSH e ndërmjetme, në bashkëpunim me OST, do të ketë te drejtë të caktojë kufizime ose të përjashtojë shpërndarjen e rezervave të fuqisë aktive që ndodhen në sistemin e shpërndarjes, bazuar në arsye teknike si vendndodhja gjeografike e njësive dhe grupeve ofruese të rezervës.
5. Çdo OSSH ku lidhet rezerva dhe çdo OSSH e ndërmjetme do të kenë të drejtë, në bashkëpunim me OST, të vendosë, para aktivizimit të rezervës, kufizime të përkohshme për shpërndarjen e rezervave të fuqisë aktive që ndodhen në sistemin e shpërndarjes. OST respektive dhe OSSH ku lidhet rezerva dhe OSSH-të e ndërmjetme do të bien dakord për procedurat që do të aplikohen.

TITULLI 11
TRANSPARENCA E INFORMACIONIT

Neni 183

Kërkesat të përgjithshme mbi transparencën

1. Të gjitha OST do të sigurojnë që informacioni i listuar në këtë Titull të publikohet në një kohë dhe në një format që nuk krijon një avantazh konkurues aktual ose të mundshëm ose disavantazh për cilëndo palë ose kategori pale dhe duke marrë parasysh si duhet ndjeshmërinë e informacionit tregtar.
2. Çdo OST do të përdorë njohuritë dhe mjetet në dispozicion për të tejkaluar kufizimet teknike dhe për të siguruar disponueshmërinë dhe saktësinë e informacionit të vënë në dispozicion të ENTSO-E në përputhje me Nenin 16 dhe Nenin 185(3).
3. Çdo OST do të sigurojë disponueshmërinë dhe saktësinë e informacionit të vënë në dispozicion të ENTSO-E në përputhje me Nenet 184 deri 190.
4. Të gjithë materialet për publikim të përmendura në Nenet 184 deri 190 do të vihen në dispozicion të ENTSO-E të paktën në Anglisht. ENTSO-E do ta publikojë këtë material në platformën e transparencës së informacionit të krijuar në përputhje me Nenin 3 të Rregullores BE Nr. 543/2013 siç është përshtatur dhe miratuar me Vendimin e Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë 2015/01/PHLG-EnC.

Neni 184

Informacion mbi marrëveshjet operacionale

1. Çdo OST do të ndajë përmbajtjen e marrëveshjes së operacionale të zonës sinkrone me autoritetin rregullator, ose ku është e aplikueshme, me një autoritet tjetër kompetent, jo më vonë së 1 muaj para hyrjes së saj në fuqi.
2. Të gjithë OST-të e secilës zonë sinkrone do të njoftojnë përmbajtjen e marrëveshjes operacionale të zonës sinkrone në ENTSO-E për publikim jo më vonë së 1 javë pas hyrjes së saj në fuqi.
3. Çdo OST e çdo blloku LFC do të ndajë përmbajtjen e marrëveshjes së operacionale të bllokut LFC me autoritetin rregullator, ose ku është e aplikueshme, me një autoritet tjetër kompetent.

Neni 185

Informacion mbi cilësinë e frekuencës

1. Kur OST-të e zonës sinkrone propozojnë të modifikojnë vlerat për parametrat përcaktues të cilësisë së frekuencës ose parametrin e synuar të cilësisë së frekuencës në përputhje me Nenin 127, do të njoftojnë për vlerat e modifikuara në ENTSO-E për publikim të paktën 1 muaj para hyrjes në fuqi të marrëveshjes së operacionale të zonës sinkrone.
2. Nëse zbatohet, të gjithë OST-të e çdo zone sinkrone do të njoftojnë për vlerat e parametrave të synuar të FRCE për çdo bllok LFC dhe secilën zonë LFC tek ENTSO-E për publikim të paktën 1 muaj para aplikimit të tyre.

3. Te gjithë OST-të e çdo zone sinkrone do të njoftojnë për metodologjinë e përdorur për te përcaktuar riskun e shterimit te FCR në ENTSO-E për publikim të paktën 3 muaj përpara aplikimit të marrëveshjes operacionale të zonës sinkrone.
4. Monitoruesi i zonës sinkrone të secilës zonë sinkrone do të njoftojnë për rezultatet e procesit të procesit të aplikimit të kritereve për zonën e tyre sinkrone në ENTSO-E për publikim, brenda 3 muajve pas stampimit të kohës të fundit të periudhës së matjes dhe të paktën katër herë në vit. Këto rezultate duhet të përfshijnë së paku:

   a) vlerat e kritereve të vlerësimit të cilësisë së frekuencës të llogaritur për zonën sinkrone dhe për çdo bllok LFC brenda zonës sinkrone në përputhje me Nenin 133 (3); dhe
   b) rezolucionin e matjes, saktësinë e matjes dhe metodën e llogaritjes, në përputhje me Nenin 132;

5. Të gjithë OST-të e secilës zonë sinkrone do të njoftojnë për periudhën e specifikuar të rampimit, në përputhje me Nenin 136 në ENTSO-E për publikim, të paktën 3 muaj përpara aplikimit të tyre.

Neni 186

Informacion mbi strukturën e kontrollit ngarkesë-frekuencë

1. Te gjithë OST-të e çdo zone sinkrone do të njoftojnë për informacionin në vijim në ENTSO-E për publikim të paktën 3 muaj para aplikimit të marrëveshjes operacionale të zonës sinkrone:

   a) informacionin mbi strukturën e procesit të aktivizimit të zonës sinkrone, duke përfshirë të paktën informacionin mbi zonat e monitorimit, zonat LFC dhe blloqet LFC të përcaktuara dhe OST-të përkatëse; dhe

   b) informacionin mbi strukturën e përgjegjësisë së procesit të zonës sinkrone, duke përfshirë të paktën informacionin mbi proceset e zhvilluara në përputhje me Nenin 140 (1) dhe (2).

2. Të gjithë OST-të që zbatojnë një proces të netimit të disbalancave duhet të publikojnë informacione lidhur me atë proces, i cili duhet të përfshijë të paktën listën e OST-ve pjesëmarrëse dhe datën e fillimit të procesit të netimit të disbalancave.

Neni 187

Informacion mbi FCR

1. Të gjithë OST-të e çdo zone sinkrone do të njoftojnë për qasjen e dimensionimit për FCR për zonën e tyre sinkrone, në përputhje me Nenin 153 (2) tek ENTSO-E për publikim të paktën 1 muaj para aplikimit të saj.
2. Kur është e aplikueshme, te gjithë OST-të e çdo zone sinkrone do të njoftojnë sasinë totale të kapacitetit rezervë të FCR dhe ndarjen e kapacitetit rezervë të FCR të kërkuar

për secilin OST të specifikuar në përputhje me Nenin 153(1) si detyrim fillestar i FCR, në ENTSO-E për publikim të paktën 1 muaj para aplikimit të tyre.

3. Të gjithë OST-të e çdo zone sinkrone do të dërgojnë vetitë e FCR të përcaktuara për zonat e tyre sinkrone në përputhje me Nenin 154 (2) dhe kërkesat shtesë për grupet ofruese të FCR në përputhje me Nenin 154 (3), në ENTSO-E për publikim të paktën 3 muaj para aplikimit të tyre.

Neni 188

Informacioni mbi FRR

1. Të gjithë OST-të e çdo blloku LFC duhet të njoftojnë kërkesat e disponueshmërisë së FRR dhe kërkesat për cilësinë e kontrollit të specifikuara në përputhje me Nenin 158(2) si dhe kërkesat teknike për lidhjen të specifikuara në përputhje me nenin 158 (3) për bllokun e tyre LFC, në ENTSO-E për publikim të paktën 3 muaj para aplikimit të tyre.
2. Të gjithë OST-të e çdo blloku LFC do të njoftojnë rregullat e dimensionimit të FRR të specifikuara për bllokun e tyre LFC në përputhje me Nenin 157 (1) në ENTSO-E për publikim të paktën 3 muaj para hyrjes në fuqi të marrëveshjes së operacionale të bllokut LFC.
3. Të gjithë OST-të e çdo zone sinkrone do të njoftojnë, deri më 30 nëntor të çdo viti, një parashikim të kapaciteteve rezervë të FRR të secilit bllok LFC për vitin e ardhshëm, në ENTSO-E për publikim.
4. Të gjithë OST-të e çdo zone sinkrone do të njoftojnë, brenda 30 ditëve pas përfundimit të tremujorit, kapacitetet rezervë aktuale të FRR të çdo blloku LFC të tremujorit të fundit, në ENTSO- E për publikim.

Neni 189

Informacioni mbi RR

1. Të gjithë OST-të e çdo blloku LFC që operojnë një proces të zëvendësimit të rezervës duhet të njoftojnë kërkesat e disponueshmërisë së RR të përcaktuara në përputhje me Nenin 161 (2) dhe kërkesat teknike për lidhjen të specifikuara në përputhje me Nenin 161(3) për bllokun e tyre LFC të disponueshëm për ENTSO-E për publikim brenda 3 muajve para zbatimit të tyre.

2. Të gjithë OST-të e çdo zone sinkrone do të njoftojnë, deri më 30 nëntor të çdo viti, një parashikim të kapaciteteve rezervë të RR të secilit bllok LFC për vitin e ardhshëm, në ENTSO-E për publikim.

3. Të gjithë OST-të e çdo zone sinkrone do të njoftojnë, brenda 30 ditëve pas përfundimit të tremujorit, kapacitetet rezervë aktuale të RR të secilit bllok LFC të tremujorit të fundit të ENTSO- E për publikim.

Neni 190

Informacioni mbi ndarjen dhe shkëmbimin

1. Të gjithë OST-të e çdo zone sinkrone do të njoftojnë përmbledhjet vjetore të marrëveshjeve për ndarjen e FRR dhe për ndarjen e RR për çdo bllok LFC brenda zonës sinkrone tek ENTSO-E për publikim në përputhje me Nenet 188 (3) dhe 189 (2). Këto përmbledhje duhet të përfshijnë informacionin e mëposhtëm:

   a. identitetin e blloqeve LFC ku ka një marrëveshje për ndarjen e FRR ose RR; dhe

   b. pjesën e FRR dhe RR që reduktohet për shkak të çdo marrëveshjeje për ndarjen e FRR ose RR.

2. Të gjithë OST-të e secilës zonë sinkrone do të njoftojnë informacionin për ndarjen e FCR midis zonave sinkrone, në ENTSO-E për publikim në përputhje me Nenin 187 (1). Ky informacion duhet të përfshijë:

   a. sasinë e kapacitetit rezervë të FCR të ndarë midis OST-ve që kanë hyrë në marrëveshje për ndarjen e FCR; dhe

   b. efektet e ndarjes së FCR në kapacitetin rezervë të FCR të OST-ve të përfshira.

3. Aty ku është e aplikueshme, të gjithë OST-të do të publikojnë informacionin për shkëmbimin e FCR, FRR dhe RR.

PJESA V
DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 191

Ndryshimet në kontrata dhe termat dhe kushtet e përgjithshme

Të gjitha dispozitat respektive në kontratat dhe kushtet e përgjithshme të OST-ve, OSSh-ve dhe përdoruesve të rëndësishëm të rrjetit në lidhje me operimin e sistemit duhet të jenë në përputhje me kërkesat e kësaj Rregulloreje. Për këtë shkak, kontratat dhe termat dhe kushtet e përgjithshme do të modifikohen në përputhje rrethanat.

Neni 192

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi me miratimin e saj nga Enti Rregullator i Energjisë.

ANEKSI I

<...>

ANEKSI II

Nivelet e tensionit sipas Nenit 27:

Tabela 1

Niveli i Tensionit në pikën e lidhjes ndërmjet 110 kV dhe 300 kV

Zona sinkrone	Niveli i tensionit
Evropa Kontinentale	0,90 pu-1,118 pu

Tabela 2

Niveli i Tensionit në pikën e lidhjes ndërmjet 300 kV dhe 330 kV

Zona sinkrone	Niveli i tensionit
Evropa Kontinentale (Moldavia dhe Ukraina)	0,90 pu-1,1 pu
Evropa Kontinentale (të tjerat)	0,90 pu-1,05 pu

Tabela 3

Niveli i Tensionit në pikën e lidhjes ndërmjet 300 kV dhe 400 kV(750 kV për Ukrainën)

Zona sinkrone	Niveli i tensionit
Evropa Kontinentale	0,90 pu-1,05 pu

ANEKSI III

Parametrat përcaktues të cilësisë së frekuencës referuar Nenit 127:

Tabela 1

Parametrat e përcaktimit të cilësisë së frekuencës së zonave sinkrone

-	Evropa Kontinentale
diapazoni i frekuencës standarde	± 50 mHz
devijimi maksimal i menjëhershëm i frekuencës	800 mHz

devijimi maksimal i frekuencës në gjendje të qëndrueshme	200 mHz
koha e rikuperimit të frekuencës	nuk përdoret
diapazoni i rikuperimit të frekuencës	nuk përdoret
koha për rivendosjen e frekuencës	15 minuta
diapazoni i rivendosjes të frekuencës	nuk përdoret
koha e aktivizimit së gjendjes alarmit	5 minuta

Parametrat e synuar të cilësisë së frekuencës sipas përcaktimeve të Nenit 127:

Tabela 2

Parametrat e synuar të cilësisë së frekuencës së zonave sinkrone

-	Evropa Kontinentale
numri maksimal i minutave jashtë diapazonit të frekuencës standarde	15 000

ANEKSI IV

<...>

ANEKSI V

Kërkesat minimale teknike të FCR referuar Nenit 154:

Tabelë

Karakteristikat e FCR në zonat e ndryshme sinkrone

Saktësia minimale e matjes së frekuencës	EK	10 mHz ose standardi industrial nëse është më i mirë
Ndikimi maksimal i kombinuar i mos ndjeshmërisë së natyrshme të përgjigjes ndaj frekuencës dhe zonës së mundshme të pandjeshme të qëllimshme të përgjigjes së frekuencës të rregullatorit të njësive ofruese të FCR ose grupeve ofruese të FCR.	EK	10 mHz
Koha e aktivizimit të plotë FCR	EK	30 s
Devijimi i frekuencës së aktivizimit të plotë të FCR	EK	± 200 mHz

ANEKSI VI

Kufijtë dhe kërkesat për shkëmbimin e FCR, referuar Nenit 163:

Tabelë

Kufizimet dhe kërkesat për shkëmbimin e FCR

Zona Sinkrone	Shkëmbimi i FCR lejohet midis:	Kufinjtë për shkëmbimin e FCR
Zona Sinkrone EK	OST-të e blloqeve LFC fqinje	o OST-të e një blloku LFC duhet të sigurojnë se të paktën 30% e detyrimeve fillestare të FCR së tyre totale të kombinuar, ofrohen fizikisht brenda bllokut të tyre LFC; dhe o sasia e kapacitetit rezervë të FCR, e vendosur fizikisht në një bllok LFC si rezultat i shkëmbimit të FCR me blloqe të tjera LFC, do të kufizohet në maksimumin e: ▪ 30% të detyrimeve totale të kombinuara fillestare të FCR të OST-ve të bllokut LFC në të cilin kapaciteti rezervë i FCR është i lidhur fizikisht; dhe ▪ 100 MW e kapacitet rezervë të FCR.
	OST-të e zonave LFC të të njëjtit bllok LFC	o OST-të e zonave LFC që përbëjnë një bllok LFC do te kenë të drejtë të specifikojnë në marrëveshjen e operacionale të bllokut LFC kufizime të brendshme për shkëmbimin e FCR midis zonave LFC të të njëjtit bllok LFC në mënyrë që të: ▪ shmangen kongjestionet e brendshme në rast të aktivizimit të FCR; ▪ sigurohet një shpërndarje e barabartë e kapacitetit rezervë të FCR për rastin e ndarjes së rrjetit; dhe ▪ shmanget cënimi i qëndrueshmërisë së FCP ose sigurisë së operacionale
Zonat e tjera Sinkrone	OST-të e Zonave të tjera Sinkrone	OST-të e zonës sinkrone do te kenë të drejtë të specifikojnë në marrëveshjen operacionale të zonës sinkrone kufinjtë për shkëmbimin e FCR-së në mënyrë që: - të shmangin kongjestionet e brendshme në rast të aktivizimit të FCR; - të sigurojë një shpërndarje të barabartë të FCR në rast të ndarjes së rrjetit; dhe - të shmangin që stabiliteti i FCP-së ose i sigurisë operacionale të ndikohet.

ANEKSI VII

Kërkesat dhe kufinjtë për shkëmbimin e FRR brenda zonës sinkrone referuar Nenit 167:

Tabelë

Kërkesat dhe kufijtë për shkëmbimin e FRR brenda një zone sinkrone

Zona sinkrone	Shkëmbimi i FRR lejohet midis	Kufijtë për shkëmbimin e FRR
Të gjitha zonat sinkrone që përbëhen nga më shumë së një bllok LFC	OST të blloqeve LFC të ndryshme	- OST-të e një blloku LFC do të sigurojnë se të paktën 50% e kapacitetit rezervë të përgjithshëm të kombinuar të tyre në FRR, që rezulton nga rregullat e dimensionimit të FRR në Nenin 157 (1) dhe para çdo reduktimi për shkak të ndarjes së FRR në përputhje me Nenin 157 (2) mbetet e vendosur brenda bllokut të tyre LFC.
	OST të zonave LFC të njëjtit bllok LFC	- OST-të e zonave LFC që përbëjnë një bllok LFC do të kenë të drejtë, nëse është e nevojshme, të përcaktojnë kufizime të brendshme, për shkëmbimin e FRR midis zonave LFC të bllokut LFC në marrëveshjen e operacionale të bllokut LFC që të: ▪ pengohen kongjestionet e brendshme për shkak të aktivizimit të kapacitetit rezervë të FRR, subjekt i shkëmbimit të FRR; ▪ sigurohet një shpërndarje e barabartë e FRR në të gjithë zonën sinkrone dhe blloqet LFC në rast të ndarjes së rrjetit; ▪ shmanget cënimi i qëndrueshmërisë së FRP ose sigurisë së operimit.

ANEKSI VIII

Kërkesat dhe kufijtë për shkëmbimin e RR brenda zonës sinkrone, referuar Nenit 169:

Tabelë

Kërkesat dhe kufijtë për shkëmbimin e RR brenda zonës sinkrone

Zona sinkrone	Shkëmbimi i RR	Kufizimet për shkëmbimin e RR
Të gjitha zonat sinkrone që përbëhen nga më shumë së një bllok LFC	OST të blloqeve LFC të ndryshme	○ OST-të e zonave LFC që përbëjnë një bllok LFC duhet të sigurojnë se të paktën 50% e kapacitetit rezervë total të tyre të kombinuar të RR që rezulton nga rregullat e dimensionimit të RR sipas Nenit 160 (3) para çdo reduktimi të kapacitetit rezervë të RR si rezultat i ndarjes së RR sipas Nenit 160 (4) dhe nenit 160 (5), mbetet brenda bllokut të tyre LFC.

	OST të zonave LFC të të njëjtit bllok LFC	○ OST-të e zonave LFC që përbëjnë një bllok LFC do të kenë të drejtë, nëse kërkohet, të përcaktojnë kufizime të brendshme për shkëmbimin e RR midis zonave LFC të bllokut LFC në marrëveshjen e operacionale të bllokut LFC që të: ▪ shmangen kongjestionet e brendshme për shkak të aktivizimit të kapacitetit rezervë të RR, subjekt i shkëmbimit të RR; ▪ sigurohet një shpërndarje e barabartë e RR në të gjithë zonën sinkrone në rast të ndarjes së rrjetit; dhe ▪ shmanget cënimi i qëndrueshmërisë së FRP ose sigurisë së operimit